

Qershor 2022

Nr.17

UMSH

EURO MEDITERRANEAN

Kriza e Coronavirusit: Sfidat dhe efektet ekonomiko-sociale të saj
në nivel global dhe Shqipëri. Cfarë do të ndodhë?

Teori e politika ekonomiko-financiare

26 qershor 2020



Bordi i Nderit

- 1.Akademik, Prof.Dr.Anastas Angjeli
- 2.Mr. Michael D. Granoff,
- 3.Prof. Nicholas Theodorakoulos
- 4.Prof. Stefano UBERTINI
- 5.Prof. Antonio Felice Uricchio
- 6.Prof.Dr.Adrian Civici

Bordi editorial

Kryetar

Akademik, Prof.Dr.Anastas Angjeli

Anëtarë:

- Prof.Dr.Ksenofon Krisafi
Prof.Dr.Dhimitër Tole
Prof.Dr.Sulo Hadëri
Prof.asoc.Greta Angjeli
Prof.asoc.Nevila Rama
Prof.asoc.Niko Pano
Prof.asoc.Përparim Kabo
-

Bordi shkencor:

- Prof.asoc.Ira Gjika
Prof.asoc.Roland Lami
Prof.asoc.Orkida Ilollari
Prof.asoc. Altin Hoti
Prof.asoc.Teuta Xhindi
Prof.asoc. Alqi Naqellari
Prof.asoc.Nevila Xhindi
Ph.D.Emilio Cika
Ph.D.Kriton Kuci
PhD.Fiona Tako
Phd. Besmir Premalaj
MSc.Eros Angjeli
Dr.Rudina Qurku
Dr.Redion Luli
Dr.Klodiana Rafti

Kryeredaktor : Prof.Dr.Adrian Civici

Drejtori organizativ : Msc.Illir Hebovija

Redaktorë teknikë:

- Elona Shehu
Morena Boja
Luljeta Kodra
Gilda Hoxha
Eni Nasi

Pasqyra e lëndës

Pandemia e covid-19 dhe mendimi ekonomik në ndryshim
Akademik, Prof. Dr. Anastas Angjeli

“Lufta” e profesioneve në periudhën e pandemisë dhe post-pandemisë Covid-19
Akademik i Asociuar, Prof.Dr.Adrian CIVICI

Skenarët dhe risqet e politikave ekonomike gjatë krizës Covid-19
Prof.asoc.Dr. Nikollaq Pano
Prof.asoc.Dr. Ira Gjika
MSc. Eros Angjeli

Blllokimi i aktivitetit ekonomik gjatë pandemisë Covid-19 dhe detyrimi për raportimin financiar
Msc.Sonila Nikolla
Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë
sonila.nikolla@umsh.edu.al
Prof. As. Greta Angjeli

Avantazhi i ekonomive mikse ndaj ekonomivce të tregur në përballikmin e pasojave negative të Covid-19
Prof.asoc. Dr.Alqi Naqellari
Dr.Vladimir Mici

Paketa mbështetëse për përballimin e krizës në Itali
Prof.asoc.Dr. Orkida Ilollari

Ekonomia post-normale : drejt një revolucioni de-globalist?
Dr. Florjan Bombaj
Dr. Valter Hoxha
Dr. Majlinda Shehu

COVID-19 - një nxitës për transformimin dixhital
Prof. As. Nevila Xhindi
PhD Vebina Resuli
Msc.Erdet Lalaj

Roli i teknologjisë në menaxhimin e situatës pandemike të Covid-19
Prof.asoc.Dr. Teuta Xhindi
Dr. Olgerta Idrizi

Transformimi dixhital dhe roli i tij në teknologjinë e informacionit
MSc.Grigorina Boce
MSc.Elektra Myrto

Politikat ekonomike në ndihmë të SME-ve përballë Covid-19 – Përvoja dhe sygjerime
Prof.asoc.Dr. Ira Gjika
Dr. Rudina Qurku

Kriza e Koronavirusit, efektet e tij në ekonomi
Dr.Florenca Gjorduni

Politikat makroekonomike të aplikuara për daljen nga kriza sanitare Covid-19 – rast studimi, Kanada, Japoni, Koreja e Jugut

Dr. Valter Hoxha

Dr. Florjan Bombaj

Dr. Majlinda Shehu

Pandemia – turizëm apo viza-tour?

MSc. Armelina Lila (Fushekati)

Dr. Ferjolt Ozuni

Si, sa dhe çfarë ndikimi pati Covid-19 në ekonominë britanike

MSc.Elona Shehu

Qëndrueshmëria e borxhit publik në kohën e Covid-19

Msc. Ina Shehu

Impakti ekonomik i Covid-19 dhe e ardhmja e sipërrmarjes

MSc.Ardita Hykaj

Kriza e koronavirusit, politikat monetare dhe sektori bankar në Shqipëri

Msc Elia Botka

Pandemia e covid-19 dhe mendimi ekonomik në ndryshim

Akademik, Prof. Dr. Anastas Angjeli
anastas.angjeli@umsh.edu.al
Msc. Jona Marashi
Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë
jona.marashi@umsh.edu.al

Përmbledhje

Me kalimin e kohës po vërtetohet çdo ditë e më shumë se pandemia e Covid-19 është ngjarja më e madhe historike e 30 viteve të fundit, që po sjell ndryshime social ekonomike në gjithë botën. Si bazat teorike, ashtu dhe në politikat ekonomike po i nënshtrohet transformimeve rrënjësore dhe pikërisht këto ndryshime janë objekt i këtij punimi. Në të analizohen në aspektin teorik dhe praktik efektet e pritshme të politikave të përdorura, për kapërcimin e kësaj situatë. Vend të veçante zënë ndryshimet në raportet ekonomike të fuqive botërore, ndryshimi e modeleve të zhvillimit në përgjithësi dhe të sistemeve ekonomike në veçanti.

Në aspektin e metodikës së studimit, punimi mundohet të vërtetojë statistikisht pasojat e përdorimit të levave ekonomike në ekonomitë e vendeve më të zhvilluara, ndryshimet në tregun e punës, efektet e mikroklimës ekonomike të çdo vendi si dhe rolin e grupimeve ekonomike të organizatave ndërkombëtare në kapërcimin e pasojave të pandemive. Ai evidenton caqet e parashikimeve makroekonomike, format e reja të vlerësimit të risqeve të zhvillimit, rolin e digjitalizimit në ekonomi, ristrukturimin e tregut shëndetësor, etj.

Në konkluzionet dhe diskutimet e punimit, mundohemi t'i japim përgjigje pyetjeve: A jemi përpara ndryshimeve epokale? A po ndryshon roli i Bankave Qendrore? Borxh, Deficit apo Inflacion? Si do zgjidhet problem i papunësisë dhe kush janë ndryshimet e tregut të punës? A do ndryshojë modeli ekonomik i zhvillimit? A do të kemi një "Revolucion" apo thellim të pabarazisë sociale.

Fjalë kyç : mendimi ekonomik; teoritë ekonomike; Roli i Bankave Qendrore; Borxhi publik; Papunësia, tregu i punës.

Abstract

With the passing of the time, we have more evidence and it is being proven that the Covid-19 pandemic is the biggest historical event causing major social and economic changes throughout the world. Economic theories and policies are undergoing thorough transformations and this article focuses especially on them.

This article addresses the expected outcomes of policies implemented for overcoming such situation at both theoretical and practical levels. Special emphasis is placed on changes to economic relations of big global powers, changes to development models, and especially to changes of economic systems.

Regarding the methodology, this article strives to statistically prove the effects of economic instruments in the economies of the most developed countries, changes to the labor markets, effects of economic micro climate of every country as well as the role of the economic groups of international organizations for overcoming the consequences of the pandemics. The article evidences the limits of the macroeconomic forecasts, new ways of development risk assessment, the role of digitalization on the economy, restructuring of the markets in the health sector, etc.

As a conclusion, answers have been provided for the following questions: "Are we facing epochal changes? Is the role of Central banks changing? Debt, Deficit, or Inflation? How to face the issue of unemployment and what are the changes to the labor markets? Is the economic development model going to change? Will we have a "Revolution" or a deepening of social inequity?"

Keywords: economic thinking; economic theories; The role of Central Banks; Public debt; Unemployment, labor market.

Përhapja e Koronavirusit ekonomikisht nuk mund të klasifikohet vetëm si një tronditje e kërkesës, e ofertës apo të dyjave njëkohësisht, por dhe një ristrukturim rrënjësor në mënyrën e konceptimit ekonomik. Ndikimi i Koronavirusit në ekonomi është shumë i madh, duke marrë parasysh shkallën e përhapjes së kësaj pandemie dhe dobësinë e strukturës ekonomike të çdo shteti (Kickbusch & Leung 2020).

Recesioni, virtualizimi i komunikimit dhe nevoja në rritje e tij, mund të detyrojë shtetet dhe organizatat ndërkombëtare të forcojnë bashkëpunimin në shkallë globale, rajonale dhe vendore. Nga ana tjetër, tendencat e de-globalizimit, të cilat pavarësisht se mund të jenë në stadet e tyre fillestare (Kozlov & Sokolova, 2020), po kushtëzojnë faktorë që riformatojnë bashkëpunimin ekonomik, kooperimin ndërkombëtar dhe lëvizjen e lirë të njerëzve.

Në mendimin ekonomik, shumë autorë po i quajnë këta elementë "post-normal", për të treguar se rrugët për zgjidhjen e enigmave të shkencës normale nuk janë më të përshtatshme si më parë. Kjo për shkak të sjelljeve të reja konsumatore, për shkak të konceptimit virtual të realitetit, inteligjencës artificiale, etj., por mbi të gjitha për shkak të pasigurive natyrore dhe ekzistenciale të racës njerëzore (Funtowicz & Ravetz, 1995).

Ndoshta është ende shumë shpejt të japim receta e formula për politikat ekonomike dhe efektet e tyre, por në të njëjtën kohë, vlerësimi i rreziqeve të kësaj krize në aspektin ekonomik, duhet të jetë shumëdimensional. Kjo situatë mund të na bëjë të vetëdijshëm për gjërat thelbësore të jetës së përditshme dhe njëkohësisht të na ndihmojë të rishikojmë modelin tonë të prodhimit dhe konsumit që sundonte deri më sot.

1. Kuadri teorik dhe një vështrim i shkurtër historik

Pandemia e COVID -19 dhe kriza ekonomike që ka përfshirë mbarë botën kanë nxitur debatin e mendimit ekonomik. Shumë çështje themelore po vihen në diskutim. Krizat janë shoqëruar me ndryshim dhe evoluim të mendimit ekonomik, veçanërisht të modeleve makroekonomike. Vetë makroekonomia e ka zanafillën në vitin 1936 me publikimin "The General Theory of Employment, Interest and Money" të John Maynard Keynes-it. Historia, që pasoi mbrapa mund të ndahet në tri epoka:

Epoka e Strategjisë, që u drejtua nga idetë e Keynes-it, filloi në vitet 1940.(rol i madh i shtetit në ekonomi).

Epoka e dytë fillon në vitet 1970 dhe kjo epokë u karakterizua nga problematika të zhvillimit dhe të rritjes së rendimentit të punës, që nuk po gjenin zgjidhje. Kështu "Modeli Keynesian u rrëzua" në fillim të viteve 1970. Inflacioni gjithnjë e në rritje dhe niveli i lartë i papunësisë i asaj dekade, i njohur si "stagflation", i hutoi ekonomistët racionalë, të cilët mendonin se të dyja ndryshoret lëviznin thuajse përherë në kahe të kundërta.

Në vitet 1980, filloi epoka e tretë e teorive ekonomike e quajtur Epoka Monetariste. Kjo u lidh ngushtë me teorinë e Milton Friedman-it, i cili drejtoi teorikisht kalimin nga Kejsianizmi në Monetarizëm. Thelbi i kritikës së Friedman-it ndaj modelit Keynesian kishte të bënte me faktin se, nëse politikëbërësit përpiqeshin të stimulonin pa u përballur me deficite strukturore, atëherë ata do të rrisin inflacionin pa ulur papunësinë. Kjo tashme ishte e provuar prandaj, teoricienët e politikëbërjes ekonomike ishin në kërkim të diçkaje të re.

Idetë monetariste të viteve 1980 frymëzuan Paul Volcker-in, që në atë kohë ishte drejtues i bankës Federal Reserve, i cili vendosi ta luftonte inflacionin me anë të normave të interesit për të arritur një "ekuilibrin natyral të tregut të kapitaleve". Pavarësisht se kjo shkaktoi një recesion që solli një rritje marramendëse të numrit të papunësisë politika monetare e shtrënguar luftoi inflacionin dhe me kalimin e kohës, SHBA-ja filloi të realizojë kompaktësinë fiskale dhe

kontrollin e borxhit shtetëror. Fill pas kësaj filloi një periudhe rritje ekonomike, me të ashtuquajturat politika të Regano-ekonomisë.

Nga vitet 1990 derri në vitet 2000, u shfaq një sintezë e modelit Keynesian dhe atij Friedman. Synimi qendror i këtyre politikave të kombinuara ishte arritja e një inflacioni të ulët dhe të qëndrueshëm, për të vendosur një ekuilibër të ri në tregun e punës dhe njëkohësisht, duke zhvilluar një internacionalizim të ekonomisë në aspektin e lëvizjes së kapitaleve.

Leva kryesore e politikave ekonomike ishte rritja dhe ulja e normave afatshkurta të interesit, rritja e numrit të transaksioneve ekonomike me zhvillimet e tregut financiar dhe mbi të gjitha privatizimet masive të pronave publike. Pavarësia e Bankave Qendrore nga qeveritë siguronte që ato të mos binin në kurthet e inflacionit, për të cilat kishte paralajmëruar Friedman. Politika fiskale, si një mënyrë për të menaxhuar ciklin e biznesit, ishte lehtësuese dhe të ardhurat kompensoheshin nga privatizimet. Detyra e politikës ishte që ta mbante borxhin publik të ulët dhe të rishpërndante të ardhurat në atë shkallë dhe në atë mënyrë, që të siguronte një dinamike të qëndrueshme të paqes sociale. Ishte koha e privatizimit të pronës publike dhe e liberalizimit të transaksioneve financiare. Jean-Baptiste Say u ringjall në forma të reja në një epokë të re.

Si pasojë ekonomia botërore pati një periudhe zhvillimi, që stimulohej nga normat e ulta të interesit, nga rritja e tregut financiar dhe transaksioneve financiare dhe mbi të gjitha nga një kreditim i çfrenuar për konsum dhe të patundura. Njerëzit filluan të jetojnë mbi mundësitë e tyre me anë të kreditimit dhe dalëngadalë zhvillimi po kthehej në një flluske financiare. Po dukej në horizont se ky model ekonomik dominues i kishte arritur limitet e veta.

Krizës financiare të viteve 2007-2009 vërtetoi se mungesa e kontrollin mbi institucionet financiare, tendenca njerëzore për të jetuar mbi nivelin e mundësive personale dhe liberalizmi ekstrem; i transaksioneve financiare krijonin flluska të mëdha në sistemet e kreditimit. Kjo gjendje i vuri politikëbërësit të përballëshin me dy probleme të mëdha:

Problemi i parë, kishte të bënte me nivelin e kërkesës në ekonomi. Për të evituar falimentimin e bankave të nivelit të dytë, bankat qendrore ulën normat e interesit dhe përdorën "Masat e Lehtësimit Sasior" (LS), rriten sasinë e parave për të blerë obligacione shtetërore në portofolat e bankave dhe për pasojë dhe likuiditetet në ekonomi. Por, edhe me politika të posaçme monetare, rimëkëmbja nga kriza 2008 ishte e ngadaltë dhe mori një kohë të gjatë. Rritja e GDP-së ishte e dobët dhe fundi i viteve 2010 vuri në dyshim njohuritë në lidhje me mënyrën e përdorimit të levave financiare në drejtimin e ekonomisë.

"Masat e Lehtësimit Sasior" ishte një mjet alternativ i politikave për kapërcimin e problematikave, por efektshmëria e saj u bë objekt diskutimesh sidomos në ndikimin e rritjes së prodhimit. Pasoja direkt e kësaj krize ishte se normat e interesit kaluan nën zero dhe nuk kishin më efekt në rritjen e kredive dhe zhvillimin e ekonomisë.

Problemi i dytë, pas krizës financiare të vitit 2008 lidhet me rishpërndarjen e të ardhurave dhe konsumet e popullsisë. Ndërsa shqetësimet që lidheshin me kostot e globalizimit, dhe automatizmin, ndihmuan në përkrahjen e politikave populiste, ekonomistët pyesnin se për interesat e kujt po punonte kohët e fundit kapitalizmi.

Rritja e papritur e pabarazisë amerikane, u vu në qendër të studimeve ekonomike. U evidentua shqetësimi se mos firmat e mëdha ishin bërë tej mase të fuqishme dhe sundonin edhe politikëbërësit. Të tjerët druheshin se mos një shoqëri e globalizuar ishte tej mase dominues dhe rritja e diferencimit social në përmasa të papara ndonjëherë pas Luftës së Dytë Botërore ishte kërcënim për zhvillimin e kapitalizmit.

U shfaqën kështu argumente dhe statistika, se rritja ekonomike strukturalist e dobët dhe keq-shpërndarja e përfitimeve të aktivitetit ekonomik, po çonin në një polarizim shumë të madh të shoqërisë dhe për pasojë dhe ndryshimin e politikave të konsumit. Vërtetohet se të pasurit ishin më të prirur të kursejnë se sa të shpenzojnë, pra nëse shpërndarja e të ardhurave rritet bashke me polarizimin social atëherë edhe kursimet e përgjithshme rriten, por nuk rritet konsumi. Rënia e konsumit nuk stimulon prodhimin dhe për pasojë kishin tendenca në rënie dhe kërkesat për kreditim.

Ky fenomen përkoi në kohë me politikën për të evituar falimentimet shtetërore si pasojë e krizës së borxhit publik në katër vende evropiane, por dhe në Brazil dhe Argjentinë. Kur këto probleme po përballoheshin nga politikën e institucioneve më të rëndësishme ndërkombëtare në vitet 2018-19 lindi problemi i luftës tregtare midis SHBA dhe Kinës, dhe në kulmin e saj filloi dhe pandemia. Kurrë në ekonominë botërore nuk kishte kaq shumë faktorë që po vepronin njëkohësisht. Kaosi dhe padija filluan të sundojnë në treg dhe risku ekonomik mori përmasa sociale.

Hymë kështu, në epokën e ndryshimeve epokale, që vetëm luftërat dhe krizat pas tyre i sollën njerëzimit. Pandemia ishte fillimi i ndryshimeve ekonomike sociale dhe politike, që do të duhet të bëjë njerëzimi për trevjeçarën 2020-2023.

Kjo analizë vë në qendër të vëmendjes disa nga pyetjet më të rëndësishme, që shumë studiues po shtrojnë në kushtet e reja ekonomike në kulmin e pandemisë :

- A jemi përpara ndryshimeve epokale?
- A po ndryshon roli i Bankave Qendrore?
- Borxh dhe Deficit apo Inflacion?
- Si do zgjidhet problemi i papunësisë dhe kush janë ndryshimet e tregut të punës?
- A do ndryshojë modeli ekonomik i zhvillimit? etj., janë objekt diskutimi në këtë punim.

Metodologjia e kërkimit e përdorur, pasqyron një përmbledhje të literaturës, përdor përpunimin statistikor të shumë të dhënave për vendet më të zhvilluara perëndimore, studion të dhënat makroekonomike për Shqipërinë.


Ne po përfjetojmë një përmblytje të opinionit publik me informacione për efektet ekonomike të pandemisë. Vlerësimi i ndikimit të këtyre politikave ekonomike është funksion i pasigurisë dhe se duhet të jetë shumëdimensional, por përzgjedhja e mendimit ekonomik dhe vlerësimi i tij ka kritere objektive dhe përgjegjësi sociale.

a) A jemi përpara ndryshimeve epokale?

Coronavirus godet papritur gjithë botën dhe dëshira për investim ka rënë ndjeshëm në një kohë që njerëzit e vendeve të pasura, janë duke kursyer sot shumicën e të ardhurave të tyre. Investimet janë pothuajse zero. Rënia e njëkohshme e kërkesës dhe ofertës nuk mund të krijojë një reaksion që njëra të ndikojë tek tjetra. Kështu teoria e kërkesës dhe ofertës në treg filloi të zëvendësohet nga ajo e transaksionit.

Mësimi kryesor ekonomik i pandemisë është se asgjë nuk do të jetë si më parë sepse kurrë nuk kishin një rënie kaq të madhe. Ne figurën e mëposhtme në krahun e majtë po shohin rënien ekonomike botërore nga kriza e vitit 1974. Le të shohim në krahun e djathtë ndryshimin e forcave ekonomike në tregun botëror deri në fund të viti 2024.

Niveli i krizave botërore nga viti 1974



Ndryshimet e GDP në vendet kryesore nga viti 1992



Në këtë kontekst ndryshon dhe analiza e funksionimit të ekonomisë që nuk mbështetet më tek oferta dhe kërkesa, por, tek koncepti i transaksionit ekonomik. Transaksioni nuk është gjë tjetër veçse një akt shitblerjeje në treg që plotëson nevojat e dy palëve.

Një ekonomi pa transaksione, si ajo që është sot në kushtet e pandemisë, do të shoqërohet në vazhdimësi nga falimentime, ristrukturime, ndryshime të modeleve të biznesit dhe lindja me

vështirësi e bizneseve të reja. Baza e çdo transaksioni është plotësimi i nevojave të reja me produkte të reja. Tërësia e transaksioneve të natyrave të njëjta përbëjnë një treg dhe tërësia e tregjeve gjithë ekonominë.

Që të rritet ekonomia, duhet të rriten transaksionet dhe që të rriten transaksionet, duhet të rriten sipërmarrjet. Kështu marrëdhëniet midis punës dhe kapitalit po zëvendësohen tërësisht nga marrëdhëniet midis sipërmarrjes dhe produktit të punës. Kjo do të sjellë pasojë të padiskutueshme në tregun e punës, tregjet e kapitaleve dhe mbi të gjitha në raportet njerëzore. Mësimi i dytë, që solli pandemia është ajo midis pasurisë nga njëra anë; sigurisë dhe qetësisë ekzistenciale nga ana tjetër. Në një moment historik, paraja si kapital dhe paraja si element i pasurisë do të zëvendësohet totalisht nga funksioni i parasë si mjet pagese. Pavarësisht sa utopike janë shumë vende me "ekonomi të centralizuara të tregut" po japin shembuj në këtë drejtim.

b) A po ndryshon roli i Bankave Qendrore, roli i Borxhit, Deficitit apo Inflacionit?

Për disa, ndryshimi më i madh që solli pandemia është homogjenizimi i rrezikut. Kjo, do të thotë se çdo vlerësim i zhvillimit ekonomik me parametra të njohura deri me sot si: niveli i borxhit, aftësia e përmbushjes së detyrimit fiskal, kostoja e deficitit buxhetor etj., nuk kanë më vlerë para një rënieje katastrofale të ekonomisë.

Ideja e lirimit të rubinetit fiskal deri në fund dhe vënia e Bankës Qendrore në shërbim të përmbushjes së këtij qëllimi, ngjan me Teorinë Moderne Monetare (TMM). Kjo është një teori ekonomike heterodokse që u bën thirrje vendeve, të cilat e presin vetë monedhën e tyre (si Amerika dhe Britania) që ta "injorjnë përkohësisht borxhin publik" dhe të mbështeten tek Bankat Qendrore, për të ndihmuar biznesin, punëzënien, pa menduar për inflacionin sa ekonomia të kthehet në gjendje e saj normale.

Ekziston një ngjashmëri midis kësaj shkolle mendimi dhe Teorisë Moderne Monetare, e njohur si MMT (Modern Monetary Theory)? Po, kur normat e interesit janë zero, nuk ekziston asnjë dallim midis marrjes së një borxhi (që në një rast tjetër do të sillte kosto interesi) me prodhimin e kartëmonedhave (gjë e cila sipas librave të studimit nuk po sjellin kosto interesi). Kur norma e interesit është zero, "nuk ka më rëndësi nëse financimi kryet me para apo përmes borxhit", u shpreh Z. Blanchard, gjatë një takimi në Webinar, financimi dhe emetimi kanë efekte të barabarta.

Të gjithë ata që mbështesin MMT-në duan që banka qendrore të kujdeset që normat e interesit të jenë në nivelin zero, por shume ekonomiste mendojnë se kjo edhe sikur të zhduke problemin e koston së parasë, do të sjellë detyrime të pa shlyera në të ardhmen dhe për pasojë do ketë falimentime në masë. Por do të krijojë prapë një fluskë financimi për aktivitetet jokonkurrenciale në treg.


Teoricienët e politikave ekonomike fiskale pranë qeverive mendojnë se do të ishte më mirë, që qeveria të nxiste shpenzimet ose të shkurtonte taksat, me deficitet buxhetore, duke i financuar ato me tepricat e kursimeve të mundësuar nga sektori privat dhe popullata. Sa do të ishin bankat e nivelit të dytë të financonin qeveritë për borxhe të madha, kjo do të varej nga normat e interesit dhe ndoshta nga perspektivat politike në çdo vend.

Fakti është që të paktën në Europë dhe në SHBA financimet me borxh janë bërë politikë dominuese. Këtu kthehem prapë tek raportet midis kreditimit (financimit) afatshkurtër dhe kreditimit afatgjatë. Kreditimi/financimi afatshkurtër nëse nuk rrit prodhimin dhe GDP-në do të fusë në kolaps dhe qeverinë që për të realizuar kompaktësinë fiskale në të ardhmen sepse nuk do të mund të arkëtojë taksa.

Pandemia po ndryshon edhe njëherë raportet kohore dhe strukturore midis financimit afatshkurtër të bankave të nivelit të dytë për biznesin dhe financimit afatgjatë shtetëror për ekonominë.


Me poshtë kemi parashikimet e ecurisë ekonomike për vendet europiane, dhe parashikimin e borxhit për to.

Previsioni di crescita del Pil 2020 delle principali istituzioni internazionali



Fonte: Commissione europea, FMI, OCSE. Con riguardo alle stime OCSE, il dato 'single-hit' si riferisce allo scenario in cui la pandemia si esaurisca in una sola ondata di contagio, mentre il dato 'double-hit' si riferisce allo scenario in cui si ripresenti una seconda ondata di contagio entro la fine del 2020.

Public debt increase



Source : Oxford Economics *Additional increase in government debt in the second wave scenario over 2020-2022

c) Si do zgjidhet problem i papunësisë dhe kush janë ndryshimet e tregut të punës?

Pandemia ka nxjerrë në pah dhe i ka thelluar më tej pabarazitë edhe në tregun e punës. "Jakat e Bardha" mund ta zhvillojnë më së miri punën e tyre nga shtëpia, kurse "punëtorët e terrenit", duhet ose ta ndërpresin atë përkohësisht ose të vazhdojnë punën e tyre në terren. Në këtë mënyrë ata janë njerëzit më tepër të ekspozuar ndaj rrezikut të shkaktuar nga Covid-19 dhe për pasojë do të kërkojnë që ky rrezik të kompensohet ose të zhdukët.

Gjetja e mënyrave të reja për të bërë të mundur sërish punësimin e plotë, u kthye edhe njëherë në prioritetin kryesor të ekonomistëve. Ky proces lidhet ngushtë me transformimet e tregut të punës, formave të reja të punësimit dhe mbi të gjitha me raportet e vlerës së kohës së punës me vlerën e produktit të punës.

Një shqetësim tjetër lidhet me faktin se në dekadat e ardhshme, qeveritë do të përballen me më shumë presion në lidhje me buxhetin për shkak të shpenzimeve që do të vijnë nga pensionet dhe nga kujdesi ndaj shëndetit që lidhen me plakjen e popullsisë. Mënyra më e mirë për të nxitur ekonominë sot dhe nesër nuk është duke krijuar fatura të panumërta për t'u paguar në çastin kur normat e interesit të rriten sërish.

Mënyra më e mirë është duke i mbajtur normat e interesit në nivel negative. Normat e ulta të interesit mund të nxisin investimet dhe për pasojë ato do të jenë mjeti kryesor për uljen e papunësisë. Evolimi i tregut të punës si pasojë e investimeve në degët e reja si digjitalizimi, ekonomia e gjelbër, shëndetësia në distancë apo kërkimi shkencor do kërkojë një rikualifikim të subjekteve të tregut dhe të biznesit. Ky operacion është e pamundur mos shoqërohet për një periudhë jo të vogël me rritje të papunësisë.

A do ndryshojë modeli ekonomik i zhvillimit?

Mësimi i fundit i pandemisë është që pas saj asgjë nuk do të jetë si më parë. Pjesa më e madhe e përfaqësuesve të shkencës ekonomike janë dakord se ndryshimet themelore do të realizohen tek modelet e biznesit. Modeli i vjetër ekonomik duket i dobët dhe format e vjetra të të bërit biznes të tejkaluara.

Nëse 10 vjet më parë ne qendër të vëmendjes ishin Startup-et sot gjithmonë e më shumë në qendër të vëmendjes janë elementet e industrisë 4.0, teknologjitë e inteligjencës artificiale, sistemet e digjitalizimit dhe shoqëritë me rikapitalizim të shpejtë të aseteve ekonomike. Në një mënyrë ose në një tjetër, ndryshimi do të vijë, bashkë me të edhe modelet e reja të biznesit. Detyra jonë është të jemi të përgatitur sa më parë për atë që do të vijë.

Literatura

1. "L'epidemia che ferma il mondo Economia e società al tempo del coronavirus" di Angelo Mastrandrea e Duccio Zola
2. Albania AL: Gross Public Debt: % of GDP: Central Government: Debt Securities, 2009 - 2020 | QUARTERLY | % | WORLD BANK
3. Albania Government Debt: % of GDP, 2010 - 2020 | QUARTERLY | % | CEIC DATA
4. Albania: Staff Concluding Statement of the First Post-Program Monitoring Mission, September 28, 2020
6. Bernanke, B., 2009, The Crisis and the Policy Response, Speech At the Stamp Lecture, London School of Economics, London, England, Janar 2009, gjendet në adresën: <https://www.federalreserve.gov/newsevents/speech/bernanke20090113a.htm>.
7. Borio, C., Disyatat, P., dhe Zabai, A., 2016, Helicopter money: The illusion of a free lunch, Maj 2016, gjendet në adresën: <https://voxeu.org/article/helicopter-money-illusion-free-lunch>.
8. Borio, C., dhe Zabai, A., 2016 Unconventional monetary policies: a re-appraisal BIS Working Papers No. 570.
9. BROWNE A., "How the Coronavirus is Accelerating Deglobalization", Bloomberg, 2020 (www.bloomberg.com/news/newsletters/2020-02-29/why-deglobalization-is-accelerating-bloomberg-new-economy).
15. Davide Franceschiello, Giuseppe Bianco, Francesca Santostefano, Davide Costa "Coronavirus, reale o falsa dicotomia tra tutela della salute e ripresa economica" 20 maggio 2020
17. Denaj: Në 2021, borxhi publik do t'i kthehet rënies; <http://www.financa.gov.al/denaj-ne-2021-borxhi-publik-do-ti-kthehet-renies/>
25. Financial Advisory– Government Debt in Rough Waters, A navigation guide, 09.2020, www.lazard.com/media/451399/20200929-whitepaper-en-final.pdf
26. Financial Times - Draghi: we face a war against coronavirus and must mobilise accordingly | Free to read, Financial Times, March 25 2020
27. FRED, Economic research Central government debt, total (% of GDP) for Albania (2020)
49. Matthews, D. (2012): Modern Monetary Theory, an unconventional take on economic strategy, in: The Washington Post, February 12,
50. Michael SPENCE & Danny LEIPZIGER, The Pandemic Public-Debt Dilemma, Project Syndicate, Dec 8, 2020
51. Modern Monetary Theory and European Macroeconomics Dirk H. Ehnts
52. National debt of Albania 2024, Published by H. Plecher, Apr 21, 2020

“Lufta” e profesioneve në periudhën e pandemisë dhe post-pandemisë Covid-19

Akademik i Asociuar, Prof.Dr.Adrian CIVICI
Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë
a.civici@umsh.edu.al

Abstrakt

Shumë sektorëve ekonomikë e financiarë, aktivitete, biznese apo individëve “po ju dridhen këmbët” nga goditjet që morën gjatë kësaj periudhe. Prodhimet dhe shërbimet e tyre po gjejnë gjithnjë e më pak hapësirë në treg, mënyrat deri tani të suksesshme të administrimit dhe inxhinierisë menaxheriale, po kalojnë një sprovë të vështirë ekzistence, duke ndjerë mbi supe etiketën “të vjetërsuara apo ezauruara në kushtet e reja post covid-19”, duke u cilësuar si “zombie jobs”, “punë dhe profesioneve pa të ardhme” ose siç quhen tashmë “bizneset e vdekura të gjalla”, ndërkohë që në horizont po lindin me shpejtësi “profesione, zanate, prodhime, shërbime e modele të reja menaxheriale e digjitale” të cilave ju përket e ardhmja.

Tashmë është e sigurt: profesionet dhe tregu i punës post Covid-19 nuk do jetë ai me të cilin jemi mësuar dhe kemi vepruar deri tani. Kriza planetare shumë dimensionale – ekonomike, financiare, sociale, psikologjike, mjedisore, sanitare, etj.; e shkaktuar nga koronavirusi, përveç dëmeve të jashtëzakonshme të shkaktuara, ka vënë në pikëpyetje dhe “sjelljen dhe zhvillimet e pritshme në tregjet e punës dhe profesioneve”.

Kriza e thellë ekonomike e financiare dhe pasojat sociale të saj, masat e jashtëzakonshme sanitare anti covid-19, paqartësitë e mëdha për të ardhmen, rritja e konfliktualitetit politik mbi mënyrat e menaxhimit të krizës dhe recetat për përballimin e saj, etj., ndikoi dhe vazhdon të ndikojë ndjeshëm edhe në tregjet e punës, në “luftën” ndërmjet profesioneve e zanateve që u goditën rëndë nga kriza dhe atyre që po “përfitojnë e lulëzojnë” nga situata e re post-krizë dhe e ardhmja e saj. Qeveritë, individët, ekonomitë dhe sistemet arsimore, sidomos ato me vokacion profesional, po reflektojnë me shpejtësi përballë kësaj situatë të re. “Lufta e profesioneve” që po shoqërohet me “humbës dhe fitues” i është bashkëngjitur intensivisht “gjendjes së përgjithshme të luftës me armikun e padukshëm por shkatërrues e vdekjeprurës Covid-19”.

Fjalë kyce : profesione të reja; zombie jobs; tregu i punës; kriza e covis-19; edukimi profesional.

Abstract

Many financial, economic, activities, businesses and individuals are yet to recover from the blows they received during this period. Their products and services are finding less and less penetration in the markets. The until-now most successful administration and managerial strategies are put to test struggling to even exist, considered as outdated on the eve of the new post-Covid setting by being considered as “zombie jobs”, “work or profession with no future” or as they are differently recognized as “dead living businesses”. This is taking place at a time when there is a massive growth and demand of “professions, crafts, productions, services, and new digital and managerial models” that aim for the future.

One thing is for sure: post-Covid – 19 professions and the labor markets will no longer be the ones we were used to. Multi-dimensional economic, financial, social, psychological, environmental, sanitary global crisis caused by the coronavirus, besides the extraordinary damage it caused, is also putting question marks on the “expected behavior and developments in the professions and labor markets sectors”.

The deep economic and financial crisis and their social impacts, extraordinary tough anti Covid-19 measures, uncertainty for the future, increase of political conflict levels on the ways to manage the crisis and formula to confront it, impacted and continues to do so on the labor markets through a “war” among professions and skills hit by the crisis and the new ones which are blooming in the new post-Covid 19 setting.

Governments, individuals, economies, and education systems, especially the ones with a strong emphasis on the vocational education are quickly reflecting in face of such new situation. "The war of professions", normally followed by "losers and winners" is intensively related to the "general setting of the war with an invisible enemy of Covid-19 which is both destructive and fatal at the same time".

Keywords: new professions; zombie jobs; labor market; crisis of covid-19; vocational education.

Cilët ishin profesionet që u goditën më shumë nga kriza?

Periudha e bllokimit total dhe distancimit social e muajve mars-maj 2020 dhe muajt në vazhdim, gjithashtu të ndikuar ndjeshëm nga dinamikat e pandemisë, evidentuan një seri profesionesh e shërbimesh që u goditën më rëndë nga kriza.

Këtu mund të përmendim: profesionet që lidhen me ofrimin direkt të shërbimeve, të cilët kanë pak apo aspak mundësi të ofrojnë shërbime në distancë, si dentistët, berberët, avokatët, hoteleria dhe shërbimet turistike në përgjithësi, restorantet, bar-kafetë, artizanati, hidraulikët, mekanikët, transporti, tregtia me pakicë, aktivitetet industriale, industria fason, call center, shërbimet financiare, ndërtimi, produktet dhe shërbimet artistike e kulturore, profesionet e lidhura me sportin dhe modën, industria e kënaqësisë dhe relaksit, etj.

Natyrisht, një pjesë e madhe e tyre u goditën si pasojë e "lockdown" total, dhe me "qetësimin e situatës" apo kthimin gradual në normalitet në muajt në vazhdim, mund ti rifitojnë pozitat e humbura, por, për shumë prej tyre kanë filluar "këmbanat e alarmit" duke i konsideruar si "profesione pa të ardhme nëse nuk bëjnë ndryshime thelbësore në përmbajtjen, kualifikimin, format e organizimit dhe shërbimet e tyre". Dhe të punësuarit në këto profesione nuk janë pak, përkundrazi, në nivel mesatar global ato zënë rreth 60-70% të të punësuarve. Në Shqipëri, duke përjashtuar të punësuarit në sektorin bujqësor, ato zënë mbi 80% të të punësuarve.

Një pjesë e madhe e bizneseve shqiptare të përballur me këtë realitet të ri, kanë filluar të kenë probleme serioze me rikthimin në punë "me kohë të plotë" të një pjese të madhe të punonjësve të tyre, me vështirësitë e respektimit të kontratave afatgjatë të punës në këtë kategori profesionesh e zanatësh, duke menduar seriozisht për nevojën e "ndryshimeve të domosdoshme të strukturës profesionale, njohurive e kompetencave të reja; që kërkojnë rikualifikime masive cilësore të tyre" në përputhje me ndryshimet që po pësojnë sektorët e ndryshëm ekonomikë e financiare në "këtë periudhë post covid-19". Përveçse një kosto shtesë për bizneset dhe sistemin arsimor e kualifikues, një proces i tillë kërkon largpamësi e vizion të qartë për "perspektivat e të ardhmes" në këto lloj aktivitetesh e shërbimesh.

Cilët ishin profesionet që i rezistuan më mirë dhe u përshtatën me krizën?

Gjatë kësaj periudhe 6 mujore krize të rëndë të shkaktuar nga pandemia e Covid-19, një kategori e caktuar aktivitetesh ekonomike, financiare apo shërbimesh, u prekën pak apo aspak nga kriza për të stopuar apo ngadalësuar aktivitetin e tyre. Bile disa prej tyre u përshtatën shpejt me situatën, kufizimet dhe kërkesat e reja, duke ndryshuar strukturën menaxheriale, riorganizuar modelin e biznesit, përshtatur aktivitetin e tyre me rregullat e reja të protokolleve sanitare, adaptuar me mënyrat e reja të konsumit të klientëve të tyre, ofruar produkte të reja të kërkuara me urgjencë në treg, dhe mbi të gjitha, duke filluar në shkallë të gjerë rikualifikimin e stafit me kompetencat dhe njohuritë e reja.

Në analizat që i bëhen këtij grupi biznesesh e shërbimesh, ato cilësohen si "profesionet e shërbimeve esenciale të frontit të parë, të domosdoshëm për funksionimin e shoqërisë" ku futen: mjekët dhe infermierët, farmacistët, arkitektët dhe dizenjuesit e mjediseve të banimit apo shërbimeve, një pjesë e rëndësishme e profesioneve e shërbimeve që lidhen me digjitalizimin e informatikën, mësuesit dhe pedagogët, specialistët e marketingut, shitjeve dhe komunikimit me klientët, tregtia me shumicë, industria agroushqimore, e-marketingu, një pjesë

e shërbimeve financiare dhe bankat, disa linja prodhimi të sektorit fason, shërbimet e personalizuara për disa kategoritë caktuara sociale, sektorët e prodhimit dhe shpërndarjes së detergjenteve e dezinfektuesve, etj.

Edhe në këtë periudhë jashtëzakonisht të vështirë, kjo kategori biznesesh e mbajti të pa prekur numrin e punonjësve dhe pagat e tyre. Siç dëshmojnë mjaft statistika në vende të ndryshme të Botës, por edhe në Shqipëri, shërbimet dhe bizneset e këtyre profesioneve e zgjeruan aktivitetin e tyre gjatë periudhës kufizuese të pandemisë, vazhduan me investimet për modernizimin dhe digjitalizimin e ofertave të tyre, përfituan nga kreditë me kushte lehtësuese të ofruara nga bankat, garantuan fitime të qëndrueshme të aktivitetit të tyre, etj.

Në kontekstin e rezistencës dhe përshtatjes me tregun dhe kërkesat e reja, evidentohen disa elemente thelbësore të kësaj rezistence apo përshtatje të shpejtë e eficiente.

Tregtia elektronike ose e-commerce. Izolimi social dhe mbyllja e një numri të madh distributorësh apo shitësish me shumicë e pakicë e ndryshoi rrënjësisht natyrën e tregtisë dhe pagesave. Vëllimi i shitjeve dhe pagesave on-line, brenda pak javësh, u rrit 300-400% në krahasim me periudhën përpara pandemisë. Po kështu dhe përdorimi i pagesave dhe transaksioneve on-line.

Profesionet dhe specialistët e tregtisë elektronike, digjitalizimit të ofertës dhe shërbimeve, digjitalizimit të pagesave, reklamës dhe publicitetit, komunikimit dhe psikologjisë konsumatore, etj., u bënë nga më të vlerësuarat dhe më të kërkuarat gjatë kësaj periudhe krize. Kjo kategori biznesesh e shërbimesh, jo vetëm që nuk u prek nga kriza, por në shumë raste, e rriti me 20-30% aktivitetin e saj, krahasuar me të njëjtat periudhe të viteve të mëparshme.

Adoptimi i modeleve të biznesit me shkallë të lartë digjitalizimi. Veçanërisht gjatë periudhës së pandemisë dhe izolimit social, digjitalizimi "pushtoi" çdo detaj të jetës sonë të përditshme, si në planin profesional ashtu dhe në planin personal. Asnjëherë nuk kishim qenë kaq shumë të varur, edhe për shërbime jetike e profesionale, nga interneti dhe digjitalizimi.

Bizneset dhe sektorët e shërbimeve më largpamëse e inteligjente ju përgjigjën menjëherë kësaj situatë duke krijuar apo zgjeruar "telework" për një pjesë të rëndësishme të shërbimeve të tyre, krijuan profesione të reja të lidhura me digjitalizimin të tilla si "ekspert në komunikimin digjital", "specialist i projekteve digjitale", "Webmaster", "Webdesigner", "ekspert i marketingut digjital", etj.

Natyrisht, që një pjesë e këtyre "profesioneve" apo "zanateve" ekzistonin dhe përpara shfaqjes së pandemisë së Covid-19 dhe situatës së jashtëzakonshme shkaktuar prej saj, por, "situata dhe sfidat e reja" ju dhanë atyre një rëndësi dhe zhvillim shumë më të shpejtë se rritimi i zakonshëm i kohës përpara pandemisë. Tashmë, "pjesën e luani" në shpenzimet e bizneseve për "kërkim-zhvillimin" dhe kualifikimin e stafit, e zënë të ashtuquajturat "profesionet digjitale". Kur gjithçka u duk sikur u "fundos", digjitalizimi rezistoi mrekullisht duke treguar rrugën e së ardhmes!

Cilat janë profesionet e reja që po lindin post Covid-19?

Tashmë është e qartë se kriza e Covid-19 ka "provokuar" lindjen e nevojave të reja në një Botë në ndryshim radikal. Nevojave dhe sfidave të reja po i "përgjigjen flakë për flakë" profesionet e reja që po profilizohen çdo ditë e më tepër. Veçanërisht bizneset e prodhimit dhe shërbimeve po përballen çdo ditë me "domosdoshmërinë e digjitalizimit sa më të gjerë të aktivitetit të tyre", me ndryshime radikale të mënyrës së tyre të punës, dhe mbi të gjitha me konstatimin shqetësues të mangësive serioze të digjitalizimit të deritanishëm të punës së tyre në gjithë hallkat e zinxhirit menaxherial dhe modelit të biznesit. "Telework" së bashku me digjitalizimin masiv të teknologjive të prodhimit, shërbimeve e proceseve të punës, tashmë është pjesë e çdo diskutimi, projekti, prioriteti e strategjie për të ardhmen.

Këto ndryshime kërkojnë me urgjencë dhe një evolucion të shpejtë të kompetencave të burimeve njerëzore në të gjithë hallkat e skemave menaxheriale. Prodhimi në distancë, puna në

distancë, shitjet në distancë, komunikimi me klientët në distancë, marrëdhëniet me bankat në distancë, kontrolli në distancë, organizues eventesh online, etj., të gjitha nëpërmjet ekranit të kompjuterit, janë shembulli më i mirë i kësaj epoke të re post covid-19.

Inteligjenca artificiale, automatizimi dhe robotika, inovacionet dhe start up-et, etj., të përfshira tashmë në nocionin e "revolucionit 4.0" po krijojnë kompetenca dhe profesione të reja: Specialist në sigurinë kibernetike, ekspert në mbrojtjen e të dhënave, inxhinier në inteligjencën artificiale, zhvillues të dhënash dhe ekspert në Big Data, këshilltar dhe analist inovacioni, ekspert efience dhe aplikimi start up-esh, menaxher tranzicioni dixhital, analist dhe këshilltar risku e paqartësie, Community Manager (Menaxher i Komunitetit), Product Owner (Pronar i Produktit), ekspert dialogimi, asistent virtual, ekspert videografië, multichannel communication consultant, menaxher rendimenti apo optimizues aktiviteti, ndërlidhës financiar, inxhinier i autonomisë financiare, ekspert tregjesh dhe monedhash virtuale, Zoom support specialists, etj., janë disa nga profesionet e reja që po zhvillohen me shpejtësi duke qenë njëkohësisht dhe më të kërkuarat në treg.

Kjo nuk është thjesht një fazë e re në krijimin e profesioneve të reja, por mbi të gjitha, është një fazë e fuqishme ekspansioni e këtyre profesioneve të reja, një sinjal i qartë i perspektivave të reja për muajt dhe vitet në vazhdim.

Ekonomia, financat, bizneset, shërbimet, sektori publik, administrimi, marrëdhëniet më të tretët, etj.; duhet të adoptohen shpejt me këtë tendencë të re të cilësuar si "de-linearizim" i zakoneve të jetës, konsumit, prodhimit e shpërndarjes, financimeve, transportit, komunikimit, modelit të biznesit, etj.; të "provokuar" fort nga situata e pandemisë së Covid-19, por njëkohësisht të servitur si: rruga drejt së ardhmes. Pothuajse çdo "vendim" apo "veprim" do bazohet në teknikat digjitale duke integruar modelin e biznesit me jetën reale".

Covid-19 nuk zhvilloi e transformoi vetëm profesionet dhe kompetencat ekzistuese në kuadrin e revolucionit 4.0 apo digjitalizimit maksimal, por mbi të gjitha, krijoi një fushë të gjerë veprimi digjitale nga A te Zh-ja në gjithë aktivitetet ekonomike, financiare, tregtare, shëndetësore, arsimore, kulturore, sportive, etj., në shërbim të zhvillimit ekonomiko-social, nivelit të jetesës dhe mirëqenies sa më të gjerë. Sipas shumë studimeve e analizave të specializuara në këtë drejtim, "25-30% e bizneseve që nuk arrijnë të përshtaten me sfidat dhe profesionet e reja digjitale, rrezikojnë të falimentojnë dhe të dalin përfundimisht nga tregu".

Transformimi dhe përshtatja e sistemeve të edukimit profesional

I gjithë ky ndryshim radikal që po ndodh "në jetën reale", i shtyrë përpara veçanërisht edhe nga kriza e Covid-19, kërkon me urgjencë "ndryshime radikale dhe në sistemet e edukimit në përgjithësi dhe ato të formimit profesional në veçanti". Sistemet arsimore, në të gjithë nivelet e tyre, por veçanërisht universitetet dhe kolegjet profesionale, duhet të reagojnë me shpejtësi në përputhje me sfidat e reja, për ti paraprirë këtyre ndryshimeve të kësaj epoke të re ku kemi hyrë. Programet mësimore, përmbajtja e diplomave, sillabuset, tekstet bazë dhe ato ndihmëse, metodat e mësimdhënies, format dhe modelet e komunikimit, laboratorët dhe kabinetet e ndryshme, lloji i njohurive, informacionit dhe dijeve, metodologjia e kërkimit shkencor, botimet e ndryshme akademike e shkencore, etj., duhet të përshtaten me shpejtësi me situatën e re, në mënyrë që të përgatisin dhe nxjerrin ekspertë e specialistë cilësorë të barazvlefshëm me profesionet dhe kompetencat e reja që po zhvillohen me shpejtësi.

Shumë nga njohuritë dhe dijet që kanë marrë apo vazhdojnë të marrin nxënësit dhe studentët aktualë shumë shpejt do jenë thjesht "pjesë e historisë dhe të kaluarës" duke mos ju përgjigjur dot zhvillimeve dhe kompetencave të reja". Ashtu si bizneset, edhe kolegjet profesionale, universitetet dhe qendrat kërkimore-shkencore po lëvizin me shpejtësi drejt përballimit me këto sfida të reja, në mënyrë që ti paraprinë kësaj tendence të re dhe jo të mbeten në bisht të saj thjesht në rolin e konstatuesit.

Skemat mbështetëse për ruajtjen e vendeve të punës të aplikuara gjerësisht gjatë periudhës intensive të ndikimit të pandemisë së Covid-19 ndihmuan në parandalimin e papunësisë masive afatshkurtër duke "shpëtuar në vendet e BE-së mbi 50 milion vende pune", por, këto lloj skemash mbështetje financiare nuk mund të vazhdojnë pafundësisht, pasi janë shumë të kushtueshme dhe e zgjidhin përkohësisht problemin e papunësisë dhe mbështetjes sociale.

Aq më tepër, në shumë vende të varfra apo ato me ekonomi emergjente, të cilat janë të kushtëzuara nga vështirësitë buxhetore e financiare për të aplikuar për një kohë të gjatë skema të tilla. Tashmë sfidat për ruajtjen e punësimit dhe gjendjes së ekonomisë e bizneseve janë krejtësisht të reja, dhe në mjaft raste të panjohura më parë.

Aktualisht, p.sh., vetëm në pesë vendet më të zhvilluara europiane, si pasojë e "zombie jobs", "punëve e profesioneve pa të ardhme" ose siç quhen tashmë "bizneset e vdekura të gjalla", këto vende po i tremben një "pamundësie rikthimi në kushte normale në punë të rreth 8-9 milion punonjësve", si pasojë e "mbyllës apo ngushtimit të aktiviteteve të profesioneve të goditura rëndë nga kriza dhe në pamundësi përshtatje me kushtet e reja". Riaftësimi i tyre profesional me profesionet apo zanatet e reja që po lulëzojnë në këtë periudhë mbetet sfida më e madhe e qeverive dhe sistemeve arsimore e kualifikuese.

"Presioni" i tregut të punës ndaj universiteteve – si duhet reaguari?

Shifrat janë impresionuese: 85% e profesioneve dhe vendeve të punës të vitit 2030 – pra vetëm 10 vite larg – nuk ekzistojnë akoma dhe do krijohen në dekadën e ardhshme. Pritet një ndryshim drastik i tregut të punës, kompetencave dhe profesioneve, tashmë në një evolucion të shpejtë. Përballë kësaj tendence, shkollat dhe universitetet duhet të organizohen e ndryshojnë me shpejtësi për të ofruar formim profesional e shkencor në përputhje me kërkesat e reja të tregut të punës.

Kjo është rruga më e domosdoshme dhe më e dobishme edhe për universitetet shqiptare, që kanë rrugë të gjatë e të vështirë përpara për tu përfshirë në këtë tendencë të re të modernizimit të universiteteve dhe integritimit sa më të plotë të tyre me evolucionin dhe zhvillimet bashkëkohore të profesioneve dhe tregjeve të punës.

Përshtatja dhe integrimi i shpejtë dhe cilësor në tregun e punës është pa dyshim një nga treguesit më domethënës të përmbajtjes dhe vlerës së një diplome universitare, qoftë kjo e nivelit 2 vjeçar profesional, bachelor, master apo dhe doktoraturë.

Në fund të fundit, një nga qëllimet bazë të studimeve universitare, përveç disa qëllimeve të tjera madhore edukuese e formuese, është formimi sa më i plotë e cilësor profesional i studentëve, në mënyrë që "specialistët apo ekspertët e rinj" të integrohen sa më shpejt dhe në përputhje me drejtimin e studimeve të tyre, në tregun e punës.

Jo pa qëllim apo formalisht, universiteteve ju kërkohet vazhdimisht të bëjnë analizën e tregut të punës, ecurinë e profesioneve të ndryshme, shpejtësinë dhe qëndrueshmërinë e të diplomuarve të tyre në tregun e punës, tendencat e reja në këto tregje, etj., në mënyrë që diplomat, programet, degët apo lëndët që ato zhvillojnë në curriculumet e tyre, të përputhen sa më mirë me këto tendenca, apo në rastin më të mirë, ti paraprijnë këtyre zhvillimeve. Edhe sot, ky mbetet një nga treguesit kryesorë të vlerësimit të cilësisë dhe standardeve të universiteteve, në nivele të ndryshme të akreditimit të tyre.

Në 2-3 dekadat e fundit, në marrëdhëniet e universiteteve me tregjet e punës, dmth, të "produktit" universitar me "blerësit dhe përdoruesit" kryesorë të tij që janë bizneset, shërbimet e ndryshme publike e private, korporatat, institucionet publike e jo-publike, qeverisja qendrore e ajo lokale, etj., janë vënë re dy tendenca madhore kryesore. Ndërkohë, zhvillimet e vullshme të "revolucionit 4.0", inteligjencës artificiale, robotikës, analizës së big-data, shtrirjes së jashtëzakonshme të digjitalizimit dhe telework-ut, etj., të shoqëruara dhe me kërkesat e reja specifike të kushtëzuara nga efektet e pandemisë së Covid-19 dhe "sfidave të reja të të ardhmes"

Deri në vitet 1960-90-të, një pjesë e rëndësishme e të punësuarve që zotëronin një diplomë universitare të niveleve të ndryshme, vlerësohej kryesisht nga "cilësia e të diplomuarit", dmth, nga shkalla e vlerësimit të tij, si dhe nga "emri dhe prestigji i universitetit". Në grupin e kriterëve të punësimit, këto dy elemente kishin peshë të rëndësishme mbi të cilat bazohej vendimmarrja e punësuesve, apo "blerësve" të individëve, të cilët aplikonin për t'u punësuar në shumicën dërrmuese të niveleve të punësimit. Natyrisht që kjo ishte shumë e rëndësishme në "punësimin e parë apo të dytë në pesë apo dhjetë vitet e para të karrierës", duke u kombinuar më vonë, dhe me plotësimin e kompetencave dhe kualifikimet specifike gjatë etapave të ndryshme të karrierës.

Koncepti "profesion" apo "vend pune i konsoliduar" ishte dominues, në kuptimin që studentët kur zgjidhnin degën apo fakultetin që do ndiqnin, kishin në mendjen dhe preferencat e tyre "profesionet" apo "drejtimet profesionale" që synonin dhe aspironin të realizonin, duke filluar që nga studimet universitare. Edhe shkalla e përputhjes ndërmjet karakteristikave dhe cilësimit të diplomës me "profesionet ekzistuese e të konsoliduara" ishte mjaft e lartë.

Edhe struktura e programeve dhe përmbajtja e kurrikulumeve universitare u përshtat me një tendencë dhe kërkesë të tillë të tregjeve të punës. Universitetet ishin shumë pak fleksibël, studimet universitare zgjasnin 4-5 vite sipas drejtimit të diplomës së zgjedhur dhe të ofruar dhe mundësitë për një "profesion të ri" ishin të vogla e të gjata, sepse kërkonin një periudhë tjetër 4-5 vjeçare, ose kurse specifike profesionale, që gjithsesi nuk kishin vlerën dhe efikasitetin e universiteteve.

Ndërkohë, në vitet 1990-2010-të, filloi të shfaqej një "fenomen i ri" që reflektonte një situatë të re në tregjet e punës dhe zhvillimet ekonomiko-sociale, sidomos në vendet e zhvilluara të botës. Ndërsa në vitet 1960-1990, mbi 80-90% e të diplomuarve, "gjenin mundësitë dhe arrinin të punësoheshin" në këto profesione "klasike" dhe të konsoliduara, dhe vetëm një pjesë e vogël e tyre ndesheshin e punësoheshin me profesione të reja të "lindura" së fundmi, apo në profesione që ata vetë i "krijonin dhe zhvillonin", sidomos mbas viteve 2000, kjo tendencë filloi të përmbysesj me shpejtësi.

Numri i të diplomuarve që gjente punë dhe punësohej në një profesion të konsoliduar apo "historik", ra nën 60%, ndërkohë që 30-40% e të diplomuarve të rinj, ose filluan të ndeshen me profesione të reja që po rriteshin e zhvilloheshin me shpejtësi, ose ishin ata vetë që krijonin shërbime e profesione të reja në përputhje me zhvillimet e vullshme të tregjeve të punës.

Tregjet e punës dhe profesionet, përveç atyre të reja, u bënë shumë më komplekse e polivalente duke kërkuar formim universitar po kaq fleksibël e polivalent. "Karta e Bolonjës" dhe gjithë platforma e format e organizimit që rridhnin prej saj ishte një nga përgjigjet më adekuate të këtyre tendencave të reja. Përveç unifikimit dhe standardizimit të sistemit universitar në nivel europian dhe krijimit të "krijimit të një monedhe të përbashkët akademike europiane siç ishte sistemi krediteve", Karta e Bolonjës ju përgjigj dhe një zhvillimi apo nevojë të re: fleksibilitetit dhe multifunksionalitetit të profesioneve, duke e bërë po kaq fleksibël dhe multifunksional dhe strukturën e ofertës universitare.

Kjo situatë i dha një mesazh shumë të rëndësishëm universiteteve në lidhje me reagimin që duhej të bënin për modernizimin dhe përshtatjen e shpejtë të programeve, degëve e profileve që ato ofronin me tendencat e reja të zhvillimit dhe për pasojë dhe ristrukturimin e tregjeve të punës.

Vetëm ato universitete që ju përgjigjën "flakë për flakë" kësaj tendence e sfide të re, duke ndryshuar rrënjësisht organizimin dhe konceptimin e kurrikulumeve dhe cikleve të studimit, metodave të mësimdhënies, informacioneve, njohurive e dijeve që ju ofronin studentëve, kabinetet e laboratorët modernë, lidhjet e ngushta me aktorët kryesorë të tregut të punës dhe kërkesave të tyre, studimin e perspektivave të zhvillimit të sektorëve të rëndësishëm të shkencës, ekonomisë e shoqërisë, zhvillimit të cilësive të kreativitetit, etj.; arritën t'i përgjigjen situatës së re, duke i bërë më "fleksibël", më "kreativ", më "kompleks", më "kritik" dhe më "funksional" ndaj ecurisë së tregjeve të punës, të diplomuarit e tyre.

Ndërkohë, 3-4 vitet e fundit, dhe veçanërisht mbas krizës së pandemisë së Covid-19 që ndryshoi dhe vazhdon të ndryshojë me shpejtësi mjaft nocione, koncepte e mënyrash të vepruari në shumë segmente të ekonomisë dhe shoqërisë sonë, përpara universiteteve, përfshirë këtu dhe kolegjet e ndryshme profesionale, po shfaqet një sfidë e re mjaft domethënëse e sfiduese. Sipas disa studimeve të bëra në mënyrën e funksionimit të tregjeve të punës, ose e thënë më thjeshtë, "ofertave për punë" në shumë degë e sektorë të ekonomisë, shërbimeve, etj., konstatohet një fenomen i ri "sfidues".

Po i referohem një analize të Prof. Riccardo Luna të botuar në gazetën La Repubblica" të datës 3 shtator 2020, i cili e konkretizon këtë sfidë të re me një shembull domethënës: "Prej disa ditësh po qarkullon një ofertë interesante për punë për drejtues studiosh, shitblerje produktesh, audio e video për Europën qendrore e lindore me bazë në Milano e Madrid.

Cilësitë e kërkuara dhe informacionet e nevojshme për tu punësuar janë: eksperiencë e spikatur në këtë sektor, kapacitet i lartë komunikimi e ndikimi tek klientët, pasion prej eksperti për subjektet e produkteve audio e video, kapacitete të mira për menaxhimin e buxhetit, aftësi për drejtimin dhe organizimin e sipërmarrjes, aftësi planifikuese dhe predispozicion për arritjen e objektivave etj. Megjithatë këtu mungon diçka shumë e rëndësishme. Mungon lloji i diplomës universitare që duhet të kenë kandidatët. Harresë e rastësishme apo tendencë e re e tregjeve të punës?

Tashmë është e sigurt se kjo "është tendenca e re me të cilën do përballemi". Dy vite më parë, një adresë e rëndësishme WEB, që publikonte oferta punësimi, konstatoi dhe evidentoi faktin se "për partnerët e saj, ku bënë pjesë dhe Google, Apple, IBM, Hilton, Starbucks, Bank of America, Quorum, YouTrend, etj., në kërkesat e tyre për cilësitë e kandidatëve për t'u punësuar, nuk bënë më pjesë diplomat universitare, të paktën në informacionet më të rëndësishme dhe decizive për të fituar postet vakante të punës.

Kjo tendencë e re të ndihmon të kuptosh më qartë përse disa javë më parë Google njoftoi se do krijonte "Universitetin e Google" dhe krijimin e tri çertifikatave profesionale, në të cilat pagesa për pjesëmarrësit ishte vetëm 49 usd në muaj. "Shkencat e informacionit dhe komunikimit", "Inxhinieri informatike", "Inxhinieri menaxheriale", "Analist të dhënash", "Administratorë projektesh", "Menaxherë eksperiencash në përdorimin e softuerëve", etj. Në pamje të parë duken si profesione apo vende pune shumë të specializuara dhe me spektër të ngushtë, por nuk janë aspak ashtu; janë një pjesë e profesioneve të së ardhmes.

Aktualisht, Bashkimi Europian publikon një raport të veçantë për vendet vakante në sektorin dixhital, të cilët janë jo pak por qindra-mijëra deri në disa milionë vende vakante. Shkaku kryesor: mungesa e kandidatëve të specializuar, mungesa e kompetencave specifike të kërkuara. Problemi kryesor është se "deri tani, për të përfituar kompetenca të tilla, apo dhe për të garantuar punëdhënësit për cilësinë e kandidatëve, nevojitej një diplomë universitare që pak a shumë përputhej me drejtime të tilla, por prej disa vitesh një tendencë e tillë ka ndryshuar".

Sipas disa të dhënave më të fundit, "56% e individëve që punojnë në këta profesione e shërbime të tilla, nuk janë të pajisur detyrimisht me diploma universitare. I kanë përvetësuar ato në rrugë të tjera apo kanë mësuar në punë e sipër". Shifrat janë impresionuese: 85% e profesioneve dhe vendeve të punës të vitit 2030 – pra vetëm 10 vite larg – nuk ekzistojnë akoma dhe do krijohen në dekadën e ardhshme.

Pritet një ndryshim drastik i tregut të punës, kompetencave dhe profesioneve, tashmë në një evolucion të shpejtë. Përballë kësaj tendence, shkollat dhe universitetet duhet të organizohen e ndryshojnë me shpejtësi për të ofruar formim profesional e shkencor në përputhje me kërkesat e reja të tregut të punës.

Në pamje të parë, të krijohet përshtypja e gabuar se "universitetet po e humbin rolin dhe rëndësinë e tyre në raport me evolucionin dhe kërkesat specifike të tregut të punës..., se për disa grupe të rëndësishme kompetencash, vendesh pune të rëndësishme dhe të paguara mirë, universitetet nuk janë më të nevojshme ..., se duhen kërkuar rrugë të tjera alternative për t'u profesionalizuar për nivele të tilla specifike".

Në fakt, ky fenomen duhet parë nga një këndvështrim tjetër: tregu i punës ka evoluar dhe ndryshuar më shpejt dhe në drejtime më specifike në raport me shpejtësinë e reagimit të universiteteve dhe “produkteve” të tyre ndaj kërkesave të tregut të punës. Janë universitetet ato që urgjentisht duhet dhe pritët të reagojnë me shpejtësi dhe inteligjencë për ti paraprirë kërkesave specifike “speciale” të tregjeve të punës, për ta kuptuar thelbin, përmbajtjen dhe evolucionin e këtij tregu, duke ju përgjigjur me një ofertë universitare të modernizuar e specifike, me diploma, programe, degë e profile specifike, lëndë apo grup lëndësh apo module specifike “shumë të specializuara e cilësisht të avancuara”.

Në mënyrë që studimet universitare, veçanërisht Kolegjet profesionale dhe programet Master të përputhen sa më mirë me kërkesat “speciale” të tregut të punës.

Shumë universitete tashmë e kanë filluar këtë rrugë, duke garantuar rolin e tyre parësor në formimin profesional të niveleve të larta, nivelin teorik e metodologjik cilësor, projektues të karrierave profesionale e kërkimore të niveleve të larta, përgatitjen e profesionistëve për poste pune që kërkojnë kualifikime speciale, lidhjen e tyre të ngushtë me qendrat e ekselencës, qofshin këto biznese, korporata, institute kërkimore, institucione të ndryshme, etj., duke u “bërë pjesë e një evolucioni të përbashkët të diktuar nga zhvillimet e ethshme bashkëkohore në çdo fushe të shkencës dhe teknologjisë”.

Kjo është rruga më e domosdoshme dhe më e dobishme edhe për universitetet shqiptare, që kanë rrugë të gjatë e të vështirë përpara për tu përfshirë në këtë tendencë të re të modernizimit të universiteteve dhe integritit sa më të plotë të tyre me evolucionin dhe zhvillimet bashkëkohore të profesioneve dhe tregjeve të punës.

Gjithashtu rruga më e sigurt drejt të ardhmes dhe përafrimit të standardeve të universiteteve tona me universitetet cilësore të mjaft vendeve të zhvilluara, është rruga e krijimit të mundësiave më të mëdha për brezin e ri që pajiset më aftësi profesionale cilësore, nivel të lartë kreativiteti e guximi profesional, kompetenca teorike e metodologjike moderne, aftësi logjike e arsyetimi, etj., sa më konvergjente me zhvillimet e reja bashkëkohore.

Literatura

1. Davide Franceschiello, Giuseppe Bianco, Francesca Santostefano, Davide Costa “Coronavirus, reale o falsa dicotomia tra tutela della salute e ripresa economica” 20 maggio 2020
2. European Commission - How COVID-19 has fundamentally changed recruitment - October 2021 European Labour Authority, Directorate-General for Employment, Social Affairs and Inclusion;
3. Europe's moment: Repair and Prepare for the Next Generation COMMISSION STAFF WORKING DOCUMENT - Identifying Europe's recovery needs SWD(2020) 98 final; 27.5.2020.
4. F.BLANCOLEVENT, K.KARALASHVILI, L.QORLAZJA - COVID-19 impact on Albania's private sector: taking stock, looking ahead, January 04, 2021
5. Gartner - Insights / Human Resources / Article/ 9 Future of Work Trends Post Covid-19, June 16, 2022, Contributor: Jordan Turner and Mary Baker;
6. HBR, Coronavirus and Business: The insights you need from Harvard Business Review, March 2020.
7. ILO Monitor 1st edition, “COVID-19 and the world of work: Impact and policy responses, 18 March 2020.
8. IMF Work - Why Jobs are Plentiful While Workers are Scarce; By Carlo Pizzinelli and Ippei Shibata; JANUARY 19, 2022;
9. Jennifer Liu - 1 in 4 workers is considering quitting their job after the pandemic—here's why

10. Majority of workers who quit a job in 2021 cite low pay, no opportunities for advancement, feeling disrespected;
11. Maryla Maliszewska Aaditya Mattoo Dominique van der Mensbrugge, "The Potential Impact of COVID-19 on GDP and Trade - A Preliminary Assessment", World Bank Group, April 2020.
12. OCDE - The impact of COVID-19 on employment and jobs, OECD.org; 2021
13. Pew Research Center - BY KIM PARKER AND JULIANA MENASCE HOROWITZ, March 9, 2022
14. Published Mon, Apr 19 2021 11:39 updated Tue, Apr 20, 2021; Make it;
15. Sułkowski, Ł. (2020). Covid-19 pandemic; recession, virtual revolution leading to de-globalization?. Journal of Intercultural Management, 12(1), 1-11.
16. World Bank, "Assessing the impact and policy responses in support of private-sector firms in the context of the COVID-19 pandemic" March 26, 2020.
17. World Economic Outlook Update, June 2020: A Crisis Like No Other, An Uncertain Recovery; IMF, June 2020.
18. Why the pandemic left long-term scars on global job market, By PAUL WISEMAN and ALEXANDRA OLSON, March 13, 2021; AP News;w;

SKENARET DHE RISQET E POLITIKAVE EKONOMIKE GJATE KRIZES COVID-19

Prof.asoc.Dr. Nikollaq Pano
Universiteti Mesdhetar i Shqiperise
npano@umsh.edu.al
Prof.asoc.Dr. Ira Gjika,
Universiteti Mesdhetar i Shqiperise
ira.gjika@umsh.edu.al
MSc. Eros Angjeli,
Universiteti "Mesdhetar i Shqiperise"
eros.angjeli@umsh.edu.al

Abstrakt

Pasiguria si pasojë e krizës aktuale ekonomike është shumë e lartë. Ky fakt evidentohet përmes disa elementëve si: modelet e parashikimit të efekteve ekonomike të politikave të caktuara, nevoja e ristrukturimit të sektorëve të vecantë të ekonomisë dhe shkalla e prishjes së ekuilibrit të tregjeve të caktuara brenda një vendi.

Ky punim ka për qëllim të analizojë dhe krahasojë vlerësimet e shkallës së rënies ekonomike në tregje të vecantë dhe lidhjen e tyre brenda një ekonomie. Raporti ndërmjet shëndetit public dhe zhvillimit ekonomik ka ndikuar në rrugët dhe aftësitë me të cilat sektorë të ndryshëm ekonomikë në vende të ndryshme, po përballojnë efektet e pandemisë. Kjo evidentohet duke analizuar faktorët ekonomikë që ndikuan në këto procese dhe duke u ndalur tek roli i politikave në stimulimin e kërkesës, format e ruajtjes së ekuilibrit në tregun e punës dhe nxitja e aktivitetit sipërmarrës.

Një vend të vecantë në këtë punim ze krahasimi i krizës aktuale ekonomike me krizën e vitit 2007-2009, që filloi në SHBA dhe u përhap në gjithë botën dhe me krizën e 2011 si pasojë e borxheve publike. Ky krahasim ndihmon të analizohen elementët e përbashkët, dallimet, pasojat e pritshme dhe risqet për të ardhmen, që mund të sjellin disa nga politikat e zbatuara kundër pasojave të pandemisë.

Trajtimi i këtyre çështjeve bëhet në kontekst botëror. Por pa dyshim politikat ekonomike, skenarët dhe pasojat e pritshme mund të prekin drejtpërdrejt ekonominë shqiptare. Ky është faktori kryesor nxitës për realizimin e studimit, i cili mbyllet me shqyrtimin e disa skenarëve kryesorë të kapërcimit të krizës së pandemisë. Analizohen mundësitë e realizimit dhe efektet që mund të shkaktohen në ekonominë e vendeve nga masat konkrete, duke i hapur rrugë vëzhgimeve të mëtejshme.

Fjale kyc: Shock–u i kërkesës dhe ofertës, borxhi privat dhe publik, ristrukturimi i ekonomisë, politikat monetare, barazia sociale.

Abstract

Uncertainty due to the current economic crisis is very high. This is highlighted through several elements such as: models of forecasting the economic effects of certain policies, the necessity to restructure specific sectors of the economy and the disparity of certain markets within a country. This study aims to analyze and compare the assessment of economic decline in specific markets and their relationship within the economy. The relationship between public health and recent economic development has affected the ways and capacities deployed by various sectors in different countries for facing the pandemic consequences. This is revealed by analysis of economic factors influencing the processes, focusing on the role of policies in stimulating demand, forms to maintain the equilibrium in the labor market and promotion of entrepreneurial activity.

The paper provides a particular attention to the comparison of the current economic crisis with that of 2007-2009 that started in the US and spread all over the world, as well as with that of 2011 as a result of public debts. This comparison helps to analyze the common elements, differences,

expected consequences and risks for the future, which may come from some of the policies implemented against the consequences of pandemics.

All topics are considered in a global context. However, there is no doubt the economic policies, scenarios and expected results might directly affect the Albanian economy. This is the driving factor for undertaking this study, which concludes with an analysis of the main scenarios of overcoming the pandemic crisis. The chances for implementation and the effects of specific measures for the local economies are analyzed, permitting future surveys.


Keywords: shock of demand and supply, private and public debt, economic restructuring, monetary policy, social equality.

1. Hyrje

Diskutimet teorike të mendimit ekonomik në ditët e sotme pasqyrojnë konfuzionin dhe në shumë raste mosnjohjen e pasojave që do të lërë pandemia e Covid-19 në ekonominë botërore në përgjithësi dhe në ekonominë e vendeve në veçanti. Debatit të madh në fushën e mjekësisë po i bashkohet dhe një debat i fuqishëm në fushën e ekonomisë ku krahas politikave ekonomike po evidentohen dhe dallime themelore të teorive në mendimin ekonomik. Ka një përpjekje të përgjithshme që të "mësojmë" nga "pësimet" e kësaj pandemie, megjithëse shpejtësia e ndryshimeve nuk lejon parashikime të qëndrueshme dhe bindëse të së ardhmes. Sikurse shprehen ekspertët e prestigjiozes Boston Consulting Group (BCG) "për shkak të dinamikës së paparashikueshme të pandemisë, mungesës së një përvoje të ngjashme të mëparshme dhe mungesës së zgjidhjeve 'të gatshme' nga autoritetet shtetërore ose ndërkombëtare për këtë krizë nuk ka përgjigje të thjeshta" (HBR, 10.03.2020). Pavarësisht se si po vazhdon pandemia në aspektin kohor dhe gjeografik, njohja me politikat ekonomike që mund të ndërmerren dhe me skenarët e mundshëm të rimëkëmbjes së ekonomive të prekura mund të jetë një kontribut në literaturën ekonomike.

2. Parashikimet e zgjatjes së krizës

Vetë parashikimet e ecurisë ekonomike të bëra nga bankat qendrore të shumë vendeve të zhvilluara, FMN dhe BB po ndryshojnë pothuajse çdo muaj. Në Mars 2020 parashikohej një rënie prej 3%, në muajin prill ajo kaloi në 5-7 % dhe në maj për zonën euro Banka Europiane parashikonte një rënie nga 6% dhe për disa vende të jugut deri në 11% sipas skenarëve më negativë (BOE, 2020), (BB, 2020). Në fund të shkurtit dhe fillimin e marsit bursat kryesore botërore humbnin mesatarisht rreth 25% të vlerës së aksioneve të tyre dhe në fillim të qershorit DOW JONES rifitoi rreth 70% të humbjeve ndërsa NASDAQ pothuajse 100% (fig.1).



Të gjitha këto të papritura e kanë bërë shumë të vështirë parashikimin e të ardhmes në aspektin ekonomik për vendet e veçanta dhe në nivel global. Megjithë situatën e pashembullt, një

vështrim historik i zhvillimeve ekonomike të 15 -20 viteve të fundit mund të vijë në ndihmë për të analizuar modelet dhe skenarët e parashikimeve ekonomike.

Kriza e vitit 2009 ishte kriza më e madhe financiare që goditi ekonominë amerikane në këtë shekull dhe pas falimentimit të “Lehman Brothers” edhe liberalistët me të flaktë pranuan domosdoshmërinë e ndërhyrjes së shtetit në ekonomi. Rezerva Federale e SHBA u detyrua të emetojë në treg një lumë parash që të rivendosej besimi në bursat dhe mbyti ekonominë e gjithë botës me dollarë (Yglesias, 2015). Ishte injektimi më i madh me likuiditete, i bërë ndonjëherë në historinë njerëzore (FED, 2013).

Në vitin 2011 në Europë, si pasojë e krizës në SHBA, u shfaq kriza e “boxheve publike” që vuri në vështirësi bankat e disa vendeve europiane. Patëm “de facto” falimentimin e Greqisë, Portugalisë, Qipros dhe Irlandës, gjë që rrezikonte të çonte në falimentimin e bankave të këtyre vendeve. Për ta parandaluar atë filluan edhe në Europë programet e shpëtimit financiar shtetëror. Me fillimin e krizave të borxhit publik Banka Qendrore Europiane ndoqi të njëjtën politikë si SHBA në 2009, me emetime masive parash për të mbrojtur monedhën e përbashkët, euron (Gourinchas et al, 2017). Nga ana tjetër për të ruajtur bankat europiane, BOE filloi blerjen masive të bonove të thesarit të vendeve europiane dhe financoi fuqishëm borxhet publike dhe private të shumë institucioneve financiare. Kjo ishte masa e dytë e madhe financiare për të hedhur në treg shuma të mëdha parash. Japonia dhe Kina kishin kohë që ndiqnin politika agresive emetimi për të siguruar zhvillimin e investimeve, kështu që paratë në treg ishin të shumta.

Të gjithë prisnin që pasojë e kësaj politike të ishte inflacioni, por ai u ruajt në nivele shumë të pranueshme (Yglesias, 2015). Kjo për faktin se paratë shkuan jo direkt te tregu i konsumit, por mbuluan humbjet e shoqërive dhe bankave të mëdha dhe mbështetën tregun financiar. Pasoja direkte e këtij procesi ishte rritja e pabarazisë, të pasurit u bënë më të pasur ndërsa të varfërit relativisht më të varfër (Fig.2). Në fund të qarkullimit të domosdoshëm monetar kjo masë parash u përqëndrua në rreth 3% të popullsisë dhe pabarazia u rrit me progresion gjeometrik (IMF, 2016; Credit Suisse, 2017). Ishte ndërhyrja më e madhe e shtetit në ekonomi dhe mbi të gjitha kjo politikë u ndoq nga një kastë neoliberalësh që mbronin parimin e vetë ekuilibrit të tregut.




Figura 2. Ndarja globale e pasurisë sipas grupeve.

Burimi: Credit Suisse, 2017

Vlen të përmenden edhe pasojat e tjera ekonomike të kësaj politike në mënyrë që të realizojmë qartë krahasimin e kësaj krize me krizat e mëvonshme. Pasoja e parë ishte ruajtja e cmimit të ulët të parasë (interesa të ulta) dhe pafuqia e bankave qendrore për të përdorur interesin si element zhvillimi (FED, 2013). Nga ana tjetër kjo masë parash filloi të qarkullojë me shpejtësi në të gjithë botën dhe thelloi më shumë dallimin e tregut financiar dhe të shërbimeve nga prodhimi. Kjo gje spostoi kapitalet prodhuese nga vendet e zhvilluara në vendet në zhvillim.

Tregu financiar u nda nga sistemi i prodhimit. Pasoja negative e këtij fenomeni u duk në kushtet e pandemisë, kur u vërtetua që të gjitha vendet e zhvilluara nuk kishin as prodhim maskash dhe as aspiratorësh. Të gjitha prodhoheshin në Kinë dhe Indi. Nëse do e shikojmë këtë fenomen në aspektin e përqëndrimit të prodhimit në disa vende, ai shoqërohet edhe me zhvillimin që morën degë dhe industri të caktuara të ndikuara nga zhvillimet teknologjike.

Tendenca drejt zinxhirëve të furnizimit të shtrirë globalisht lidhet me mësimet nga shpërthimet e epidemive të SARS dhe H1N1, në 2003 dhe 2009, të cilat i kishin nxitur kompanitë kineze të projektonin sisteme të teknologjisë së lartë, duke reduktuar punën e punëtorëve dhe duke rritur distancimin dhe masat e higjienës (The Economist, 08.04.2020). Nga kjo pikëpamje, si institucionet shtetërore edhe biznesi sot mund të mbështeten në modelet, zgjidhjet dhe masat e ndërmarra gjatë dy dhjetëvjeçarëve të fundit për të lehtësuar kapërcimin e krizës aktuale.

Pikërisht, problemi më i debatuar në literaturën ekonomike të specializuar nuk është vetëm kur fillon ngritja, por çfarë ristrukturimesh do të sjellë kjo ringritje (McKinesy, BCG, DeLoitte). Ky fakt evidentohet përmes disa elementëve si: saktësia e modeleve të parashikimit të efekteve ekonomike të politikave të caktuara, aftësia e qeverive në ristrukturimin e sektorëve të vecantë të ekonomisë dhe shkalla e prishjes së ekuilibrit të tregjeve të caktuara brenda një vendi. Këta elementë analizohen në vijim, duke filluar nga elementi që kushtëzoi këtë krizë, shëndeti.

3. Shëndeti - një e mirë publike dhe element i barazisë sociale.

Elementi i parë që ndryshoi pandemia e Covid-19 është konceptimi shoqëror për shëndetin publik. Kushtetutat e pothuajse të gjitha vendeve demokratike e njohin shëndetin si një "të drejtë themelore të individit" dhe mbrojtja publike e tij është një detyrë e domosdoshme. Në këtë aspekt shëndeti u konsiderua një e mirë publike globale (WHO, 2002).

Historikisht rëndësia e të mirave publike globale u evidentua si koncept në fund të viteve 1990 në debatin për globalizimin (Kaul et al., 1999) që analizoi në thellësi edhe çështjen e shëndetit. Banka Botërore vitet e fundit ka zhvilluar instrumente financiare të reformave shendetësore me një qasje ekonomike shumë të diskutueshme "të zhvillimit të tregut shendetësor" sidomos për të evituar rrezikun e një pandemie globale. (Stein & Sridhar, 2017). Vërtet shendetësia hyri në treg dhe zhvillohet me ritme shume të shpejta, por sa e garanton kjo politikë atë që të gjithë e quajnë sot siguri për shëndetin publik?

Siç dëshmohet nga debati për globalizimin në fillim të viteve 2000 (Plant, 2001), kur u rishfaq modeli neoliberal ekonomik që lehtësoi flukset e kapitalit dhe të mallrave, pati si pasojë krijimin e fuqive mbikombëtare për t'i menaxhuar ato. Gjithë këto vite kjo dukej qartë në ndërhyrjen e agjensive mbiqeveritare si Organizata Botërore e Tregtisë, Fondi Monetar dhe Banka Botërore, por dhe struktura private si qendrat financiare të Wall Street dhe City, kompanitë e vlerësimit financiar, kompanitë e mëdha shumëkombëshe, etj., të cilat kanë kushtëzuar ekonominë dhe politikën e shumë shteteve e kombeve në mbarë botën.

Në këtë mënyrë, u ndërtua një ekonomi e globalizuar e mallrave dhe kapitalit, pa kufizime në tregun e punës, me pak detyrime në ruajtjen e mjedisit dhe pa rregulla të forta financiare. Këto aspekte janë konsideruar gjithë këtë kohë "kosto" për ekonominë dhe pengesë për zhvillimin. Po a janë vërtet të tilla?

Pandemia vuri në pikpyetje të gjithë këta elementë. Njerëzit filluan të kuptojnë se një politikë për ndryshimin e sistemit të prodhimit duhet të fillojë me mbrojtjen e shëndetit, të vazhdojë me një "politikë të gjelbërt industriale" dhe të përfundojë në një ekonomi ciklike të mbyllur dhe të përshtatshme për zhvillim të qëndrueshëm. Kështu mund të realizohet një revolucion i pa parë në tregun ekonomik me në qendër shëndetin, ambjentin dhe inovacionin. (WEF, 2020).

Nga pikëpamja ekonomike, shëndeti është një e mirë publike globale sepse nuk mund të prodhohet si një produkt i shitur në treg për konsumatorët individualë. Bota dhe çdo vend kuptoi që tani mund të kërcënohet nga mungesa e shëndetit publik (ose, më saktësisht, nga shfaqja e epidemive) në çdo kohe e pikë të planetit dhe njerëzimi të humbasë pa kuptuar jo

vetëm nivelin ekonomik, por, mbi të gjitha, ekzistencën e tij. Për sa i përket të ardhurave dhe pasurisë, si rezultat i politikave neoliberalë, që nga vitet '80 të gjitha vendet e përparuar kanë pësuar rritje të mprehta të pabarazive ekonomike dhe sociale. Pandemia e C-19 evidentoi një koncept të ri të rëndësishëm që ka të bëjë me çështjen e pabarazisë.

Pas Luftës së Dytë Botërore, shteti i mirëqenies ishte një faktor thelbësor në zvogëlimin e pabarazive, pikërisht për shkak të natyrës së tij si furnizues i mallrave dhe shërbimeve bazuar në nevojat e jo në kenaqësitë. Siç është evidentuar në vite, zvogëlimi i politikave sociale, privatizimi i shërbimeve publike dhe shtrirja e tregut në zonat e mbrojtura më parë me veprim publik, ka futur mekanizma të rinj që gjenerojnë pabarazi ekonomike dhe sociale (Franzini & Pianta, 2016). Në një moment të caktuar historik në shekullin e ri dhe vitin e "dy njëzetave" kjo pandemi i bëri njerëzit barazisht të pafuqishëm dhe për pasojë të barabartë në mundësinë e prekjes nga kjo sëmundje. Ndoshta ky ishte një evidentim i barazisë natyrore që kanë njerëzit në shoqëri.

Lidhjet midis pabarazive ekonomike dhe pabarazive shëndetësore kanë qenë objekt analize në literaturën ekonomike. Është vërtetuar tashmë se sa më shumë rritet pabarazia, aq më shumë sundojnë kushte më të këqia sociale, të shëndetit dhe mirëqenies. Hendeqet e mëdha midis të pasurve dhe të varfërve shoqërohen me përkeqësim të kushteve shëndetësore dhe uljen e jetëgjatësisë së popullatës më të varfër (Wilkinson & Pickett, 2010; Cas & Deaton, 2020). Një raport nga Komisioni Europian mbi gjendjen e shëndetit thekson se në Komunitetin Europian "njerëzit me nivel më të ulët arsimimi, kualifikimesh dhe të ardhurash kanë tendencë të kenë sëmundje më të shumta dhe vdekshmëri më të lartë" (EC, 2017). Duke marrë parasysh efektet ekonomike të pabarazive në shëndetësi është llogaritur se "Shuma totale e kostove për shkak të pabarazive shëndetësore është afër 980 miliardë euro, ose 9.38% të PBB-së së BE-së ndaj 25 Shteteve Anëtare në 2014. Me fjalë të tjera, humbja e shëndetit për shkak të pabarazive socio-ekonomike përfaqëson 15% të kostove të sistemeve të sigurimeve shoqërore dhe 20% të kostove të sistemeve të kujdesit shëndetësor të Bashkimit Europian në tërësi" (Armiento, 2018).

Cuditërisht, epidemia krijoi një gjendje të "pothuajse barazisë" përballë probabilitetit të ngjittjes së sëmundjes, niveli i të ardhurave ka shumë pak rëndësi në këtë proces dhe nuk ka asnjë mënyrë për të blerë mbrojtje individuale në treg. Barazia në sjellje dhe trajtim shëndetësor bëhet kështu thelbësore për të luftuar epideminë. Por barazia, është një rezultat themelor i shtetit të mirëqenies, si dhe një objektiv kushtetues për të gjithë vendet demokratike. Si e tillë, ajo bëhet një përparësi politike e qeverive për kujdesin ekonomik, social dhe shëndetësor për epokën e post-epidemisë dhe shikohet si një nga sektorët kryesorë të zhvillimit dhe investimeve publike (WHO, 2019).

4. Elementët e përbashkët dhe pritshmëritë e politikave ekonomike për kapërcimin e krizës.

Angazhimi i menjëhershëm dhe i përbashkët i institucioneve ndërkombëtare të të gjitha fushave është tipari dallues i aktiviteteve që po zhvillohen në mbarë globin që nga fillimi i pandemisë. Shumë nga institucionet me influencë në vendimmarrjen ekonomike të shteteve rekomanduan për të gjitha vendet e prekura nga pandemia ndërhyrje "urgjente", me politika aktive ekonomike. OECD kërkonte "një përpjekje të koordinuar nga qeveritë dhe bankat qendrore për të kapërcyer krizën" (OECD, 30.03.2020). Pavarësisht se koncepti i ndërhyrjes aktive të shtetit në ekonomi është bërë një motiv bazë për gjithë drejtuesit e vendeve të zhvilluara, specialistët e FMN janë shumë të matur në gjykimin e politikave 'dorëlëshuara' të qeverive. Konfirmohet se vërtet është i nevojshëm një injeksion monetar i përmasave të mëdha, por gjithmonë duke pasur parasysh stabilitetin financiar (FMN, 09.03.2020).

Fondi Monetar Ndërkombëtar u kujtoi Qeverive të vendeve të prekura se pasi të ketë kaluar kriza shëndetësore, është e nevojshme "të implementohet një paketë e plotë e masave për të stimuluar rritjen ekonomike dhe për të përmirësuar aftësinë e rimëkëmbjes shoqërore". Kjo

politike duhet të përfshijë reforma strukturore për të rritur produktivitetin dhe investimet, konsolidimin e besueshëm të buxhetit afatmesëm me qëllim për të vendosur borxhin publik në një tendencë të uljes të sigurtë në të ardhmen. Gjithashtu këshillohet se duhen marrë masa për të mbështetur shëndetin e sektorit financiar, sepse – sipas eksperiencave nga krizat e mëparshme - ai do të karakterizohet nga lekundje shumë të mëdha.

Do rrisim borxhet, inflacionin apo të dyja së bashku? Kjo është pyetja që bëjnë specialistët e ekonomisë në të gjitha vendet e goditura nga pandemia. Nëse do të risim borxhin do të lëmë tek femijet tanë më shumë detyrime, më pak mundësi zhvillimi, më pak patenta dhe gjithmonë e më pak mundësi zhvillimi. Nëse risim inflacionin do të bëjmë të varfërit më të varfër dhe të pasurit më të pasur. Në një botë ku Covid-19 kërkonte barazi sociale, ky vendim është i vështirë. Kështu fillon përsëri përplasja teorike midis neoliberalëve dhe etatistëve për zhvillimin e ekonomisë.

Për t'ju kthyer prapë pyetjes së bërë më lart, lidhur me politikat e ndërhyrjes aktive në ekonomi me rastin e Covid-19 duhet të njohim nga afër parashikimet e bëra nga institutet e specializuara. Në epokën e koronavirusit një nga shqetësimet e evidentuara edhe nga FMN është mundësia e kthimit të borxhit privat në borxh shtetëror. Le të analizojmë shkurtimisht këtë mekanizëm dhe këto koncepte.

Cdo shtet duke akumuluar deficite buxhetore krijon në vite karshi subjekteve të tregut financiar një borxh shtetëror i cili sipas strukturës së tij është detyrim në monedha të ndryshme, në kohë të ndryshme dhe me garanci të ndryshme. Është një borxh që qeveritë mundohen ta manaxhojnë dhe rifinancojnë në kohë mbi bazën e politikave ekonomike sipas orientimeve ideologjike. Karakteristika themelore e tij është fakti që ky borxh nuk shlyhet por rifinancohet. Borxhi privat është përgjithësisht një detyrim që ka një subjekt privat për një kredi të marrë karshi një institucioni financiar për konsum apo investim. Është një borxh detyrimisht i kthyeshëm, vetëm përkohësisht i rifinacuashëm dhe mosrespektimi i tij con në shumicën e rasteve në falimentimin e shoqërisë, por dhe në rritjen e humbjeve të bankave të nivelit të dytë ose institucioneve të tjera kreditore.

Në treguesit statistikor makroekonomik modern, analizat e potencialit të zhvillimit të një vendi nuk behen tashme vetëm me vlerësimin e borxhit publik por dhe të atij privat, sepse instrumentat e reja financiare kanë krijuar një lidhje të ngushtë midis këtyre dy borxheve. Pavarësisht se borxhi shtetëror nuk shlyhet por rifinancohet përjetësisht, ndërsa ai privat shlyhet dhe nuk rifinancohet përjetësisht për ekonominë e një vendi, këta dy tregues janë dy anë të së njëjtës medaljeje. Koronavirusi dhe politikat ekonomike për mbështetjen e biznesit po nxjerrin në pah problemet që mund të sjellin kalimin e borxhit privat në një borxh publik. Vendet e ndryshme kanë përdorur politika të ndryshme financimi të biznesit të vogël që direkt ose indirekt cojnë në kalimin e borxhit privat në borxh publik.

Të gjitha politikat e ndërhyrjes aktive të shtetit në ekonomi me rastin e Covid-19 perfundonin në dhenien e financimeve buxhetore ose private me garanci buxhetore, sikurse evidentohet në raportin e Bankës Botërore "Global Economic Prospects" (BB, qershor 2020). Ato synonin të aktivizonin si tregun e konsumit ashtu dhe atë të kapitalit me shpresën që rritja e prodhimit dhe e GDP të mos lejonte rritjen e metejshme të raportit midis borxhit publik dhe produktit të brendshëm bruto. Kjo sollti në vëmendje të të gjithë qeverive të vendeve në të gjithë botën, plane të mëdha ristrukturimi për fushat e investimeve publike, ristrukturimin e degeve të ekonomisë për rritjen e qëndrueshme të ciklit ekonomik dhe domosdoshmerinë e rritjes së ekonomisë së gjelber.

Masat e kontrollit të vendosura nga qeveritë e vendeve të ndryshme për të frenuar përhapjen e pandemisë, ndikojnë në nivele të ndryshme në sektorët e ekonomisë. Një parashikim i masës së rënies së GDP, në mungesë të informacioneve të tjera, mund të bëhet vetëm duke marrë në konsideratë për secilën degë të veprimtarisë ekonomike këto elementë:

- Kohëzgjatjen e masave kufizuese të qeverisë sipas aktiviteteve,
- Peshën specifike që këto aktivitete kanë në vlerën totale të GDP,

- Nivelin e pritshëm të rënies së xhiros së këtyre aktiviteteve.
- Dizekuilibret e tregut të punës brenda këtyre aktiviteteve.

Rënia e pritshme e GDP do përllorritej në këto raste duke evidentuar nivelin e rënies së xhiros së pritshme të korrigjuar me peshën specifike që ky sektor kishte para pandemisë.

Vështirësia kryesore e këtij sistemi në modelin përkatës është që asnjë nga shifrat bazë nuk janë reale por të pritshme dhe mbi të gjitha të pritshme në kushte të ndryshme ekonomike. Modeli tremujor nuk është në gjendje të simulojë një skenar të tillë, por përmes rregullimeve në përbërësit e kërkesës agregate, mund të përllorarisim në një interval të caktuar rënien e GDP.

Kjo procedurë ka dy mangësi:

Së pari, mund të bëhet në një numër të pafundmë rezultatesh që përcaktohen nga masa e ndikimeve faktoriale. Kjo sjell parashikime joidentike duke u bazuar në të njëjtët faktorë, por në masa ndikimi të ndryshme për cdo faktor. Nëse pandemia e mbylli aktivitetin për një muaj apo për tre muaj nuk vërtetohet dot se ndikimi ka qenë konstant dhe nuk ka qenë më i vogël në muajin e parë dhe më i madh në muajin e tretë apo anasjelltas. Kështu po të ndryshojë GDP, në intervalin e ndyshit të saj ndryshojnë të gjithë variablat e tjerë.

Së dyti, nuk lejon të vlerësohet ndërveprimi midis ofertës dhe kërkesës për të njëjtin produkt në pjesë të ndryshme të tregut ose të kanaleve të shpërndarjes. Një shembull tipik është ai që përfaqësohet nga shitja e disa produkteve ushqimore, si për shembull vera, e cila u prek rëndë nga mbyllja e restoranteve, pavarësisht se hynte në tregun e ushqimeve, treg i cili nuk pati rënie, përkundrazi u rrit sepse supermerkatet mbetën të hapura.

Mënyra më e thjeshtë për të analizuar një skenar të tillë është të modifikohen vlerat e treguesve me metodën e sistemit “ad factors” që përllorarit vlerën me metoda të ndryshme të një aseti ekonomik. Përcaktimi i intervalit të vlerësimit të një treguesi (psh. xhiros) behet me interval nga një nivel i ulët tek një më i lartë dhe për këtë interval shihen se cilët faktorë mund të ndikojnë më shumë. Në këtë mënyrë përcaktohet dhe pesha specifike e ndikimit të faktorëve të ndryshëm dhe si lëviz ajo me luhatjen e treguesit në interval. Si pasojë e masave kufizuese ose të kontrollit, punësimi dhe të ardhurat nga puna janë në rrezik për shumë familje, gjë që çon në një ulje të shpenzimeve të konsumatorit, por në disa raste për shkak të mbylljes drastike, në një rritje të kursimeve paraprake.

Një formë tjetër e vlerësimit është analiza e tregjeve të vecanta dhe ekuilibrave të tyre. Duke u nisur nga një numër faktorësh si ashpersia e shpërthimit të Covid-19, strukturat demografike, gjeografia ekonomike, strukturat e tregjeve të punës dhe madhësia e mbështetjes financiare të ofruar, disa vende mund ta kenë më të lehtë të dalin nga distancimi social dhe të rimëkëmbin ekonominë. E tillë është analiza për një numër vendesh të rajonit, përfshirë Shqipërinë, që mbështetet në dy grupime faktorësh, sipas ekspertëve të BERZH (EBRD, 08.06.2020).

Grupi i parë i faktorëve merr në shqyrtim se sa e ashpër ishte përhapja e virusit në popullatat e vendeve dhe sa të ashpra ishin masat kufizuese. Kjo analizë është në vijim të asaj të bërë në fillim të muajit prill po nga BERZH për vendet anëtare të kësaj organizate, që lidhej me qendrueshmërinë dhe aftësinë e cdo vendi për të përballuar pandeminë në aspektin e kohëzgjatjes dhe masës së dëmeve ekonomike individuale e në nivel biznesi/ vendi (Tab. nr.1).

Tabela nr. 1 – analizë e rezistencës së vendeve ndaj krizës shndetësore-ekonomike (prill 2020)

1. Shpërthimi dhe distancimi						
Ashpersia e shpërthimit dhe bllokimi/ lockdown			Kushtet për distancimin social			
	ashpersia e shpërthimit	ndjeshmeria demografike	ashpersia e kufizimeve	dendësia popullore lokalizuar	qytete me mbi 1 mln banore	masa e pop. Në qytete me mbi 300.000 banore
Ballkani Perendimor						
Albania	low	moderate	moderate	moderate	low	moderate
Bosnia and Herzegovina	moderate	high	moderate	low	low	low

Kosovo	low	moderate	moderate	low	low	low
Montenegro	low	moderate	moderate	low	low	low
North Macedonia	moderate	moderate	moderate	low	low	moderate
Serbia	moderate	high	moderate	moderate	moderate	moderate

2. Lehtësia e rimekmbjes									
		Kushtet e tregut të punës dhe lehtësitë nga qeveritë				Struktura e ekonomisë			
		masa e kontratave të perkohshme	punësimi në SME	vetëpunësimi	mbështetja financiare	punësimi në sektorin publik	punësimi në sektorët më të prekshëm	varesia e ekonomisë nga pak sektore	varesia nga pak partnerë tregëtarë
Ballkani Perëndimor									
Albania		moderate	high	high	low	low	high	moderate	high
Bosnia and Herzegovina		moderate	low	moderate	low	moderate	moderate	moderate	moderate
Kosovo		moderate	moderate	moderate	low	high	high	moderate	high
Montenegro		moderate	high	moderate	low	high	high	moderate	moderate
North Macedonia		low	high	moderate	low	moderate	moderate	moderate	high
Serbia		moderate	moderate	high	high	moderate	moderate	low	low

Duke ju referuar vetëm vendeve të rajonit tonë, vërehet ndryshueshmëria e ndikimit të faktorëve të tregut të punës dhe e strukturës ekonomike. Në kushtet e Shqipërisë përqindja e lartë e punësimit në SME dhe e vetëpunësimit, kombinuar me një mbështetje jo të lartë financiare nga ana e shtetit e bën më të vështirë kapërcimin e situatës për bizneset shqiptare (markuar me ngjyrë të kuqe). Struktura e ekonomisë, me një masë të madhe të përfaqësuar nga turizmi dhe shërbimet – sektorët më të prekshëm në të gjitha vendet – dhe varësia nga relativisht pak partnerë tregëtarë (për furnizimin me inpute në shumë sektorë dhe për tregjet e shitjes për sektorin facon, call centers, etj.) gjithashtu e bëjnë më pesimist skenarin e daljes nga kriza, në aspektin e kohëzgjatjes. Nga ana tjetër, struktura e ekonomisë me një shumëllojshmëri aktivitësh prodhimi (bujqësi, ndërtim, industri ushqimore) që mundën të vazhdonin aktivitetin dhe tashmë janë rikthyer pak a shumë me kapacitet të plotë, mundëson rimëkëmbjen më të shpejtë të ekonomisë në tërësi, duke ju afruar një skenari më optimist. Sidoqoftë, sikurse sugjeron Banka Botërore në analizën për Shqipërinë (WB ReR17 Albania) reformat strukturore për të përmirësuar mjedisin e biznesit dhe adresimin e fushave të tjera që janë pengesa për rritje të qëndrueshme dhe më të lartë ekonomike do të ndihmojnë në rritjen e fleksibilitetit të ekonomisë.

5. Konkluzione.

Një punim i vetëm, sado i gjerë qoftë, do ta kishte të pamundur të trajtonte shumëllojshmërinë e problematikave që pasiguria e një krize të tillë ka shkatëruar në nivel global. Aq më pak, të mund të përmbledhonte skenarët dhe politikat ekonomike që mund të conin në daljen prej saj dhe në rimëkëmbjen ekonomike të vendeve. Gjithsesi, analiza jonë e mësipërme lejon të theksojmë disa përfundime.

1 - shëndeti është një e mirë publike globale, sepse nuk mund të prodhohet si një produkt i shitur në treg për konsumatorët individualë. Bota dhe çdo vend mund të kërcënohet nga mungesa e shëndetit publik në çdo kohë e pikë të planetit dhe njerëzimi mund të humbasë pa kuptuar jo vetëm nivelin ekonomik, por, mbi të gjitha, ekzistencën e tij. Për rrjedhojë kujdesi

ekonomik, social dhe shëndetësor për epokën e post-epidemisë do duhet të bëhet një përparësi politike e qeverive dhe të shikohet si një nga sektorët kryesorë të zhvillimit dhe investimeve publike.

2 – krizat e mëparshme, sidomos të këtij shekulli, na mësojnë që vendet, industritë dhe bizneset preken në masa të ndryshme dhe pasojat kapërcehen me politika ekonomike të përshtatura sipas vendeve. Megjithëse kriza aktuale, ndryshe nga të tjerat, ishte jo thjesht financiare, zgjidhjet lidhen ngushtësisht me injektimin e fondeve në ekonomitë e prekura (pothuajse në të gjithë botën) duke bërë kujdes për stabilitetin financiar.

3 – skenarët e rimëkëmbjes duhet të marrin parasysh strukturën ekonomike të çdo vendi dhe të realizohen duke vënë si përparësi ristrukturimin e ekonomisë drejt formave të reja të biznesit, produkteve të reja, ekonominë me cikël të mbyllur dhe zhvillimin e gjelbër. Këto skenarë do të vendosin ekuilibra të rinj edhe në tregun financiar, me përparësi bizneset digjitale.

Bibliografi

- Armiento, M. "The Sustainable Welfare Index: Towards a Threshold Effect for Italy". In Ecological Economics, 2018.
- Case, A., Deaton, A., Deaths of Despair and the Future of Capitalism, 2020.
- Credit Suisse Global Wealth Report - inequality.org, 2017.
- Franzini, M., Pianta, M. The Engines of Inequality. Intereconomics 51, 49–55, 2016. <https://doi.org/10.1007/s10272-016-0576-0>
- HBR, Coronavirus and Business: The insights you need from Harvard Business Review, March 2020.
- Kaul, I., O. Grunberg, M. A. Stern. Global public goods: international cooperation in the 21st century, New York: Oxford University Press, 1999.
- IMF (FMN), "Greece, preliminary debt sustainability analysis – updated estimates and further considerations", Mat 23, 2016.
- Yglesias, M., The Fed and the 2008 financial crisis, Vox, 13.05.2015.
- Pierre Olivier Gourinchas, Philippe Martin, Todd Messer The Economics of Sovereign Debt, Bailouts and the Eurozone Crisis https://www.ecb.europa.eu/pub/conferences/shared/pdf/2017_1120_fiscal_conference
- Plant, R., Politics, Theology and History, Cambridge University Press, 2001.
- Raport i Komisionit Evropian, 2017, https://ec.europa.eu/health/sites/health/files/state/docs/2017_companion_en.pdf
- Stein, F.; Sridhar, D. Health as a "global public good": Creating a market for pandemic risk. August 2017 DOI: 10.1136/bmj.j3397
- The Economist (08.04.2020) Still made in China, <https://www.economist.com/briefing/2020/04/08/how-to-reopen-factories-after-covid-19>
- WHO Commission on Macroeconomics and Health. Working Group 2. Global public goods for health, 2020.
- Wilkinson R., Pickett, K., The spirit level: why equality is better for everyone, 2010.
- World Economic Forum (2020), <https://www.weforum.org/reports/the-global-risks-report-2020>
- https://blogs.imf.org/2020/03/09/limiting-the-economic-fallout-of-the-coronavirus-with-large-targeted-policies/?utm_medium=email&utm_source=govdelivery
- https://read.oecd-ilibrary.org/vieè/?ref=126_126496-evgsi2gmqj&title=Evaluating_the_initial_impact_of_COVID-19_containment_measures_on_economic_activity
- <https://www.ecb.europa.eu/pub/projections/html/index.en.html>

- https://www.federalreservehistory.org/essays/great_recession_of_200709 The great recession November 22, 2013.
- <https://www.teleborsa.it/>
- <https://www.worldbank.org/en/news/press-release/2020/03/30/east-asia-and-pacific-countries-must-act-now-to-mitigate-economic-shock-of-covid-19>
- <https://www.mckinsey.com/industries/public-sector/our-insights/saving-our-livelihoods-from-covid-19-toward-an-economic-recovery#>
- <https://www.mckinsey.com/featured-insights/leadership/the-future-is-not-what-it-used-to-be-thoughts-on-the-shape-of-the-next-normal>
- <https://www2.deloitte.com/global/en/pages/about-deloitte/articles/institute-crisis-and-resilience-planning.html>

BLLOKIMI I AKTIVITETIT EKONOMIK GJATE PANDEMISE COVID-19 DHE DETYRIMI PER RAPORTIM FINANCIAR

Msc.Sonila Nikolla
Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë
sonila.nikolla@umsh.edu.al
Prof. As. Greta Angjeli
Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë
gretaangjeli@umsh.edu.al

Abstrakt

Drejtimi dhe menaxhimi i njësive ekonomike duhet të marrë në konsideratë, ngjarjet e ndodhura pas përfundimit të pedhiudhës kontabël dhe ndikimin e tyre në matjen dhe vlerësimin e elementëve të pasqyrave financiare. Aktualisht për shkak të situatës së Covid-19 është shtyrë afati i dorëzimit të Pasqyrave Financiare të cilat po përgatiten mbi bazën e shqetësimit të vazhdueshëm nëse aktiviteti i pezulluar përkohësisht do të ndërpritet përfundimisht apo ka alternativa për ristrukturim. Kjo shtyrje e afatit të dorëzimit paraqet një problem në hartimin dhe dorëzimin e pasqyrave financiare të vitit 2019, duke marrë parasysh nëse ngjarjet që ndodhën pas fundit të vitit kanë një rëndësi të konsiderueshme për biznesin dhe për palët e treta të lidhura me të.

Ngjarjet të cilat kanë ndodhur pas fundit të vitit dhe që kanë ndikim në pasqyrat financiare duhet të përfshihen në vlerat e bilancit referuar parimit të kompetencës dhe nëse nuk janë në kompetencën e vitit raportues duhet të merren në konsideratë për rëndësinë e tyre. Por, më e rëndësishme është evidentimi i ngjarjeve pasuese të cilat ndikojnë dhe vënë në rrezik vazhdimësinë e biznesit. Raportimi financiar duhet të jetë cilësor dhe besueshmëria e informacioneve financiare që percjell kontribuon në vendimmarrjen ekonomike të biznesit duke e bërë dhe një faktor shumë të rëndësishëm për një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm të vendit.

Fjalë kyçe: Raportim financiar, Covid-19, Pasqyra financiare, Vazhdimësia e biznesit

Abstract

The Management of commercial companies should take into account the events that occurred after the completion of the financial year and their impact on the measurement and evaluation of the elements of financial statements. Currently, due to the situation of Covid-19, the deadline for submission of Financial Statements which are being prepared on the basis of constant concern whether the temporarily suspended activity will be terminated or if there are alternatives for restructuring is postponed. This postponement of the submission deadline presents a problem in drafting and submitting the financial statements of 2019, taking into account whether the events that occurred after the end of the year are of significant importance to the business and to the third parties related to it.

Events that occurred after the end of the year and that have an impact on the financial statements should be included in the balance sheet values referring to the principle of competence and if they are not within the competence of the reporting financial year they should be considered for their importance. But more important is the identification of subsequent events that affect and risk the continuity of the business. Financial reporting should be qualitative and the reliability of the financial information that derives from it contributes towards to the economic decision-making of the business, making it a very important factor for a sustainable economic development of the country.

Keywords: Financial Reporting, Covid-19, Financial Statement, Business Continuity

Hyrje

Ndërsa pandemia po zgjerohet, njësitë ekonomike po përballen me kushte të vështira, të shoqëruara me sfida që kërkojnë jo vetëm zgjidhje afatshkurtra por dhe afatmesme e më tej, sfida të lidhura dhe me zhvillimet ekonomike të vendit. Praktikisht u gjenden të papërgatitura të gjitha njësitë ekonomike të bujqësisë, shërbimeve, industrisë etj., për t'u përballur me situatën e gjendjes së jashtëzakonshme. Tashmë pasiguria po sjell paqëndrueshmeri në tregjet financiare, përkeqësim të dukshëm të situatës së kredisë, probleme me likuiditetin, rritje të ndjeshme të papunësisë, rënie të shpenzimeve të konsumatorit duke u shoqëruar me një rënie të të hyrave buxhetore. Njësitë ekonomike po përballen me probleme të nivelit të inventarit, mungesa ose teprica, dhe reduktim të konsiderueshëm të prodhimit për shkak të masave të marra në të gjithë botën për ndalimin e prodhimit, vështirësitë në eksporte etj., që kanë çuar në ulje të kërkesës si dhe me probleme që lidhen me likuiditetin, probleme këto që tashmë i kalojnë kufijtë e një njësie ekonomike të vetme duke kërkuar më shumë se asnjëherë një ndërhyrje të qeverisë në marrjen e masave lehtësuese për të mundësuar vazhdimësinë e aktivitetit ekonomik pasi kjo katastrofë të ketë kaluar.

Kuadri ligjor i përgatitjes së pasqyrave financiare

Standartet e kontabilitetit (SKK 1)- Kuadri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, në pjesën "PARIMI I VIJIMËSISË" theksojnë:

"Pasqyrat financiare përgatiten sipas parimit të vijimësisë, që do të thotë se veprimtaria ekonomike e njësisë ekonomike do të ketë vijimësi dhe njësia ekonomike nuk ka në plan ose nuk do ta ketë të nevojshme ta ndërpresë aktivitetin e saj. Nëse pasqyrat financiare nuk përgatiten në përputhje me parimin e vijimësisë, parimi tjetër kontabël i përdorur për përgatitjen e tyre, duhet të sqarohet në shënimet shpjeguese.

Gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare, drejtuesit duhet të vlerësojnë mundësinë e njësisë ekonomike për të vazhduar aktivitetin e saj për 12 muaj pas datës së pasqyrave financiare. Nëse kjo vazhdimësi aktivitetesh të njësisë ekonomike nuk është e sigurt (për shembull, njësia ekonomike nuk i plotëson kërkesat ligjore), drejtuesit e njësisë ekonomike duhet të sqarojnë në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare, kushtet dhe rrethanat që e shkaktojnë këtë pasiguri. Nëse njësia ekonomike ka filluar procesin e likuidimit ose është e mundur që brenda 12 muajve të ardhshëm njësia ekonomike do ta likuidojë ose do t'i duhet që ta likuidojë aktivitetin e saj, atëherë pasqyrat financiare duhet ta reflektojnë këtë fakt si dhe bazën e vlerësimit të aktiveve dhe detyrimeve."

Gjithashtu i njëjti standart më poshtë thekson: "NGJARJET PAS PËRFUNDIMIT TË PERIUDHËS RAPORTUESE"

Kontabilizimi i ngjarjeve që ndodhin pas mbylljes së periudhës raportuese, por para datës kur pasqyrat financiare autorizohen për t'u publikuar, varet nga fakti nëse këto ngjarje janë të tilla që kërkojnë rregullim ose jo.

Ngjarja pas periudhës raportuese për të cilën duhet të bëhen rregullime, është një ngjarje që evidenton kushte që kanë ekzistuar në datën e mbylljes së periudhës raportuese. Një njësi ekonomike duhet të rregullojë shumat e njohura në pasqyrat e saj financiare, duke përfshirë dhënien e informacioneve përkatëse shpjeguese, për të pasqyruar ngjarjet rregulluese pas përfundimit të periudhës raportuese. Ngjarjet, për të cilat nuk bëhen rregullime janë ngjarjet që nuk evidentojnë kushtet që kanë ekzistuar pas mbylljes së periudhës raportuese. Njësia ekonomike nuk do të korrigjojë shumat e njohura në pasqyrat e saj financiare për të reflektuar ngjarjet për të cilat nuk bëhen rregullime, pas përfundimit të periudhës raportuese. Efekti i ngjarjeve për të cilat nuk bëhen rregullime do të përshkruhet në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare nëse ato janë materiale.

SHËNIMET SHPJEGUESE:

Njësia ekonomike duhet të japë informacionet e mëposhtme shpjeguese për çdo kategori ngjarjeje pas përfundimit të periudhës raportuese, që nuk mund të rregullohet: (a) llojin e ngjarjes; (b) një vlerësim të efektit të saj financiar; (c) një deklaratë që një vlerësim i tillë nuk mund të bëhet.

Nëse ka pasiguri në lidhje me vazhdimësinë e veprimtarisë së njësies ekonomike, në shënimet shpjeguese duhet të jepen faktorët që shkaktojnë këtë pasiguri. Nëse pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e likuidimit të operacioneve të njësies ekonomike, atëherë do të shpjegohet arsyeja dhe baza e përgatitjes.

Por le të ndalemi në Raportimin Financiar dhe Aktin normativ të Këshillit të Ministrave për shtyrjen e afatit të dorëzimit të tyre në situatën e COVID -19 dhe masave të marra për ndalimin e shumë aktiviteteve ekonomike. Më datë 26.03.2020 hyri në fuqi Akti Normativ nr. 10 për një ndryshim në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar. Bazuar në këtë akt tatimpaguesit mund t'ë dorëzojnë pasqyrat e tyre financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 në sistemin e tatimeve, brenda datës 31 korrik 2020.

Aktualisht për shkak të situatës së COVID-19, shtyrja e afatit të dorëzimit të pasqyrave financiare, ka sjellë dhe përgatitjen e tyre mbi bazën e shqetësimit të vazhdueshëm (në kushtet kur asnjë nuk e di se sa do të zgjasë kjo situatë) nëse aktiviteti i pezulluar përkohësisht do të ndërpritet përfundimisht apo ka alternativa për ristrukturim. Kjo shtyrje e afatit të dorëzimit paraqet një problem në hartimin dhe dorëzimin e pasqyrave financiare të vitit 2019, ndoshta përpara kthimit në normalitet, duke marrë parasysh nëse ngjarjet që ndodhën pas fundit të vitit kanë një rëndësi të konsiderueshme për biznesin dhe për palët e treta të lidhura me të.

Pandemia po krijon jo pak probleme tek njësitet ekonomike të cilat duhet të marrin në konsideratë nëse kjo situatë do të vazhdojë gjatë, gjendje e cila sjell ulje të prodhimit, ulje të kërkesës për produkte dhe shërbime, ose mungesë të konsiderueshme të likuiditetit ose edhe të dyja bashkë. Gjatë vlerësimit drejtimi duhet të identifikojë ngjarjet dhe kushtet të cilat mund të çojnë në dështim të biznesit duke marrë në konsideratë pasigurinë dhe suksesin e mundshëm të këtyre ngjarjeve dhe duke gjetur përgjigje realiste për të zbutur këtë pasiguri.

Në situatën aktuale vlerësimi bëhet pak më i vështirë duke marrë parasysh paqartësitë në lidhje me kohëzgjatjen e situatës si dhe të masave për distancimin social në fuqi, ndaj drejtimi duhet të marrë në konsideratë, jo vetëm ndikimin e situatës në ekonomi por situatën specifike të njësies duke u fokusuar në burimet aktuale dhe potenciale të parasë duke përfshirë këtu dhe masat e marra nga qeveria mbi lehtësitë e financimit. Në këtë moment informacioni duhet të fokusohet në masat që aktualisht po merr qeveria dhe si ndikojnë ato në aftësinë e njësies për të operuar apo dhe të programeve të asistencës ndaj të cilave mund të përfitojë.

Në rast kur drejtimi është i vetëdijshëm për paqartësi materiale të cilat hedhin dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e njësies ekonomike për të vazhduar aktivitetin atëherë është e nevojshme që kjo pasiguri të shpjegohet si dhe ndikimi i saj në burimet e njësies, në likuiditet dhe aftësinë paguese.

Ndikimi i covid-19 në pasqyrat financiare për periudhat raportuese që përfundojnë pas 31 dhjetorit 2019

Ngjarjet që kanë ndodhur pas fundit të vitit dhe që kanë ndikim në pasqyrat financiare duhet të përfshihen në vlerat e bilancit referuar parimit të kompetencës, nëse nuk janë në kompetencën e vitit raportues duhet të merren në konsideratë për rëndësinë e tyre. Por, më e rëndësishme është evidentimi i ngjarjeve pasuese të cilat ndikojnë dhe vënë në rrezik vazhdimësinë e biznesit. Për disa biznese, të cilat ndodhën në një pozicion të mirë financiar dhe të cilat nuk e kanë ndërprerë aktivitetin e tyre, ose një pjesë të rëndësishme të tij, kjo situatë mund të kalohet me pak probleme, pavarësisht kohëzgjatjes së saj, por për një pjesë të konsiderueshme të bizneseve duhet marrë seriozisht në konsideratë vlerësimi i vijimësisë së biznesit. Të gjithë ato

biznese të cilave u është dashur të ndërpresin totalisht aktivitetin, nëse kjo gjendje e jashtëzakonshme vazhdon për një kohë të gjatë, në kontekstin e një situatë ku mungon ekuilibri ekonomik dhe financiar, gjenden përballë një situatë ku duhet të hartojnë pasqyrat financiare të vitit 2019 në gjendje jo-aktiviteti, paditur nëse do të jetë e mundur t'i rikthehen aktivitetit normal. Gjatë vlerësimit bizneset duhet të fokusohen mbi dinamikën e ardhshme financiare, të vlerësojnë aftësinë paguese të klientëve, të analizojnë rikuperueshmërinë e inventarit, të përcaktojnë ndikimin në asetet e saj dhe çdo investim në kompani të tjera si dhe mundësinë e përballimit të detyrimeve.

Standarti ndërkombëtar i kontabilitetit 10 përcakton ngjarjet të cilat nuk korrigjohen pas periudhës raportuese. Standarti kërkon që një njësi ekonomike të mos përgatise pasqyrat financiare mbi një bazë vijimesie nëse ngjarjet pas periudhës së raportimit deshmojnë se hipoteza e vijimesisë nuk është e përshtatshme. Nëse ndikimi i përhapur i COVID-19 filloi gjatë periudhës së raportimit të njësisë ekonomike, ndikimi do të pasqyrohet në pasqyrat e saj financiare për atë periudhë. Sidoqoftë, në rastin që ndikimi COVID-19 ndodhi gjatë "periudhës së ngjarjeve vijuese" të njësisë ekonomike (d.m.th. periudha midis fundit të periudhës së raportimit dhe datës kur pasqyrat financiare janë të gatshme për publikim), menaxhimi duhet të përcaktojë se si zhvillimet pas përfundimit të vitit duhet të pasqyrohen në pasqyrat financiare të njësisë ekonomike për periudhën nën rishikim.

Në përputhje me SNK 10 'Ngjarjet pas periudhës së raportimit', njësisë ekonomike u kërkohet të bëjnë dallimin midis ngjarjeve të mëvonshme që kërkojnë rregullim (d.m.th. ato që ofrojnë dëshmi të mëtejshme të kushteve që ekzistojnë në datën e bilancit) dhe jo rregulluese (d.m.th. ato që janë tregues i kushteve që u krijuan pas datës së bilancit). Subjekteve u kërkohet të rregullojnë shumat e njohura në pasqyrat e tyre financiare për të pasqyruar çdo ngjarje rregulluese që ndodh gjatë periudhës së ngjarjeve vijuese. A është ndikimi i COVID-19 një ngjarje rregulluese për periudhat e raportimit që përfundoi më 31 dhjetor 2019 (ose më parë)? Në këndvështrimin tonë, ndikimi i COVID-19 është përgjithësisht një ngjarje pasuese jo rregulluese për periudhat e raportimit të përfunduara në ose para 31 Dhjetorit 2019. Si pasojë, nuk do të ketë ndikim në njohjen dhe matjen e aktiveve dhe detyrimeve në pasqyrat financiare të një njësie ekonomike.

Pasqyrat financiare për një njësi ekonomike me një periudhë raportuese që përfundon në ose para 31 dhjetorit 2019 duhet të pasqyrojnë vetëm kushtet që ekzistuan në 31 Dhjetor 2019 dhe për këtë arsye duhet të përjashtojë efektet domethënëse të shpërthimit të COVID-19. Sidoqoftë, njësitë ekonomike do të duhet të përcaktojnë nëse duhet të japin shënime shpjeguese shtesë për të përshkruar ndikimet e shpërthimit në periudhën e ngjarjeve vijuese.

Në përgjithësi, duhet të jepen shënime të atyre ngjarjeve gjatë periudhës së ngjarjeve vijuese që nuk kanë të bëjnë me kushtet që ekzistojnë në datën e pasqyrave financiare, por që shkaktojnë ndryshime të rëndësishme në aktivet ose detyrimet në periudhën pasuese dhe ose mund të ketë një efekt domethënës në veprimtarinë e ardhshme të njësisë ekonomike. Për ngjarjet jo-rregulluese materiale, një njësi ekonomike duhet të shpallë (a) një përshkrim të natyrës së ngjarjes; (b) një vlerësim të efektit financiar, ose një deklaratë që një vlerësim i tillë nuk mund të bëhet. Për më tepër, njësi ekonomike duhet të marrë parasysh vlerësimin e tyre për parimin e vijimesisë dhe të rregullojë pasqyrat financiare, siç është e përshtatshme.

Që nga fundi i janarit të vitit 2020, numri i rasteve të COVID-19 dhe vendeve të prekura jashtë Kinës është rritur me shpejtësi, dhe më 11 mars 2020, OBSH deklaroi COVID-19 si një pandemi globale. Gjatë kësaj periudhe, qeveritë kombëtare dhe organizata të ndryshme të sektorit privat kanë ndërmarrë masa të konsiderueshme për të frenuar virusin, përfshirë karantinat dhe mbylljen e shkollave, dyqaneve, kantierëve/uzinave dhe kufijve. Pasojat e shpërthimit kanë kontribuar gjithashtu në paqëndrueshmëri të konsiderueshme në bursat botërore të aksioneve që nga fundi i shkurtit 2020. Për periudhat e raportimit pas 31 Dhjetorit 2019 (d.m.th. periudhat e raportimit që përfundojnë në vitin 2020), kishte më shumë informacion që përgatitësit dhe pjesëmarrësit e tregut do t'ju duhet të faktojnë në supozimet dhe vlerësimet e tyre. Prandaj, sa

më vonë është periudha e raportimit pas 31 dhjetorit 2019, aq më e madhe është nevoja të merret parasysh nëse ndikimet e COVID-19 në periudhën e ngjarjeve vijuese duhet të konsiderohen si ngjarje që kërkojnë rregullim. Për periudhat që përfundojnë pas 31 dhjetorit 2019, njësitë duhet të përdorin gjykimin e tyre për të përcaktuar ndikimin e COVID-19. Ata duhet të marrin në konsideratë me kujdes kushtet që ishin të pranishme në datën e raportimit.

Kjo mund të mos rezultojë domosdoshmërisht në njësitë që arrijnë në të njëjtin përfundim për të njëjtën datë raportimi. Menaxhmenti duhet të marrë parasysh rrethanat specifike që lidhen me operimet e njësive ekonomike dhe ngjarjet përkatëse që ekzistojnë në juridiksionin e tyre në atë kohë. Për shembull, disa vende janë vënë në bllokim dhe u është thënë njerëzve që të mos largohen nga shtëpitë e tyre dhe disa vende jo. Nëse, për shembull, njësi ekonomike është në industrinë e mikpritjes, kjo mund të ketë një ndikim të madh. Kur ky gjykim ka një ndikim të konsiderueshëm në shumën në pasqyrat financiare, ai duhet të shpaloset në përputhje me SNK 1. Kur përcaktohet që COVID-19 ishte një ngjarje që ekzistonte dhe shkaktoi një ndikim në operacionet në ose para datës së raportimit, ngjarjet pas datës së raportimit duhet të llogariten si ngjarje rregulluese. Parimi i vijimësisë vlerësimi nëse një njësi ekonomike vazhdon punën në bazë të parimit të vijimësisë SNK 1 përmban udhëzime në lidhje me supozimin e vijimësisë dhe përshkruan kur pasqyrat financiare përgatiten mbi supozimin që njësi ekonomike do të vazhdojë në vijimësi për të ardhmen e parashikueshme.

SNK 1 shprehet në mënyrë të qartë që në çdo datë raportimi, menaxhmenti kërkohet të vlerësojë aftësinë e njësive ekonomike për të përmbushur parimin e vijimësisë dhe të konsiderojë të gjithë informacionin në dispozicion i për të ardhmen, i cili është të paktën, por nuk është i kufizuar në, dymbëdhjetë muaj nga data e raportimit vjetor. Menaxhmenti duhet të marrë parasysh një gamë të gjerë faktorësh, siç janë: Përfitueshmeria e tashme dhe e pritur, afatet e ripagimit të borxhit dhe burimet e mundshme të financimit alternativ dhe aftësinë për të vazhduar ofrimin e shërbimeve. Nëse menaxhmenti arrin në përfundimin se njësi ekonomike mund të likuidohet (ose me zgjedhje ose sepse nuk ka alternativë tjetër realiste, përveçse ta bëjë këtë), parimi i vijimësisë nuk do të ishte i duhuri dhe pasqyrat financiare mund të duhet të përgatiten në një bazë tjetër, si p.sh. baza e likuidimit.

Nëse ka paqartësi materiale në lidhje me aftësinë e njësive ekonomike për të operuar në vijimësi, njësi ekonomike duhet të japë shënime shpjeguese rreth parimit të vijimësisë në pasqyrat të saj financiare. Për shkak se vlerësimi në lidhje me aftësinë e një njësie ekonomike për të operuar në vijimësi përfshin periudhën jo më pak se dymbëdhjetë muaj nga data e raportimit vjetor, të gjitha ngjarjet që ndodhin gjatë periudhës së ngjarjeve pasuese të një njësie ekonomike duhet të merren parasysh kur vlerësojnë nëse ka dyshime të arsyeshme për aftësinë e njësive ekonomike për të vazhduar në vijimësi. Me fjalë të tjera, edhe nëse ngjarjet gjatë periudhës së ngjarjeve vijuese nuk konsiderohen rregulluese, ato gjithsesi duhet të përfshihen në vlerësimin parimit të vijimësisë. Për më tepër, ngjarjet ose kushtet që hedhin dyshime të mëdha në aftësinë e një njësie ekonomike për të operuar në vijimësi duhet të shpalosen nëse janë paqartësi materiale ose nëse një sasi e konsiderueshme gjykimi është i përfshirë në arritjen e konkluzionit që parimi i vijimësisë është i duhuri.

Autoritetet rregullatore dhe qeveritë në shumë vende kanë pranuar faktin që bizneset po përballen me vështirësi në përmbushjen e afateve të raportimit për shkak të pengesave të paraqitura nga COVID-19, ndaj dhe kanë ofruar lehtësira për raportimin financiar, kryesisht në formën e zgjatjes së afateve të raportimit ose ofrimit të mundësisë që ata të aplikojnë për zgjatje të këtij afati. Në SHBA, Komisioni i Sigurisë dhe Bursës (SEC) dhe Bordi i Mbikëqyrjes Publike për Entitetet Kontabël (PCAOB) kanë rënë dakord që dhënia e shënimeve shpjeguese në pasqyrat financiare duhet të përfshijë edhe ndikimin e situatës aktuale. Ndërsa lehtësirat do të vendosen në varësi të rastit, por në varësi të rrethanave këto mund të ndryshojnë dhe të vendosen edhe më gjerë. Profesionistët kontabël në Mbretërinë e Bashkuar kanë paralajmëruar se vlera e instrumentave financiare do të bëhet e paqëndrueshme, kështu që raportimi financiar dhe dhënia e shënimeve shpjeguese që lidhen me to duhet të përcjellë të

gjitha efektet materiale të COVID-19. Qeveria britanike ka marrë masa për të shtyrë afatin e pagesës së detyrimeve tatimore për t'i ndihmuar sadopak bizneset në këtë periudhë të vështirë, pavarësisht se nuk dihet ndikimi afatshkurtër ose afatgjatë i koronavirusit. Në Belgjikë disa profesionistë kontabël kanë ndërmarrë individualisht iniciativën për të siguruar informacion në lidhje me klientët e tyre mbi procedurat e disponueshme për subjektet që hasin vështirësi financiare gjatë krizës ekonomike aktuale. Gjithashtu në Belgjikë Covid-19 njihet si një arsye që bizneset e vogla dhe të mesme të kërkojnë papunësi të përkohshme, shtyrjen e pagesave të TVSH-së, kontributeve për sigurimet shoqërore, etj. Shumë vende të tjera kanë shtyrë të gjitha afatet për pagesat e detyrimeve tatimore dhe deklarimin e pasqyrave financiare. Në Kinë, vendi nga i cili nisi kjo pandemi, njofton se ato entitete të cilat nuk mund të plotësojnë dot afatet për dorëzimin e pasqyrave financiare të 2019 dhe për tremujorin e parë të 2020 duhet të aplikojnë pranë autoriteteve përkatëse për zgjatjen e afatit të deklarimit.

Konkluzione dhe përfundime

Është e rëndësishme të mbahet parasysh se kjo situatë vazhdimisht po lëviz. Vlerësimet duhet të mbahen të azhornuara, për shembull, ato të kryera dy javë para se të nënshkruhen pasqyrat financiare, me shumë mundësi do të jenë të vjetëruara dy javë më vonë. Pra, është thelbësore të sigurohemi që të gjitha gjykimet e bëra janë aktuale dhe të bazuara në informacionin e disponueshëm në datën më të fundit të mundshme (d.m.th. datën kur jepen autorizimet dhe miratimet e pasqyrave financiare). Tani më shumë se kurrë lindnevoja që klientët dhe auditori ose këshilltari i tyre të punojnë ngushtë.

Ndaj është i nevojshëm dhe i domosdoshëm një planifikim i të gjithë rezervave, përdorimi i të gjitha mjeteve ndihmëse (si psh. i kredive me kushte lehtësuese, akomodimi sa më i shpejtë me të punuarin në kushtet e kufizimeve) si dhe në ndihmën direkte të Qeverisë nëpërmjet marrjes së masave ekonomike dhe financiare në mbështetje të biznesit për të menaxhuar krizën në këtë situatë të jashtëzakonshme, për të mundësuar vazhdimësinë dhe ndihmuar atë kur të vijë koha për rekuperim.

Në këtë kuptim, shtyrja e raportimit financiar është një masë e mirë e cila duhet shoqëruar dhe me masa të tjera të shkallëzuara për ato njësi që u goditen më shumë nga kjo situatë, siç thamë më lart me mbështetje direkte, kredi me garanci dhe forma të tjera që lidhen me shtyrje të disa pagesave ose rrillogaritjen e tyre mbi bazën e rezultateve të pritshme të këtij viti e në vazhdim për të mundësuar rifillimin sa më shpejt të aktivitetit ekonomik menjëherë pas kalimit të situatës së COVID -19, që të mos kalojmë në një krizë të thellë ekonomike që do të sillte mbase pasoja edhe më të vështira.

Bibliografia

- Këshilli kombëtar i kontabilitetit - SKK 1 Kuadri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare
- <http://www.kkk.gov.al/foto/uploads/File/SKK%20nentor%202015/01.%20SKK%201.pdf>
- Akti Normativ nr. 10 për një ndryshim në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", 26.03.2020
- www.tatime.gov.al
- Këshilli kombëtar i kontabilitetit - Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe Raportimit Financiar, SNK 10, Ngjarje pas datës së periudhës së raportimit
- <http://www.kkk.gov.al/faqe.php?id=1&l2=135&gj=sh>
- IEKA – Instituti i Eksperteve kontabel të autorizuar, Ndikimi i COVID-19 në Auditim dhe masat e marra nga vendet e ndryshme
- <http://ieka.al/content/posts/id/80/cid/495/ndikimi-i-covid-19-ne-auditim-dhe-masat-e-marra-nga-vendet-e-ndryshme;>

AVANTAZHI EKONOMIVE MIKSE NDAJ EKONOMIVE TË TREGUT NË PËRBALLIMIN E PASOJAVE NEGATIVE TË COVID-19

Alqi Naqellari

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë

alqinaqellari@umsh.edu.al

Vladimir Mici

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë

vladimirmici@umsh.edu.al

Abstrakt

Covid-19 goditi rëndë popullsinë. Shtetet për të mbrojtur popullsinë morën masa me pasoja drastike negative mbi ekonominë, duke goditur rëndë njëkohësisht kërkesën dhe ofertën agregate. Në vendet më të mëdha të botës, aktiviteti ekonomik thuajse kaloi tërësisht në ngrirje. Pasojat e pandemisë mbi popullsinë, numrin e vdekjeve ishin të ndryshme në vende të ndryshme. Dallim të madh kishte midis vendeve të BE, SHBA, UK etj, të ekonomisë së tregut, dhe vendeve me ekonomi mikse si Kina, Rusia, Vietnam, etj. Ky dallim u reflektua jo vetëm në fushën sociale, por edhe në fushën e ekonomisë, financave etj. Sistemet mikse patën më pak pasoja negative mbi popullsinë, në fushën e ekonomisë reale dhe në sistemin financiar, në krahasim me sistemet e ekonomisë tregut. Shtetet e këtyre dy grupimeve reagojnë në mënyra të ndryshme ndaj pasojave të Covid-19. Ndryshimi i reagimit të tyre konsistonte, së pari, në shkallën e ngujimit të popullatës dhe ndalimin e aktivitetit të bizneseve, së dyti, në masat e marra nga qeveria nëpërmjet politikave fiskale dhe së treti, në aspektin e politikave monetare të aplikuara nga Bankat Qëndrore të këtyre vendeve. Çfarë roli luajtën Bankat Qëndrore në përballimin e pasojave? Konkluzioni. Vendet me sistem miksi u mbështetën kryesisht në masat fiskale të marra nga qeveria, në masat nga Bankat Qëndrore në mbështetje të këtyre politikave. Vendet përëndimore, nëpërmjet rritjes së madhe të deficitit buxhetor vepruan më agresivisht në dy drejtime. Në njërin krah, stimuluan kërkesën për konsum të popullit, dhe në krahun tjetër stimuluan biznesin me kesh. Duke parë se ekonomitë mikse e përbaluan me më shumë sukses goditjen në kërkesë-ofertë shtrohet pyetja: a duhen vlerësuar sistemet mikse? Në studim janë aplikuar metodat statistikore, të krahasimit, përshkrimit etj.

Fjalë kyçe: politika monetare, politika fiskale, norma interesi, kredi, paga mbështetëse, taksatatime, rritje ekonomike, inflacion, papunësi etj.

Abstract

Covid-19 severely affected the population. States to protect the population took measures with drastic negative consequences on the economy, hitting both aggregate demand and supply at the same time. In most parts of the world, economic activity is almost completely frozen. The consequences of pandemics on the population, the number of deaths were different in different countries. There was a big difference between the EU countries, the USA, the UK, etc., of the market economy, and the countries with mixed economies such as China, Russia, Vietnam, etc. This difference was reflected not only in the social field, but also in the field of economy, finance, etc. Mixed systems had fewer negative consequences on the population, in the real economy and in the financial system, as opposed to market economy systems. The states of these two groups reacted differently to the consequences of Covid-19. Changing their reaction consisted of, first, the degree of population isolation and the cessation of business activity, second, to the measures taken by the government through fiscal policies third, in terms of monetary policy applied by the Central Banks of these countries. The question is, what role did the Central Banks play in dealing with the consequences? Conclusion. Countries with a mixed system relied mainly on government-

implemented fiscal policies, on monetary policies implemented by Central Banks in support of these policies. Western countries, through the huge increase in the budget deficit, acted more aggressively in two directions. On the one hand, they stimulated the demand for consumption of the people, and on the other hand they stimulated the cash business. Seeing that mixed economies have more successfully met the demand-supply shock, the question arises: does the future belong to this system? Statistical methods of comparison, description, etc. have been applied in the study.

Keywords : monetary policy, fiscal policy, interest rates, loans, support salaries, taxes, economic growth, inflation, unemployment, etc.

Hyrje

Pandemia Covid-19 e kishte origjinën e saj në Wuhan, të provincës Hubej të Kinës. Kjo pandemi, me pasoja serioze ndaj shëndetit të popullatës kishte disa karakteristika. U përhap vetëm në një zonë të Kinës, u përhap shumë shpejt, preku vendet më të mëdha dhe më të zhvilluara të botës me të cilat Kina kishte lidhje ekonomike. Në një kohë rekord thuhet se u përhap në gjithë botën. Sipas WHO në 30 maj 2020 në botë kishte 5,819,962 të prekur me Covid-19 duke përfshirë 362,786 të vdekur. Grupi vendeve Perëndimore me ekonomi të tregu të lirë; SHBA kishte 1,694,864 raste me 100,304 të vdekur, Franca 146,657 raste me 28,660 të vdekur, Spanja 238,936 me 29,039 të vdekur, Italia 232,248 të prekur me 33,249 të vdekur. Grupi vendeve me ekonomi mikse Kina kishte 84,565 raste me 4,645 të vdekur, Rusia 396,575 raste dhe 4,555 të vdekur, Vietnam, Laos, Kamboxhia asnjë të vdekur, Kuba me 1916 raste me 81 të vdekur etj.

Shifrat tregojnë se vendet perëndimore, të ekonomisë tregut, kanë një numër shumë më të madh të prekurish dhe në mënyrë të veçantë të vdekurish, në krahasim me vendet me ekonomi mikse. Ekonomia e vendeve perëndimore pati më shumë pasoja negative dhe po ringrihet më ngadalë se ekonomitë mikse. Pse ndodhi kjo dukuri, çfarë të veçanta kanë sistemet mikse në krahasim me ekonominë e tregut? Si e vlerësojnë Organizmat financiarë ndërkombëtarë dhe ekspertët e ekonomisë këtë situatë? Përgjigje do ti japim më poshtë.

1. Masat e mara për përballimin e pasojëve negative të coronavirusit (Covid-19). Përhapja e shpejtë e pandemisë koronavirusit solli reagimin e vendeve tëndryshme për uljen e pasojave negative në popullatë dhe në ekonomi. Ato dallonin nga shkalla e ngujimit të popullatës sipas moshës, nga vlerësimi i moshës së tretë, nga uniteti brendshëm dhe i jashtëm, nga shkalla e dhënies së informacionit, nga shkalla e mbylljes së bizneseve prodhuese, bizneseve të shërbimeve, financiare, nga mbështetja direkte financiare në formë monetare të punonjësve dhe konsumatorëve, nga mbështetja e bizneseve me likuiditete, nga mbështetja me masa lehtësuese të detyrimeve të tyre ndaj qeverisë dhe bankave tregëtare, nga shkalla e angazhimit të prodhimit të vaksinës etj. Disa nga këto reagime kanë qënë sipas vëndeve:

Shtetet e Bashkuara të Amerikës. në Fazën 1 (6 Mars 2020) - 8.3 miliardë dollarë në ndihmë: Financimi fillestar dhe mbështetja për zhvillimin e vaksinave. (Act, HR 6074).

Faza 2 (18 Mars 2020) - Ndhimë 105 miliardë dollarë: Pushime të paguara për sëmundje, papunësi dhe ndihmë ushqimore. (Act, HR 6201).

Faza 3 (27 Mars 2020) - Akti i Ndhimës, 2.3 mijë miliardë dollarë në ndihmë: Ndhima kryesore individuale dhe e biznesit dhe stimulim ekonomik, paketa më e madhe që adreson COVID-19 deri më sot. Ndhima ndaj 120 shteteve 2.4 miliardë dollarë. (CARES Act), HR 748.

Masat tatimore - direkte dhe indirekte me shtyrjen e pagesës së detyrimeve tatimore, uljet e tarifave, etj.

Bashkimi Europian. Për të mbështetur qytetarët dhe vendet e BE-së në rimëkëmbjen nga rënia ekonomike e shkaktuar nga pandemia COVID-19, udhëheqësit e BE më 23 Prill 2020, u angazhuan për krijimin e një fondi të rimëkëmbjes së BE që synonte zbutjen e efekteve të krizës. Më 27 maj 2020, Komisioni Evropian prezantoi propozimin e tij për planin e rimëkëmbjes, duke përfshirë:

-një buxhet i rishikuar afatgjatë i BE-së prej 1100 miliardë € për 2021-2027 për eleminimin e pasojave që COVID-19 dha në ekonominë europiane.

-një përforsim i përkohshëm prej 750 miliardë € (Gjenerata e ardhshme BE)

Këto elemente janë përveç tre rrjetave të sigurisë prej 540 miliardë eurosh të vendosura tashmë nga BE për të mbështetur punëtorët, bizneset dhe vendet.

Politika monetare e BQE

Në zonën e euros, Banka Qendrore Evropiane ka reaguar me politikë të fortë monetare dhe masa mbikëqyrëse të shpallura në 12 dhe 18 Mars 2020. Qeveritë në të gjithë Bashkimin Evropian shpallën masa të ndryshme fiskale për të përmirësuar pasojat ekonomike. Banka Qendrore Evropiane ECB shpall programin e blerjes urgjente 750 miliardë euro (17 Mars 2020). Më 4 qershor 2020, Banka Qendrore Evropiane njoftoi se programi i blerjes së urgjencës pandemike do të rritet për 600 miliardë euro, duke arritur në një total prej 1 350 miliardë eurosh.

EIB aprovon 25 miliardë euro Fondi Garantues Pan-Evropian në përgjigje të krizës COVID-19 (EIB=Banka Evropiane e Investimeve, 26 maj 2020).

Nga një studim për masat e zbutjes së pasojëve negative të covid-19 në ekonomi në BE janë këto të dhëna (tabela 1). (Anderson J, Bergamini E, dhe Co. 2020). Shifrat janë në % ndaj PBB, përfshijnë masat e vitit 2020 me PBB-në 2019, likuiditet e garanci përjashton veprimet e bankës qendrore.

Tabela Nr.1 Përqindja e shpenzimeve sipas grupimeve ndaj PBBn në %

	Impulsi i menjëhershëm fiskal	Shtyrje	Likuiditet / garanci tjetër	Përditësimi i fundit
Belgjika	1.40	4.80	21.90	3/6/2020
Danimarka	2.10	7.20	2.90	28/03/2020
Franca	3.60	8.10	13.90	4/6/2020
Gjermania	13.30	7.30	27.20	3/6/2020
Greqia	1.10	2.00	0.50	1/4/2020
Hungaria	0.40	8.30	0.00	25/03/2020
Italia	0.90	13.20	29.80	27/04/2020
Hollanda	3.70	7.90	3.40	27/05/2020
Portugalia	2.50	11.10	5.50	4/5/2020
Spanja	2.30	0.90	9.20	25/05/2020
UK	4.80	1.90	14.90	25/05/2020
SHBA	9.10	2.60	2.60	27/04/2020

Burimi. The fiscal response to the economic fallout from the coronavirus. Last update: 04 June 2020 by Julia Anderson, Enrico Bergamini, Sybrand Brekelmans, Aliénor Cameron, Zsolt Darvas, Marta Domínguez Jiménez, Catarina Midões.

-Impulsi i menjëhershëm fiskal: Në këtë zë janë përfshirë, shpenzime shtesë qeveritare (të tilla si burimet mjekësore, mbajtja e njerëzve të punësuar, subvencionimi i NVM-ve, investimet publike) dhe të ardhurat e prapambetura (siç është anulimi i taksave dhe sig. shoqërore dhe shëndetsore.). Këto lloj masash çojnë në përkeqësim të bilancit të buxhetit pa ndonjë kompensim të tanishëm apo të ardhshëm.

- Shtyrje e pagesa të caktuara, përfshirë taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, të cilat në parim duhet të paguhen më vonë. Këto masa përmirësojnë pozicionet e likuiditetit të individëve dhe kompanive, por nuk anulojnë detyrimet e tyre. Disa vende gjithashtu kanë shtyrë shërbimin e kredive ose pagesën e faturave të shërbimeve, këto veprime do sjellin të njëjtën pasojë. Këto masa shkaktojnë përkeqësim të bilancit të buxhetit në vitin 2020, por e përmirësojnë atë më vonë.

-Dispozitat dhe garancitë e tjera të likuiditetit: përfshijnë garancitë e eksportit, ndihmën e likuiditetit, linjat e kredisë përmes bankave kombëtare të zhvillimit. Linjat dhe garancitë e

kredisë mund të mos e dobësojnë bilancin e buxhetit në vitin 2020, por do të krijonin detyrime të mundshme që mund të shndërrohen në shpenzime faktike qoftë në vitin 2020 ose më vonë.

Konkluzioni: SHBA, Gjermania dhe Anglia kanë marrë risk shumë më të madh në "Impulsin e menjëherëshëm fiskal" duke thëlluar Deficitet Fiskale të vendeve të tyre pa perspektivë rikuperimi. Për mendimin tonë një nga arsytet që këto vende e bëjnë këtë veprim është se shfrytëzojnë funksionin e Dollarit dhe Euros si para botërore. Këtë veprim nuk e ka bërë asnjë nga vendet e Azisë në këto përmasa. Vendet e Azisë, si Kina, Rusia, Vietnamit etj me ekonomi mikse janë shumë të përmbajtura dhe kanë më shumë mundësi të veprojnë me politikën ekspansioniste të Bankave Qëndrore pasi kanë më shumë efekt në transmetimin e politikave monetare sesa Ekonomitë Perëndimore.

Në zërin e dytë dhe të tretë SHBA është shumë ulët. Kjo do thotë se reagimi fillestar ka mbuluar nevojat e menjëherëshme të kërkesës dhe ofertës. Ndryshe është reagimi i Gjermanisë, Francës dhe Italisë. Këto vende kanë marrë risk të madh për të ardhmen, duke marrë më shumë masa strukturore.


2. Parashikimet për të ardhmen e ekonomisë globale.

Në 2009 ekonomia botërore u kontraktua (rritja) me 1.7%. Sipas Kombeve të Bashkuara nga +2.5% që ishte parashikimi rritjes së ekonomisë botërore para Covid-19, pas tij parashikohet një rënje me 1%.

"Mesatarisht, rritja e PBB-së në vendet e prekura është rreth 2.4% nën atë të vendeve të pa prekura. Ulja e rritjes së PBB-së është pasuar nga një rimëkëmbje e shpejtë me vendet e prekura që gëzojnë një normë rritjeje prej një përqindje më të lartë sesa vendet e pa ndikuara në vitin pas krizës...." "...konstaton se rënia e rritjes së PBB-së është, mesatarisht, më pak e rëndë në vendet me të ardhura të ulëta që përjetojnë një krizë shëndetësore sesa në ekonomitë e përparuar..." "...ata gjejnë një ndikim të fortë të stimulit të politikës fiskale në performancën e rimëkëmbjes. Prandaj lind pyetja nëse COVID-19 mund të jetë më pak shqetësuese për vendet në zhvillim sesa për vendet e zhvilluara..." (UNIDO, 26 maj 2020).

"Rritja globale e PBB-së: parashikimet për vitin 2020 variojnë midis -8.8 përqind (OBT) dhe 1 përqind (UNDESA= Departamenti i Kombeve të Bashkuara për Ekonominë dhe Çështjet Sociale), skenari optimist... rritja globale do të tkurret me -4.2 përqind, një ndryshim prej 7 pikë përqindje në krahasim me parashikimet e publikuara para shpërthimit të krizës (FMN 2020).

Figura 1: Dallimet rajonale të niveleve të rritjes së PBB-së të parashikuara për vitin 2020 në WEO të FMN-së Tetor 2019 dhe Prill 2020



Burimi: UNIDO elaboration based on IMF.

Në tabelë shihet qartë se rënia më e madhe e GDP është parashikuar të jetë në vendet e zhvilluara dhe në Europë me respektivisht -7.8% dhe -7.7%. Ato do të kenë një rënie me -1.4% dhe -1.3% mbi mesataren botërore. Rënie më të ulët, nën mesataren botërore, do ta kenë vendet e Azisë, Azia Qëndrore dhe Lindjes së mesme me respektivisht -4.9% dhe -5.7%.

Disa tregues të tjerë për rënie të ekonomisë botërore janë:

-Vëllimet e tregtisë botërore pritet të bien midis -32 përqind (OBT, skenari pesimist) dhe -9 përqind (FMN) në vitin 2020.

-Prodhimet farmaceutike(+14.8%), ushqimore, të gazetarisë, duhanit patën rritje pozitive, ndërsa prodhimi lëkurës(-17%), automjeteve(14.8%), transportit(2%), elektronike, tekstileve etj patën rënie të dukëshme.(UNIDO statistic portal 2020)

-Rritja e pritshme e varfërisë ekstreme do të sillet nga 0.8 përqind në 1.5 pikë përqindje. Kjo është e barabartë me një rritje midis 50 milion deri në 70 milion njerëz në krahasim me vlerësimet origjinale për vitin 2020.(UNIDO 2020).

-Eksporti është ulur më shumë në vendet me të ardhura të larta. Sipas OECD 2020, vendet me të ardhura mesatare dhe mbi mesatare ku përfshihen edhe Kina, Rusia, India, etj do kenë një rënie, Mars 2020 ndaj dhjetor 2019 me -7.4, ndërsa vendet me të ardhura të larta do kenë një rënie me -9.0. Rënja në krahasim me Marsin e 2019 do jetë më e madhe, në vendet me të ardhura të mesatare dhe mbi mesatare do jetë -7.5, ndërsa në vendet me të ardhura të larta do jetë -11.5%. Edhe në këtë tregues vendet me ekonomi mikse kanë treguar më shumë vitalitet.

-Pothuajse në të gjitha rajonet pritet të pësojnë rënie dyshifrore në vëllimin e tregtisë, madje edhe në skenarët më optimistë. Në një krahasim rajonal, Amerika e Veriut dhe Azia parashikohet të pësojnë ndikimet më të larta negative në vëllimet e tyre të eksportit.

Në skenarin pessimist(UNIDO 2020) vëllimi tregëtar në SHBA pritet të bjerë me -17%, në një kohë që në Europë dhe Azi pritet të bjerë me -12 dhe -14%, për botën është llogaritur -13%. Në skenarin optimist vëllimi tregëtar pritet të bjerë në SHBA me -41% ndërsa në Europë dhe Azi me respektivisht -33 dhe -36%, për botën është llogaritur -32%.

-Sa i përket papunësisë dhe orëve të punës "...pritet të ulen në të gjitha rajonet, "Amerikanët" dhe "Evropa dhe Azia Qendrore" do të goditen më së shumti përkatësisht me 12,4 përqind dhe 11,8 përqind"(UNIDO+ILO 2020).

-Një tregues i rëndësishëm për vlerësimin e rënies ekonomike është "Prodhimi Industrial" parashikimet për të cilin nga organizmaprestigjoze(UNIDO) janë dhënë në tabelën Nr.2.

"Kur krahasojmë të dhënat për periudhat Mars 2020 kundrejt Dhjetorit 2019 (para krizës) dhe Mars 2020 ndaj Mars 2019 (qasja vit-mbi-vit), shumica e vendeve të konsideruara (77 përqind dhe 72 përqind, përkatësisht) regjistroi një rritje negative në rritjen e PI. Normat mesatare të rritjes negative në 48 vendet janë përkatësisht -4,8 përqind dhe -4,6 përqind. Ashtu si me parashikimet e tjera të paraqitura në këtë material, ndikimi është veçanërisht i rëndë në Evropë dhe në Amerikë, ndërsa efekti i tij është më i dobët në Rusi dhe Azi (Tabela 2).(UNIDO Maj 2020).

Tabela 2: Ndryshimi mesatar në Indeksin e Prodhimit Industrial (IIP) nëpër rajone të botës

	SHBA	Amerika Qendrore dhe Jugore	Europa	Azia	Federata Ruse
Numri vendeve	1	6	31	9	1
Mars 2020/ dhjetor 2019	-6.4	-7.2	-5	-3.1	-0.26
Mars 2020 /mars 2019	-6.4	-6.6	-6	-0.87	2.89

Burimi: UNIDO Statistics Portal

Të dhënat e kësaj tablele tregojnë se vendet e Azisë do kenë më pak pasoja negative në prodhimin industrial. Në krahasim me ekonominë amerikane kanë një prioritet të dukshëm. Rënja në krahasim me muajin dhjetor do jetë sa gjysma e rënjes së ekonomisë amerikane, ndërsa në krahasim me marsin e 2019 do jetë vetëm -0.87 nga 6.4% që përllogaritet në SHBA. Sa i përket rënjes së ekonomisë Ruse ajo do ketë jo rënie në krahasim me marsin e 2019 por do ketë rritje me 2.89%. Edhe në krahasim me ekonomitë europiane ekonomitë e Azisë kanë vitalitet më të madh ekonomik.

Konkluzioni. Sipas parashikimeve të organizmave ndërkombëtare, të paraqitura më sipër, pasojat negative mbi kërkesë-ofertë, të pandemisë covid-19 do të jenë më të ndjeshme në

ekonomitë e BE dhe SHBA-së në krahasim me vendet si Kina, Rusia, Vietnami etj, me ekonomi mikse.

3. Kina, pandemia, masat, pasojat dhe ringritja. Nuk është rastësi që Kina është sot fuqia ekonomike e dytë e botës, pas SHBA. Ajo është udhëhequr nga Partia Komuniste e Kinës duke zbatuar politika pragmatiste-largpamëse, në raport me shkallën e zhvillimit të vendit dhe në raport me vendet e tjera të botës. Ndikim të madh, të jashtëzakonshëm, ka pasur kapitali i huaj japonez, amerikan, gjerman, italian, francez, rus, korean, etj. Krijimi "gorillës 800 paundshe aziatike" (Greenspan A, 2007) krijimi i centralit ekonomik botëror kinez është frut i etjes për fitim të kapitalit përëndimor që nuk njuh kufi, që nuk njuh sisteme e rregjime.

Kina nuk është me të njëjtin organizim si Bashkimi europian, si SHBA-ja, si Federata Ruse, Britania e madhe etj, etj. Kina është një vend me dy sisteme (Hong Kongu) dhe me disa krahina autonome.

Kina nuk ka qenë asnjëherë një vend me ekonomi plotësisht të centralizuar, ose plotësisht të decentralizuar. Kina është vendi që përfaqëson një sistem tipik të një Ekonomie Mikse, në të cilin ka elementë të ekonomisë së centralizuar dhe elementë të ekonomisë së tregut. Sistemi tyre mbështetet në pronën shtetërore dhe në pronën private, në organizimin shtetëror dhe në organizimin publik. Ky kombinim ka krijuar modelin e socializmit kinez me tipare të tregut.

Kina e filloj ndërtimin e sistemit "socialist" nën udhëheqjen e Mao-Ce Dunit. Rrugën socialiste të zhvillimit e vazhduan dhe përshtatën me ekonominë e tregut, udhëheqësit pas Maos. Për rolin e planifikimit Deng Xiaoping ka theksuar: "Një ekonomi e planifikuar nuk është përkufizimi i socializmit, sepse ka planifikim nën kapitalizëm, ekonomia e tregut ndodh nën socializmin, planifikimi dhe forcat e tregut janë të dy mënyra për të kontrolluar aktivitetin ekonomik" (Xiaoping D. 30 June 1984). Në qendër të këtij sistemi ka qenë ligji themelor i socializmit, synimet për realizimin e të cilit kanë ndryshuar sipas periudhave të zhvillimit. Në Kongresin e 19 të PKK theksohet: "...që socializmi me karakteristika kineze ka hyrë në një epokë të re dhe kontradikta kryesore në shoqërinë kineze ka evoluar në një mes zhvillimit të pabalancuar dhe joadekuat dhe nevojave gjithnjë në rritje të njerëzve për një jetë më të mirë."...

Ekonomia kineze ka marrë një zhvillim të shpejtë sidomos vitet e fundit. Popullsia aktuale e Kinës është 1,438,919,251 banorë, zë 18.47% të popullsisë së botës. 60.8% e popullsisë është urbane, mosha mesatare 38.4 vjet, jetëgjatësia 77.4 (Worldometer 2020). Kina ka 783 milion punëtorë, forca punëtore kineze është më e madhja në botë që nga viti 2019. Sipërfaqja territoriale e Kinës është 9.596 ml km², duke zënë vendin e 3 në botë pas Rusisë dhe Kanadasë, e krahasueshme me sipërfaqen e SHBA me 9.525 ml km². (Demographic Yearbook 2014). Treguesit makroekonomik janë në nivele pozitive.

Tabela Nr.3 Disa tregues makroekonomik të ekonomisë kineze.

Viti	Rrija e GDP r %	Investime /GDP në %	Inflacion %	Papunësi %	Binaci Buxhetor në %/GDP	Deficiti Qeveritar në %/GDP	Llogaria korente ndaj/GDP në %	Kursi CNY/\$
1990	2.4	34.40	3.10	2.50	-0.7	n/a	n/a	4.783
2000	7.6	34.30	0.40	3.10	-2.8	22.80	1.70	8.278
2010	10.1	47.90	3.30	4.10	-0.4	33.70	3.90	6.769
2017	6.3	44.40	1.60	3.90	-3.9	47.80	1.40	6.751

Burimi. Report for Selected Countries and Subjects". www.imf.org. Archived from the original on 17 September 2018. Retrieved 17 September 2018.

-Nga viti 2019, për GDPn, renditet si e dyta në botë (IMF 2018) dhe që nga viti 2017 i pari në botë duke marrë parasysh barazinë e fuqisë blerëse (PPP). Kina ka ekonominë më të madhe në zhvillim më të shpejtë në botë, me ritme të rritjes mesatarisht 6% për 30 vjet. (Worldometer 2020).

-GDPn nga 1211 mld \$ në vitin 2000 në 2017 ka qënë 12238 mld ose e rritur me 10 herë. Në 2019 ka qënë 14140 mld (IMF 2019). 53.6% llogaritet nga shpenzimet e konsumit, 44.4% nga shpenzimet për investime dhe 2% eksport neto.

-GDP për frymë nga 1073\$ në 2000 në 2017 ishte 7150\$ ose u rrit me 4.1 herë (Worldometer 2020), në 2019 ka qënë 10099 \$ (IMF 2019). Sipas FMN-së, mbi bazën e të ardhurave për frymë, Kina u rendit në vendin e 73-të në vitin 2019. (www.imf.org. 2019).

Në vitin 2002, Kina kontribuoi 23% të rritjes së PBB-së botërore, në vitin 2019 Kina kontribuoi rreth 38% të rritjes botërore.... Në vitin 2019, kërkesa për naftë e Kinës ishte 13.9 ml fuçi/ditë ose 14% e tregut botëror kundrejt 5,6 ml fuçi/ditë në vitin 2003 që barazonte me 7% të kërkesës botërore. ...Kina kontinentale tani është importuesi i dytë më i madh në botë, duke përbërë 10.4% të importeve të mallrave në botë, krahasuar me 4.0% të importeve në botë në 2002. Kina përbënte gjysmën e rritjes së kërkesës botërore të naftës në vitin 2019." (EMS NOW. Analisa Asia 2020).

-Në vitin 2018, sektori privat i Kinës zinte 60% të PBB-së; (www.chinadaily.com.cn.) sektori privat është përgjegjës për 80% të punësimit urban dhe 90% të vendeve të reja të punës (Zitelmann, Rainer 2020). Kina ka burime natyrore me një vlerë prej 23 mijë mld dollarë, 90% e të cilave janë qymyr dhe metale të rralla të tokës. (Anthony, Craig. 2017).

-Kina ka investimin e katërt më të madh të drejtpërdrejtë të huaj (CIA 2013) dhe zë vendin e njëmbëdhjetë për investimet e huaja direkte të jashtme (CIA 2011). Kina ka numrin e dytë të miliardërëve në botë me pasuri të përgjithshme prej 996 miliardë dollarë (CNBC 2019). Nga 500 ndërmarrjet më të mëdha në botë, 129 janë me seli në Kinë (CNBC 2019).

-Kina është prodhuesi më i madh i automobilave në botë, duke prodhuar më shumë se 27 milion automjete në vitin 2018 — për krahasim, numrat përkatës për SH.B.A. dhe Japoninë ishin përkatësisht 11.3 milion dhe 9.7 milion.

-Kina është nisëtare e "Një brez një rrugë" që u mbështet edhe nga Italia (Vendi parë i G7).

-Ekonomia kineze është e lidhur me aktivitetin e ekonomive më të mëdha të botës. Kina ka me mijra filiale të kompanive të huaja, si dhe ka me qindra filiale ose kompani të saja të shpërndara në të gjithë botën. Në Kinë kanë filialet e tyre kompanitë e mëdha Amerikane, të BE, të Koresë Jugut, të Japonisë etj. Aty kanë filiale të tyre kompani të automjeteve, të elektronikës, të robotikës, të internetit, të transportit, ndërmarrje kimike, në Kinë është "lugina e Silikonit". Kina është një krijesë e kapitalit perëndimor, Korean, japonez, por që ka ecur edhe vetë para duke përsosur teknologjinë perëndimore dhe duke u bërë konkurent i vetë këtyre firmave. Mund të themi se pagat e punës në Kinë janë rritur aq sa tashmë kompanitë e huaja kërkojnë të largojnë filialet e tyre nga që tregu fuqisë punëtore nuk është më i lirë.

-Është ekonomia më e madhe prodhuese dhe eksportuese e mallrave në botë dhe importuesi i dytë më i madh i mallrave. (thomasnet.com. 2013). Është kombi më i madh tregtar në botë dhe luan një rol të spikatur në tregtinë ndërkombëtare, është angazhuar gjithnjë e më shumë në organizata tregtare dhe traktate në vitet e fundit (WTO 2017). Partnerët më të mëdhenj tregtarë të Kinës janë SHBA, BE, Japonia, Koreja e Jugut, India, Tajvani, Australia, Vietnami, Malajzia dhe Brazili.

Çfarë tregon Bilanci Tregëtar i Kinës?

-Partnerët kryesorë të Kinës në eksport në 2019 kanë qënë: SHBA-ja me 19.25%, BE me 16.43%, ASEAN me 12.83%, Hong Kong me 12.16%, Japoni me 5.91%, Koreja e Jugut me 4.37%, India me 3.08%, Rusia me 2.64%, etj.

-Partnerët kryesorë të Kinës në import në 2019 kanë qënë: BE me 12.82%, ASEAN me 12.58%, Koreja e Jugut 9.58%, Japonia 8.45%, Tajvani me 8.32%, SHBA-ja me 7.24%, India me 4.03%, , Brazili me 3.63%, të tjerët me 33.74%.

Çfarë vërejmë në këto Balance? Eksport-Importi kinez është më i lartë se i SHBA-s në shifër absolute. Vërejmë se Kina i ka më të diversifikuara eksport-importet. Ajo eksporton në BE dhe SHBA rreth 35% të mallrave ndërsa importon prej tyre rreth 20% të mallrave. Pjesën më të

madhe të eksport importeve e kryen,(përveç ASEAN) me vendet e Lindjes. (Wikipedia, economy of China). Duke parë këtë Bilanc dhe bilancin e investimeve të huaja mund të themi se ekonomia kineze është e lidhur në mënyrë të pazgjdhëshme me ekonominë botërore.

Çfarë tregon Bilanci Tregëtar i SHBA?

-Partnerët kryesorë të SHBA-s në eksport në 2018 kanë qënë: BE me 18.7%, Kanada me 18.3%, Meksika me 15.9%, Kina me 8%, Japonia me 4.4%, etj.

-Partnerët kryesorë të SHBA-s në import për vitin 2018 kanë qënë: Kina me 21.4%, BE me 18.9%, Meksika me 13.2%, Kanadaja me 12.6%, Japonia me 6% etj. Në këtë mënyrë Kina është partneri kryesor i SHBA-s në importe.Për SHBA-n është e rëndësishme tregëtia me vendet fqinje dhe Europën.

Siç shihet SHBA ndaj Kinës ka një deficit të dukshëm tregëtar, po të kemi parasysh se Importi ka qënë 2.54 trilion\$ dhe eksportet vetëm 1.66 trilion\$.

Vlerësohet se rënja e ekonomisë Kineze do ndikojë më shumë sesa ndikoj në vitin 2003 dhe 2009, në ekonominë botërore sepse, në kohën e SARS, Kina ishte ekonomia e gjashtë më e madhe, duke përbërë vetëm 4.2% të PBB-së botërore. Në 2020 Kina është ekonomia e dytë.Prandaj, çdo ngadalësim në ekonominë kineze nuk dërgon kërcime, por valë në të gjithë globin.Kështu mund të themi se “kur teshtin Kina ftohet bota”. Sipas ekspertëve nëse masat në Kinë nuk do hiqen shpejt, do të shoqërohen “me një ulje të PBB-së reale globale prej 0.8% në Tr.1 dhe 0.5% në Tr. 2. Në këtë skenar, koronavirusi dhe masat që rrjedhin do të zvogëlojnë PBB-në reale globale me 0.4% në vitin 2020(EMS NOW. Analisa Asia 2020).

3.1. Roli i Bankës Popullore të Kinës në përballimin e pasojave negative të coronavirusit (covid-19)

Masat nga fusha sociale kaluan edhe në fushën ekonomike.“Kina sipas -Xi Jinping- ka dy qëllime kryesore për të rifilluar punën. Së pari, është të ruajmë jetën normale duke siguruar funksionimin themelor të ekonomisë së vendit, duke zvogëluar numrin e falimentimeve dhe duke garantuar punësimin sa më shumë që të jetë e mundur.Së dyti, Kina duhet të sigurojë rimëkëmbjen ekonomike në mënyrë që të ruajë statusin e vendit si qendra e industrisë prodhuese në botë.Këto synime përcaktojnë punën aktuale strategjike të Kinës”.

Për realizimin e tyre u aplikuan të kombinuara politikat fiskale dhe politikat monetare.Politikat monetare të Kinës nuk janë të njëjta me politikat e Fed-it dhe BOE-së.Ndërsa Rezerva Federale e Sh.B.A.-së ka ndërmarrë një qasje 'çfarëdo që të duhet'whatever- it-takes' duke përmbytur tregun me likuiditet përmes një seri lehtësish, të pasqyruara në këtë punim, Banka Popullore e Kinës, deri më tani, ka qënë e qetë për të dhënë ndonjë sinjal të lehtësimit sasior. Kjo ka disa arsye. Monedha kineze renminbi nuk ka funksionin e parasë botërore, ajo zë vetëm 1.96% të rezervave botërore. BQK aplikon instrumente direkt dhe indirekt sepse në Kinë ka banka tregëtare me kapital tërësisht shtetëror. Synimi i BQK është ruajtja e stabilitetit tëjuanit(renminbit) me synim rritjen ekonomike dhe stabilitetin financiar. Kina aplikon shumë normën e REPO-ve dhe normën e Rezerves së Detyrueshme, dhe pak blerjen e letrave me vlerë të qeverisë.Ndryshe BOE dhe Fed-i aplikojnë blerjen e letrave me vlerë dhe pak instrumentet e tjera sepse NBI(REPO) e këtyre bankave është afër zeros dhe efekti i saj është thuajse i pa përfillëshëm në nxitjen e rritjes ekonomike.Instrumente të tjera e kanë ulur normën me shenjën minus.

Cili është vendi renminbit në ekonominë botërore?Kina ka monedhë zyrtare, renminbi ose ndryshe juanin.Renminbi i Kinës, po i nënshtrohet procesit të nevojshëm të ndërkombëtarizimit të tij.(Cocurrency reform” 2015). Ai ka filluar të marri funksionin e parasë botërore në vitin 2016. Në këtë mënyrëjo në çdo vend të botës mund të bëhet direkt tregëti me juan pa u konvertuar në monedhat kryesore rezervë siç janë dollari dhe euro. Kjo tregon se renminbi është inferior në raport me dollarin dhe euron në tregëtinë ndërkombëtare.Kina nuk mund të kalojë vështirësitë e saj financiare në vendet e tjera.Vetëm duke qënë me funksionin para botërore, pa ndërmjetës mund të realizohet një kalim i tillë.Dinamika e monedhave tregon për mundësinë e veprimit të Bankave Qëndrore.

Tabela Nr.4 Përqindja ndaj totalit të rezervës botërore sipas monedhave

	2019	2018	2017	2016
US dollar	60.89	61.74	62.72	65.36
Euro	20.54	20.67	20.16	19.13
Japanese yen	5.70	5.20	4.89	3.95
Pound sterling	4.62	4.42	4.54	4.34
Chinese renminbi	1.96	1.89	1.23	1.07
Canadian dollar	1.88	1.84	2.02	1.94
Australian dollar	1.69	1.62	1.80	1.69
Swiss franc	0.15	0.14	0.18	0.16

Burimi. FMN 2020

Në vitin 1965 dollari zinte 72,93% të rezervave botërore ndërsa paundi zinte 25,76 %. Ishin thuajse monedhat e vetme që shërbenin si rezerva botërore. Kjo pozitë ju jepte mundësi Fed-t dhe BOA të aplikojnë politika monetare ekspansioniste duke kaluar problemet monetare jashtë vendit të tyre. Sot këtë status e gëzojnë dollari dhe euro dhe më pak paundi dhe jeni, ndërsa nuk e gëzojnë monedhat e vendeve me ekonomi mikse. Kështu Bankat e ekonomive me sistem mikse, nuk mund të emetojnë monedhë mbi nevojat e ekonomisë dhe mundësitë e mbulimit të tyre sepse nuk mund ti shkarkojnë ato në tregjet botërore, ashtu siç mund të bëhet me dollarin dhe me euron. Në këtë mënyrë në periudhën e pandemicë Covid-19 SHBA dhe BE e kishin më të lehtë të "futeshin në borxh", të risnin deficitin buxhetor për t'ju ardhur në ndihmë kërkesës dhe ofertës agregate. Euro dhe dollari i hedhur në treg thjesht mund të kalonte dhe të kthehej në mall konsumi apo në faktor ekonomik, në Kinë në Rusi apo në vende të tjera të botës.

Banka Qëndrore e Kinës ose Banka Popullore e Kinës.

Sistemi financiar kinez i është përshtatur sistemit ekonomik, është dy nivelor. Banka Qëndrore e Kinës dhe Bankat e nivelit të dytë. Në nivelin e dytë ka banka me pronësi private dhe me pronësi shtetërore. Në Kinë zbatohen të dy instrumentet politikë monetare, instrumentet direkte dhe indirekte. Neni 3 Qëllimi i politikave monetare është të ruajë stabilitetin e vlerës së monedhës dhe në këtë mënyrë të promovojë rritjen ekonomike... Kapitulli IV Operacionet e Biznesit... Neni 22... pika 4) të sigurojë kredi për bankat tregtare;... Neni 27 Banka Popullore e Kinës, sipas nevojës për zbatimin e politikave monetare, mund të përcaktojë shumat, kohëzgjatjen, normën e interesit dhe formën e kredisë për bankat tregtare, por kohëzgjatja nuk duhet të kalojë një vit..."

Sistemi bankar Kinez ka 6 banka të nivelit të dytë, ose banka tregëtare me kapital tërësisht shtetëror. Katër bankat e para janë bankat më të mëdha në Kinë. Këto katër banka janë katër bankat më të mëdha në të gjithë botën në vitin 2018, sipas sondazhit statistikor të bërë nga The Banker. Pasuritë e përgjithshme të sistemit bankar kinez ishin 254.3 trilion juanë, ose 14.4 trilion dollarë amerikanë, në mesin e vitit 2018. Pesë bankat e specializuara kontrollojnë 90.4 trilion juanë ose afërsisht 35.5% të këtyre aktiveve. Ajo ka rezervat më të mëdha të këmbimit valutor në botë me vlerë 3100 mld dollarë.

Si reagoj sistemi bankar kinez ndaj koronavirusit(covid-19)?

Më 30 Janar, PBOC njoftoi se kishte planifikuar të sigurojë 300 miliardë juanë (42.3 miliardë dollarë) kredi me kosto të ulët për bankat dhe i udhëzoi ata të rivendosnin ato para për ndërmarrjet në vijën e parë të luftimit të koronavirusit. Më 26 shkurt, PBOC njoftoi 500 miliardë juan të tjerë në fonde për programin dhe më 20 prill zbuloi një tjetër 1 trilion juan.

Që nga 5 maj, gjithsej 7,037 ndërmarrje kishin marrë 269.3 miliardë juanë nga faza e parë e programit me një normë mesatare vjetore të ponderuar të interesit prej 2.5%, dhe 399.6 miliardë juanë ishin disbursuar në fazën e dytë.

Norma mesatare e interesit për kreditë e biznesit në mars ishte 0.3 pikë përqindje më e ulët se në dhjetor, një rënie më e madhe se ajo e normave të reja kryesore të kredisë kombëtare

Banka Popullore Kinës:

- Njoftoi paketën shumë-agjencive për të mbështetur sistemin financiar.
- Rriti likuiditetin e bankës përmes një operacioni të madh në REPO.
- Njoftoi rimbursim special të RMB përmes bankave komerciale kombëtare dhe lokale.
- Paralajmëroi hapa për të mbështetur emetimin e bonove nga institucionet financiare.
- Uli normën e lehtësimit të kredisë afatmesme me 10 pikë bazë (bp).
- Uli normën fillestare të kredisë 1-vjeçare me 10bp dhe nivelin e parë të kredisë 5-vjeçare me 5bp.

-Banka Popullore e Kinës (PBOC) do të rrisë kredinë, dhe kostot më të ulëta të financimit, veçanërisht për firmat e vogla që konsiderohen si jetike për rritjen dhe vendet e punës, dhe akomodimin e shpenzimeve të rritura fiskale, sipas tre burimeve të përfshira në diskutimet mbi politikën e brendshme.

-PBOC po shkurton raportin e kërkesës së rezervës (RRR) - shumën e parave të gatshme që bankat duhet të mbajnë si rezerva - për herë të tretë këtë vit, dhe uli normën e interesit për rezervat e tepërta të bankave për herë të parë që nga viti 2008.

- "PBOC do të forcojë politikën monetare lehtësuese, por është e pamundur që ajo të ndjekë Rezervën Federale," do të ndërmarrë një qasje hap pas hapi dhe do të rezervojë disa mjete mbrojtëse."

- PBOC ka mbajtur të pandryshuar normën e depozitave bazë në 1.5% që nga tetori 2015. Inflacioni i konsumatorit ishte 5.2% në shkurt.

- Një deklaratë e PBOC tha se Kina do t'i përmbahet "qëndrimit të kujdesshëm të politikës monetare" megjithëse zbatimi do të jetë "më fleksibël". -do të maksimizonte plotësisht, Regjimin e Normës Fillestare të Kredisë, por nuk përmendi normat e interesit.

-Studiuesit e (BIS) kohët e fundit thanë se pandemia e koronavirusit mund të inkurajojë miratimin e pagesës dixhitale dhe të frymëzojë më shumë bisedime rreth monedhave dixhitale midis bankave qendrore në të gjithë botën. Sipas studjuesve ka dy përfitime. Së pari, ajo do të vendosë mbizotërimin e Kinës në këtë botë të re të orientuar dixhital. Së dyti, monedha do të ishte më e dobishme gjatë kohës së pasigurisë.

- Në përgjigje të paralizës ekonomike të sjellë nga koronavirusi, banka qendrore kineze ka pompuar 243 miliardë dollarë në tregjet financiare.

Tabela Nr.5 NBI e BQ të Kinës dhe Rusisë ndaj disa Bankave të tjera;

	Banka Qëndrore	Norma aktuale	Takimi tjetër	Ndryshimi fundit
1	SHBA (FED)	0.00%-0.25%	10-Qr-20	Mar 15, 2020 (-100bp)
2	Bashkimi Europian (ECB)	0.00%	4- Qr -20	Mar 10, 2016 (-5bp)
3	Angli(BOE)	0.10%	18- Qr -20	Mar 19, 2020 (-15bp)
4	Zvicër (SNB)	-0.75%	18-Qr-20	Jan 15, 2015 (-50bp)
5	Australia (RBA)	0.25%	2-Qr-20	Mar 19, 2020 (-25bp)
6	Kanada (BOC)	0.25%	3-Qr-20	Mar 27, 2020 (-50bp)
7	Japoni (BOJ)	-0.10%	16-Qr-20	Jan 29, 2016 (-20bp)
1	Kina (PBOC)	4.35%		Oct 23, 2015 (-25bp)
2	Rusia (CBR)	5.50%	19-Qr-20	Apr 24, 2020 (-50bp)
3	India (RBI)	4.00%	6-G-20	May 22, 2020 (-40bp)

Burimi.Investing.com 2020.world Central Banks

Banka qendrore kineze ka një autonomi të plotë në lidhje me përdorimin e instrumenteve monetarë. Kjo do të thotë - ndër të tjera - që banka cakton normat e interesit për bankat tregtare(sht). Banka ka një ndikim të madh mbi normat të cilat duhet të paguhet në treg për kredi dhe hipotekë dhe interesin që paguhet për depozitat.Interesat e NBI, sipas vendeve, tregojnë se vendet me ekonomi mikse kanë më shumë mundësi të aplikojnë politika

ekspansioniste fiskale nëpërmjet uljes së këtyre normave. Ndërsa vendet me ekonomi tregu nuk e kanë këtë mundësi sepse ato i janë afruar zeros. Ato më së shumti ju drejtohen blerjeve të letrave me vlerë të qeverisë. Ky është një dallim shumë i madh midis këtyre dy sistemeve. Në këtë instrument kanë avantazh ekonomitë mikse.

Tabela Nr.6 Vlerat aktuale dhe historike të normës bazë të interesit të bankës qendrore të Kinës.

Muaj, data, viti	20 Pr. 2020	20 Shk. 2020	20 Nënt. 2019	20 Sht. 2019	20 G. 2019	23 Tet. 2015	25 G. 2015	27 Ko. 2015	10 Maj. 2015	28 Shk. 2015	21 Nënt. 2014
Përqindje	3.85	4.05	4.15	4.20	4.25	4.35	4.60	4.85	5.10	5.35	5.60

Burimi. TRADINGECONOMICS.COM/PEOPLES BANK OF CHINA

BE e ka normën bazë të interesit 0 dhe USA 0.25, Kina e ka 4%. Banka Qendrore e Kinës ka shumë mundësi të operojë me normat e interesit në krahasim me Fed-in dhe BOE-në që i kanë normat të pa përfillëshme. Dinamika e uljes së NBI kineze nga viti 2014 në prill 2020 ka qënë shumë e moderuar, ajo është ulur nga 5.6% në 3.85% ose me -1.75%. Një ulje pak e prekëshme në gjashtë vite, që tregon për efektivitet të sistemit monetar.

Konkluzione dhe Rekomandime. Vendet e ndryshme të botës reagojnë në mënyra të ndryshme ndaj pasojave negative të koronavirusit (COVID-19). SHBA dhe BE reagojnë në mënyrë agresive duke rritur dukshëm deficitet fiskale të tyre. Vendet e Azisë, Kina, Rusia nuk vepruan në këtë mënyrë, ata ishin më të përmbajtur dhe kishin më shumë mundësi të vepronin me politikat monetare të kombinuara me politikat fiskale.

Vendet Perëndimore nuk mund ti përdornin më të gjitha instrumentet politike monetare sepse ato kishin arritur afër 0 në 0 dhe nën zero me normat e interesave të kredive midis bankave, normat një ditore, Normën e REPO-ve etj. Ato përdorën blerjen e Bonove të Thesarit të Qeverisë ose të letrave të tjera me vlerë, si mënyrë për të rritur likuiditetin në qarkullim.

Vendet e Azisë kanë një ritëm më të madh rritje se vendet e Europës dhe SHBA-së. Kina ka një rritje mesatare prej 6% në 30 vitet e fundit. Ajo është ekonomia e dytë e botës.

Vendet e Azisë me sisteme mikse treguan më shumë vitalitet, në disa drejtime.

E para patën më pak vdekje se vendet e SHBA, BE dhe UK.

E dyta, treguan shpejtësi dhe efektivitet në përballimin e situatës duke e izoluar dhe eliminuar për një kohë të shkurtër.

Së treti, hapën bizneset dhe filluan aktivitetin e tyre në një kohë të shkurtër, duke filluar rikuperimin e humbjeve ekonomike.

Së katërti, Bankat e tyre kishin më shumë instrumenta për të rritur likuiditetin në ekonomi, sepse mund të vepronin lirshëm me norma interesi 4%. Kredia në këto vende është kryesisht në shërbim të rritjes së ekonomisë nëpërmjet stabilitetit të monedhës, sepse edhe objektivi i BQ të tyre ka përparësi rritjen ekonomike.

Politikat fiskale ishin të matura dhe nuk ndoqën politikat e FED-it amerikan, por u mbështetën kryesisht në nevojat e tyre.

-Ekonomitë perëndimore dhe Ekonomia Shqiptare duhet të shikojnë që në disa sektorë strategjikë dhe në Banka të përfshijnë kapitalin shtetëror.

-Ti shtojnë më shumë kujdes dhe fonde shëndetësisë. Të shikojnë njeriun si kapitalin më të çmuar.

-Të përmirësojnë/ose të ndryshojnë objektivat Bankave Qendrore të tyre, në funksion të rritjes së prodhimit dhe rënjes së papunësisë.

-Të shikojnë futjen e parasë virtuale si mjet këmbimi globale, ndër shtetëror, duke eliminuar funksionin e dollarit, euros, paundit etj si para botërore.

Bibliografi

- Worldometer elaboration of the latest United Nations data.2020

- Source, unless otherwise specified: "Demographic Yearbook – Table 3: Population by sex, rate of population increase, surface area and density" (PDF). United Nations Statistics Division. 2012. Retrieved 29 November 2014.
- "World Economic Outlook Database, October 2019". IMF.org. International Monetary Fund. 15 October 2019.
- IMF report for China". International Monetary Fund. October 2018.
- "How is China shaping the global economic order?". CSIS China Power. Archived from the original on 20 September 2016. Retrieved 26 August 2016.
- "GDP ranking". World Bank. Archived from the original on 14 January 2015. Retrieved 25 January 2015.
- "China's private sector contributes greatly to economic growth: federation leader - Chinadaily.com.cn". www.chinadaily.com.cn. Retrieved 21 January 2020.
- Zitelmann, Rainer. "State Capitalism? No, The Private Sector Was And Is The Main Driver Of China's Economic Growth". Forbes. Retrieved 21 January 2020.
- "Report for Selected Countries and Subjects". www.imf.org. Retrieved 21 September 2019.
- Anthony, Craig (12 September 2016). "10 Countries with the Most Natural R. Investopedia. Archived from the original on 16 September 2017. Retrieved 15 September 2017. Resources".
- China's banking institutions report growth in total assets, liabilities in March – Xinhua English.news.cn". www.xinhuanet.com. Archived from the original on 28 April 2019. Retrieved 7 April 2018.
- "China Total Deposits [1997–2019] [Data & Charts]". www.ceicdata.com. Archived from the original on 8 April 2018. Retrieved 7 April 2018.
- "Country Comparison: Stock of direct foreign investment – at home". CIA. Archived from the original on 17 September 2013. Retrieved 14 August 2013.
- Country Comparison: Stock of direct foreign investment – abroad". CIA. Archived from the original on 24 May 2011. Retrieved 9 May 2011.
- "Country Comparison: Stock of direct foreign investment – abroad". CIA. Archived from the original on 24 May 2011. Retrieved 9 May 2011.
- "The US is home to more billionaires than China, Germany and Russia combined". CNBC. Archived from the original on 9 May 2019. Retrieved 9 May 2019.
- "Global 500 (updated)". Fortune. Archived from the original on 7 August 2019. Retrieved 10 September 2019.
- China Widens Lead as World's Largest Manufacturer". thomasnet.com. Archived from the original on 27 July 2013. Retrieved 25 August 2013.
- China's Economy Is Catching Up to the U.S." Archived from the original on 17 March 2018. Retrieved 8 March 2018.
- "Trade recovery expected in 2017 and 2018, amid policy uncertainty". Geneva, Switzerland: World Trade Organization. 12 April 2017. Archived from the original on 3 July 2017. Retrieved 22 June 2017.
- "Currency Reform" (PDF). brookings.edu. Archived (PDF) from the original on 2 April 2015. Retrieved 28 March 2015.
- CONSTITUTION OF THE PEOPLE'S REPUBLIC OF CHINA". 2004.
- Source: World Currency Composition of Official Foreign Exchange Reserves. International Monetary Fund. 11 april 2020.
- Coronavirus Preparedness and Response Supplemental Appropriations Act, HR 6074
- Families First Coronavirus Response Act, HR 6201
- Coronavirus Aid, Relief, and Economic Security Act, (CARES Act), HR 748.

- The fiscal response to the economic fallout from the coronavirus. Last update: 04 June 2020 by Julia Anderson, Enrico Bergamini, Sybrand Brekelmans, Aliénor Cameron, Zsolt Darvas, Marta Domínguez Jiménez, Catarina Midões.
- Impacts of Coronavirus Containment Effort Ripple Through Global Economy. Feb 13, 2020. Analysis, Asia.
- UNIDO. Coronavirus: the economic impact. Which countries and manufacturing sectors are most affected by the COVID-19 crisis? Some early evidence and possible policy responses. 26 may 2020
- Ligji i Republikës Popullore të Kinës për Bankën Popullore të Kinës (Miratuar në Sesionin e Tretë të Kongresit të Tetë Kombëtar Popullor më 18 Mars 1995, shpallur me Urdhrin Nr. 46 të Presidentit të Republikës Popullore të Kinës më 18 Mars 1995, dhe ndryshuar në përputhje me Vendimin për Ndryshimin e Ligjit të Republikës Popullore të Kinës në Bankën Popullore të Kinës të miratuar në Takimin e 6-të të Komitetit të Përhershëm të Kongresit të Dhjetë Popullor Kongresit më 27 Dhjetor 2003).
- TRADINGECONOMICS.COM/PEOPLES BANK OF CHINA.
- Investing.com 2020. world Central Banks.

PAKETAT MBËSHTETËSE PËR PËRBALLIMIN E KRIZËS NË ITALI

Prof.asoc.Dr. Orkida Ilollari
Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë
orkida.ilollari@umsh.edu.al

Abstrakt

Pandemia e koronavirusit është një tragjedi njerëzore me përmasa potenciale jetike dhe mbijetese ekonomike. Ndikimi i pandemisë Covid19 në ekonominë botërore ishte mëse i dukshëm. Masat e bllokimit synuan zvogëlimin e infeksioneve dhe dëshmuar të ishin efektive në kontrollimin e përhapjes së virusit, veçanërisht në Itali, ku tendenca javore e infeksioneve të reja tashmë po shkon drejt zvogëlimit në mënyrë të vazhdueshme.

Sidoqoftë, nëse nga njëra anë këto janë përfitimet e bllokimit, nga ana tjetër duhet të shohim edhe kostot ekonomike që sollën masat e marra të izolimit. Nga raportet ekonomike ditore të paraqitura tregojnë një pamje e qartë e uljes së mprehtë të kërkesës dhe konsumit e cila nuk ishte vetëm në Itali, por në të gjithë botën.

Rezultati në ekonomi është i padiskutueshëm, këto muaj u karakterizuan nga rënia e kërkesës, një ulje drastike të PBB-së dhe për rrjedhojë një ulje të vlerës së prodhuar nga ndërmarrjet, ose në terma më të thjeshtë, një ulje e përgjithshme e të ardhurave.

"Pyetja kryesore nuk është nëse, por sesi shteti duhet ta vendos buxhetin e tij në përdorim në mënyrën më efikase. Prioriteti nuk duhet të jetë vetëm sigurimi i të ardhurave themelore për ata që humbasin punën e tyre. (Draghi 2020)

Tashmë është e qartë se çdo qeveri e të gjitha vendeve do të përballej me një rritje të konsiderueshme të borxhit publik.

Nëse këto janë efektet afatshkurtra, lind pyetja: Se cilat do të jenë efektet në planin afatgjatë? Mund të kemi përgjigje të ndryshme por asnjëra mund të mos jetë e saktë pasi këto parashikime janë në të vërtetë të pasigurta.

Nga dekreti "Rinisa" i qeverisë italiane qëllimi është të garantohet likuiditeti për bizneset dhe qytetarët me qëllim të ruajtjes së sistemit të prodhimit dhe mbështetjes së kërkesës, në mënyrë që të mos lihen pjesë të tëra të popullatës pa të ardhura. Një ngjarje katastrofike jo vetëm për stabilitetin shoqëror të Italisë, por edhe për të gjithë sistemin ekonomik global.

Fjalët kyçe: Covid-19, Coronavirus, pandemi, kriza financiare, recension global, politika monetare, politika fiskale.

Abstract

Coronavirus pandemic is a human tragedy with impending vital dimensions and economic survival. The impact of Covid19 pandemic on the world economy was more than obvious. The lockdown measures aimed at reducing infections proved to be effective in controlling the spread of the virus, especially in Italy, where the weekly trend of new infections is already steadily declining. However, if on one hand these were the benefits of the lockdown and restriction measures, on the other we should also have a look at the financial costs that the undertaken measures brought. The presented daily financial reports showed a clear picture of the sharp decline in demand and consumption which was not only in Italy but all over the world. The impact it had on the economy is indisputable and these months were seemingly characterized by a drop off demand, a drastic GDP declining and consequently a decrease in the value produced by enterprises, or in other simply put words: it led to a wide-range shrink of revenues.

"The main question though is not "whether", but "how" the state should allocate its budget by setting it in use to work in the most efficient way. Providing and securing basic income for those who lose their jobs shall not be its sole priority. (Draghi 2020).

It is already clear that all governments, in all countries, would see a significant increase in their public debt. If these are short-term effects, than: What will be the effects in the long run? We may have different answers but none can be accurate as these forecasts are actually uncertain.

The aim of Italian Government Decree "Renewal", is to guarantee liquidity for businesses and citizens in order to maintain the production system and sustain demand, so as to secure that population and vast categories of citizens are not left without an income. A shattering, catastrophic occurrence not only for Italy's social stability, but also, for the entire financial system.

Keywords: Covid-19, Coronavirus, pandemic, financial crisis, global recession, monetary policy, fiscal policy, liquidity provision.

Hyrje

Trendi i ekonomive të shumë vendeve ndërlidh ngushtë me zhvillimin e pandemisë dhe pasigurisë, si dhesesi do të përhapej apo do të izolohej virusi. Efektet do të ishin të paparashikueshme nëse valët e reja të virusit e bënin të domosdoshme alternimin midis periudhave të hapjes dhe të mbylljes.

Sidoqoftë, është po aq e rëndësishme të kuptohet sesi do të shpërndahen edhe kostot e krizës. Në fakt, joçdo kush ka pësuar një ulje të të ardhurave dhe madje disa madje mund të gjenden edhe më të pasur në fund të kësaj krize. Të gjithë e dimë se është më i varfëri ai që mbart kostot më të mëdha ekonomike. Të rinjtë e pasigurt, punonjësit e bizneseve të vogla të cilët po bëjnë sakrificat në fund të muajit, punëtorët e padeklaruar, janë segmenti i popullatës tashmë të varfër, segment i cili po varfërohet edhe më tepër. Është e qartë se vendimi midis "mbylljes" dhe "hapjes" duhet të jetë rezultat i një analize kosto-përfitim.

- Po si u shndërrua një krizë shëndetësore në një krizë ekonomike?
- Pse përhapja e koronavirusit uli në gjunjë ekonominë globale?

Përgjigja qëndron në dy mënyra me të cilat covid 19 mbyti aktivitetet ekonomike.

Së pari, përhapja e virusit solli distancimin fizik i cili çoi në mbylljen e tregjeve financiare, zyrave të korporatave, bizneseve, ativiteve ekonomike etj.

Së dyti, shkalla eksponenciale në të cilën u përhap virusi si dhe rritja e pasigurisë që situata mund të perceptonte keq e më keq çoi drejt uljes së konsumit, prodhimit dhe investimeve. Ajo çfarë edhe u pa, ishte se rritja e numrit të ditëve dhe javëve të bllokimit dhe izolimit, vendimet e politikës monetare dhe kufizimet e udhëtimeve ndërkombëtare, ndikuan rëndë nivelin e aktiviteve ekonomike si dhe në bursa.

Coronavirus, ndikimi në ekonominë ndërkombëtare

Në këtë kontekst, stabiliteti makroekonomik do të sigurohet vetëm brenda një kornize të ndarjes më të madhe në nivelin evropian të ngarkesave të krizës shëndetësore dhe efekteve të saj. Natyra e tronditjes, simetrike dhe ekzogene, ka nevojë për një përgjigje të përbashkët si në përballjen me rritjen e shpenzimeve të lidhura me nevojat e menjëhershme, ashtu edhe në mënyrë që të mbështesë rimëkëmbjen e ekonomisë reale. Asnjë vend nuk mund të dalë vetëm prej tij. Financimi i këtyre shpenzimeve me emetimet e letrave me vlerë evropiane do të bënte të mundur uljen e barrës për buxhetet kombëtare dhe gjithashtu të bënte një hap përpara drejt krijimit të asaj pasurie të sigurt kontinentale që mund të favorizonte diversifikimin e rrezikut të sistemeve financiare. Mos procedimi në këtë mënyrë do të rrezikojë të dobësujë projektin evropian, duke e vënë të ardhmen e tij në rrezik.

Ndërsa shpërthimi i krizës dhjetë vite më parë u iniciua nga financat, sot natyra e tronditjes është nga bllokimet e aktiviteve dhe karantinimi. Në këtë fazë u goditën

veçanërishtshërbimet, si pjesa më e rëndësishme e vlerës së shtuar në vendet e përparuara, me më shumë punonjës sesa sektori i prodhimit dhe ku shitjet e humbura vështirë se mund të rikuperohen. Natyra reale dhe globale e një krize që fillon nga shërbimet, sjell efekte shumë të rënda shumëfishuese të lidhura me tregtinë ndërkombëtare, duke e bërë rënien e këtyre aktiviteteve edhe më të madhe. Përveç të gjitha paqartësive që lidhen me kohëzgjatjen dhe intensitetin e mbylljeve të aktiviteteve, është reaktiviteti pasues me të cilin vendet e ndryshme do të përpiqen të rikuperohen.

Prometeia vlerëson për vitin 2020 një reëesion në ekonominë botërore (-1.6%), i përhapur për vendet e industrializuara dhe jotë industrializuara, ku vetëm Kina shmanë një rënie falë reagimit pozitiv në gjysmën e dytë të vitit. Duke e krahasuar me vitin 2009, rënia globale e aktivitetit rezultoi 0.4%, ndërkohë për vitin 2021, rikthimi në ekonominë globale pritet të arrijë në 4.6%. Më në fund, në Shtetet e Bashkuara, ku një paketë masash prej 2,000 miliardë dollarë (9.3% e të ardhurave kombëtare, më shumë se niveli i PBB-së italiane) është duke u aprovuar për të ndihmuar bizneset dhe familjet, PBB në vitin 2020 do të bjerë me 2.5%, për t'u rikuperuar më pas me 3.6% vitin e ardhshëm.

Efektet ekonomike të pandemisë Covid 19-Itali

Epidemia në fillim u adresua dhe u komentua kryesisht në anën shëndetësore të qytetarëve dhe sigurisht që emergjenca shëndetësore mbetet parësore. Por nga ana tjetër vëmendjau drejtua me shpjëtësinë efektet ekonomike që po shkaktonte kjo pandemi. Bota tashmë ishte në një fazë të ngadalësimit të fortë ekonomik, situata aktuale e kontaminimit, e cila preku rreth 48 vende, e theksoi këtë ngadalësim edhe më tej. Përsa i përket Italisë, parashikimi ekonomik për vitin 2020 është ai i stanjacionit. Tani, çdokush mund të mendojë se kur të tejkalohet kjo krizë shëndetësore, situata e një krize shumë serioze ekonomike do të prekë industrinë, sistemin e biznesit, prodhimit dhe punëtorët (tashmë të prekur).

Italia, vendi më i prekur nga virusi në Evropë, tashmë po përballet me probleme seriozeshëndetësore ashtu si edhe ekonomike. Tremujori i fundit i vitit 2019, ndikoi gjatë gjithë vitit dhe përfundoi me një rënie të PBB-së në -0.3%.


Tremujori i parë i vitit 2020 ishte vështirë në vetvete dhe PBB rezultoi negative. Nga ana tjetër, rajonet më të prekura (Lombardia, Piemonte e Veneto) ndikuan shumë në PBB. Shumë ekonomistë mendojnë se pa ndërhyrje adekuate, problemi mund të jetë i tillë për të gjithë vitin si dhe e parashikojnë këtë vështirësi të fortë ekonomike edhe për vitin 2021.

Të dhënat para pandemisë, ishin të lidhura kryesisht me vështirësi në prodhim dhe bujqësi, të lidhura kryesisht me lehtësimin e shërbimeve. Shumë sektorë tashmë janë në vështirësi serioze, sidomos sektori i turizmit që është edhe nga sektorët më të prekur. Problemi tjetër është edhe aktiviteti prodhues në vend, mungesa e kapitalizimit të mijëra bizneseve të vogla dhe vështirësia për t'u kredituar mund të çojnë në mbyllje të tjera pasi kohëzgjatja e tyre pa aktivitet dhe pa kredi kufizon më tej bazën e prodhimit. Edhe rënia e bursave, që tani i atribuohet vetëm frikës, lë rrezikun e spekulimeve financiare të lidhura me një mbivlerësim të mëparshëm të disa letrave me vlerë. Në këtë situatë, të gjitha mjetet që lidhen me emergjencën në fakt janë të nevojshme, duke filluar me rrjetet e sigurimeve shoqërore (amortizatorët sociale).

Sasia monetare e vënë në dispozicion prej 4.5 miliardë të parashikuara në dy dekretet po rezultojnë shumë të vlefshme dhe pritet të verifikohen edhe rezultatet. Bankat qëndrore ndërhyjnë, me norma të ulta interesi dhe ndërhyrja kryesore lidhet me injektimin e likuiditetit. Por kjo nuk mund të sigurojë siguri kredie për bizneset dhe familjet. Vendet që janë në një situatë të "ngjarjeve të jashtëzakonshme", jo vetëm që duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme, por është vetë Evropa, nën trysinë e perspektivës së saj.

Parashikimi i ekonomisë italiane për vitin 2020

Zona e Euros, tashmë ka paguar për Covid-19 me -3.8% në PBB-në. Sipas analizave dhe parashikimeve të institutit të Bolonjës për vitin 2020 janë përlllogaritur nga -6.5% në -8.5% të PBB-së për faktin se bllokimi mund të dëmtojë rimëkëmbjen e disa sektorëve më shumë se të tjerët. Të gjitha këto të kombinuara me faktin se masat për të mbështetur ekonominë italiane do të çojnë borxhin publik në 155.4% të PBB-së për vitin 2020, duke e bërë qëndrueshmërinë e rimëkëmbjes edhe më të brishtë. Duke iu referuar Bankës së Italisë, emergjenca e koronavirusit ka rënduar tashmë PBB-në. Sipas edhe shumë studimeve të paraqitura rreth vijimësisë së ekonomisë italiane, si më poshtë në grafik shikohet parashikimi i PBB për vitin 2021 duke e krahasuar atë me vitin aktual 2020 dhe 2019.



Sipas Banka D'Italia (maj 2020), ndikimi i pandemisë Covid - 19 në ekonominë Italiane nuk prononcohet me një fjali përfundimtare, por përshkruan disa alternativa të mundshme, të gjitha këto si pasojë e recesionit për vitin 2020. Gama e vlerësimeve për vitin 2020 dhe 2021, është jashtëzakonisht e madhe: midis -6 dhe -15 pikë përqindje për vjeshtën e vitit 2020, dhe midis 2 dhe 13 pikë përqindje për rikuperimin në vitin e ardhshëm (2021). Një pasiguri po aq e lartë vlen për vendet e tjera në zonën e euros.

Skenari makroekonomik i ilustruar për ekonominë italiane në (%)			
	2019	2020	2021
PBB	0.3	-9	4.8
Konsumi i familjeve	0.4	-8.8	4.6
Investime fikse bruto	1.4	-12.4	3.2
Eksporte	1.4	-15.4	8
Importe	-0.2	-17.3	9.7
Punësimi (njësi pune ekuivalente)	0.3	-9.8	5
Punësimi	0.6	-3.8	2.7
Inflacioni në konsum	0.6	-0.1	0

Banka D'Italia (2020)

Një hipotezë e ndërmjetme do të ishte: "PBB-ja në Itali bie me 9 përqind mesatarisht në vitin 2020 dhe më pas do të zgjerohej me 4.8 përqind në 2021, këto janë vlera afër mesatares të paraqitura nga parashikuesit kryesorë makroekonomik. Përveç rënies së kërkesës së huaj dhe flukseve turistike ndërkombëtare, rënia e mprehtë e kërkesës së brendshme, pas pezullimit të disa aktiviteteve ekonomike për të përmirësuar ngjitjen dhe pasojat e krizës mbi punësimin, do të kontribuonte në trendin e vitit aktual dhe mbi të ardhurat shtëpiake. Rimëkëmbja e PBB-së, nga gjysma e dytë e vitit 2020, do t'i atribuohet kryesisht zhdukjes së efekteve negative të furnizimit të lidhura me masat e kontrollit. Ndërsa pasojat e rënies së kërkesës së huaj, të flukseve turistike dhe sjelljes më të kujdesshme të familjeve dhe bizneseve, do të kishin efekte

më të vazhdueshme ekonomike, duke ngadalësuar kthimin e aktivitetit të prodhimit në nivelet e para krizës.

Itali -Dekreti Ligjor "Rinisja" prej 55 miliardë euro në lidhje me masat urgjente në mbështetje të ekonomisë.

Ky dekret është një "mburojë" prej 55 miliardë euro për të mbrojtur bizneset, familjet dhe punëtorët nga dëmet e shkaktuar nga pasojat e emergjencës shëndetësore. Dekreti ligjor përmban kushtet për fillimin e rimëkëmbjes. Konfirmohen pikat kyçe, nga fondet në shëndetësi dhe mbrojtje civile deri në rinovimin e të gjithë rrjeteve të amortizatorëve sociale, deri në krijimin e një bonusi për punëtorët dhe kujdestarët vendas, si dhe të një instrumenti ad hoc, të ardhura në favor të emergjencës për familjet në vështirësi. Në tërësi, burimet për shëndetësinë të përfshira në dekret arrijnë në 3.25 miliardë.

Në dekret ka burime për CIG dhe bonuse për të vetëpunësuarit: 25.6 miliardë euro shkojnë në funksion për të rifinancuar CIG (cassa integrazione guadagni) dhe bonuse për të vetëpunësuarit të cilat janë amortizues shoqërorë dhe ekonomikë sepse ndihmojnë gjithashtu kompanitë të ruajnë efikasitetin e prodhimit. Deri tani janë paguar 85% të aplikacioneve CIG dhe gati 80% të bonuseve për punonjësit e pavarur, për 4.6 milion punëtorë. Në dekret u përfshi edhe një masë tjetër falë së cilës, kompanitë mund të ndajnë një pjesë të orëve të punës për trajnimin e punëtorëve, të cilat do të paguhen nga Shteti (përfshirë kontributet e sigurimeve shoqërore dhe të mirëqenies) falë një "Fondi të veçantë të Trajnimit" të financuar me 230 milion euro.

Pothuajse 16 miliardë për bizneset, përmes taksës rajonale të aktiviteteve prodhuese (IRAP) në muajin qershor: Duke hyrë në detajet e angazhimeve ekonomike, gati 16 miliardë euro shkojnë në disbursim në forma të ndryshme. Do të ulen 4 miliardë euro tatime për të gjitha kompanitë deri në 250 milion euro faturime, duke hequr edhe këstin e IRAP për muajin qershor. Gjithashtu hiqet kësti i parë i Taksës Unike të Bashkisë (IMU) për hotelet, bujtinat, stacione plazhi, si dhe shtyhen të gjitha detyrimet, TVSH-ja, kontributet e sigurimeve shoqërore deri në shtator.

Në prespektivë do të jetë një reformë më gjithëpërfshirëse fiskale: Të bësh një zbritje tatimore për të gjitha bizneset sot, siç ndodh në dekretin e rimëkëmbjes, do të thotë të sigurosh një formë indirekte të likuiditetit, do të thotë të lihen para në arkat e kompanive. Ende nuk është përcaktuar një reformë e sistemit tatimor, por kjo është një ndërhyrje una tantum. Qëllimi është përballja me një reformë më gjithëpërfshirëse në perspektivë, por kjo gjë nuk mund të bëhet në këto kushte.

Në lidhje me shëndetësinë vendet e kujdesit intensiv rriten me 115%: Me ndarjet e përcaktuara, vendet e kujdesit intensiv rriten me 115%, duke lëvizur në mënyrë të qëndrueshme nga 5179 vende përpara emergjencës pandemike në mbi 11000 vende.

3.25 miliardë euro të alokuara për shëndetin, 240 milion euro do të ndahen për punësime të reja, përfshirë ato të 9600 infermierëve të destinuar për të gjithë territorin, si dhe 190 milion euro në stimulim për mjekët dhe punonjësit e kujdesit shëndetësor.

Sektorët e përfshirë në rregullim janë: bujqësia, blegtoaria dhe zooteknika, peshkimi si dhe aktivitetet që lidhen me to. Parashikohet pagesa prej 400 eurosh për secilin punëtor, ose 160 euro për procedurën dhe një shumë të kontributit për shumatat e detyruara nga punëdhënësi në shpërblim, kontribute dhe taksë.

Superbonusi – një revolucion për ekonominë dhe mjedisin: Miratimi i superbonusit 110% për efikasitetin e energjisë dhe përshtatjen sizmike të banesave përfaqëson një revolucion për ekonominë dhe mjedisin. Bëhet fjalë për një normë që gjen konsensusin maksimal në qeveri dhe vlerësimin transversal të palëve dhe shoqatave të ndryshme.

4 miliardë euro për sektorin e turizmit: Bonusi i pushimeve për familjet me të ardhura jo më shumë se 40 mijë euro, ndalimi i këstit të parë të taksës unike të bashkisë për bizneset hoteliere

dhe vendpushimet e plazheve dhe më gjerë. Masat për turizmin të përfshira në dekret kanë një vlerë totale prej 4 miliardë eurosh. Dekreti i rindërtimit parashikon ndërhyrje për të mbështetur bizneset. Nga kreditë për qiratë, përjashtim nga IMU për hotele, agriturizëm, kamping dhe biznese të tjera akomodimi; kontribute në favor të ndërmarrjeve me humbje të mëdha të faturimit, ndërhyrje në fonde të pakthyeshme për agjensitë e udhëtimit dhe operatorët turistikë, fonde për të mbrojtur markën italiane, deri në forcimin e shtesave të pagave për punëtorët sezonalë dhe amortizatorët social (asistenca), si dhe kontributet domethënëse për rimëkëmbjen dhe përshtatjen e strukturave me kërkesat shëndetësore. Gjithashtu është parashikuar promovimi i turizmit, i cili do të ketë fonde të destinuar për turizëm të brendshëm duke filluar nga bonusi i pushimeve, i cili vetëm vlen rreth 2.4 miliardë euro, dhe deri te thjeshtëzimet e shumta si ato për baret dhe restorantet që do të inkurajojnë konsumin e jashtëm për një rikuperim më të sigurt .

Masat për të mbështetur 11 mijë ndërmarrje të reja (start-up): Në dekretin e rinisjes ka rregulla në lidhje me 11 mijë ndërmarrje të reja (start-up) që kishin vështirësi dhe mund të zhdukeshin si pasojë e emergjencës. Dekreti parashikon një dispozitë për të mbështetur biznesin e tyre dhe për të qëndruar pranë biznesit të së ardhmes.

Shtesa për punonjësit shtëpiakë dhe kujdestarët për fëmijë do të jetë 500 euro, për muajt prill dhe maj, alokimi i parashikuar në dekret është 468.3 milion euro. Kontribut deri në 840 euro për grupet me persona me aftësi të kufizuara. Në dekretin e rinisjes janë të parashikuara të ardhurat e emergjencës, me të cilat do të ndihmojmë konkretisht ata që sot janë pa mbështetje dhe nuk janë në gjendje të sigurojnë ushqim për veten dhe fëmijët e tyre. Kjo shumë arrin deri në 840 € për familjet që kanë të afërmit me aftësi të kufizuara ose jo të mjaftueshme.

Fond prej 3.5 miliardë euro për Bashkitë, Provincat dhe Qytete Metropole: Me këtë dekret arrihet themelimi i një fondi në Ministrinë e Brendshme me një alokim për vitin 2020 prej 3.5 miliardë eurosh, që do të ndahet midis Komunave, Provincave dhe qyteteve metropolitane, deri më 10 korrik 2020, bazuar në humbjen e të ardhurave dhe nevojat për funksionet themelore. Pritet të disbursohen 30 përqind të fondit si një pagesë në përpjesëtim me të ardhurat në 31 Dhjetor 2019. 190 milion euro për stimulim për mjekët dhe infermierët: Më në fund, mbërrijnë 190 milion euro stimuj për punonjësit e kujdesit shëndetësor. Në dekret, norma e primeve që do të paguhet për mjekët dhe infermierët ka ndryshuar nga draftet e mëparshme. Ndarja, paraqitur nga qeveria, tani arrin në 190 milion euro.

A po humbasin italianët besimin në BE dhe si iu përgjigj Evropa Italisë?

Kur Covid-19 u shfaq në Evropë ishte Italia ajo që u godit e para dhe u godit fort. Pak ndihmë erdhën nga fqinjët e saj evropianë në ato javë të para në shkurt dhe mars, pasi spitalet në veri ishin të mbingarkuar. Ndërsa Italia numëron 31,000 të vdekur, shqetësimi po rritet edhe për ndikimin ekonomik, dhe ka shenja të një rritje të numrit të italianëve që humbin besimin në BE. Sipas një studimi të 1.000 italianëve të kryer në muajin prill'20 nga Tecné, 42% e të anketuarve thanë që do të largoheshin nga BE. Sidoqoftë, një e katërta e këtij numri thanë që ata do të jenë të përgatitur të qëndrojnë në bllok nëse Evropa aprovon masa konkrete për Italinë. Sipas edhe parashikimeve prodhimi ekonomik i vendit do të bjerë me 8% për vitin 2020.

Kjo shkallë e rënies do të shtojë borxhin publik të Italisë këtë vit në 155.7% të PBB-së (ISTAT 2020) .

Në nivel evropian, instrumentet kryesore që u diskutuan ishin: "Recovery Fund", "MES", "SURE (Support to mitigate unemployment risks in emergency), BEI, "Bazooka BOE". "Coronabond". Pra bëhej fjalë për një fond prej më shumë se 2000 miliardë euro në funksion të mbështetjes ekonomike e sociale anti-krizë në nivel evropian. Më 18 mars, Banka Qendrore Evropiane filloi një program të blerjes së bonove prej 750 miliardë eurosh për të ndihmuar vendet më të borxhit të eurozonës duke ulur kostot e huamarrjes.

Më 8 prill'20, Eurogrupi i ministrave të financave të eurozonës ranë dakord për një plan shpëtimi prej 540 miliardë eurosh.

Plani i shpëtimit ishte e përbërë nga:

- 200 miliardë euro si një linjë e re krediti për kompanitë, e siguruar nga Banka Evropiane e Investimeve
- 100 miliardë kredi për të mbështetur skemat e papunësisë së përkohshme
- 240 miliardë euro si një linjë kredie e siguruar nga Mekanizmi Evropian i Stabilitetit (MES) për të financuar sistemet shëndetësore të eurozonës.

Ajo çfarë nuk u prit mirë në Itali ishte pikërisht pjesa e fundit të paketës, pra MES i cili u aplikua për herë të parë në vitin 2012, siguroi kredi për Greqinë dhe disa vende të tjera të BE-së gjatë krizës financiare. Italia MES-in nuk e cilësoi dhuratë por një hua, për t'u ripaguar me kushte tepër të sakta të zgjedhura në Bruksel

Po çfarë ofroi BE për Italinë më 27 Maj'20?

Paketa e Fondit të Rimëkëmbjes të propozuar nga Komisioni Evropian për Italinë arrin në 172.7 miliardë euro: 81.807 miliardë do të paguhen si ndihmë dhe 90.938 miliardë si kredi.

Shifrat madje tejkalojnë propozimin e Macron dhe Merkel që propozuan vetëm për 500 miliardë në subvencione. Brukseli do të rimbursojë pronarët e letrave me vlerë në BE falë burimeve të reja të Unionit, siç është taksat plastike, ndalimi i shmangies së taksave të gjigandëve të web-it dhe një sistemi të ri të pagesave të kuotave duke përfshirë edhe kompanitë ajrore dhe anijet. Italia do të jetë përfituesi kryesor i fondeve: kështu mbledh gati një të katërtën e të gjithë paketës, pasi do të përcaktohet nga BE si "vendi më i prekur" nga viruset dhe recesioni.

Në fakt, Komisioni i kërkoi Romës të forcojë sistemin shëndetësor, të lehtësojë efektet sociale të krizës, të përmirësojë arsimin dhe të bëjë drejtësinë dhe administratën publike më efikase.

Në fjalimin në Parlamentin Evropian Ursula von der Leyen pasi prezantoi propozimet e Komisionit për të mbështetur rimëkëmbjen evropiane në këtë moment të vështirë, përfundon fjalimin duke u shprehur se: "Ne ia kemi borxh brezave të ardhshëm. Rroftë Evropa".

5. Parashikimet e S&P për ekonominë evropiane pas koronavirusit

Sipas S&P Global Ratings, Eurozona do të përballlet me një recesion në rend të një rënie prej 2% të PBB-së në vitin 2020, e barabartë me 420 mijë miliardë euro të PBB-së reale, për shkak të pandemisë. Rreziqet janë të gjitha në riulje, në rast se pandemia mund të zgjasë më gjatë sesa pritej, duke depresionuar PBB-në e eurozonës me deri në 10%. Në vitin 2021, megjithatë, pritet një rikthim prej + 3%, përveç një + 1.5% të mëtejshëm në 2022 dhe 2023.

Për momentin, masat fiskale dhe monetare si dhe politikat ekonomike në përgjithësi do të jenë çelësi i përballjes së emergjencës ekonomike që do të pasojë këtë periudhë. Sidoqoftë, megjithëse të gjitha vendet e BE-së kanë miratuar masa të ngjashme, jo të gjithë do të përjetojnë të njëjtën shpejtësi të rimëkëmbjes për shkak të "frymës" të ndryshme fiskale që ekonomitë e tyre përkatëse do të jenë në gjendje të tërheqin. Në veçanti, Franca dhe Gjermania kanë më shumë fonde për të financuar papunësinë sesa Italia dhe Spanja, të cilat gjithashtu kanë një numër më të madh të SME (ndërmarrjet e vogla dhe të mesme) të pavarura, të cilat do të jenë kompanitë më të dëmtuara nga tronditja ekonomike. Prandaj ka më shumë të ngjarë që ekonomitë franceze dhe gjermane të shërohen më shpejt se të tjerat.

Konkluzione

Si fillim çfarë mund të mësohet nga Pandemia e Covid-19?

Pandemia e koronavirusit dhe kriza ekonomike pasuese po evoluojnë me shpejtësi në shtrirje dhe ashpërsi. Po çfarë është specifike në lidhje me këtë krizë? Pasojat ekonomike, financiare, sociale, politike e mjedisore të covid-19 në shkallë globale janë shumë të rënda, duke e renditur atë si një nga pandemitë më shkatërruese në histori.

Ajo çfarë u identifikua pas muajve kur kjo krizë shpërtheu si dhe sfidat ekonomike që çdo vend prekur do të përballlet janë:

Kostot ekonomike do të jenë të konsiderueshme

Është e qartë se kostoja e krizës do të tejkalojë parashikimet e mëparshme nga analiza e G20 / FMN (duke parashikuar një rënie prej 0,1% dhe 0,5% të PBB-së vjetore përkatësisht) dhe me siguri do të arrijë të paktën 1.5% ose 1 trilion dollarë në të gjithë botën. Kjo do të thoshte teknikisht një recesion global (rritje botërore më pak se 2.5%) me të gjitha rajonet kryesore të prekura.

Kriza kombinon goditjet e kërkesës dhe ofertës

Kufizimet për njerëzit, punëtorët dhe firmat kanë çuar në një rënie paralele të kërkesës në sektorë si prodhimi, tregtie, udhëtimi, argëtimi etj.

Zinxhirët e furnizimit global po shohin përçarje në furnizimin e komponentëve, të tilla si makineri ose pëlhura nga Italia apo Kina, ku eksportet ranë me një të pestën në muajin Janar'20 dhe Shkurt'20. Ka rëndësi sesi vendet janë të integruara në zinxhirë të tillë vlerash dhe sa janë të diversifikuar ku ato më të integruara do të goditen më rëndë.

Kriza është përhapur në sektorin financiar

Tregjet e aksioneve kanë rënë me shpejtësi, duke fshirë edhe fitimet e realizuara gjatë vitit të kaluar. Portofolet e kredive të këqija do të rriten dhe do të bëhet më e vështirë edhe mbledhja e tyre. Kjo periudhë e paqëndrueshmërisë tashmë ka bërë që rreth 42 miliardë dollar, të tërhiqen nga tregjet në zhvillim ndërsa investitorët kërkojnë siguri në tregjet e vendosura dhe monedhat.

Të gjitha vendet së bashku në këtë pandemi

Kjo krizë ndikoi në shëndetin dhe më shumë në pasurinë e klasave të mesme dhe të varfëra. Vendet me të ardhura të ulëta do të preken përmes mekanizmave të ndryshëm, si rëniet në turizëm dhe transportin ajror, uljet e çmimeve të naftës dhe çmimet e mallrave (përgjysmimi i çmimeve të naftës që nga fillimi i vitit 2020 do të zvogëlojë eksportet neto nga Afrika nën-Sahariane me 30 miliardë dollarë), ose ndërprerje e zinxhirit të furnizimit.

Por vendet dhe sektorët e ndryshëm kanë cënueshmëri të veçantë ekonomike, duke përfshirë nivele të ndryshme të ekspozimit dhe rezistencës, të cilat nuk janë përcaktuese. Ata që varen nga mallrat do të mbesin gjithmonë më të paqëndrueshëm derisa të kenë një përhapje më të larmishme të prodhimit.

Bibliografia

- Atkeson, A. (2020). What will be the economic impact of COVID-19 in the US? Rough estimates of disease scenarios (No. w26867). National Bureau of Economic Research.
- Baldwin, R., & Tomiura, E. (2020). Thinking ahead about the trade impact of COVID-19. *Economics in the Time of COVID-19*, 59.
- Barbieri, T., Basso, G., & Scicchitano, S. (2020). Italian workers at risk during the Covid-19 epidemic. Available at SSRN 3572065.
- Boccia, S., Ricciardi, W., & Ioannidis, J. P. (2020). What other countries can learn from Italy during the COVID-19 pandemic. *JAMA Internal Medicine*.
- Crespi, C. Covid-19 Outbreak In Italy: Are we ready for the psychosocial and the economic crisis? Baseline findings from the PsyCovid Study.
- Economist, The. 2020a. "Commodity Economies Face Their Own Reckoning Due to Covid-19." March 5. <https://www.economist.com/finance-and-economics/2020/03/05/commodity-economiesface-their-own-reckoning-due-to-covid-19>

- WHO. Global surveillance for human infection with coronavirus disease (COVID-2019). Available at: [https://www.who.int/publications-detail/globalsurveillance-for-human-infection-with-novel-coronavirus-\(2019-ncov\)](https://www.who.int/publications-detail/globalsurveillance-for-human-infection-with-novel-coronavirus-(2019-ncov)) (Accessed Jan 31, 2020).
- Fernandes, N. (2020). Economic effects of coronavirus outbreak (COVID-19) on the world economy. Available at SSRN 3557504.
- Goumenou, M., Sarigiannis, D., Tsatsakis, A., Anesti, O., Docea, A. O., Petrakis, D., ...& Aschner, M. (2020). COVID 19 in Northern Italy: An integrative overview of factors possibly influencing the sharp increase of the outbreak. *Molecular Medicine Reports*.
- https://www.repubblica.it/economia/2020/05/27/nee/recovery_fund_ue_von_der_ley_en_crisi_coronavirus-257720493/
- La Marca, A., Niederberger, C., Pellicer, A., & Nelson, S. M. (2020). COVID-19: lessons from the Italian reproductive medical experience. *Fertility and sterility*, 113(5), 920.
- Loayza, N. V., & Pennings, S. (2020). Macroeconomic policy in the time of COVID-19: A primer for developing countries.
- Lustig, N., & Mariscal, J. 20 How COVID-19 could be like the Global Financial Crisis (or worse). *Mitigating the COVID Economic Crisis: Act Fast and Do Whatever*, 185.
- McKibbin, W. J., & Fernando, R. (2020). The global macroeconomic impacts of COVID-19: Seven scenarios.
- Ozili, P. K., & Arun, T. (2020). Spillover of COVID-19: impact on the Global Economy. Available at SSRN 3562570.
- Presidenza del Consiglio dei Ministri. Available at: <http://www.governo.it/it/articolo/coronavirus-contefirma-il-dpcm-11-marzo-2020/14299>
- Ruiz Estrada, M. A., & Khan, A. (2020). Globalization and Pandemics: The Case of COVID-19. Available at SSRN 3560681.
- Santacroce, L., Charitos, I. A., & Del Prete, R. (2020). COVID-19 in Italy: an overview from the first case to date. *Electron J Gen Med*. 2020; 17 (6): em235.
- Surico, P., & Galeotti, A. (2020). *The economics of a pandemic: the case of Covid-19*. Wheeler Institute for Business and Development, LBS. London: London Business School.

EKONOMIA POST-NORMALE: DREJT NJË REVOLUCIONI DE-GLOBALIST?

Dr. Florjan Bombaj
Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë
florjan.bombaj@umsh.edu.al
Dr. Valter Hoxha
Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë
valter.hoxha@umsh.edu.al
Dr. Majlinda Shehu
Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë
majlinda.shehu@umsh.edu.al

Abstrakt

Ky artikull ekzaminon ndikimin e krizës së Koronavirusit në proceset evolutive aktuale të ekonomive Europiane, dhe sfidat për udhëheqësit e njësive ekonomike në shumë sektorë. Hipoteza kryesore e diskutuar në këtë artikull është që në kushtet e një ekonomie post-normale sjellja e aktorëve ekonomikë do të ndryshojë në atë kah që mund të impaktojë në mënyrë afatgjatë strukturën e ekonomive Europiane dhe botërore. Me një metodologji observuese të mbledhjes së të dhënave sasiore dhe cilësore, rezultatet paraprake elucidojnë faktin që puna fizike, siç njihet deri më sot, e ekonomisë normale po tenton drejt ndryshimit të vlerës dhe drejt virtualizimit të saj. Çështje të tilla si de-globalizimi dhe recesioni në të cilën ekonomia do të gjejë veten diskutohen në këtë artikull.

Fjalë kyçe: De-globalizimi; Recesioni; Franca; Spanja

Abstract :

This article examines the impact of the Coronavirus crisis on the current evolutionary processes of European economies, and the challenges for economic units' leaders in many sectors. The main hypothesis discussed in this article is that in the conditions of a post-normal economy the behavior of economic actors will change in a way that can affect in the long run the structure of the European and global economies. With an observational methodology of collecting quantitative and qualitative data, the preliminary results elucidate the fact that the physical work, as it was known until today, of the normal economy is tending towards the change of value and towards its virtualization. Issues such as de-globalization and the recession in which the economy will find itself are discussed in this article.

Keywords: De-globalization; Recession; France; Spain

Konteksti botëror

Sistemi mbizotëruar globalist, i përqendruar në rritjen e pafundme të materies në një botë të fundme, varfëron burimet natyrore dhe shkakton degradim që prek seriozisht ekosistemet. Njerëzimi ka ushtruar, në një mënyrë jashtëzakonisht të pabarabartë midis individëve që e përbëjnë atë, një "gjurmë ekologjike" gati mbi dy herë të kapacitetit të planetit. Shoqëria aktuale njerëzore, pra, po jeton me kredi "në kurriz të brezave të ardhshëm". Sistemi ekonomik global tashmë po penalizon familjet me të ardhura të ulëta dhe njerëzit që jetojnë në varfëri, në të gjithë dimensionet (Jha et al., 2019). Korrigjimi urgjent i këtyre problemeve të ndërlydhura kërkon një reagim sistemik dhe global që i ripozicionon speciet njerëzore brenda ekosistemit të tyre natyror nga i cilijanë distancuar gabimisht dhe nga padija.

Ndërsa Koronavirusi përhapet në të gjithë globin, është bërë e qartë se ai ka potencialin të largojë nga shinat e prosperitetit ekonominë botërore. Si një person i shëndetshëm që kap gripin sezonal, kriza mund të jetë e shkurtër dhe e mprehtë. Një postulat i tillë dukej i mundshëm kur Koronavirusi ishte në thelb një problem kinez dhe Kina po merrej me të. Kohët tanimë kanë ndryshuar (Baldwin & di Mauro, 2020). Duket se e sëmura aziatike i la stafetën e përballimit të

krizës ekonomike vendeve Europiane, ku ndër më të prekurat në kontinentin European mbeten Franca dhe Spanja. Masat e izolimit kanë një ndikim shumë domethënës në jetën shoqërore dhe ekonomike, duke shndërruar thellësisht kushtet e funksionimit të njerëzve dhe organizatave. Esencialisht, në shumë fusha të menaxhimit, është e nevojshme një diagnozë e ndikimit të një krize shëndetësore në proceset organizative dhe parashikimi i sfidave me të cilat përballen menaxherët dhe organizatat në shumë sektorë. Kërkimi dhe reflektimi mbi aspektet sociale, ekonomike dhe organizative të krizës së Koronavirusit është utilitarist.

Pak studime ekzistojnë mbi ndikimin e kësaj krize në jetën ekonomiko-shoqërore. Në të njëjtën kohë, vlerësimi i rreziqeve dhe efekteve të saj duhet të jetë shumëdimensional dhe i nënshtrohet një pasigurie të konsiderueshme (Ragheb, 2020). Pas kësaj krize sjellja jonë do të ndryshojë, me detyrimapo me vullnet të lirë kjo mbetet për t'u parë. Kjo situatë mund të na bëjë të vetëdijshëm për gjërat thelbësore dhe të ndihmojmë për të vënë në pikëpyetje kuptimin e modelit tonë të prodhimit dhe konsumit globalist.

Ky artikull është një përpjekje për të bërë një diagnozë në lidhje me ndikimin e krizës së Koronavirusit në nivel europian, duke përfshirë proceset organizative në ndërmarrje, dhe sfidat për shtetete përzgjedhura në analizën shumë fusha të ekonomisë. Hipoteza kryesore e diskutuar në këtë artikull është që në kushtet e një ekonomie post-normale sjellja e aktorëve ekonomikë do të ndryshojë në atë kah që mund të impaktojë në mënyrë afatgjatë strukturën e ekonomive Europiane dhe të planetit. Artikulli në pjesën e dytë trajton kuadrin teorik në lidhje me ekonominë post-normale dhe sfidat e saj. Në pjesën e tretë metodologjia shpjegon mënyrën e mbledhjes së rezultateve që analizohen në pjesën e katërt të këtij artikulli. Pjesa e pestë diskuton rezultatet dhe tenton t'i japë përgjigje hipotezës sonë fillestare.

Kuadri teorik dhe pyetja e kërkimit

Zhvillimet kolektive e bëjnë sejcilin nga elementët e dallueshëm të një tërësie të pamundur për t'u perceptuar në përgjithësinë e tij (Durkheim, 1898). Në zonat urbane, shoqërueshmëria dhe kultura krijojnë kushtet më të favorshme për përmbushjen individuale. Moda dhe konsumi intensifikojnë jetën, qarkullojnë paratë, zhvillojnë njohuritë dhe kulturën (Simmel, 2011). Në kohë krize, është e vështirë t'i rezistosh tundimit për t'u rikthyer te imazhet konvencionale të kombit, me rrezikun e këtij vizioni të karikaturës vestfaliane që përfundimisht prish ndjenjën e përkatësisë (Whimster & Lash, 2014). Kështu, në epokën e globalizimit, një patogjen mund të dëshmojë se është më i fuqishëm se infrastruktura e planifikuar për t'a kontrolluar atë. Natyra rastësore e efekteve kumulative të urbanizimit industrial duhet të merret në konsideratë për të kuptuar ndërthurjen midis natyrës, teknologjisë dhe shoqërisë (Larrère & Larrère, 2015). Wuhan është një nga këta qytete industriale i lindur nga globalizimi. Jeta e përditshme e punëtorëve nuk është e rregulluar siç mund të jetë prodhimi i teknologjisë së lartë, sepse vetëm një kosto minimale e jetesës garanton vazhdimin e mrekullisë ekonomike të tij, ndërkohë që mbyllja e menjëhershme e zinxhirëve të prodhimit tregoi ndërvarësinë e jashtëzakonshme të ekonomive të globalizuara (Sułkowski, 2020).

Përhapja e Koronavirusit nuk klasifikohet si një tronditje e kërkesës ose e ofertës (Cochrane, 2020). Por mund të rezultojë në tronditje të kërkesës "praktike dhe psikologjike", nëse agjentët ekonomikë parandalohen të hyjnë në dyqane ose të shtyjnë blerjet përballë një pasigurie të madhe (Baldwin & di Mauro, 2020). Ndikimi i Koronavirusit në ekonomi do të jetë shumë domethënës, duke marrë parasysh shkallën e tij dhe dobësinë e ekonomisëaktuale (Kickbusch & Leung 2020). Recesioni, virtualizimi i komunikimit dhe nevoja në rritje e tij mund të detyrojë shtetet dhe organizatat ndërkombëtare të forcojnë bashkëpunimin në shkallë globale. Nga ana tjetër, tendencat e de-globalizimit mund të jenë gjenezat e tyre (Kozlov & Sokolova, 2020; He, Lin, & Zhang, 2020).

Ndërsa shkenca ishte kuptuar më parë si përparim i qëndrueshëm në sigurinë e njohurive tona dhe kontrollin e botës natyrore, tani shkenca shihet se po përballlet me shumë paqartësi në

çështjet e politikës së rrezikut dhe mjedisit. Si përgjigje, stilet e reja të veprimtarisë shkencore janë duke u zhvilluar (Funtowicz&Ravetz, 1995). Tani që çështjet e politikës së rrezikut dhe mjedisit paraqesin problemet më urgjente për shkencën, pasiguria dhe cilësia po lëvizin nga periferia e metodologjisë shkencore, për t'u bërë konceptet qendrore, integruese të kësaj ekonomie post-normale. Një rol i ri për shkencëtarët do të përfshijë menaxhimin e këtyre paqartësive thelbësore; këtu qëndron detyra e sigurimit të cilësisë së informacionit shkencor të dhënë për vendimet e politikave ekonomike. Metodologjia post-normale aplikohet kur pasiguritë janë të llojit epistemologjik ose etik, ose kur aksionet e vendimeve reflektojnë qëllime kontradiktore midis palëve të interesuara. Ne e quajmë atë "post-normale" për të treguar se ushtrimet për zgjidhjen e enigmave të shkencës normale nuk janë më të përshtatshme për zgjidhjen e çështjeve të rreziqeve dhe pasigurive natyrore (Funtowicz&Ravetz, 1995). Kjo analizë e të dhënave apo e realitetit është një formë e vlefshme kërkimi, e përshtatshme për nevojat e së tashmes. Duke u bazuar në hipotezën tone fillestare, pyetja jonë e kërkimit është si vijon: a jemi duke konverguar drejt një sistemi ekonomik de-globalist?

Metodologjia e kërkimit

Metodologjia e kërkimit është një përmbledhje e literaturës, jo shumë e gjerë, në lidhje me këtë temë. Ekziston një mungesë e studimeve për pasojat organizacionale dhe sociale të Koronavirusit dhe në të njëjtën kohë ne po përjetojmë një përmbajtje të informacionit nga ana e medieve. Ne jemi të vetëdijshëm se vlerësimi i ndikimit është subjekt i pasigurisë dhe se duhet të jetë shumëdimensional. Materiali ynë bazë bazohet në një koleksion të madh të të dhënave cilësore dhe sasore, parësore dhe dytësore mbi dy vendet ndër më të prekurit nga kriza e Koronavirusit në nivel European, Franca dhe Spanja. Një monitorim i vazhdueshëm i informacioneve që vinin nga mediet më të mëdha Europiane u bë gjatë periudhës Mars-Maj 2020. Në të njëjtën kohë u bë një kërkim i literaturës shkencore më të fundit mbi konceptin e deglobalizimit që po diskutohet nga rrymat alternative të ekonomistëve modernë.

Metoda ndjek tre etapa:

Etapa e parë: Leximi iartikujvedhe publikimeve mbi krizën shëndetësore dhe ekonomike për të dy vendet e përzgjedhura. Identifikimi i çdo ndryshimi ekonomik apo masave të marra nga qeveritë respektive.

Etapa e dytë: Ndjekja e reagimeve institucionale të bankave qendrore dhe organizmave botërorë në lidhje me krizën ekonomike si dhe publikimet më të fundit mbi gjendjen e sektorëve ekonomikë më të rëndësishëm për të dy vendet.

Etapa e tretë: Analiza e rezultateve.

Rezultatet

Ekonomia Franceze dhe koronavirusi

Një humbje prej 60 miliardë eurosh çdo muaj karantine, një rënie prej 18% e konsumit të familjeve, papunësi e pjesshme e cila mund të prekë 5.7 milion punonjës. "Kjo krizë është jashtë të gjitha proporcioneve me gjithçka që kemi njohur" sipas publikimit të fundit të OFCE-së, qendrës kërkimore mbi ekonominë në Science-Po (30 Mars, 2020). Pasi Instituti Kombëtar i Statistikave dhe Studimeve (INSEE), i cili vlerësoi, më 26 Mars, se tronditja e shkaktuar nga epidemia e koronavirusit do t'i kushtonte Francës rreth 3 pikë përqindje të PBB-së gjatë vitit, OFCE-ja, vlerësoi, të hënën, 30 mars 2020, ndikimin në aktivitetin dhe punësimin e krizës shëndetësore dhe masat e kufizimit që ai vendos. "Është një tronditje përtej masës me gjithçka që ne kemi njohur" (Xavier Ragot, president i INSEE). Në fakt OFCE-ja vlerëson se masat e kontrollit të vendosura për të frenuar epideminë do të kushtonin pak më shumë se 30 pikë të PBB-së mujore, duke përfaqësuar një humbje prej 2.6% gjatë vitit, që përfaqëson 60 miliardë humbje të pasurisë në muaj karantine. Kjo tronditje e konsiderueshme transmetohet kryesisht

përmes kanalit të kërkesës, përmes rënies së konsumit të familjeve, por edhe rënies së investimeve, veçanërisht në sektorin e ndërtimit, me ndalimin e shumë projekteve. Kësaj i duhet shtuar edhe ndikimi i krizës në turizëm, të huaj dhe vendas, humbjet e të cilit mund të kthehen rreth 14 miliardë në muaj për shkak të mbylljes së kufijve. Goditja e ofertës buron nga vështirësia e ndërmarrjeve në vazhdimin e aktiviteteve të tyre. Shumë prej tyre janë detyruar të mbyllën me dekretin e qeverisë, të tjerat përballen me mungesë të punës për arsye të ndryshme. Mbetet për tu parë se sa do të jetë fatura nëse kriza zgjat më shumë se një muaj. Rënia e kërkesës dhe ngadalësimi ose ndërprerja e aktivitetit mund të provokojnë një rekurs masiv ndaj punës me kohë të shkurtër, e cila mund të prekte, në afat të gjatë, 5.7 milion njerëz, ose 21% të punësimit të paguar. Në këtë hipotezë - duke marrë parasysh që të gjitha kërkesat pranohen -, kostoja direkte për financat publike do të ishte 12.7 miliardë euro në muaj, të cilave duhet t'i shtohen 8.7 miliardë humbje nga kontributet shoqërore. Kjo do të thotë në total një kosto buxhetore e cila mund të arrijë në më shumë se 20 miliardë euro në muaj.

Banque de France dhe kriza ekonomike.

Sipas parashikimeve të Banque de France, PBB-ja franceze pritet të tkurret me 6% në tremujorin e parë të vitit 2020, si rezultat i koronavirusit. Pas rënies prej 0,1% të PBB-së në tremujorin e katërt të vitit 2019 (veçanërisht për shkak të grevës në transport), Franca do të hyjë në recesion. Në të vërtetë, një recesion karakterizohet nga një rënie e PBB-së gjatë dy tremujorëve radhazi. Rënia në PBB që pritet në tremujorin e parë është historike. Vendi duhet të përjetojë një krizë më të dhunshme se ajo e vitit 2008-2009, e cila tashmë ishte më e rënda që nga viti 1945. Rënia më e madhe tremujore e PBB-së deri më tani ka ndodhur në tremujorin e dytë të vitit 1968. PBB-ja më pas ra për 5,3% për shkak të grevave, para se të rritej 8% në tremujorin e tretë. Sipas Banque de France, aktiviteti ekonomik u zvogëluar me 32% gjatë 15 ditëve të izolimit në mars. Një izolim dy javor rezultoi në një humbje vjetore të PBB-së prej rreth 1.5%. Kjo shifër është një vlerësim i marrë duke ndarë humbjen e aktivitetit në lidhje me mbylljen gjatë 15 ditëve (32%) me numrin e 15 ditëve në vit (24). Sidoqoftë, nuk merr parasysh efektet kumulative të izolimit së zgjatur, ose efektet e mundshme të rimëkëmbjes pasi të hiqet izolimit. Sektorët e biznesit më të prekur janë sektori i ndërtimit (-75%) dhe sektori i tregtisë, transportit, akomodimit, hotelarisë (-65%). Humbja e aktivitetit për industrinë prodhuese (përfshirë ushqimin dhe rafinimin) vlerësohet në 48%, dhe shërbimet e tregut pësojnë një rënie të aktivitetit prej 37%. Përkundrazi, bujqësia dhe shërbimet jo-tregtare (veçanërisht shërbimet publike) panë që aktiviteti u ul respektivisht vetëm me 6% dhe 9% (Banque de France, 08 Prill 2020).

Kritikat e modelit ekonomik francez

Për Ministrin e Ekonomisë dhe Financave Franceze, Bruno Le Maire, kriza nga Covid-19 ofron një mundësi për të vënë në dyshim gjithçka, për të krijuar një model të ri ekonomik, më njerëzor, më të bashkuar, më altruist dhe më empatik. "Ne kemi nevojë për një kapitalizëm të ri, i cili ka më shumë respekt për njerëzit, më i interesuar për të luftuar pabarazitë dhe më shumë respekt për mjedisin" (Bruno Le Maire, 02 Prill 2020). Sipas Christophe Ramaux, Profesor në Universitetin Paris 1 Panthéon-Sorbonne dhe autor i librit "L'État social" ky kapitalizëm neoliberal, i përcaktuar në katër pika (sfida e një sistemi universal të mbrojtjes shoqërore, liberalizimi i tregut të punës, privatizimi i shërbimeve publike dhe liberalizimi i politikave ekonomike), është "vrasësi i rritjes shumëvjeçare dhe të qëndrueshme, mirëqenies së pakushtëzuar dhe lumturisë kolektive. Kujdesi spitalor, shërbimet shëndetësore dhe të gjitha shërbimet publike janë viktimat shlyese të kapitalizmit neoliberal" (Christophe Ramaux, 02 Prill 2020).

Në të vërtetë, ky model mbizotëruar në botën perëndimore për më shumë se dy shekuj dhe i ripohuar pas krizës "subprime" në 2008 po vihet në dyshim. Kritikët kundër globalizimit, kundër akumulimit të pasurisë, kundër përpjekjes së pandërprerë për fitim, kundër individualizimit dhe egoizmit moral po përshpejtohen dhe forcohen. Sidomos pasi që, në kohën e luftës kundër

pandemisë, shenjat e solidaritetit dhe simpatisë pohohen nëpër rrugë, në ndërtesa, në fshatra, në lagje. Njerëzit ndihmojnë njëri-tjetrin dhe bashkojnë forcat, duartrokasin dhe mbështesin spitalin, forcojnë dhuratat e tyre, përballen me njëri-tjetrin duke kundërshtuar ideologjinë e secilit për veten e tij dhe të laissez-faire specifike për kapitalizmin. Muajt do të shënojnë një rënie të konsiderueshme të tregtisë ndërkombëtare. Mbyllja e kufijve do të kufizojnë zinxhirët e prodhimit, në dobi të shkëmbimeve lokale dhe rajonale, me fjalë të tjera "de-globalizimin e ekonomive reale". Sipas ekonomistëve të bankës së investimeve Natixis tashmë ne po shohim shenja të këtij deglobalizimi të vërtetë si për shembull rënia e investimeve të drejtpërdrejta në Kinë (nga 300 miliardë dollarë në 2017 në 225 miliardë dollarë në vitin 2020) dhe stanjacioni i tyre në vendet e tjera në zhvillim. Po përjetojmë pra një rritje të qëndrueshme të shpenzimeve publike për shëndetin, pagesa të papunësisë, mbështetjen e korporatave, dhe fundin e shtrëngimi buxhetor. Me fjalë të tjera, fundi i kapitalizmit do të ilustron nga një rishpërndarje më e mirë e të ardhurave publike dhe mbështetje për aktivitetin primar. Pra thjesht, duke forcuar shtetin e mirëqenies. Prandaj ishte koha për t'i dhënë fund një sistemi të tillë që mbështet masat shtrënguese dhe konkurrencën e taksave kundër solidaritetit dhe ndihmës së ndërsjellë.

Ekonomia Spanjolle dhe koronavirusi

Spanja është sot një ndër vendet më të prekura në botë nga pandemia Covid-19, sa i përket vdekjeve dhe kontaminimit. Një situatë që e detyroi qeverinë të forcojë masat e kontrollit të popullatës, me pezullimin e prodhimit të mallrave dhe shërbimeve jo thelbësore. Cilat do të jenë pasojat ekonomike për vendin? Çfarë ndikimi, në planin afatgjatë, për financat publike? Ekonomia spanjolle po e kalonte krizën e borxhit. Vendi madje regjistroi rritje ekonomike prej 2% në 2019, pra më shumë mbi mesataren e zonës së euros. Por kriza aktuale shëndetësore e lidhur me pandeminë e koronavirusit do ta çojë vendin në recesion. Shkalla e këtij recesioni do të varet nga kohëzgjatja e masave të kontrollit dhe në rastin më të keq, PBB-ja mund të ulet me 6% këtë vit. Në këtë kontekst, Spanja mund të shohë papunësinë të rritet me shpejtësi, dhe falimentimet e biznesit të rriten. Kjo situatë shpjegohet në veçanti nga varësia e madhe e ekonomisë spanjolle nga turizmi, e cila përfaqëson 15% të PBB-së dhe 13% të vendeve të punës në vend. Sidoqoftë, rimëkëmbja e këtij sektori varet jo vetëm nga situata në Spanjë, por edhe nga heqja e masave të kontrollit në pjesën tjetër të botës. Për t'u marrë me këto rreziqe të shumta ekonomike, ekonomia e katërt në zonën e euros ka planifikuar një plan mbështetjeje për familjet dhe bizneset. Por ndikimi i tij i drejtpërdrejtë në financat publike mbetet i vështirë për t'u vlerësuar në këtë fazë, sipas ekonomistëve të EulerHermes. Gjithçka do të varet, ndër të tjera, nga numri i Spanjollëve që do të përfitojnë nga masat e papunësisë të pjeshme.

Banco de España dhe kriza ekonomike.

Banco de España vlerëson se masat ekonomike të miratuara deri më tani, përfshirë mbështetjen për kujdesin shëndetësor, me 0.3 përqind të PBB-së, përfaqësojnë 1.4 % të PBB-së Spanjolle, ose rreth 17.43 miliardë euro. Raporti sqaron se nga kjo shumë totale, 0.5% e PBB-së (6.22 miliardë €) përfaqëson një rritje të drejtpërdrejtë të shpenzimeve, ndërsa pjesa tjetër ka për qëllim të sigurojë garanci dhe linja kredituese për kompanitë. Banco de España, si autoritet kompetent kombëtar nën Mekanizmin e Vetëm Mbikëqyrës (SSM), miraton masat e njoftuara nga BQE-ja dhe i shtrin ato, aq sa është e aplikueshme, për të gjitha institucionet financiare mbi të cilat ushtron kompetenca të drejtpërdrejta mbikëqyrëse.

Kritikat e modelit ekonomik spanjoll

Me borxhin sovran që afrohet 100% të PBB-së, Spanja ka më pak fleksibilitet fiskal dhe ekonomik sesa në vitin 2008 (Pedro Aznar, Profesor i ekonomisë, financave dhe kontabilitetit - ESADE Business School). Ai thekson rëndësinë e menaxhimit të pritshmërive dhe besueshmërinë për të siguruar që publiku të silllet në një mënyrë që ndihmon për të zbutur ndikimin e kësaj krize.

Një nga faktorët më përcaktues në lidhje me rezistencën e ekonomisë spanjolle përballë krizës COVID-19 është varësia e saj nga turizmi, një nga industritë më të rëndësishme për sa i përket PBB-së dhe ajo do të vuajë më së shumti për shkak të ndikimit në kërkesën agregate dhe punësim. Në fund të vitit 2019, industria e turizmit përbënte 2.3 milion persona të regjistruar në sistemin e sigurimeve shoqërore nga 19 milion gjithsej në Spanjë. Një tjetër faktor kryesor në ekonominë spanjolle është mbizotërimi i bizneseve të vogla dhe të mesme, dhe kjo tregon se ofertaagregate do të preket gjithashtu nga kjo krizë pasi zinxhirët e furnizimit po fillojnë të goditen. Sipas tij, një krizë e likuiditetit është eminentë dhe nuk është e vështirë të imagjinohet se së shpejti do të bëhet një krizë e aftësisë paguese me shumë kompani që hyjnë në rënie të aktivitetit. Për të mbrojtur vendet e punës dhe për të ndihmuar kompanitë, qeveria ka ndërmarrë hapa për t'i bërë politikat tatimore më fleksibile, siç janë pagesa e shtyrë e taksave, mbështetja për familjet në nevojë dhe personat e prekur nga skemat e tepërta të përkohshme, etj, megjithëse këto do të kenë një ndikim negativ mbi të ardhurat nga taksat - një burim financimi për këto politika. Për t'iu përgjigjur sfidave ekonomike të kësaj krize globale shëndetësore, është e nevojshme të gjesh një zgjidhje globale, shumëpalëshe bazuar në bashkëpunimin ndërkombëtar. BE-ja tashmë ka ndërmarrë një hap në këtë drejtim duke lehtësuar objektivat e defiçitit por ato mund të ndërmarrin më shumë veprime dhe të përparojnë drejt një koordinimi më të ngushtë në lidhje me taksimin dhe politikat ekonomike.

Kriza ekonomike në nivel European

Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) vlerësoi të hënën, 30 Mars 2020, se një recesion i thellë në vitin 2020 në kontinentin European është i pa evitueshëm për shkak të pasojave serioze ekonomike të koronavirusit. Në ekonominë e mëdha europiane, shërbimet jo thelbësore të mbyllura me dekretet e qeverive përbëjnë rreth një të tretën e prodhimit (Poul Thomsen, FMN). Kjo do të thotë se çdo muaj këta sektorë mbeten të mbyllur, kjo përkthehet në një rënie prej 3% të PBB-së vjetore. Ekonomisë sëEurozonës mund t'i duhen deri në vitin 2023 për tu rikuperuar nga ndikimi i krizës nga koronavirusi sipas raportit më të fundit tëMcKinsey & Company .Industritë më të goditura nga kriza, përfshirë hapësirën ajrore, udhëtimet dhe sigurimet, mund të shohin një rikuperim më të ngadaltë. Brenda sektorit të udhëtimeve, tronditja ndaj kërkesës së menjëhershme vlerësohet të jetë 5-6 herë më e madhe sesa pas sulmeve terroriste të 11 shtatorit 2001 - megjithëse shërimi mund të jetë më i shpejtë për udhëtimet brenda Unionit.

Kriza ka përforcuar gjithashtu sfidat ose dobësitë ekzistuese në hapësirën ajrore dhe automobilave, të cilat do të ndikojnë në nivelet e rikuperimit të tyre.Ndërsa zinxhirët e furnizimit në të gjithë botën janë ndërprerë, raporti paralajmëron se ndikimi i plotë nuk është ndjerë ende. Drejtuesit e biznesit duhet të përgatiten për efektet në prodhim, transport dhe logjistikë dhe kërkesat e klientëve. Këto përfshijnë një rënie të kërkesës nga konsumatorët që çon në fshikullimë të stoqeve, si mungesën e fuqisë punëtore për shkak të mbylljes ose zvogëlimit të kapaciteteve prodhuese.Ndërsa qeveritë Europeanepërballen me koronavirusin, Brukseli analizon planin rezervë të emergjencave për kornizën financiare shumëvjeçare, pra buxhetin e ardhshëm shtatëvjeçar të BE-së që do të fillojë nga fillimi i vitit të ardhshëm.Ursula von der Leyen , presidentja i Komisionit European, deklaroi që do të zbulojë një propozim të ri për buxhetin 2021-2027, i krijuar për të ndihmuar në mbajtjen e financave të shëndosha pas krizës së koronavirusit. Këto plane do të përfshijnë një paketë rikuperimi për goditjen e pashmangshme të shkaktuar nga kriza. Por negociatat për buxhetin janë jashtëzakonisht të vështira në periudha të zakonshme dhe tani, me qeveritë që përballen me raste emergjente shëndetësore dhe ekonomike, shanset për miratimin e shteteve anëtare të këtij rishikimi me vlerë 1 095 trilionë euro, janë të pakët.

Reagimi institucional në nivel European

Në Europë, qeveritë kanë vendosur garanci publike në shumën prej 1 mijë miliardë euro vetëm për Eurozonën (500 miliardë euro në Gjermani, 300 miliardë në Francë, EUR 100 miliardë në

Spanjë) për të shmangur një rritje të falimentimeve të korporatave, dhe për të rritur shpenzimet fiskale mbi 250 miliardë euro. Masat përfshijnë moratoriumet e taksave, papunësinë e pjeshme dhe mbështetjen nga bankat publike kombëtare. Banka Qendrore Europiane ka lëshuar përveç blerjeve QE (Quantitative Easing) mujore edhe një Program të ri të Blerjes së Urgjencës së Pandemisë (PEPP) me vlerë 750 miliardë EUR (rreth 6% e PBB-së së Eurozonës), pas asaj të blerjeve mujore në shumën prej 20 miliardë eurosh dhe zarfin QE prej 120 miliardë eurosh. Kjo e çon totalin që do të blihet për pjesën e mbetur të vitit në 1.1 mije miliardë euro, duke i thënë lamtumirë kufizimit limitues të emetimit. Sidoqoftë, institucionet europiane kanë zhgënjyer pasi nuk kanë arritur të krijojnë ndërhyrje të mjaftueshme supranacionale.

Kostoja e masave stimuluese fiskale, ndikimi në rritjen e PBB-së dhe defiçitit fiskal

	Stimujt fiskalë (miliardë)	Pjesa e PBB-së	Impakti në rritjen e PBB-së (në pikë %)	Ndikimi në bilancin fiskal (në pikë %)
Gjermani	123	3,6%	1.3	-2.8
Francë	45	2,0%	0.8	-1.3
Itali	25	1,4%	0.7	-0.9
Spanjë	18	1,4%	0.5	-1.1
Mbretëria e Bashkuar	60	2,7%	1.1	-1.8

Burimi: Euler Hermes, Allianz Research

Diskutimi dhe konkluzionet

Ka të ngjarë që sektorë jetikë të rëndësishëm të ekonomisë do të preken nga përparimi i krizës së Koronavirusit në shkallë të ndryshme, megjithëse shkalla e humbjeve ka të ngjarë të jetë shumë e gjerë dhe shumë-sektoriale. Më të ndjeshmit dhe në të njëjtën kohë më të prekurit nga sektorët e kësaj krize do të përfshijnë turizmin, industrinë e hotelarisë, kinematografinë, transportin, edukimin dhe shëndetin (Sułkowski, 2020). Sektori i tregtisë, financiar, bankar dhe i sigurimeve dhe shumë aktivitete të tjera janë gjithashtu të ndjeshme. Disa lloje të veprimtarive të specializuara në lidhje me prodhimin farmaceutik, pajisjet mjekësore, si dhe llojet e zgjedhura të aktiviteteve të teknologjive të reja të informacionit mund të mbështeten në ruajtjen ose madje rritjen e nivelit të rritjes. Ndoshta më të kërcënuarit janë subjektet nga grupi i Sipërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme që nuk kanë burime për të mbijetuar nga kriza. Pasoja e mundshme e krizës në rritje të ekonomisë botërore do të jetë rritja e rolit ndërhyrës të shteteve dhe institucioneve financiare ndërkombëtare. Paketat mbrojtëse të ekonomisë që japin mundësinë për shtyrjen e ripagimit të huasë dhe taksave, marrjen e një pjese të kostove të punësimit ose të sigurimeve shoqërore nga buxheti qendror, dhënien e ndihmës shtetërore, prezantohen si modele nga qeveritë e shumë vendeve, përfshirë Francën, Spanjën, etj. Ndryshimi thelbësor do të jetë gjithashtu qëndrimi i ri i qeverive ndaj kujdesit shëndetësor, i cili do të bazohet më shumë në menaxhimin e sigurisë dhe ilaçeve nga katastrofat. Si rezultat i përhapjes së shpejtë të virusit, një ndryshim revolucionar po ndodh në mënyrat dominuese të komunikimit. Për arsye të sigurisë shëndetësore, biznesi, arsimit, madje dhe administrata qendrore dhe globale lëviz në internet. Ky është një ndryshim i thellë që përfshin: infrastrukturën teknike dhe elektronike, por mbi të gjitha formimin e modeleve të reja socio-kulturore. Duket se kalimi në metodat e komunikimit me bazë internetin po zhvillohet me një ritëm të shpejtë dhe gjithashtu përfshin trajnime, motivim dhe kontroll të punonjësve.

Pyetja fillestare e këtij artikulli vlen të merret në konsideratë nëse kriza e Koronavirusit do të kontribuojë në rritjen e globalizmit ose, përkundrazi, do të forcojë tendencat e de-globalizmit. Të dy variantet janë të mundshme. Recesioni, virtualizimi i komunikimit dhe nevoja në rritje e koordinimit të veprimtarive epidemike, shëndetësore dhe mjekësore midis vendeve mund të

detyrojnë qeveritë kombëtare dhe organizatat ndërkombëtare të forcojnë bashkëpunimin në shkallë globale. Nga ana tjetër, tendencat e de-globalizimit mund të jenë gjenezat e tyre (Kozlov & Sokolova, 2020, He, Lin, & Zhang, 2020). Padyshim, në fazën e tanishme të zhvillimit të kësaj situate, qeveritë kombëtare luajnë një rol udhëheqës. Roli i institucioneve të tjera si: OBSH-ja, Kleri dhe Bashkimi Europian është plotësues. Në këtë kuptim, qeveritë në përgjithësi do të dalin me një fuqi më të fortë nga kriza e Koronavirusit në krahasim me kohën para krizës. Në fazën e tanishme të krizës, vendet bëjnë zgjedhjet e tyre, duke zgjedhur politika më radikale të shëndetit dhe publikut (p.sh. Kina, Koreja e Jugut) ose aktivitete në shkallë më të vogël (p.sh. Mbretëria e Bashkuar, SHBA). Vendet gjithashtu mbështeten kryesisht në burimet e tyre të kujdesit shëndetësor dhe sistemin kombëtar të shëndetit dhe sigurisë. Nëse nuk bëhet një veprim ndërkombëtar i koordinuar në shkallë të gjerë, mund të flasim për një mbizotërim absolut të luftimit të kësaj krize në nivele kombëtarë, duke përdorur vetëm përvojën e importuar sipas protokolleve të parapërcaktuara.

Pritet që gjithnjë e më shumë, qytetarët në Perëndim do të kuptojnë ndërhyrjen e nevojshme të Shtetit për të përcaktuar dhe zhvilluar industri strategjike (farmaci, teknologji të reja, energji të rinovueshme, etj). Pra të kuptuarit se e gjithë popullata duhet të ketë mbrojtje të përshtatshme sociale. Është deri diku e dukshme që laissez-faire do të forcojë pabarazitë dhe ndryshimet si dhe do të rrisë rrezikun e pasigurisë ndaj të ardhmes. Kriza e koronavirusit do të çojë në dyshimin e të gjitha këtyre zgjedhjeve dhe mund të shpall fundin e kësaj forme të kapitalizmit. Si përfundim mund të themi që të dhënat që analizuam vërtetojnë pjesërisht hipotezën tonë fillestare dhe se studime të thelluara krahasimore midis shteteve të ndryshme janë të nevojshme për një panoramë më të saktë të asaj se si do të jetë ekonomia post-normale e kësaj krize.

Limitet e artikullit

Ky artikull analizoi tendencën e de-globalizimit në bazë të të dhënave të mbledhur për Francën dhe Spanjën gjatë një periudhe kohore tre mujore. Artikulli u përqendrua vetëm në këta dy vende. Hulumtimi i mëtejshëm në vendet e tjera mund të sjellë një pamje më të gjerë të potencialit të hipotezës sonë fillestare.

Bibliografia

- Baldwin, R., & di Mauro, B. W. (2020). Economics in the Time of COVID-19. A VoxEU.org Book, Centre for Economic Policy Research, London. Accessed, 26.
- Cochrane, John H. (2020) Coronavirus Monetary Policy, pp. 105–108: CEPR Press.
- Durkheim, É. (1898). Représentations individuelles et représentations collectives. *Revue de Métaphysique et de Morale*, 6(3), 273-302.
- Funtowicz, S. O., & Ravetz, J. R. (1995). Science for the post normal age. In *Perspectives on Ecological Integrity* (pp. 146-161). Springer, Dordrecht.
- He, L. Y., Lin, X., & Zhang, Z. (2020). The impact of de-globalization on China's economic transformation: Evidence from manufacturing export. *Journal of Policy Modeling*. <https://doi.org/10.1016/j.jpolmod.2020.02.001>
- Jha, A. K., Iliff, A. R., Chaoui, A. A., Defossez, S., Bombaugh, M. C., & Miller, Y. R. (2019). A crisis in health care: a call to action on physician burnout. Waltham, MA: Massachusetts Medical Society MHaHA, Harvard TH Chan School of Public Health, and Harvard Global Health Institute.
- Kickbusch, I., & Leung, G. (2020). Response to the emerging novel coronavirus outbreak. *BMJ*, 368. [Aksesuar online, 30/05/2020] <https://umsu.ac.ir/uploads/106.pdf>
- Kozlov, N., & Sokolova, N. (2020). Deglobalization: The Impact of the External Environment on Russian Economic Development. *Norwegian Journal of Development of the International Science*, (38-2).
- Ragheb, M. (2020). Risk quantification. *Nature*, 2, 26.
- Simmel, G. (2011). *Georg Simmel on individuality and social forms*. University of Chicago Press.

- Sułkowski, Ł. (2020). Covid-19 pandemic; recession, virtual revolution leading to de-globalization?. *Journal of Intercultural Management*, 12(1), 1-11.
- Whimster, S., & Lash, S. (Eds.). (2014). *Max Weber, rationality and modernity*. Routledge

COVID-19 NJË NXITËS PËR TRANSFORMIMIN DIXHITAL

Prof. As. Nevila Xhindi
Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë
nevila.xhindi@umsh.edu.al
PhD Vebina Resuli
Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë
vebina.resuli@umsh.edu.al
Msc. Erdet Lalaj
Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë
erdetlalaj@umsh.edu.al

Abstrakt

Pandemia e Covid-19 ka goditur veçanërisht sektorin e arsimit, dhe aktivitetet e mësimimëdhënies në të gjithë botën janë ndërprerë mbi 1.53 miliardë nxënës pas mbylljes së shkollave në të gjithë botën. Pandemia ka ndikuar në 87.6% të gjithë nxënësve të regjistruar në të gjithë botën (Anguiano et al., 2020). Edhe pse nevoja të tjera kërcënuese për jetën si shëndetësia, uji dhe higjiena kanë marrë shqetësime serioze. Ato janë referuar në kërkesat udhëzuese nuk mund të anashkalohen pasi ato gjithashtu kanë një efekt të pafavorshëm në mënyrë të ngjashme nëse jo të pa adresuar. Meqenëse nxënësve u kërkohet të vazhdojnë shkollimin gjatë kohës që janë në shtëpi, çështje të ndryshme si monitorimi i procesit të të nxënësve të studentëve, provimet, ndërveprimet në internet ose mësimi në grup, çështjet e të dhënave dhe intimitetit dhe qasja në materialin arsimor kanë qenë një sfidë për mësuesit, nxënësit, si dhe prindërit. Qeveritë duhet të sigurojë një platformë të qëndrueshme, të barabartë dhe uniforme që duhet të përdoret nga mësuesit dhe nxënësit në një vend të caktuar. Shumë qeveri në mbarë botën kanë inkurajuar mësuesit dhe nxënësit që të zhvillojnë procesin e tyre të mësimin në internet online. Ky hap është pak sfidues, veçanërisht për nxënësit në pamundësi ekonomike pasi nuk mund të përballojnë pajisjet e nevojshme për t'u regjistruar dhe për të marrë pjesë në proceset e klasave në internet, veçanërisht pas situatës më të rëndë ekonomike të dëshmuar gjatë krizës Covid-19. Nxënësit e tjerë nuk janë të njohur me platformat që përdoren për të zhvilluar orët mësimore, të tilla si zmadhimi i klasave të Google classroom e Microsoft Teams WhatsApp dhe Telegram. Monitorimi i procesit mësimor të nxënësit është i vështirë pasi nuk ka plan ose metodologji të caktuar për të bërë ose vlerësuar detyrat e shtëpisë. Bashkëveprimi në internet me nxënësit e tjerë gjatë mësimin në grup është mjaft sfidues jo vetëm për studentët, por edhe për mësuesit e tyre. Disa prej nxënësve u kërkohet të marrin materiale shtesë të kursit arsimor nga prindërit e tyre, gjë që është sfidues pasi shumica prej tyre nuk janë mësuar me të. Ekzistojnë mundësi më të larta që studentët nuk do t'i përmbahen rregulloreve të provimeve kur marrin provime nga shtëpia. Prandaj, është e vështirë të administrohen provime kur studentët janë në shtëpi sepse nuk do të përqendrohen ose ndjekin udhëzimet e nevojshme.

Fjalë kyçe: arsim, teknologji, zgjidhje, covid-19, sfidues, nxënës.

Abstract

The Covid-19 pandemic has particularly hit the education sector, and learning activities all over the world have been disrupted with over 1.53 billion students out of school after worldwide school closures. The pandemic has impacted 87.6% of the total enrolled learners around the world (Anguiano et al., 2020). Even though other life-threatening needs like healthiness, water, and hygiene have received serious concerns. They have been retorted to instructive requirements cannot be overlooked since they as well have a similarly disadvantageous effect if not unaddressed. Since learners are required to continue with their education while at home, various issues such as monitoring of students' learning process, examinations, online interactions or group learning, data and privacy issues, and access to educational material have been a challenge to teachers,

learners, as well as parents. The government should provide a consistent, equal, and uniform platform that should be used by teachers and learners in a particular country.

Many governments around the world have encouraged teachers and learners to conduct their learning process online. This step is a bit challenging, especially to the learners from poverty-stricken homes since they cannot afford the necessary gadgets to log in and take part in online class proceedings, especially after the worst economic situation witnessed during the Covid-19 crisis. Other learners are not conversant with the platforms being used to conduct the classes, such as Google classroom zoom Microsoft teams WhatsApp and Telegram. Monitoring the learner's instructive process is hard since there is no prescribed plan or methodology for doing or assessing homework. Interacting online with other learners during group learning is quite challenging not only for the students but also for their teachers. Some learners are required to get additional educational course materials from their parents, which is challenging since most of them are not used to it. There are higher possibilities that students will not adhere to exam regulations when taking exams from home. Therefore, it is hard to administer examinations when students are at home because they will not concentrate or follow the necessary guidelines.

Keywords: education, technology, solution, covid-19, challenging, learners.

Procesi i transformimit dixhital tenton të përmirësojë performancën dhe produktivitetin duke synuar inovacionin dhe njëkohësisht reduktimin e kostove. Në një nga publikimet e Këshillit Kombëtar të Kontrollit Rregullator Gjerman[1] është analizuar se duke eliminuar letrën nga transaksionet për shërbimet më të zakonshme:

Qytetarët mund të kursenin 84 milion orë kohë të lirë në vit

Kompanitë mund të zvogëlonin kohën e kaluar duke ndërvepruar me zyrat e qeverisë me 54% Autoritetet publike do të ishin në gjendje të kursenin rreth 3,9 miliardë Euro.

Shifra të tilla nxjerrin në pah efektin e madh që ka dixhitalizimi i proceseve për qeveritë, qytetarët si dhe për biznesin.

Transformimi dixhital ka një ndikim të gjerë në të gjitha fushat, biznes, mjekësi, qeverisje, duke krijuar oportunitete dhe njëkohësisht sfida. Disa drejtime si E-commerce, Big Data, Machine Learning, Inteligjenca Artificiale dhe Internet of Things (IoT) mund të sjellin përfitime të mëdha financiare.

Qasje e re mbi zhvillimin e teknologjisë në sektorë të ndryshëm, ndikon në përmirësimin dhe lehtësimin e jetës së qytetarëve, individit, biznesit etj. Tashmë nëpërmjet shërbimeve të dixhitalizuara që shumë vende të botës po ofrojnë, qytetarët marrin shërbimin e nevojshëm duke shmangur burokracitë dhe duke ulur koston në kohë dhe para. Psh, në Singapor, përdoret sistemi Singapore Personal Access (ose SingPass)[2] për të aksesuar një mori shërbimesh. Ky system mundëson ndërveprimin e drejtpërdrejtë, përmes një platforme të vetme, midis të gjitha agjencive qeveritare dhe qytetarëve. Gjithashtu, Estonia është në rrugën e saj për të ndërtuar kombin dixhital, duke u shndërruar kështu në një nga vendet më të dixhitalizuara në botë.

Termi E-qeverisje nuk shpjegohet vetëm me ofrimin e shërbimeve administrative ndaj qytetarëve, pra bashkëveprim qytetar-qeveri-qytetar (C2G, G2C), por edhe bashkëveprimin online qeveri-qeveri (G2G), duke shkëmbyer ide dhe informacion online mes qeverive të ndryshme, ndërveprimin qeveri-punonjes (G2E), që përfshin pagesat, taksat, trajnime etj, apo qeveri-biznes (G2B).

Disa nga bizneset të cilët kanë ndryshuar rrënjësisht për shkak të ndryshimeve në teknologji janë si më poshtë:

Agjensitë e udhëtimit. Më parë duhej të kontaktoje me një agjent udhëtimesh për të prenotuar një udhëtim ndërsa sot nëpërmjet faqeve të agjensive online apo rrjeteve sociale ofrohen shërbimet e nevojshme. Çdo gjë, që nga udhëtimi, hoteli, makinat me qera vetëm nëpërmjet faqes së agjensisë mund të merret shërbimi i nevojshëm. Gjithashtu rezervimi i udhëtimit tashmë mund të bëhet edhe individualisht, online, duke aksesuar faqet e hoteleve, linjave ajrore,

etj. Kjo ka sjellë ulje të numrit të agjensive dhe faktin që profesionet si agjent udhëtimesh të mos preferohen aq shumë.

Tregtia e videove me qera. Disa prej tyre kanë dalë jashtë tregut e të tjera luftojnë për mbijetesë. Sot njerëzit preferojnë të shohin filmat më të fundit online. Tashmë njerëzit preferojnë Netflix apo kompani të tjera duke mos harruar kompanitë pirate online. Pra mund të paguajnë një shumë fikse dhe mund të shohin të gjithë filmat që ofron faqja.

Industria e muzikës. Disqet tashmë kanë dalë jashtë loje pasi njerëzit preferojnë MP3, MP4 etj. Përveç rrugës ligjore për të shkarkuar muzikë, industria ka hasur problemin e shkarkimeve pirate, të cilat i nxjerrin këngët para se albumet të dalin në treg duke i shkaktuar problem artistëve por edhe kompanive të lidhura me to.

Industria e gazetave po vuan më së shumti nga teknologjia, pasi njerëzit preferojnë t'i lexojnë ato falas nga interneti. Disa gazeta kanë arritur t'i nxjerrin fitimet e tyre duke përdorur teknikat e marketingut në faqet e tyre. Disa janë vetëm një pjesë informacioni pa pagesë dhe ofrojnë lajmin e plotë kundrejt një tarife. Megjithatë kjo nuk është krejtësisht ligjore.


Libraritë. Librat e printuar tashmë janë zëvendësuar nga kopjet online. Ekzistojnë aplikacione të cilat ofrojnë libra kundrejt një pagese. Disa librari janë mbyllur e të tjera hasin probleme për sa kohë njerëzit preferojnë librat online [3].

Bashkë me teknologjinë, ka ndryshuar edhe mënyra e të bërit biznes dhe shumë biznese duhet të gjejnë mënyra inovative për të mbijetuar në tregun konkurrencial.

Shqipëria ka bërë hapa para në përdorimin e teknologjisë, por ka akoma shumë punë për të bërë në këtë drejtim.

Sipas INSTAT, [4] në vitin 2019, 5,8 % e ndërmarrjeve kanë aplikuar përdorimin e tregtisë elektronike nëpërmjet faqes së internetit apo aplikacioneve të dedikuara, nga 5,6 % që ishte në vitin 2018. Figura 1, paraqet shitjet online (%) nga ndërmarrjet sipas aktivitetit ekonomik për vitin 2019. Përqindjen më të lartë në grafikun më poshtë e zënë bizneset që ushtrojnë aktivitet në fushën e informacionit dhe komunikacionit me 28,5 %, pasuar nga akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit me 12,8 %, si dhe shërbimeve administrative dhe mbështetëse me 9,7 %. Gjithashtu në vitin 2019, ndarja automatike e informacionit brenda biznesit është përdorur në shifrën 38,5%. Përdorimi i sistemeve CRM, të cilët ndihmojnë në menaxhimin e marrëdhënieve me klientët, është ulur në vlerën 22,1%, tregues jo i mirë ky krahasuar me vitin 2018. Megjithatë sipas të dhënave ndër vite, vërehet se përdorimi i teknologjisë së informacionit ka rritje nga viti në vit, pikërisht për shkak të impaktit të saj në fusha të ndryshme.

Fig. 1 Shitjet online (%) nga ndërmarrjet sipas aktivitetit ekonomik në vitin 2019



Burimi: INSTAT, Punoi: Autorët

2. Teknologjia nëpandeminë COVID-19

Në situatën dramatike pandemike Covid-19, ka një element pozitiv: edukimi me teknologjitë e reja për personat dhe kompanitë që deri dje refuzonin përdorimin e tyre. Kështu, shumë nga punët dhe proceset që deri dje kryheshin offline, sot mund të kryhen në distancë. Gjatë situatës pandemike, teknologjia i erdhi në ndihmë shumë sektoreve në luftën për mbijetesë duke mundësuar që biznesi dhe jeta të vazhdojnë si zakonisht.

Situata pandemike e shkaktuar nga COVID-19, ka evidentuar trendet e mëposhtme teknologjike të cilat ndihmuan në zvogëlimin e përhapjes së koronavirusit dhe gjithashtu ndihmuan që bizneset të mos mbylleshin (World Economic Forum 2020) [5].

Këto trende janë:

Blerja online dhe shpërndarja nëpërmjet Robotëve. COVID-19 e beri të domosdoshëm blerjen online si dhe shpërndarjen e mallrave nëpërmjet robotëve. Blerja online duhet të mbështetet nga një sistem logistik shumë i zhvilluar

Pagesat dixhitale dhe pa kontakt. Duke qenë se paraja cash mund të përhapte virusin, gjatë periudhës pandemike, u përdorën pagesat digjitale si nëpërmjet kartave ashtu edhe e-kuletat.

Puna në largësi. Shume kompani aplikuan punën nga shtëpia gjatë situatës pandemike. Puna në largësi mundësohet nga përdorimi i teknologjisë duke përfshirë VPN, takimet virtuale, teknologjinë cloud dhe deri tek teknologjitë e njohjes së fytyrës.

Mësimi në distancë. Në mesin e muajit prill, 191 vende mbyllën shkollat dhe universitetet si pasojë e situatës pandemike, duke lënë jashtë auditoreve 1.57 bilion studentë. Përdorimi i teknologjisë mundësoi mësimin në distancë duke siguruar vazhdimësinë e procesit mësimor.

Telehealth. Në kushtet e pamundësisë së takimeve me mjekun në situatën pandemike, Telehealth siguroi kujdesin e domosdoshëm parësor duke përcaktuar diagnozën e pacientit nëpërmjet bisedës online.

Argëtimi Online. Gjatë periudhës pandemike, muzetë dhe vendet e trashëgimisë ndërkombëtare ofruan turne virtuale. Gjithashtu, u mundësuan koncerte dhe lojera të ndryshme online.

Zinxhiri i furnizimit 4.0. Pandemia e COVID-19 krijoi ndërprerje në zinxhirin global të furnizimit. Në mënyrën se si funksionon ky zinxhir, shpesh me të dhënat e bazuara në letër, mungesa e diversitetit dhe fleksibilitetit bënë që sistemi ekzistues i zinxhirit të furnizimit të kishte probleme gjatë situatës pandemike. Teknologjitë e Revolucionit të Katërt Industrial, siç janë Big Data, computing cloud, Internet-of-Things ("IoT") dhe blockchain po ndërtojnë një sistem më të qëndrueshëm të menaxhimit të zinxhirit të furnizimit për të ardhmen duke përmirësuar saktësinë e të dhënave dhe duke inkurajuar shkëmbimin e të dhënave.

3D Printing. Teknologjia 3D Printing, gjatë situatës pandemike, mundësoi lehtësimin e problemeve në kushtet e ndërprerjes në zinxhirin global të furnizimit.

Robotika dhe dronet

COVID 19, i dha një shtysë përdorimit të robotëve dhe kërkimit në robotikë. Gjatë situatës pandemike, robotët u përdorën për disinfektimin e sipërfaqeve dhe shpërndarjen e ushqimit tek personat në karantinë.

5G dhe Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit.

Gjatë periudhës pandemike, teknologjia 5G, pavarësisht debateve, ka demonstruar rëndësinë e saj në monitorimin në distancë dhe konsultimin e kujdesit shëndetësor.


Referuar Shqipërisë, nuk kemi shifra zyrtare mbi përdorimin e teknologjisë në të gjithë kohën e pandemisë, por të gjithë jemi të vetëdijshëm se sa shpejt bizneset e mëdha u përshtatën me tregtinë online dhe filluan të operojnë shumë shpejt në tregun konkurrencial. Në këto muaj kujtdo që i është dashur të kryejë një veprim financiar, një shërbim administrativ apo edhe një blerje të thjeshtë, të paktën një herë ka mundur ta realizojë atë online.

Bizneset u adaptuan shpejt me ndryshimet e reja. Teknologjia ndryshoi dhe transformoi mënyrën e të bërit biznes dhe solli krijimin e një mjedisi akoma edhe më dinamik. Bizneset u gjendën në një situatë të pa menduar më parë dhe i duhej të përshtateshin për të qenë konkurent me tregun. Shumë kompani e kishin të ngritur një sistem E business, dhe nuk u gjendën të pa përgatitur në këto kushte, por pjesës më të madhe iu desh të rimodelonte dhe të vendoste në funksion të teknologjisë biznesin e tyre. Tashmë blerjet dhe çdo transaksion tjetër biznesi po bëhen edhe online, gjë që rezultojë mjaft efektive.

Sipas një ankete mbi sjelljen e biznesit shqiptar ndaj COVID 19, të realizuar nga Këshilli i Investimeve, rezultoi se pothuajse gjysma e bizneseve të anketuar, në periudhën 28 mars-9 prill u mbyllën tërësisht [6] Në këtë anketë, morën pjesë 361 biznese të shpërndarë në të gjithë Shqipërinë, dhe 46% e tyre ishin me xhiro mbi 14 milionë lekë, çka do të thotë biznes i mesëm dhe i madh.

Vetëm 7.6% e bizneseve nuk e ndërprerë aktivitetin gjatë muajit Mars. Këto rezultojnë të jenë bizneset ushqimore dhe farmacitë, të cilët u lejuan të funksiononin. Ndërsa 42.5% e bizneseve, që e ndërprerë aktivitetin pjesërisht, janë bizneset të cilat e kryen aktivitetin e tyre online.

Fig. 2 Aktiviteti në pandeminë COVID 19



Burimi: Sekretariati KI, Punoi:Autorët

Përgjigja mbi impaktin e COVID-19 në aktivitetin e biznesit, ka rezultuar: 73% e të anketuarve deklarojnë se ndikimi do të jetë shumë negativ, 26% negativ dhe vetëm 1% mendon se impakt do të jetë pothuajse 0. Në këtë rezultat (1%) përfshihen bizneset e zinxhirit ushqimor.

Fig. 3 Ndikimi i COVID 19 në aktivitetin e biznesit (Sekretariati KI)



Burimi: Sekretariati KI, Punoi: Autorët

Pjesa dërrmuese e subjekteve të pyetura në anketë përgjigjen se presin ulje të të ardhurave vjetore. Pritshmëria është e njëjtë në të gjithë sektorët e ekonomisë dhe pavarësisht madhësisë së tyre. Bizneset rendisin si tre problemet kryesore: mungesën e klientëve; mungesën e likuiditetit dhe pamundësinë për të paguar detyrimet tatimore. Problemi i parë (mungesa e klientëve) me adaptimet dhe ndryshimet që mund të realizohen nëpërmjet përshtatjes së teknologjisë e zbeh deri diku këtë problematikë, ndërkohë që nëse do të kemi një rritje të numrit të klientëve do të kemi edhe rritje të likuiditeteve, në një kohë kur detyrimet tatimore janë ulur për biznesin e vogël.

Fig. 4 Problematikat me të cilat u ndesh biznesi shqiptar



Burimi: Sekretariati KI, Punoi: Autorët

Por efekti i dixhitalizimit nuk u vu re vetëm në fushën e biznesit por edhe në administratën publike dhe institucionet shtetërore. Përvet dixhitalizimit të proceseve të punës së administratës, janë dixhitalizuar edhe dokumentacionet. Tashmë në zyrat e shtetit nuk gjen dosje fizike, por materiale dixhitale të arkivuara sipas standardeve.

Dixhitalizimi ka filluar më herët, me zhvillimin e disa sistemeve në institucione të ndryshme, të cilat ishin të nevojshme për kohën. Në vitin 2009, u dixhitalizua Rregjistri Kombëtar i Gjendjes Civile.

Avantazhet dhe efektet që sjell dixhitalizimi në Administratën Publike janë:

- Reduktim i kohës dhe kostove të ofrimit të shërbimeve publike
- Përmirësim në ofrimin e shërbimeve
- Rritja e transparencës
- Ulja e shtrirjes së korrupsionit
- Krijimin e një mekanizmi transparence, në mënyrë që qytetarët të japin vlerësimin e tyre mbi performancën e ofrimit të shërbimeve.

Gjatë pandemisë Covid-19, qytetarët mundën të merrnin shërbimet e ofruara nga Administrata Publike nëpërmjet portalit E Albania tashmë online, duke shtuar në këtë portal funksionalitete shtesë si dhe duke përditësuar ato ekzistueset.

Përsa i përket ndikimit të teknologjisë në mjekësi, mund të themi se COVID 19 ishte jo vetëm një sfidë mjekësore, por sfidë edhe në ruajtjen e kontaktit mjek-pacient, në të mirë të cilësisë së shëndetit. Në këtë rast, mjekësia dixhitale luajti rol shumë të rëndësishëm. Disa forma ishin: konsultime online me mjekët; platforma të mirëfillta të kontrolluara nga organe shëndetësore ku pacientët kontrollonin për ankesa specifike të lidhura me COVID dhe jo vetëm; receta elektronike; kartelat mjekësore elektronike; webinarët mjekësore etj.

3. Disa shembuj të përdorimit të teknologjive të avancuara dixhitale gjatë situatës pandemike

Një sërë teknologjish të avancuara u përdorën në vende të ndryshme për të identifikuar njerëzit e infektuar, për të kontrolluar lëvizjen e tyre, për të reduktuar mundësinë e infektimit si dhe për të zhvilluar strategji dhe veprime për shërimin nga infeksioni. Inteligjenca Artificiale (AI), Big data, Teknologjia 5G u përdorën gjatë situatës pandemike në kombinim me robotët, dronet dhe pajisjet e automatizuara.

Më poshtë janë paraqitur disa raste të përdorimit të teknologjive të avancuara dixhitale gjatë situatës pandemike.

Në rastin e Kinës, Universiteti Fudan dhe qeveria e qytetit të Shangait, bashkë me Qendrën për Kontrollin e Sëmundjeve, zhvilluan një sistem unik për ekzaminimin mjekësor dhe kontrollin për bllokimet e frymëmarrjes bazuar në Inteligjencën Artificiale, i cili rriti shpejtësinë e marrjes së vendimeve. Ky sistem u përdor te më shumë se 93% e banorëve të Shangait për të kontrolluar sistemin e tyre të frymëmarrjes [7].

Gjithashtu, Big data u përdorën për të identifikuar grupet e njerëzve të infektuar. Të dhënat e lëvizjes së njerëzve u përdorën për të identifikuar lëvizjen nga një vend tek një tjetër gjatë fazës fillestare të përhapjes së sëmundjes, duke ndihmuar në marrjen e vendimeve kritike për izolimin e sipërfaqeve me risk të lartë [8]. Kombinimi i dronëve me të dhënat 5G u përdorën në sistemin e transportit për të identifikuar thyerjen e ligjit në periudhën e emergjencës. Kameran termike u përdorën në helmetat e policisë dhe zyrtarëve të tjerë publikë për matjen e shpejtë të temperaturës së njerëzve në qytetin e Guangdong, dhe të dhënat transmetoheshin me anë të rrjetit 5G. Kombinimi i robotëve me rrjetin 5G u përdor për higjienizimin e qytetit të Wuhan në periudhën e pikut të pandemisë, atëherë kur shërbimet publike ishin me risk të lartë. Gjithashtu, kombinimi i pajisjeve të automatizuara me rrjetin 5G u përdor për shpërndarjen e ushqimeve në zonat e kontaminuara. Teknologjia 5G u përdor për kujdesin dhe këshillat tele-mjekësore në spitalin e Wuhan. Në qytetin Hangzhou, u përdor për herë të parë sistemi i shëndetit me barcode, që ndihmoi në identifikimin e personave të infektuar. Më pas, ky sistem u përdor edhe në 200 qytete të tjera të Kinës. Ky aplikacion tregon nëse ke qenë afër personave të infektuar, ndihmon në bërjen e hartës me personat e infektuar duke paralajmëruar kështu evitimin e frekuentimit të zonave ku gjenden personat e infektuar. Nëse rezulton se një individ ka qenë në kontakt me një person të infektuar, aplikacioni rekomandon vetë-izolim dhe gjithashtu i dërgon një mesazh alarmi zyrtarëve të shëndetit.

Investimet në shërbimet e reja dixhitale, qeverisja dixhitale etj, bënë të mundur që vende si Taiwan dhe Koreja e Jugut, të përballojnë me shumë sukses krizën e koronavirusit, duke parandaluar kështu kolapsin e sistemit shëndetësor publik dhe shkatërrimin e ekonomisë. Këto dy vende kanë filluar me kohë procesin e dixhitalizimit dhe rritja ekonomike mbështetet pikërisht në zhvillimin e teknologjisë përmes investimeve në shërbimet e reja dixhitale dhe qeverinë dixhitale.

Koreja e Jugut, nëpërmjet përdorimit të "sistemit të informacionit të karantinës së zgjuar" dhe zhvillimit të shpejtë të testimit të kiteve, arriti të testojë më shumë se 20000 persona/ditë. Prej testimit masiv, u morën një numër mjaft i madh të dhënash dhe u siguruan statistika të sakta duke kontrolluar situatën pa qenë nevoja e marrjes së masave ekstreme të bllokimit.

Taiwan është një rast suksesi në menaxhimin e situatës së krijuar nga koronavirusi. Që nga fillimi i shpërthimit, në Taiwan, u analizuan në mënyrë proaktive të dhënat nga kujdesi kombëtar i shëndetit, migracioni dhe doganat për të gjurmuar lëvizjen e individëve të infektuar në përpjekje për të lokalizuar grupime të mundshme si dhe për të ndërgjegjësuar për rrezikun në zonat me riks të lartë. Në shkurt të vitit 2020, Tajvani aplikoi Sistemin ad hoc të Hyrjes në Karantinë, sipas të cilit udhëtarët që vinin në vend, duhet të skanonin një kod tek sistemi dhe të fusnin aty informacionin personal. Në prani të një infektimi të ri, posedimi i një platforme dixhitale të besueshme u dha autoriteteve të Taiwanit mundësinë për të ndjekur historinë e udhëtimit të të infektuarve dhe të gjurmojnë kontaktet e tyre të mëparshme. Duke ja transmetuar këtë informacion njerëzve në zonat potencialisht të rrezikuara përmes mesazheve të menjëhershme, vendi kufizoi në mënyrë efektive dhe efikase përshkallëzimin e shpërthimit. Krejt ndryshe u administrua situata në Itali. Që në momentin kur u identifikua "Pacienti 0", përgjigjja italiane ka treguar një mungesë të qartësisë në lidhje me statistikat e raportuara, mungesën e njëtrajtshmërisë në mbledhjen e të dhënave dhe mungesën e shkëmbimit të informacionit midis rajoneve. Deri në mes të muajit mars, shumica e rajoneve italiane testonin vetëm njerëz me simptoma të rënda, duke lënë jashtë ekuacionit një pjesë të madhe të bartësve "ndoshta asimptomatikë", gjë që shkaktoi një kaos masiv. Ndërsa numri i vdekjeve rritej, të dhënat lëviznin ngadalë, duke mundësuar përhapjen e informacionit jo të saktë. Megjithatë asnjë vend nuk mund të ishte përgatitur për një emergjencë të këtyre përmasave, Italia ishte veçanërisht e papërgatitur për sa i përket qasjes në të dhëna. Në situata të tilla, statistikat e sakta janë gurthemeli i një përgjigjeje të fortë; popullata duhet të informohet në mënyrë që të shmangët paniku masiv [9].

Modelet e Taiwan-it dhe të Koresë së Jugut kanë demonstruar se Big Data, testimi në masë dhe koordinimi janë thelbësore për të kontrolluar krizat e shëndetit publik. Në dallim nga Taiwan dhe Koreja e Jugut, sistemi legjislativ Italian nuk lejon përdorimin e të dhënave të hapura, të dhënat nuk janë ende të dixhitalizuara dhe një pjesë e madhe e popullsisë ka mungesë në aftësitë dixhitale.

Prej modeleve të suksesshme të Tajvanit dhe Koresë së Jugut, Italia mund të nxjerrë mësim që vendosja e një ekuilibri mes të dhënave të hapura dhe mbrojtjes së privatësisë mund të jetë çelësi për t'i menaxhuar me sukses situata të tilla.

Ndërsa në SHBA, gjatë periudhës së pandemisë, duke filluar nga mesi i muajit prill, kompanitë e makinave po testojnë makinat pa shofer për shpërndarjen e ushqimeve, mallrave dhe ilaçeve[10]. Ndërsa lidhur me projeksionin se çfarë do të ndodhë me investimet në teknologjitë dixhitale, nga një sondazh i bërë nga kompania OpsRamp, kompani konsulente në fushën e shërbimeve IT, me 1 prill 2020, me 137 lider të operacioneve IT, në kompanitë amerikane me të paktën 500 të punësuar dhe 5 milion \$ buxhet vjetor në IT, rezultoi se: në mendjet e menaxherëve të kompanive mbizotëron ideja e mbajtjes në nivele të larta të investimeve në sektorin e transformimit dixhital dhe në fushën e sigurisë së informacionit. Nga ky sondazh, rezultoi se prioritetet e punësimit janë IT financial analysts dhe data scientists [11].

4. Konkluzione

Teknologjia nuk mund ti parandalojë pandemitë, megjithë ajo ndihmon në parandalimin e përhapjes, edukimin, dhe informimin e qytetarëve në mënyrë që këta të fundit të jenë sa më të vetëdijshëm për situatën duke zvogëluar kështu impaktin negative [12].

Teknologjitë, si Inteligjenca Artificiale dhe Big Data, mund të aplikohen në vende të populluara spitale, stacione treni, aeroporte etj, për të identifikuar sa më shpejt personat e sëmurë, me qëllim izolimin e tyre para se ata të bëhen shkaktarë për infektimin e personave të tjerë.

Pas Covid-19, disa profesione ekzistuese do të dalin të tepërta, por njëkohësisht do krijohen profesione dhe të reja. Do të ketë kërkesë të shtuar për kurse trajnimi në internet se si të përdoren portalet online që ofrojnë shërbime të ndryshme për klientët, qofshin këto shërbime fetare, mjekësore ose arsimore, por jo vetëm kaq, kompanitë dhe institucionet do të përshtaten me mënyrën e re të të jetuarit dhe punuarit online dhe profesionet automatike shumë shpejt do të zëvendësohen nga robotika dhe teknologjia.

Ndërtimi i infrastrukturës së nevojshme për të mbështetur një botë të dixhitalizuar dhe për të qënë të informuar për teknologjitë më të fundit, do të jenë thelbësore për çdo shtet apo biznes që të mbetet konkurrues në një botë pas COVID-19.

Duhet të nxjerrim mësim nga ky moment dhe të zhvillojmë ide inovatore në funksion të përmirësimit të jetëve tona, uljes së kostos dhe rritjes së përfitimeve të përbashkëta.

Ajo çfarë bota kaloi, ishte një sprovë për qytetarin, individin, biznesin dhe qeverinë, në përshtatjen me teknologjinë, dhe Covid 19 u shfaq për ti dhënë një shtysë ndryshimeve në aspektin teknologjik, politik, ekonomik, social etj.

5.Rekomandime

Mësimet e nxjerra nga situata pandemike e shkaktuar nga COVID-19, duhet të shërbejnë si këmbanë alarmi për ndërmarrjet shqiptare lidhur me investimet në fushën e teknologjisë. Bazuar në të dhënat e INSTAT, tek raporti Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit në Ndërmarrje, rezulton se vetëm 23.4% e ndërmarrjeve gjatë vitit 2019 kanë specialist të fushës së teknologjisë së informacionit. Kjo shifër do të thotë se pjesa më e madhe e ndërmarrjeve ndjen nevojën e specialistëve të kualifikuar në fushën e teknologjisë së informacionit të cilët duhet të jenë të aftë për të mbështetur proceset e punës në përditshmëri por edhe për ti zhvilluar ato më tej.

Prej këtu, institucioneve akademike i del si detyrë që të ndërtojnë kurrikulat e programeve që lidhen me teknologjinë në mënyrë të tillë që studentët jo vetëm të përballojnë kërkesat që ka aktualisht tregu i punës por edhe sfidat e të ardhmes.

Kjo periudhë duhet të shërbejë si refleksion për reformatorët e politikës publike që të të punohet me shumë seriozitet për:

Të krijuar infrastrukturën e nevojshme dhe sistemet e duhura për një qasje të re drejt botës dixhitale. Duhet të fillojë dixhitalizimi në arsim, gjykata, mjeksi, institucione lokale etj.

Të krijuar një strukturë të unifikuar sistemesh, ku çdo njësi apo institucion të japë dhe marrë të dhënat e nevojshme, me aprovimin e qytetarit dixhital, duke shmangur burokracitë.

Të siguruar një marrëveshje institucionale dhe ndër qeveritare për njohjen e vulave dhe firmave elektronike. Në 2017 u miratua ligji për njohjen e vulës elektorinke njësoj me atë të njomë, por përsëri ka problematika.

Të punuar për profesionet e automatizuara. Ka kohë që flitet për automatizim të proceseve dhe profesioneve më së shumti atyre mekanike. Ka ardhur koha që të punohet për këtë dhe Covid 19 na e tregoi më së miri këtë fakt.

Referencat:

[1] <https://www.normenkontrollrat.bund.de/nkr-en/publications>

[2] <https://scanbot.io/blog/government-digitization-trends>

- [3]<https://tekbiz.al/index.php/2018/09/19/5-bizneset-qe-teknologjia-i-ka-ndryshuar-nemenyre-dramatike/>
- [4] http://www.instat.gov.al/media/7028/njoftimi_p%C3%ABr_shtyp_tik_2019.pdf
- [5]<https://www.weforum.org/agenda/2020/04/10-technology-trends-coronavirus-covid19-pandemic-robotics-telehealth/>
- [6] <https://www.investment.com.al/sq/covid-19/>
- [7] Hua J., Kim J., & Shaw R., (2020), Governance, technology and citizen behavior in pandemic: Lessons from COVID-19 in East Asia.
Online:<https://www.sciencedirect.com/science/article/pii/S2590061720300272>
- [8] Chaturvedi A., (2020), "The China way: Use of technology to combat Covid -19".
Online:<https://www.geospatialworld.net/article/the-sino-approach-use-of-technology-to-combat-covid-19/>
- [9]<https://blogs.lse.ac.uk/internationaldevelopment/2020/04/28/why-technological-development-is-the-only-way-out-of-the-covid-19-pandemic-considerations-from-italy/>
- [10]<https://www.weforum.org/agenda/2020/05/self-driving-vehicles-contact-free-deliveries-covid19/>
- [11]<https://www.globenewswire.com/news-release/2020/04/21/2019332/0/en/OpsRamp-Survey-Shows-IT-Spending-Remains-Strong-With-Focus-on-Minimizing-Business-Risk-during-COVID-19.html>
- [12] Manjunath B.S, (2020), "COVID-19: 8 ways in which technology helps pandemic management".
Online:<https://cio.economictimes.indiatimes.com/news/next-gen-technologies/covid-19-8-ways-in-which-technology-helps-pandemic-management/75139759>

ROLI I TEKNOLOGJISË NË MENAXHIMIN E SITUATËS PANDEMIKE TË COVID-1

Prof.asoc.Dr. Teuta Xhindi
Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë
teuta.xhindi@umsh.edu.al
Dr. Olgerta Idrizi
Universitet Mesdhetar i Shqipërisë
olgerta.idrizi@umsh.edu.al

Abstrakt:

COVID - 19 u raportua fillimisht në Wuhan, në Dhjetor të 2019. Ai u përhap shpejt në pjesë të ndryshme të Kinës dhe më pas në mbarë botën duke shkaktuar situatën e pandemisë globale në Mars të 2020. Epiqendra e situatës pandemike u zhvendos nga Azia në Europë dhe më pas në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Gjatë pandemisë COVID -19, në periudhën e karantinës dhe të izolimit, teknologjia luajti një rol shumë të rëndësishëm në mbajtjen funksionale të shoqërisë. Pa dyshim që teknologjia do të vazhdojë të ketë impakt në shoqëri dhe në çdo sferë të jetës edhe në të ardhmen. Teknologjitë e avancuara janë përdorur në vende të ndryshme për identifikimin e njerëzve të sëmurë, kontrollin e lëvizjeve të tyre, uljen e mundësisë për përhapjen e infektimit dhe zhvillimin e strategjive dhe veprimeve për kurimin e infeksionit. Gjatë pandemisë, u përdorën Inteligenca Artificiale (AI), Big Data, Teknologjia 5G etj, së bashku me dronet dhe pajisjet e automatizuara. Ky punim analizon rolin që ka luajtur teknologjia për menaxhimin e situatës pandemike në vende të ndryshme të botës. Gjithashtu, analizohet ndikimi i teknologjisë në administratën publike, në biznes, në mjekësi etj në realitetin shqiptar. Për fat të mirë, Shqipëria e kishte të ngritur sistemin e e-qeverisjes dhe COVID-19 na gjeti deri diku të përgatitur në ofrimin e shërbimeve online për qytetarët. Nisur nga mësimet e nxjerra nga situata pandemike, ndërmmarrjet shqiptare duhet të reflektojnë për të shtuar investimet në fushën e teknologjisë për të siguruar së pari ekzistencën dhe në perspektivë rritjen e performancës financiare. Gjithashtu, institucioneve akademike i del si detyrë që të ndërtojnë kurrikulat e programeve që lidhen me teknologjinë në mënyrë të tillë që studentët jo vetëm të përballojnë kërkesat që ka aktualisht tregu i punës por edhe sfidat e të ardhmes.

Fjalë kyçe: COVID-19, pandemi, dixhitalizim, teknologji informacioni, inteligenca artificiale etj

Abstract:

The new corona virus was first reported in Wuhan, in December 2019. It spread rapidly in the other Chinese regions and later worldwide reaching the pandemic state in March 2020. The epicenter of the pandemic shifted from Asia to Europe and after that to the United States.

During the COVID-19 pandemic, which forced an all-around quarantine and isolation, technology led a crucial role in maintaining the society functional. Undoubtedly, technology will continue to impact the society and every sphere of life in the future.

A number of advanced technologies have been used by various countries to identify infected people, control their movement, reduce the possibility of infection, and develop strategies and actions to cure the infection. Artificial Intelligence (AI), Big Data, 5G Technology were used during the pandemic in combination with robots, drones and automated devices.

This paper analyzes the role that technology has played in managing the pandemic in different countries of the world. Also, the impact of technology on public administration, business, medicine, etc. in the Albanian reality is analyzed.

Fortunately, Albania has set up a system of e-governance and COVID 19 found us somewhat prepared in offering the online services to the Albanian citizens.

Based on the lessons learned from the pandemic, Albanian companies need to reflect on increasing investment in technology to first ensure their existence and, in perspective, increase financial performance.

Also, the academic institutions have the task of building curricula for technology-related programs in such a way that students not only meet the demands of the current job market but also the challenges of the future.

Keywords: COVID-19, pandemic, digitalization, information technology, artificial intelligence etc.

1.Hyrje

Procesi i transformimit dixhital tenton të përmirësojë performancën dhe produktivitetin duke synuar inovacionin dhe njëkohësisht reduktimin e kostove. Në një nga publikimet e Këshillit Kombëtar të Kontrollit Rregullator Gjerman[1] është analizuar se duke eliminuar letrën nga transaksionet për shërbimet më të zakonshme:

Qytetarët mund të kursenin 84 milion orë kohë të lirë në vit

Kompanitë mund të zvogëlonin kohën e kaluar duke ndërvepruar me zyrat e qeverisë me 54% Autoritetet publike do të ishin në gjendje të kursenin rreth 3,9 miliardë Euro.

Shifra të tilla nxjerrin në pah efektin e madh që ka dixhitalizimi i proceseve për qeveritë, qytetarët si dhe për biznesin.

Transformimi dixhital ka një ndikim të gjerë në të gjitha fushat, biznes, mjekësi, qeverisje, duke krijuar oportunitete dhe njëkohësisht sfida. Disa drejtime si E-commerce, Big Data, Machine Learning, Inteligjenca Artificiale dhe Internet of Things (IoT) mund të sjellin përfitime të mëdha financiare.

Qasje e re mbi zhvillimin e teknologjisë në sektorë të ndryshëm, ndikon në përmirësimin dhe lehtësimin e jetës së qytetarëve, individit, biznesit etj. Tashmë nëpërmjet shërbimeve të dixhitalizuara që shumë vende të botës po ofrojnë, qytetarët marrin shërbimin e nevojshëm duke shmangur burokracitë dhe duke ulur koston në kohë dhe para. Psh, në Singapor, përdoret sistemi Singapore Personal Access (ose SingPass)[2] për të aksesuar një mori shërbimesh. Ky system mundëson ndërveprimin e drejtpërdrejtë, përmes një platforme të vetme, midis të gjitha agjencive qeveritare dhe qytetarëve. Gjithashtu, Estonia është në rrugën e saj për të ndërtuar kombin dixhital, duke u shndërruar kështu në një nga vendet më të dixhitalizuara në botë.

Termi E-qeverisje nuk shpjegohet vetëm me ofrimin e shërbimeve administrative ndaj qytetarëve, pra bashkëveprim qytetar-qeveri-qytetar (C2G, G2C), por edhe bashkëveprimin online qeveri-qeveri (G2G), duke shkëmbyer ide dhe informacion online mes qeverive të ndryshme, ndërveprimin qeveri-punonjës (G2E), që përfshin pagesat, taksat, trajnime etj, apo qeveri-biznes (G2B).

Disa nga bizneset të cilët kanë ndryshuar rrënjësisht për shkak të ndryshimeve në teknologji janë si më poshtë:

Agjensitë e udhëtimit. Më parë duhej të kontaktoje me një agjent udhëtimesh për të prenotuar një udhëtim ndërsa sot nëpërmjet faqeve të agjensive online apo rrjeteve sociale ofrohen shërbimet e nevojshme. Çdo gjë, që nga udhëtimi, hoteli, makinat me qera vetëm nëpërmjet faqes së agjensisë mund të merret shërbimi i nevojshëm. Gjithashtu rezervimi i udhëtimit tashmë mund të bëhet edhe individualisht, online, duke aksesuar faqet e hoteleve, linjave ajrore, etj. Kjo ka sjellë ulje të numrit të agjensive dhe faktin që profesionet si agjent udhëtimesh të mos preferohen aq shumë.

Tregtia e videove me qera. Disa prej tyre kanë dalë jashtë tregut e të tjera luftojnë për mbijetesë. Sot njerëzit preferojnë të shohin filmat më të fundit online. Tashmë njerëzit preferojnë Netflix apo kompani të tjera duke mos harruar kompanitë pirate online. Pra mund të paguajnë një shumë fikse dhe mund të shohin të gjithë filmat që ofron faqja.

Industria e muzikës. Disqet tashmë kanë dalë jashtë loje pasi njerëzit preferojnë MP3, MP4 etj. Përveç rrugës ligjore për të shkarkuar muzikë, industria ka hasur problemin e shkarkimeve pirate, të cilat i nxjerrin këngët para se albumet të dalin në treg duke i shkaktuar problem artistëve por edhe kompanive të lidhura me to.

Industria e gazetave po vuan më së shumti nga teknologjia, pasi njerëzit preferojnë t'i lexojnë ato falas nga interneti. Disa gazeta kanë arritur t'i nxjerrin fitimet e tyre duke përdorur teknikat e marketingut në faqet e tyre. Disa janë vetëm një pjesë informacioni pa pagesë dhe ofrojnë lajmin e plotë kundrejt një tarife. Megjithatë kjo nuk është krejtësisht ligjore.


Libraritë. Librat e printuar tashmë janë zëvendësuar nga kopjet online. Ekzistojnë aplikacione të cilat ofrojnë libra kundrejt një pagese. Disa librari janë mbyllur e të tjera hasin probleme për sa kohë njerëzit preferojnë librat online [3].

Bashkë me teknologjinë, ka ndryshuar edhe mënyra e të bërit biznes dhe shumë biznese duhet të gjejnë mënyra inovative për të mbijetuar në tregun konkurrencial.

Shqipëria ka bërë hapa para në përdorimin e teknologjisë, por ka akoma shumë punë për të bërë në këtë drejtim.

Sipas INSTAT, [4] në vitin 2019, 5,8 % e ndërmarrjeve kanë aplikuar përdorimin e tregtisë elektronike nëpërmjet faqes së internetit apo aplikacioneve të dedikuara, nga 5,6 % që ishte në vitin 2018. Figura 1, paraqet shitjet online (%) nga ndërmarrjet sipas aktivitetit ekonomik për vitin 2019. Përqindjen më të lartë në grafikun më poshtë e zënë bizneset që ushtrojnë aktivitet në fushën e informacionit dhe komunikacionit me 28,5 %, pasuar nga akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit me 12,8 %,si dhe shërbimeve administrative dhe mbështetëse me 9,7 %. Gjithashtu në vitin 2019, ndarja automatike e informacionit brenda biznesit është përdorur në shifrën 38,5%. Përdorimi i sistemeve CRM, të cilët ndihmojnë në menaxhimin e marrëdhënieve me klientët, është ulur në vlerën 22,1%, tregues jo i mirë ky krahasuar me vitin 2018. Megjithatë sipas të dhënave ndër vite, vërehet se përdorimi i teknologjisë së informacionit ka rritje nga viti në vit, pikërisht për shkak të impaktit të saj në fusha të ndryshme.

Fig. 1 Shitjet online (%) nga ndërmarrjet sipas aktivitetit ekonomik në vitin 2019



Burimi:INSTAT, Punoi: Autorët

2. Teknologjia nëpandeminë COVID-19

Në situatën dramatike pandemike Covid-19, ka një element pozitiv: edukimi me teknologjitë e reja për personat dhe kompanitë që deri dje refuzonin përdorimin e tyre. Kështu, shumë nga punët dhe proceset që deri dje kryheshin offline, sot mund të kryhen në distancë. Gjatë situatës

pandemike, teknologjia i erdhi në ndihmë shumë sektoreve në luftën për mbijetesë duke mundësuar që biznesi dhe jeta të vazhdojnë si zakonisht.

Situata pandemike e shkaktuar nga COVID-19, ka evidentuar trendet e mëposhtme teknologjike të cilat ndihmuan në zvogëlimin e përhapjes së koronavirusit dhe gjithashtu ndihmuan që bizneset të mos mbylleshin (World Economic Forum 2020) [5].

Këto trende janë:

Blerja online dhe shpërndarja nëpërmjet Robotëve. COVID-19 e beri të domosdoshëm blerjen online si dhe shpërndarjen e mallrave nëpërmjet robotëve. Blerja online duhet të mbështetet nga një sistem logistik shumë i zhvilluar

Pagesat dixhitale dhe pa kontakt. Duke qenë se paraja cash mund të përhapte virusin, gjatë periudhës pandemike, u përdorën pagesat digjitale si nëpërmjet kartave ashtu edhe e-kuletat.

Puna në largësi. Shume kompani aplikuan punën nga shtëpia gjatë situatës pandemike. Puna në largësi mundësohet nga përdorimi i teknologjisë duke përfshirë VPN, takimet virtuale, teknologjinë cloud dhe deri tek teknologjitë e njohjes së fytyrës.

Mësimi në distancë. Në mesin e muajit prill, 191 vende mbyllën shkollat dhe universitetet si pasojë e situatës pandemike, duke lënë jashtë auditoreve 1.57 bilion studentë. Përdorimi i teknologjisë mundësoi mësimin në distancë duke siguruar vazhdimësinë e procesit mësimor.

Telehealth. Në kushtet e pamundësisë së takimeve me mjekun në situatën pandemike, Telehealth siguroi kujdesin e domosdoshëm parësor duke përcaktuar diagnozën e pacientit nëpërmjet bisedës online.

Argëtimi Online. Gjatë periudhës pandemike, muzetë dhe vendet e trashëgimisë ndërkombëtare ofruan turne virtuale. Gjithashtu, u mundësuan koncerte dhe lojera të ndryshme online.

Zinxhiri i furnizimit 4.0. Pandemia e COVID-19 krijoi ndërprerje në zinxhirin global të furnizimit. Në mënyrën se si funksionon ky zinxhir, shpesh me të dhënat e bazuara në letër, mungesa e diversitetit dhe fleksibilitetit bënë që sistemi ekzistues i zinxhirit të furnizimit të kishte probleme gjatë situatës pandemike. Teknologjitë e Revolucionit të Katërt Industrial, siç janë Big Data, computing cloud, Internet-of-Things ("IoT") dhe blockchain po ndërtojnë një sistem më të qëndrueshëm të menaxhimit të zinxhirit të furnizimit për të ardhmen duke përmirësuar saktësinë e të dhënave dhe duke inkurajuar shkëmbimin e të dhënave.

3D Printing. Teknologjia 3D Printing, gjatë situatës pandemike, mundësoi lehtësimin e problemeve në kushtet e ndërprerjes në zinxhirin global të furnizimit.

Robotika dhe dronet

COVID 19, i dha një shtysë përdorimit të robotëve dhe kërkimit në robotikë. Gjatë situatës pandemike, robotët u përdorën për disinfektimin e sipërfaqeve dhe shpërndarjen e ushqimit tek personat në karantinë.

5G dhe Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit.

Gjatë periudhës pandemike, teknologjia 5G, pavarësisht debateve, ka demonstruar rëndësinë e saj në monitorimin në distancë dhe konsultimin e kujdesit shëndetësor.


Referuar Shqipërisë, nuk kemi shifra zyrtare mbi përdorimin e teknologjisë në të gjithë kohën e pandemisë, por të gjithë jemi të vetëdijshëm se sa shpejt bizneset e mëdha u përshtatën me tregtinë online dhe filluan të operojnë shumë shpejt në tregun konkurrencial. Në këto muaj kujto që i është dashur të kryejë një veprim financiar, një shërbim administrativ apo edhe një blerje të thjeshtë, të paktën një herë ka mundur ta realizojë atë online.

Bizneset u adaptuan shpejt me ndryshimet e reja. Teknologjia ndryshoi dhe transformoi mënyrën e të bërit biznes dhe solli krijimin e një mjedisi akoma edhe më dinamik. Bizneset u gjendën në një situatë të pa menduar më parë dhe i duhej të përshtateshin për të qenë konkurent me tregun. Shumë kompani e kishin të ngritur një sistem E business, dhe nuk u gjendën të pa përgatitur në këto kushte, por pjesës më të madhe iu desh të rimodelonte dhe të vendoste në funksion të teknologjisë biznesin e tyre. Tashmë blerjet dhe çdo transaksion tjetër biznesi po bëhen edhe online, gjë që rezultojë mjaft efektive.

Sipas një ankete mbi sjelljen e biznesit shqiptar ndaj COVID 19, të realizuar nga Këshilli i Investimeve, rezultoi se pothuajse gjysma e bizneseve të anketuar, në periudhën 28 mars-9 prill u mbyllën tërësisht [6] Në këtë ankete, morën pjesë 361 biznese të shpërndarë në të gjithë Shqipërinë, dhe 46% e tyre ishin me xhiro mbi 14 milionë lekë, çka do të thotë biznes i mesëm dhe i madh.

Vetëm 7.6% e bizneseve nuk e ndërprerë aktivitetin gjatë muajit Mars. Këto rezultojnë të jenë bizneset ushqimore dhe farmacitë, të cilët u lejuan të funksiononin. Ndërsa 42.5% e bizneseve, që e ndërprejnë aktivitetin pjesërisht, janë bizneset të cilat kryejnë aktivitetin e tyre online.


Fig. 2 Aktiviteti në pandeminë COVID 19



Burimi: Sekretariati KI, Punoi: Autorët

Përgjigja mbi impaktin e COVID-19 në aktivitetin e biznesit, ka rezultuar: 73% e të anketuarve deklarojnë se ndikimi do të jetë shumë negativ, 26% negativ dhe vetëm 1% mendon se impakt do të jetë pothuajse 0. Në këtë rezultat (1%) përfshihen bizneset e zinxhirit ushqimor.

Fig. 3 Ndikimi i COVID 19 në aktivitetin e biznesit (Sekretariati KI)



Burimi: Sekretariati KI, Punoi: Autorët

Pjesa dërrmuese e subjekteve të pyetura në anketë përgjigjen se presin ulje të të ardhurave vjetore. Pritshmëria është e njëjtë në të gjithë sektorët e ekonomisë dhe pavarësisht madhësisë

së tyre. Bizneset rendisin si tre problemet kryesore: mungesën e klientëve; mungesën e likuiditetit dhe pamundësinë për të paguar detyrimet tatimore. Problemi i parë (mungesa e klientëve) me adaptimet dhe ndryshimet që mund të realizohen nëpërmjet përshtatjes së teknologjisë e zbeh deri diku këtë problematikë, ndërkohë që nëse do të kemi një rritje të numrit të klientëve do të kemi edhe rritje të likuiditeteve, në një kohë kur detyrimet tatimore janë ulur për biznesin e vogël.

Fig. 4 Problematikat me të cilat u ndesh biznesi shqiptar



Burimi: Sekretariati KI, Punoi: Autorët

Por efekti i dixhitalizimit nuk u vu re vetëm në fushën e biznesit por edhe në administratën publike dhe institucionet shtetërore. Përvet dixhitalizimit të proceseve të punës së administratës, janë dixhitalizuar edhe dokumentacionet. Tashmë në zyrat e shtetit nuk gjen dosje fizike, por materiale dixhitale të arkivuara sipas standardeve.

Dixhitalizimi ka filluar më herët, me zhvillimin e disa sistemeve në institucione të ndryshme, të cilat ishin të nevojshme për kohën. Në vitin 2009, u dixhitalizua Rregjistri Kombëtar i Gjendjes Civile.

Avantazhet dhe efektet që sjell dixhitalizimi në Administratën Publike janë:

- Reduktim i kohës dhe kostove të ofrimit të shërbimeve publike
- Përmirësim në ofrimin e shërbimeve
- Rritja e transparencës
- Ulja e shtrirjes së korrupsionit
- Krijimin e një mekanizmi transparence, në mënyrë që qytetarët të japin vlerësimin e tyre mbi performancën e ofrimit të shërbimeve.

Gjatë pandemisë Covid-19, qytetarët mundën të merrnin shërbimet e ofruara nga Administrata Publike nëpërmjet portalit E Albania tashmë online, duke shtuar në këtë portal funksionalitete shtesë si dhe duke përditësuar ato ekzistueset.

Përsa i përket ndikimit të teknologjisë në mjekësi, mund të themi se COVID 19 ishte jo vetëm një sfidë mjekësore, por sfidë edhe në ruajtjen e kontaktit mjek-pacient, në të mirë të cilësisë së shëndetit. Në këtë rast, mjekësia dixhitale luajti rol shumë të rëndësishëm. Disa forma ishin: konsultime online me mjekët; platforma të mirëfillta të kontrolluara nga organe shëndetësore ku pacientët kontrollonin për ankesa specifike të lidhura me COVID dhe jo vetëm; recetat elektronike; kartelat mjekësore elektronike; webinarët mjekësore etj.

3. Disa shembuj të përdorimit të teknologjive të avancuara dixhitale gjatë situatës pandemike

Një sërë teknologjish të avancuara u përdorën në vende të ndryshme për të identifikuar njerëzit e infektuar, për të kontrolluar lëvizjen e tyre, për të reduktuar mundësinë e infektimit si dhe për të zhvilluar strategji dhe veprime për shërimin nga infeksioni. Inteligjenca Artificiale (AI), Big data, Teknologjia 5G u përdorën gjatë situates pandemike në kombinim me robotët, dronet dhe pajisjet e automatizuara.

Më poshë janë paraqitur disa raste të përdorimit të teknologjive të avancuara dixhitale gjatë situatës pandemike.

Në rastin e Kinës, Universiteti Fudan dhe qeveria e qytetit të Shangait, bashkë me Qendrën për Kontrollin e Sëmundjeve, zhvilluan një system unik për ekzaminimin mjekësor dhe kontrollin për bllokimet e frymëmarrjes bazuar në Inteligjencën Artificiale, i cili rriti shpejtësinë e marrjes së vendimeve. Ky sistem u përdor te më shumë se 93% e banorëve të Shangait për të kontrolluar sistemin e tyre të frymëmarrjes [7].

Gjithashtu, Big data u përdorën për të identifikuar grupet e njerëzve të infektuar. Të dhënat e lëvizjes së njerëzve u përdorën për të identifikuar lëvizjen nga një vend tek një tjetër gjatë fazës fillestare të përhapjes së sëmundjes, duke ndihmuar në marrjen e vendimeve kritike për izolimin e sipërfaqeve me risk të lartë [8]. Kombinimi i dronëve me të dhënat 5G u përdorën në sistemin e transportit për të identifikuar thyerjen e ligjit në periudhën e emergjencës. Kamerat termike u përdorën në helmetat e policisë dhe zyrtarëve të tjerë publikë për matjen e shpejtë të temperaturës së njerëzve në qytetin e Guangdong, dhe të dhënat transmetoheshin me anë të rrjetit 5G. Kombinimi i robotëve me rrjetin 5G u përdor për higjenizimin e qytetit të Wuhan në periudhën e pikut të pandemisë, atëherë kur shërbimet publike ishin me risk të lartë. Gjithashtu, kombinimi i pajisjeve të automatizuara me rrjetin 5G u përdor për shpërndarjen e ushqimeve në zonat e kontaminuara. Teknologjia 5G u përdor për kujdesin dhe këshillat tele-mjekësore në spitalin e Wuhan. Në qytetin Hangzhou, u përdor për herë të parë sistemi i shëndetit me barcode, që ndihmoi në identifikimin e personave të infektuar. Më pas, ky sistem u përdor edhe në 200 qytete të tjera të Kinës. Ky aplikacion tregon nëse ke qenë afër personave të infektuar, ndihmon në bërjen e hartës me personat e infektuar duke paralajmëruar kështu evitimin e frekuentimit të zonave ku gjenden personat e infektuar. Nëse rezulton se një individ ka qenë në kontakt me një person të infektuar, aplikacioni rekomandon vetë-izolimin dhe gjithashtu i dërgon një mesazh alarmi zyrtarëve të shëndetit.

Investimet në shërbimet e reja dixhitale, qeverisja dixhitale etj, bënë të mundur që vende si Taiwan dhe Koreja e Jugut, të përballojnë me shumë sukses krizën e koronavirusit, duke parandaluar kështu kolapsin e sistemit shëndetësor publik dhe shkatërrimin e ekonomisë. Këto dy vende kanë filluar me kohë procesin e dixhitalizimit dhe rritja ekonomike mbështetet pikërisht në zhvillimin e teknologjisë përmes investimeve në shërbimet e reja dixhitale dhe qeverinë dixhitale.

Koreja e Jugut, nëpërmjet përdorimit të "sistemit të informacionit të karantinës së zgjuar" dhe zhvillimit të shpejtë të testimit të kiteve, arriti të testojë më shumë se 20000 persona/ditë. Prej testimit masiv, u morën një numër mjaft i madh të dhënash dhe u siguruan statistika të sakta duke kontrolluar situatën pa qenë nevoja e marrjes së masave ekstreme të bllokimit.

Taiwani është një rast suksesi në menaxhimin e situates së krijuar nga koronavirusi. Që nga fillimi i shpërthimit, në Taiwan, u analizuan në mënyrë proaktive të dhënat nga kujdesi kombëtar i shëndetit, migracioni dhe doganat për të gjurmuar lëvizjen e individëve të infektuar në përpjekje për të lokalizuar grupime të mundshme si dhe për të ndërgjegjësuar për rrezikun në zonat me riks të lartë. Në shkurt të vitit 2020, Tajvani aplikoi Sistemin ad hoc të Hyrjes në Karantinë, sipas të cilit udhëtarët që vinin në vend, duhet të skanonin një kod tek sistemi dhe të fusnin aty informacionin personal. Në prani të një infektimi të ri, posedimi i një platforme dixhitale të besueshme u dha autoriteteve të Taiwanit mundësinë për të ndjekur historinë e udhëtimit të të infektuarve dhe të gjurmojnë kontaktet e tyre të mëparshme. Duke ja transmetuar këtë informacion njerëzve në zonat potencialisht të rrezikuara përmes mesazheve të menjëhershme, vendi kufizoi në mënyrë efektive dhe efikase përshkallëzimin e shpërthimit.

Krejt ndryshe u administrua situata në Itali. Që në momentin kur u identifikua "Pacienti 0", përgjigjja italiane ka treguar një mungesë të qartësisë në lidhje me statistikat e raportuara, mungesën e njëtrajtshmërisë në mbledhjen e të dhënave dhe mungesën e shkëmbimit të informacionit midis rajoneve. Deri në mes të muajit mars, shumica e rajoneve italiane testonin vetëm njerëz me simptoma të rënda, duke lënë jashtë ekuacionit një pjesë të madhe të bartësve "ndoshta asimptomatikë", gjë që shkaktoi një kaos masiv. Ndërsa numri i vdekjeve rritej, të dhënat lëviznin ngadalë, duke mundësuar përhapjen e informacionit jo të saktë. Megjithatë asnjë vend nuk mund të ishte përgatitur për një emergjencë të këtyre përmasave, Italia ishte veçanërisht e papërgatitur për sa i përket qasjes në të dhëna. Në situata të tilla, statistikat e sakta janë gurthemeli i një përgjigjeje të fortë; popullata duhet të informohet në mënyrë që të shmangët paniku masiv [9].

Modelet e Taiwan-it dhe të Koresë së Jugut kanë demonstruar se Big Data, testimi në masë dhe koordinimi janë thelbësore për të kontrolluar krizat e shëndetit publik. Në dallim nga Taiwan dhe Koreja e Jugut, sistemi legjislativ Italian nuk lejon përdorimin e të dhënave të hapura, të dhënat nuk janë ende të dixhitalizuara dhe një pjesë e madhe e popullsisë ka mungesë në aftësitë dixhitale.

Prej modeleve të suksesshme të Tajvanit dhe Koresë së Jugut, Italia mund të nxjerrë mësim që vendosja e një ekuilibri mes të dhënave të hapura dhe mbrojtjes së privatësisë mund të jetë çelësi për t'i menaxhuar me sukses situata të tilla.

Ndërsa në SHBA, gjatë periudhës së pandemisë, duke filluar nga mesi i muajit prill, kompanitë e makinave po testojnë makinat pa shofer për shpërndarjen e ushqimeve, mallrave dhe ilaçeve [10]. Ndërsa lidhur me projeksionin se çfarë do të ndodhë me investimet në teknologjitë dixhitale, nga një sondazh i bërë nga kompania OpsRamp, kompani konsulente në fushën e shërbimeve IT, me 1 prill 2020, me 137 lider të operacioneve IT, në kompanitë amerikane me të paktën 500 të punësuar dhe 5 milion \$ buxhet vjetor në IT, rezultoi se: në mendjet e menaxherëve të kompanive mbizotëron ideja e mbajtjes në nivele të larta të investimeve në sektorin e transformimit dixhital dhe në fushën e sigurisë së informacionit. Nga ky sondazh, rezultoi se prioritetet e punësimit janë IT financial analysts dhe data scientists [11].

4. Konkluzione

Teknologjia nuk mund ti parandalojë pandemitë, megjithatë ajo ndihmon në parandalimin e përhapjes, edukimin, dhe informimin e qytetarëve në mënyrë që këta të fundit të jenë sa më të vetëdijshëm për situatën duke zvogëluar kështu impaktin negativ [12].

Teknologjitë, si Inteligjenca Artificiale dhe Big Data, mund të aplikohen në vende të populluara spitale, stacione treni, aeroporte etj, për të identifikuar sa më shpejt personat e sëmurë, me qëllim izolimin e tyre para se ata të bëhen shkaktarë për infektimin e personave të tjerë.

Pas Covid-19, disa profesione ekzistuese do të dalin të tepërta, por njëkohësisht do krijohen profesione dhe të reja. Do të ketë kërkesë të shtuar për kurse trajnimi në internet se si të përdoren portalet online që ofrojnë shërbime të ndryshme për klientët, qofshin këto shërbime fetare, mjekësore ose arsimore, por jo vetëm kaq, kompanitë dhe institucionet do të përshtaten me mënyrën e re të të jetuarit dhe punuarit online dhe profesionet automatike shumë shpejt do të zëvendësohen nga robotika dhe teknologjia.

Ndërtimi i infrastrukturës së nevojshme për të mbështetur një botë të dixhitalizuar dhe për të qënë të informuar për teknologjitë më të fundit, do të jenë thelbësore për çdo shtet apo biznes që të mbetet konkurrues në një botë pas COVID-19.

Duhet të nxjerrim mësim nga ky moment dhe të zhvillojmë ide inovatore në funksion të përmirësimit të jetëve tona, uljes së kostos dhe rritjes së përfitimeve të përbashkëta.

Ajo çfarë bota kaloi, ishte një sprovë për qytetarin, individin, biznesin dhe qeverinë, në përshtatjen me teknologjinë, dhe Covid 19 u shfaq për ti dhënë një shtysë ndryshimeve në aspektin teknologjik, politik, ekonomik, social etj.

5.Rekomandime

Mësimet e nxjerra nga situata pandemike e shkaktuar nga COVID-19, duhet të shërbejnë si këmbanë alarmi për ndërmarrjet shqiptare lidhur me investimet në fushën e teknologjisë. Bazuar në të dhënat e INSTAT, tek raporti Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit në Ndërmarrje, rezulton se vetëm 23.4% e ndërmarrjeve gjatë vitit 2019 kanë specialist të fushës së teknologjisë së informacionit. Kjo shifër do të thotë se pjesa më e madhe e ndërmarrjeve ndjen nevojën e specialistëve të kualifikuar në fushën e teknologjisë së informacionit të cilët duhet të jenë të aftë për të mbështetur proceset e punës në përditshmëri por edhe për ti zhvilluar ato më tej.

Prej këtu, institucioneve akademike i del si detyrë që të ndërtojnë kurrikulat e programeve që lidhen me teknologjinë në mënyrë të tillë që studentët jo vetëm të përballojnë kërkesat që ka aktualisht tregu i punës por edhe sfidat e të ardhmes.

Kjo periudhë duhet të shërbejë si refleksion për reformatorët e politikës publike që të të punohet me shumë seriozitet për:

Të krijuar infrastrukturën e nevojshme dhe sistemet e duhura për një qasje të re drejt botës dixhitale. Duhet të fillojë dixhitalizimi në arsim, gjykata, mjeksi, institucione lokale etj.

Të krijuar një strukturë të unifikuar sistemesh, ku çdo njësi apo institucion të japë dhe marrë të dhënat e nevojshme, me aprovimin e qytetarit dixhital, duke shmangur burokracitë.

Të siguruar një marrëveshje institucionale dhe ndër qeveritare për njohjen e vulave dhe firmave elektronike. Në 2017 u miratua ligji për njohjen e vulës elektorinke njësoj me atë të njomë, por përsëri ka problematika.

Të punuar për profesionet e automatizuara. Ka kohë që flitet për automatizim të proceseve dhe profesioneve më së shumti atyre mekanike. Ka ardhur koha që të punohet për këtë dhe Covid 19 na e tregoi më së miri këtë fakt.

Referencat:

[1] <https://www.normenkontrollrat.bund.de/nkr-en/publications>

[2] <https://scanbot.io/blog/government-digitization-trends>

[3] <https://tekbiz.al/index.php/2018/09/19/5-bizneset-qe-teknologjia-i-ka-ndryshuar-ne-menyre-dramatike/>

[4] http://www.instat.gov.al/media/7028/njoftimi_p%C3%ABr_shtyp_tik_2019.pdf

[5] <https://www.weforum.org/agenda/2020/04/10-technology-trends-coronavirus-covid19-pandemic-robotics-telehealth/>

[6] <https://www.investment.com.al/sq/covid-19/>

[7] Hua J., Kim J., & Shaw R., (2020), Governance, technology and citizen behavior in pandemic: Lessons from COVID-19 in East Asia.

Online: <https://www.sciencedirect.com/science/article/pii/S2590061720300272>

[8] Chaturvedi A., (2020), "The China way: Use of technology to combat Covid -19".

Online: <https://www.geospatialworld.net/article/the-sino-approach-use-of-technology-to-combat-covid-19/>

[9] <https://blogs.lse.ac.uk/internationaldevelopment/2020/04/28/why-technological-development-is-the-only-way-out-of-the-covid-19-pandemic-considerations-from-italy/>

[10] <https://www.weforum.org/agenda/2020/05/self-driving-vehicles-contact-free-deliveries-covid19/>

[11] <https://www.globenewswire.com/news-release/2020/04/21/2019332/0/en/OpsRamp-Survey-Shows-IT-Spending-Remains-Strong-With-Focus-on-Minimizing-Business-Risk-during-COVID-19.html>

[12] Manjunath B.S, (2020), "COVID-19: 8 ways in which technology helps pandemic management".

Online: <https://cio.economictimes.indiatimes.com/news/next-gen-technologies/covid-19-8-ways-in-which-technology-helps-pandemic-management/75139759>

TRANSFORMIMI DIXHITAL DHE ROLI NE TEKNOLLOJINE E INFORMACIONIT

Grigorina Boce
Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë
grigorina.boce@umsh.edu.al
Elektra Myrto
Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë

Abstrakt:

COVID-19 i ka treguar botës diçka që industria prodhuese tashmë duhet ta dijë. Zinxhirët tradicionalë të furnizimit dhe ekosistemet prodhuese janë duke dështuar dhe ne duhet të kalojmë në një zgjidhje më të adaptueshme, të shkathët që është plotësisht e mundësuar në mënyrë dixhitale. Virusi, si çdo krizë, ka nënvizuar thjesht atë nevojë dhe urgjencën dhe ka të ngjarë të shërbejë për përshejtimin e këtij ndryshimi. Kjo duhet të rezultojë në plane reale të veprimit, sesa në debate.

Transformimi dixhital ka pasur gjithmonë kuptim por adoptimi është ngadalësuar pasi njerëzit merren me disa nga konceptet dërrmuese përreth Industrisë 4.0, madhësinë e plotë të detyrës dhe luftën për të kuptuar se nga vjen vlera dhe ku mund të gjejnë dividendin dixhital. Tani nevojat janë imponuese dhe urgjente dhe ato që nuk arrijnë të shndërrohen ka gjasa të lihen pas dhe të rrezikojnë të bëhen të parëndësishme dhe jo konkurruese. Trendi i Industrisë 4.0, i referuar gjithashtu si Industrial IoT ose Fabrika e zgjuar, filloi në katin e parë të një fabrike dhe u paralajmërua si shpëtimtar për industrinë e prodhimit, veçanërisht në vendet me kosto më të lartë të punës. Në fakt hyrja në në epokë të re të zhvillimit ekonomik botëror, ishte paralajmëruar nga organizimi me i madh botëror për ekonominë Davos 2018. Në këtë event prestigjioz u lajmërua fillimi i epokës së re të zhvillimit që quhet "revolucioni i 4-t industrial" ose "industria 4.0". Kjo epokë e re zhvillimi bazohet kryesisht në burime të reja dhe në teknologjinë e informacionit në format e saj më të përparuara sic janë dixhitalizimi i mëtejshëm i proceseve dhe inteligjenca artificiale.

Cdo makinë do të ishte një ishull inteligjence që përmes lidhjes me makineritë e tjera mund të krijonte një linjë prodhimi vetë-shëruese, të vetë-optimizuar. Dhe ndërsa kemi disa shembuj të shkëlqyeshëm të zgjidhjeve inteligjente të fabrikës, ne nuk kemi parë shumë nga ato që u premtuan.

Fjalë kyçe: Industria 4.0, COVID-19, zgjidhje inteligjente të fabrikës, dividendi dixhital, industria prodhuese, transformimi dixhital.

Abstract:

COVID-19 has shown the world something that the manufacturing industry should already know. Traditional supply chains and manufacturing ecosystems are failing and we need to shift to a more adaptable, agile solution that is fully digitally enabled. The virus, like any crisis, has merely underlined both that need and the urgency and will likely serve to accelerate that change. This needs to result in real plans of action, rather than debate.

Digital transformation has always made sense but adoption has been slowed as people deal with some of the overwhelming concepts around Industry 4.0, the sheer size of the task, and struggle to figure out where the value is coming from and where they can find the 'digital dividend'. Now the needs are compelling and urgent and those that fail to transform will likely be left behind and risk becoming irrelevant and uncompetitive.

The Industry 4.0 trend, also referred to as Industrial IoT or Smart Factory, started on the factory floor and was heralded as the savior for the manufacturing industry, particularly in higher labor cost countries. It spoke of 'lot sizes of one' where each assembly would find its way through the factory and every process would be dynamic, seamless and fully automated. Every machine would

be an island of intelligence that through connection to other machines could create a self-healing, self-optimizing production line. And while we do have some great examples of intelligent factory solutions we have not seen much of what was promised.

Keywords: Industry 4.0, COVID-19, Intelligent factory solutions, Digital dividend, Manufacturing industry, Digital transformation.

1. Hyrje

Ndërprerja e aktiviteteve për shkak të koronavirusit (Covid-19) po e detyron përsheptimin e ndryshimit teknologjik.

Transformimi dixhital paraqet një mënyrë të re dhe revolucionare të të menduarit, një proces ndryshimi që nuk konsiston vetëm në adoptimin e teknologjive të reja, por gjithashtu, mbi të gjitha në mënyrën e të kuptuarit të një modeli biznesi, dhe në aftësinë për të ditur se si ta rizbulojmë atë.

Është e paqartë se sa do të zgjasë kjo pandemi, pasi nuk ka ende një vaksinë për ta luftuar atë, as ndonjë terapi të aprovuar për të ngadalësuar veprimin e virusit në trupin e njeriut. Ajo që duket të jetë e qartë tashmë është se COVID-19 do të ndikojë në mënyrë rrenjësore në shumicën e bizneseve dhe ky ndikim nuk është aspak afatshkurtër. Kështu që bizneset duhet të përgatiten. Ajo çka mund të thuhet tani në një analizë paraprake është që transformimi digjital i përsheptuar nga pandemia COVID-19 do t'i jap një shtysë edhe më të madhe ekonomisë digjitale.

Që tani ka edhe disa sinjale pozitive. Disa efekte pozitive të situatës ku gjendet biznesi sot në kushtet e pandemisë dhe të sforcimit për të qenë online, janë: aftësia në përmirësim e sipër për të punuar nga distanca dhe online me kolegë e bashkëpunëtorë; njohja e gjerë e vlerës dhe rëndësisë së transformimit dixhital dhe teknologjisë së informacionit midis të gjithë punonjësve dhe sidomos midis pronarëve apo menaxherëve, të cilët duhet të mendojnë për modele të reja biznesi; përdorimi i gjerë i marketingut digjital, shitjeve online dhe takimeve virtuale si instrumenta për zhvillimin e biznesit.

Deri më tani janë realizuar disa studime lidhur me përdorimin e teknologjisë në biznese në Shqipëri, megjithatë situata e krijuar nga pandemia COVID-19 kërkon një vlerësim të plotë të kapaciteteve institucionale dhe njerëzore që kanë SME-të në vend për tu digjitalizuar dhe mbi të gjitha për ta përbrendësuar përdorimin e teknologjisë jo thjesht në rast emergjence, por në proceset e tyre të përditshme. Kështu ekspertët, qendrat kërkimore, institucionet akademike, organizatat ombrellë të bizneseve, dhomat e tregtisë, donatorët dhe aktorë të tjerë mund të bashkojnë forcat për të realizuar një vlerësim të tillë që do të informonte më tej modelet e reja të biznesit në një botë të re post-COVID-19.

2. Industria 4.0 - digjitalizimi

Industria 4.0 i përket ndryshimeve revolucionare të filluara në fund të shekullit të 20 dhe të masivizuara në këto 2 dekadat e para të shekullit të 21. Revolucioni industrial i radhës e ka emrin digjitalizim i prodhimit. Interneti, një mënyrë komunikimi në një rrjet të përbashkët, fillimisht i përdorur në ushtri, është tashmë një element jetik, i cili ka ndikuar jo vetëm prodhimin por edhe jetën sociale të shoqërisë. Ndarja e informacionit ka mundësuar uljen e kostove në mënyrë të ndjeshme dhe rritjen e përfitimeve të ardhura nga bashkëveprimi. Teknologjia avancoi në drejtim të prodhimit të robotëve të pavarur, makinave autonome të sinkronizuara nëpërmjet një sistemi qendror, informacioni satelitor për rrugët, motin, mediat audiovizive, etj. Ky revolucion industrial është në zhvillim e sipër dhe me një shpejtësi të lartë. Gjithnjë e më shumë shërbime publike dhe private po digjitalizohen duke rritur jo vetëm informimin e lehtë dhe të shpejtë, por në të njëjtën kohë duke ulur ndjeshëm kostot monetare dhe ato burokratike. Karakteristikat më dalluese të kësaj etape zhvillimi janë shpejtësia dhe saktësia e lartë, koordinimi në një rrjet gjithnjë në zgjerim, rritja e prodhimit dhe ulja e kostove, transformimi i

disa shërbimeve ekzistues dhe dalja e shërbimeve të reja dhe mbi të gjitha, për një gamë në rritje shërbimesh po rritet konkurrenca e tregut të punës në nivel global.

3. Çfarë është digjitalizimi i punëve?

Në thelb digjitalizimi ose Industria 4.0 i referohet prirjes aktuale të automatizimit dhe shkëmbimit të të dhënave në nivel rajonal dhe global duke përmirësuar ndjeshëm eficiencën në prodhim dhe tregtim. Zhvillimet e ditëve të sotme të internetit, sistemeve kibernetike, sistemeve të serverëve, etj. kanë mundur jo vetëm shkëmbimin e shpejtë të volumeve gjithnjë e më të mëdha të informacionit por kanë arritur që në shumë drejtime të krijojnë një realitet paralel.

Eficienca e tregjeve është rritur dhe identifikimi i klientëve po arrin nivele të larta saktësie të paimagjinuara më parë. Nëpërmjet rrjeteve, kryesisht atyre sociale, po arrihet të identifikohen, gjithnjë e më mirë, nevojat e klientëve në mënyrë individuale, çka rrit saktësinë e planifikimit të prodhimit dhe në të njëjtën kohë, orienton prodhuesit më mirë drejt nevojave të tregut. Nga këto zhvillime transformuese janë krijuar dhe forma të reja biznesesh, të cilët kërkojnë aftësi të reja të stafit që i shërben. Kjo etapë aktuale e zhvillimit industrial shfaqet në 4 drejtimet e mëposhtme:

3.1. Sistemet kibernetike.

Një sistem kibernetik është sistem në cilin janë të integruar kompjuterë, rrjete dhe procese fizike. Në thelb, ai përfaqëson një mekanizëm që monitorohet nga algoritme të bazuara në kompjuterë të integruar ngushtë me internetin dhe përdoruesit e tyre .

Shembuj të sistemeve kibernetike përfshijnë rrjetet, sistemet autonome të automobilave, sistemet e kontrollit të proceseve prodhuese, sistemet e robotikës, avioni me pilot automatik, etj. Potenciali ekonomik dhe shoqëror i sistemeve të tilla është shumë më i madh gjë që ka nxitur rritjen e investimeve për të zhvilluar teknologjinë në këtë fushë.

3.2. Interneti i gjërave.

Interneti ka mundur lidhjen në të njëjtin rrjet të pajisjeve elektronike, automjeteve dhe makinerive të cilët janë pajisur me programe dhe sensorë, që u mundësojnë atyre lidhjen dhe shkëmbimin në kohë reale të të dhënave . Çdo gjë është e identifikueshme në mënyrë unike nëpërmjet sistemit të informatizimit dhe në të njëjtën kohë është në gjendje të ndërveprojë me të gjithë infrastrukturën ekzistuese të internetit . Gjërat që ndikohen nga interneti janë të shumëllojshme dhe në zgjerim e sipër. Ndër to mund të përmenden implantet e monitorimit të zemrës; kamerat e sigurisë dhe monitorimit të prodhimit; automjetet me sensorë të integruar; pajisjet e analizës së ADN-së për monitorimin e mjedisit, ushqimit, patogjenitose; pajisjet e operimit në terren, që ndihmojnë zjarrfikësit në operacionet e kërkim-shpëtimit, etj.

3.3. Sistemet "cloud" të ruajtjes së të dhënave Sistemet e serverëve të quajtur "cloud" përfaqësojnë një mjedis të përbashkët, ku përveç mundësisë së ruajtjes së të dhënave ofrohen dhe shumë shërbime me nivel të lartë cilësie dhe me pak kërkesa manaxhimi nga ana e përdoruesve. Avantazhi i kësaj forme të ruajtjes së të dhënave është se ajo menaxhon vetë pjesën më të madhe të proceseve dhe ofron rezultate të gatshme, sipas kërkesave të përdoruesve. Çdo përdorues i këtyre sistemeve përfiton në shërbim dhe paguan aq sa përfiton dhe për aq kohë dhe atë masë sa shërbimi përdoret.

Këto sisteme shkarkojnë shpenzimin për infrastrukturën kompjuterike dhe mirëmbajtjen, si dhe eliminojnë një pjesë të punëve për bizneset duke u mundur atyre përqendrimet më të larta në aktivitetet e tyre kryesore. Ndër avantazhet më të theksuara të këtyre sistemeve është mundësia që ato u japin kompanive për të shmangur ose minimizuar kostot e infrastrukturës së IT-së¹¹.

Përkrahësit, gjithashtu, pohojnë se informatika "cloud" lejon ndërmarrjet të marrin aplikimet e tyre dhe të konkurrojnë më shpejt, me menaxhim të përmirësuar dhe më pak mirëmbajtje dhe

që të mundësojë ekipet e IT-së që të rregullojnë më shpejt resurset për të përmbushur kërkesat e luhatshme dhe të paparashikueshme të biznesit .

3.4. Informatika konjiktive

Informatikë konjiktive është një model i kompjuterizuar, i cili realizon simulimin e proceseve të mendimit njerëzor. Informatika konjiktive përfshin sistemet e vetëmësimit që përdorin bazat e të dhënave, njohjen e modelit dhe përpunimin e gjuhës natyrore për të imituar mënyrën se si funksionon truri i njeriut .

Qëllimi i informatikës konjiktive është krijimi i sistemeve të automatizuara të teknologjisë së informacionit, që janë në gjendje të zgjidhin problemet pa kërkuar asistencë njerëzore. Informatikë konjiktive përdoret në shumë aplikacione të inteligjencies artificiale (AI), duke përfshirë programimin e gjuhës natyrore, rrjetet nervore, robotikën dhe realitetin virtual. Karakteristikat kryesore që sistemet konjiktive mund të shfaqin janë:

a) Përshtatshmëria: Sistemet konjiktive kanë aftësi të përshtaten në pjesën më të madhe të rrethanave. Këtë e arrijnë duke mbledhur të dhëna dhe duke krijuar "përvojë" nëpërmjet analizës së mënyrës se si informacioni ndryshon dhe mënyrës se si qëllimet dhe kërkesat evoluojnë.

Këto sisteme mund të bëjnë zgjedhje në situata të paqarta, si dhe janë të aftë të tolerojnë paparashikueshmërinë.

b) Interaktiviteti: Sistemet konjiktive mund të bashkëveprojnë lehtësisht me përdoruesit e tyre duke arritur që nëpërmjet bashkëveprimit të identifikojnë në kohë nevojat e tyre. Ata, gjithashtu, mund të bashkëveprojnë me procesorë të tjerë, pajisje dhe shërbime "cloud", si dhe me njerëz .

c) Autonomia: Sistemet konjiktive mund të ndihmojnë në përcaktimin e një problemi ose gjetjen e një zgjidhjeje nëse një pjesë e problemit është e paqartë ose jo e plotë. Ata mund të "kujtojnë" ndërveprimet e mëparshme në një proces dhe të kthejnë informacionin, që është i përshtatshëm për aplikimin specifik në atë çast në kohë .

d) Kontekstualiteti: Sistemet konjiktive janë në gjendje të ruajnë kontekstin ngjashmërisht si inteligjencia artificiale. Ata mund të identifikojnë elemente kontekstuale të tillë si qëllimi, detyrat, koha, vendndodhja, rregulloret, profili i përdoruesit, procesi, etj.

4. Sfidat e digjitalizimit të ekonomisë

Revolucioni i katërt industrial, i cili ka kryefjalë të tij digjitalizimin, mbart natyrshëm dhe sfida për t'u përballur. Grumbullimi dhe transferimi i volumeve të mëdha të informacionit krijon vështirësi në menaxhim dhe sjell risqe të panjohura më parë. Jo vetëm kaq, por si çdo revolucion është duke dhënë ndikimin e tij në jetën social ekonomike të individëve dhe shoqërive në tërësi. Ndër sfidat kryesore të këtij procesi transformues mund të identifikohem 7 prej tyre të renditura në vijim , të cilët ndahen në 2 kategori bazë:

1. Sfida me natyrë teknologjike të tilla si siguria kibernetike, pirateria dhe vlerësimi i riskut;
2. Sfida me natyrë ekonomike të tilla si ndikimi në tregun e punës, transferimin e të dhënave ndërmjet vendeve dhe aspektet ligjore të lidhura me to.

4.1. Siguria kibernetike dhe pirateria

Digjitalizimi i ekonomisë përveç komoditetit që sjell ka mundësuar rritjen e sigurisë. Duke transferuar informacionin nga dosjet fizike në formë elektronike është shmangur mundësia e humbjes apo vjedhjes së tyre gjatë transportimit. Por si në çdo rast tjetër, sa herë që shpiket një proces i ri shpiket njëkohësisht edhe një rreng i ri. Volume të mëdha të informacionit të grumbulluara në serverë mbrohen nga programe dhe elementë teknikë sigurie. Historia e shkurtër ka treguar se këto të dhëna nuk janë plotësisht të sigurta për shkak se elementë mbrojtës të serverëve shpesh janë thyer duke vënë në dispozicion të personave të paautorizuar dhe keqbërësve informacione personale dhe konfidenciale për individët, kompanitë dhe entet

shtetërore. Ngjarje të tilla kanë ndodhur dhe kanë shkaktuar zbulimin e të dhënave dhe lëvizjen e fondeve nga llogaritë e depozituesve në sektorin bankar, nxjerrjen e të dhënave financiare dhe atyre tregtare, nxjerrjen e informacioneve sekrete shtetërore apo dhe nxjerrjen e komunikimeve dhe të dhënave personale të individëve me funksione të larta në administratën shtetërore dhe shoqëritë tregtare. Të gjitha në thelb kanë synuar nxjerrjen e përfitimeve ekonomike dhe politike nëpërmjet vjedhjes dhe përdorimit të të dhënave.

4.2. Vlerësimi i riskut

Nuk janë vetëm faktorët e jashtëm ata të cilët mund të venë në rrezik të dhënat dhe sistemet kibernetike. Entet publike dhe kompanitë duhet të vlerësojnë në çdo kohë nivelin e riskut ndaj të cilit është e ekspozuar organizata. Piratët e internetit mund të thyejnë elementët e sigurisë së të dhënave dhe të dëmtojnë apo përdorin programet, bazë e të dhënave dhe rrjetet e krijuara. Punonjësit mund të bëjnë me ose pa dashje gabime, duke vënë në rrezik funksionimin e sistemit dhe sigurinë e tij. Në çdo rast kompania apo enti publik duhet të llogarisë paraprakisht vlerën e dëmit të mundshëm së bashku me probabilitetet përkatëse të ndodhjes së tij. Bazuar në një vlerësim të tij, duhet hartuar një plan i detajuar veprimi për minimizimin e ndodhjes së ngjarjeve me risk dhe minimizimin e pasojave të tyre në ato raste, kur ato nuk arrihet të parandalohen.

4.3 .Përditësimi i infrastrukturës digjitale

Digjitalizimi i proceseve dhe punëve synon të krijojë rrjete gjithnjë e më të gjerë, me gjithnjë e më shumë anëtarë dhe me gjithnjë e më shumë procese të integruara në to. Integrimi i proceseve të punës nëpërmjet lidhjes mes pajisjeve të ndryshme në formën e një zinxhiri kërkon një infrastrukturë të përditësuar digjitale. Ndryshimi i shpejtë teknologjik dhe zhvillimi i shpejtë i teknologjisë elektronike dhe i softëve në të njëjtën kohë, i vjetëron shpejt pajisjet dhe rrjetet e komunikimit. Nëse gjatë këtij procesi, një pajisje pjesë e një procesi do të ishte e papërditësuar apo zëvendësuar me një të përshtatshme, atëherë ajo do të bëhej pengesë në realizimin me sukses të procesit duke shkaktuar humbje apo dhe dështim të krejt procesit.

4.4. Ndikimi në tregun e punës

Çdo revolucion industrial ka dhënë impakt të fuqishëm në tregun e punës. Profesione të reja kanë lindur dhe janë zhdukur apo minimizuar profesione tradicionale. Në të njëjtën kohë është rritur efektiviteti i punës: prodhimi është shtuar dhe përmirësuar në cilësi, ndërkohë që numri i personelit është zvogëluar. Epoka e re e digjitalizimit po shkakton të njëjtit ndikim në tregun e punës. Makinat inteligjente kanë filluar të zëvendësojnë njerëzit. Ato punojnë 7 ditë në javë dhe 24 orë në ditë. Ato nuk mbartin emocione, nuk kanë kërkesa sociale, nuk bëjnë grevë, nuk lodhen dhe as nuk sëmuren. Kapaciteti i tyre prodhues është shumë i lartë. E thënë kështu, asnjë njeri nuk mund t'i konkurrojë ato. Ajo që u mbetet njerëzve është të përshtaten në profesionet që makinat nuk mund t'i bëjnë dot apo ato profesione të cilët i shërbejnë vetë sistemit.

Ky revolucion industrial i radhës po shfaq dy karakteristika të dukshme në tregun e punës.

Në radhë të parë po shkakton zëvendësimin e disa profesioneve tradicionale me disa profesione të reja të panjohura më parë. Ka lindur dhe është rritur nevoja për programues, kodues, profesionistë kibernetikë, manaxherë projektësh, inxhinierë elektronikë, etj. Këto kategori të reja dhe në shtim kërkojnë përgatitje të lartë teknike për t'iu përshtatur teknologjisë dhe nevojës për të punuar në një rrjet të përbashkët.

Gjithashtu, kërkon trajnim të herëpashershëm për t'iu përshtatur dinamikës së lartë të zhvillimeve digjitale. Këto nevoja për informacion dhe trajnime përjashtojnë nga integrimi në vendet e reja të punës stafin ekzistues me përvojë, i cili nuk ka as njohuritë bazë dhe as kohën e nevojshme për trajnim dhe integrim. Dhe në radhë të dytë, ndryshimi i shpejtë dhe ndonjëherë drastik i mënyrës së të punuarit ndikon në vetë kulturën e punës në një organizatë apo kompani. Nevoja për trajnim e punonjësve do të sjellë automatikisht përjashtimin nga

organizata e atyre punonjësve, të cilët nuk përshtaten me kërkesat e reja. Kjo do të ndikojë në një masë të caktuar në krijimin e një rezistence nga ana e punonjësve për të pranuar apo përqaftuar digjitalizimin e punëve

4.5. Shpejtësia e ndryshimit

Meqenëse çdo zhvillim teknologjik sjell metoda të avancuara dhe gjithnjë më të automatizuara në prodhim rrit prodhimin dhe/ose ul njëkohësisht kostot për njësi. Si të tilla këto zhvillime priten me entuziazëm nga pronarët dhe manaxherët e kompanive, të cilët synojnë implementimin sa më të shpejtë të metodave dhe pajisjeve të reja. Kjo tendencë është vërejtur edhe me revolucionin aktual të digjitalizimit. Afrimi me shpejtësi dhe në një masë të shtuar i pajisjeve inteligjente digjitale dhe eliminimi i disa shërbimeve, të cilat tradicionalisht janë ofruar nga dora e njeriut në bashkëpunim ose jo me makineritë, ka nxjerrë jashtë tregut të punës një kategori të konsiderueshme të punësuarish. Këta të fundit gjenden përballë dy rrugëve: ose të mbesin pa punë ose të përshtaten dhe të integrohen me pajisjet e reja. Kjo përshtatje kërkon kualifikim çka është e vështirë për një pjesë të të punësuarve, sidomos atyre me arsim mesatar apo me moshë mbi mesatare. Kjo kategori rrezikon të mos integrohet në vendet e reja të punës ose integrimi i tyre do të jetë gjysmak duke zbritur në nivele më të ulëta hierarkie.

5. Sektorët që ka prekur digjitalizimi në Shqipëri

Ndër shërbimet më të spikatura të cilat kanë përfituar nga avantazhet e digjitalizimit në Shqipëri janë:

- Digjitalizimi i shërbimeve financiare.

Niveli në rritje i shërbimeve financiare sidomos i operacioneve bankare, që pasqyrohet në dixhitalizimin total të shërbimeve bankare, rritjen e numrit të POS, bankomatëve, si dhe masivizimi gjithnjë në rritje i përdorimit të kartave dhe së fundmi i aplikacioneve bankare.

- Transferimi i shërbimeve.

Rritja e sektorit të "call center", të cilët shfrytëzojnë digjitalizimin për të transferuar një pjesë të shërbimeve nga vendet me nivel të lartë pagash drejt Shqipërisë, ku niveli i pagave është më konkurrues. Kjo natyrisht që ka transferuar një pjesë të papunësisë nga një vend në zhvillim si Shqipëria në vendet e zhvilluara, kryesisht Itali, Gjermani, etj.

- Përfitimet për turizmin.

Prej disa vitesh po intensifikohen tentativat për të shfrytëzuar favore të digjitalizimit në sektorin e turizmit. Përkrah rritjes së kapaciteteve dhe cilësisë së shërbimit turistik që po synohet nga investimet publike, private dhe mbështetja me legjislacion të favorshëm, po vërehet shfrytëzimi në rritje nga operatorët turistikë shqiptarë i portaleve më të rëndësishëm në fushën e prenotimit të shërbimeve turistike siç është Booking, AirBNB, etj.

- Digjitalizimi i shërbimeve publike.

Shqipëria ka një nivel të kënaqshëm të digjitalizimit të shërbimeve publike krahasuar me vendet e rajonit. Nëpërmjet sistemit e Albania ofrojnë në kohë reale dhe me kosto minimale një gamë gjithnjë në rritje shërbimesh për kompanitë dhe individët, duke filluar nga certifikatat, kartat e shëndetit, vërtetim për kontributet për gjendjen e tatimpaguesit, për mjetet e transportit dhe lejet e drejtimit, informacione, vërtetime dhe leje në lidhje me pasuritë e paluajtshme, etj. Në mjekësi është në proces projekti i transferimit në mënyrë digjitale i gjithë rekomandimeve mjekësore, recetave dhe shërbimeve të tjera me natyrë administrative.

- Digjitalizimi i transmetimeve audiovizive.

Në vitin 2012, Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) shpalli strategjinë e kalimit nga transmetimet analoge në ato numerike. Kjo strategji përbënte hapin e parë drejt digjitalizimit të plotë të transmetimeve televizive në Shqipëri. Ky kalim realizohet në kuadër të një procesi global të koordinuar të Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacioneve. Edhe pse muaji qershor i vitit 2015 ishte afati përfundimtar i mbylljes së të gjithë transmetimeve analoge për Shqipërinë ky afat nuk u arrit as nga vendet e tjera. Prosesi aktualisht është në fazën e zbatimit

të tij, ku në disa qytete është duke u shkëputur përfundimisht transmetimi analog për t'u zëvendësuar plotësisht nga ai digjital (numerik). Objektivi i digjitalizimit të transmetimeve televizive është digjitalizimi i rrjeteve tokësore me synim rritjen e kapaciteteve nëpërmjet futjes së teknologjive të reja mediatike HD TV, DVB-T2 dhe DVB-H. Nëpërmjet kësaj teknologjie të re synohet të mbulohet së paku 85% e territorit dhe 90% e popullsisë së vendit.

- Digjitalizimi në arsim.

Arsimi në Shqipëri ka filluar të prekë komoditetet dhe avantazhet e digjitalizimit. Edhe pse në hapat e parë, po vërehen shenja të testimit të platformave të kombinuara në mësimdhënie, të organizimit dhe kontrollit të dijeve në mënyrë elektronike, ofrimi i informacioneve të bollshme dhe njoftimeve nëpërmjet faqeve të internetit. Strategjia e kalimit nga transmetimet analoge në transmetimet numerike, rrjeteve sociale, hapja e llogarive personale për studentët e universiteteve nga ku marrin informacion online dhe në kohë reale për detyrimet, provimet dhe rezultatet e provimeve, etj

5.1. Shanset që vijnë prej digjitalizimit:

1. Kosto e lirë e punës.

Futja gjithnjë e më shumë e shërbimeve duke përdorur pajisjet digjitale pritet të rrisë nivelin e transferimit të këtyre shërbimeve nga vendet me kosto të lartë të punës drejt Shqipërisë. Kjo pritet të rrisë numrin e specialistëve shqiptarë të punësuar në ofrimin e shërbimeve për vendet me kosto të lartë të specialistëve, kryesisht vendet e BE-së .

2. Niveli i lartë i mësimin të gjuhëve të huaja.

Për fat të mirë Shqipëria trashëgon një traditë të mësimin në nivel të kënaqshëm të më shumë se një gjuhe të huaj. Kjo rrit konkurrimin e të rinjve shqiptarë në tregun e punës për të ofruar shërbime të ndryshme për kompanitë e huaja, që pritet të transferojnë këto shërbime nga vendet e tyre të origjinës.

3. Mungesa e një tregu pune të ngopur. Tregu i punës në Shqipëri nuk është i ngopur. Ka akoma hapësira për investime dhe për vende të reja pune. Kjo mund të bëjë që ndikimi i digjitalizimit në uljen e vendeve të punës të balancohet nga hapja e vendeve të reja të punës që do të vijnë prej investimeve të reja që mund të nxisë digjitalizimi. Madje duke njohur përqindjen e lartë të të papunëve të rinjtë ekzistojnë shanset që digjitalizimi shoqëruar me rritjen e investimeve të prodhojë më shumë vende pune se sa ato që do të mbyllën.

4. Integrimi Europian.

Anëtarësimi i Shqipërisë në BE do të vinte në pozita preferenciale vendin për të ofruar mallra dhe shërbime për vendet e BE çka do të nxiste rritjen e vendeve të punës në të njëjtën kohë me digjitalizimin e ekonomisë. Në këtë mënyrë integrimi do të balanconte deri diku rënien e vendeve të punës që do të shkaktonte procesi i vazhduar i digjitalizimit.

5. Zvogëlimi i popullsisë dhe forcës së punës.

Nuk është lajm i mirë por është i vërtetë: popullsia e Shqipërisë, ashtu si popullsia e shumë vendeve të tjera, ka ndalur rritjen. Duke pasur në konsideratë numrin e lindjeve, i cili ka rënë në 1.54 fëmijë për çift, si dhe nivelin e lartë të emigrimit të moshave të reja gjatë këtyre viteve, mund të pritet një rënie e forcës së punës në vitet në vijim që do të ulë presionin në tregun e punës dhe rrjedhimisht edhe nivelin e papunësisë.

5.2 .Pikat e dobëta përballë digjitalizimit:

1. Të qenit vetëm konsumator i produkteve digjitale kërkon volume të mëdha fondesh për blerjen e teknologjisë. Pamundësia për të qenë ofruese në ambientin e ri teknologjik bën që Shqipëria të investojë vlera të mëdha për të përvetësuar teknologjinë e re. Shqipëria është një ekonomi e vogël dhe, ashtu si deri më tani, është vetëm një konsumatore e produkteve digjitale. Ashtu sikundër më parë, kur ekonomia shqiptare ka blerë nga jashtë makineritë e reja,

kompiuterët, programet, etj., ashtu edhe tani ajo do të shpenzojë fonde për blerjen e softeve dhe pajisjeve inteligjente.

2. Emigrimi i "trurit". Edhe pse në një masë të reduktuar krahasuar me vite më parë, Shqipëria akoma vuan nga emigrimi i specialistëve të kualifikuar dhe talenteve drejt 14 vendeve perëndimore, ku vlerësimi është më i lartë. Ky fenomen nxit "importimin" e specialistëve të lartë nga vendet e tjera çka godet tregun e punës në Shqipëri.

6. Konkluzione dhe rekomandime

Mbështetur në nivelin e zhvillimit dhe frymën që ka sjellë digjitalizimi i ekonomisë, ndikimi i këtij procesi në tregun e punës, si dhe duke njohur realitetin dhe sfidat e tregut të punës në Shqipëri përgjatë zhvillimit të këtij procesi, janë nxjerrë disa konkluzione dhe rekomandime.

6.1. Konkluzione

Softet dhe elektronika janë duke përparuar me shpejtësi përgjatë dy dekadave të fundit. Janë krijuar pajisje me shpejtësi të lartë, sisteme me kapacitete të larta ruajtjeje të dhënash dhe softe të cilët mund të përpunojnë në kohë reale këto të dhëna. Kjo natyrë me dinamikë të lartë e digjitalizimit e bën të nevojshëm investimin e herëpashershëm në pajisje dhe sisteme me synimin për t'u siguruar që proceset do të realizohen me sukses dhe pa humbje.

Digjitalizimi i punës ka krijuar shumë profesione të reja të cilët kërkojnë përgatitje të lartë teknike dhe trajnim të herëpashershëm për t'u përshtatur teknologjisë së re dhe dinamikës së lartë të zhvillimeve digjitale. Këto nevoja për informacion dhe trajnime përjashtojnë nga integrimi në vendet e reja të punës stafin ekzistues me përvojë, i cili nuk ka kohën e nevojshme për trajnim dhe integrim.

Një ndër elementët që prek digjitalizimi i shërbimeve është transferimi i lehtë i një pjese të punëve nga njëri vend në tjetrin, çka ka rritur ndjeshëm konkurrencën në tregun e punës dhe ka ndikuar në transferimin e punëzënies nga njëri vend në tjetrin, kryesisht nga vendet e zhvilluara në vendet në zhvillim, siç është Shqipëria. Për shkak të kostos më të ulët të punës shumë shërbime të tilla si shërbimet "call center", shërbimet kontabile, shërbimet e sigurisë kibernetike, ofrimi i produkteve në fushën e dizajnit, arkitekturës, marketingut, etj. ofrohen nga subjekte dhe individë të ndodhur në vende të ndryshme të botës. E thënë ndryshe, bëhet fjalë për një treg global gjithnjë në rritje për disa kategori në rritje shërbimesh.

Ekziston një nevojë aktuale dhe potenciale për rregullime ligjore në përshtatje me ndryshimet dhe sfidat që do të sjellë revolucioni digjital. Nga njëra anë nevojitet mbrojtja ligjore e "viktimave" të këtij revolucioni të cilët priten të jenë punonjësit e pakualifikuar dhe ata me moshë mbi mesatare në pamundësi kohore për t'u trajnuar sipas kërkesave të pajisjeve të reja digjitale dhe nga ana tjetër mungojnë ligje të koordinuara në nivel global, të cilët do të mbronin të dhënat personale në kudër të zgjerimit të volumit të të dhënave dhe shtrirjes së tyre, sidomos përtej kufijve të një vendi.

Niveli i zhvillimit të digjitalizimit në Shqipëri, ndryshe nga parametrat ekonomikë apo dhe ato sociale dhe juridikë, ka ecur me një shpejtësi të kënaqshme krahasuar me vendet e zhvilluara dhe, në disa sektorë, mbart të njëjtin nivel dhe gjendet në të njëjtën etapë zhvillimi. Këtu duhet nënvizuar se Shqipëria është pothuajse një përdoruese e risive teknologjike, që vijnë prej digjitalizimit duke ofruar vetëm "feedback" në procesin e evolucionit të kësaj forme të avancuar zhvillimi. Gjithsesi këtu nuk duhen nënvlerësuar kontributet individuale të shkencëtarëve dhe inovatorëve shqiptarë, të cilët japin kontribute në mënyrë individuale në shtete dhe institucione që janë në krye të makinerisë së digjitalizimit të prodhimit. Natyrisht që këto raste janë të pakta për shkak dhe të numrit të vogël të popullsisë së Shqipërisë.

6.2. Rekomandime

Për shkak të dinamikës së lartë dhe kostove relativisht të larta të teknologjisë së re, institucionet publike dhe shoqëritë tregtare në Shqipëri duhet të parashikojnë më tepër fonde në dispozicion

të blerjes së pajisjeve digjitale. Këto fonde duhet të parashikojnë jo vetëm koston e blerjes së teknologjisë, por në të njëjtën kohë dhe kostot për të mbuluar deri diku pasojat e saj mbi tregun e punës. Konkretisht, këto fonde do të duhen për trajnimin e stafit, si dhe mbështetjen sociale për ato shtresa, të cilat nuk do të mund të integrohen me teknologjinë e re.

Meqenëse Shqipëria është në procesin e integritimit në Bashkimin Europian, është e nevojshme përshtatja e legjislacionit të punës dhe atyre, që lidhen indirekt me tregun e punës, me modelet më të mira dhe të avancuara të vendeve të BE-së. Këtu duhen përzgjedhur në veçanti ato modele, të cilët ofrojnë zgjidhje të problemeve që digjitalizimi shkakton në tregun e punës dhe në të njëjtën kohë nuk bëhen pengesë për procesin.

Nevojiten politika dhe programe qeveritare të plota dhe afatmesme lidhur me përfshirjen e digjitalizimit në ekonominë e vendit. Duke evidentuar në gjerësi pikat e dobëta dhe të forta të vendit, duhen analizuar përfitimet që mund të nxirren duke analizuar shanset dhe kërcënimet që vijnë nga digjitalizimi, sidomos kërcënimet për tregun e punës.

Politikëbërësit në Shqipëri duhet të mbajnë gjithnjë parasysh faktin se një ndër përfitimet aktuale të digjitalizimit është importimi i vendeve të punës nga vendet e zhvilluara kryesisht të BE-së. Këtu duhet të tregohet kujdes në trajtimin e atyre bizneseve, që sjellin vende punë në Shqipëri duke shfrytëzuar pajisjet digjitale. Pas një analize të arsyeve pse ata zgjedhin Shqipërinë dhe njohjeje të konkurrencës që vjen nga vendet e rajonit, duhet të ndërtohen politika ekonomike të tilla që të mos të zbehin avantazhin konkurrues të Shqipërisë në këto sektorë të cilët prodhojnë (importojnë) vende pune duke shfrytëzuar pajisjet digjitale.

Bibliografia

- "Upgrading Smart Manufacturing with Industry 4.0", Richard E. Crandall, September/October 2017 - Almada-Lobo, Francisco. 2017. "The Business Value of Industry 4.0." Where Manufacturing Meets IT, May 24. <http://blog.mesa.org/2017/05/the-business-value-of-industry-40.html>.
- Sniderman, Brenna, Monika Mahto and Mark Cotteleer. 2016. "Industry 4.0 and Manufacturing Ecosystems." Deloitte University Press, February 22. https://dupress.deloitte.com/content/dam/dup-us-en/articles/manufacturing-ecosystemsexploring-world-connectedenterprises/DUP_2898_Industry4.0ManufacturingEcosystems.pdf.
- The Connected Planet. n.d. "General Electrics Industry 4.0 Vision." The Connected Planet. http://www.theconnectedplanet.net/general-electrics-industry-4-0-vision/?_sm_au_=inVqpDW2rq2DH4H8
- The MPI Group. 2017. "What a Difference a Year Makes: Manufacturers from around the World Are Now Profiting from the Internet of Things (Are You?)" The MPI Group, May. - "INDUSTRIE 4.0
- Smart Manufacturing for the Future" Germany Trade and Invest GTAI - Christoph Roser at www.AllAboutLean.com
- "AWFS Fair plans Industry 4.0 technology focus", March 13, 2017, Woodworking Network, <https://www.woodworkingnetwork.com/awfs/awfs-news/awfs-fair-plans-industry-40-technology-focus>
- "What is Cloud Computing?". Amazon Web Services. 2013-03-19. Retrieved 2013-03-20. - Baburajan, Rajani (2011-08-24). "The Rising Cloud Storage Market Opportunity Strengthens Vendors". It.tmcnet.com. Retrieved 2011-12-02.
- Oestreich, Ken, (2010-11-15). "Converged Infrastructure". CTO Forum. Thectoforum.com. Archived from the original on 2012-01-13. Retrieved 2011-12-02. - Dr. John Kelly, 2016, Essential Guide "How to solve your TMI problem: Data science analytics to the rescue"

- Ferrucci, D. et al. (2010) Building Watson: an overview of the DeepQA Project. Association for the Advancement of Artificial Intelligence, Fall 2010, 59–79.
- Terdiman, Daniel (2014) .IBM's TrueNorth processor mimics the human brain.<http://www.cnet.com/news/ibms-truenorth-processor-mimics-the-human-brain/> - Knight, Shawn (2011). IBM unveils cognitive computing chips that mimic human brain TechSpot: August 18, 2011

POLITIKAT EKONOMIKE NË NDIHMË TË SME-VE PËRBALLË COVID-19, PËRVOJA DHE SUGJERIME

Prof.asoc.Dr. Ira Gjika
Universiteti "Mesdhetar i Shqiperise"
ira.gjika@umsh.edu.al
Dr. Rudina Qurku
Universiteti "Mesdhetar i Shqiperise"
rudina.qurku@umsh.edu.al

Abstrakt

Situatat e jashtëzakonshme kapërcehen me mjete dhe politika që kërkojnë angazhimin e të gjithë aktorëve. Kriza aktuale e shëndetit publik dhe ekonomik karakterizohet nga shumëllojshmëria e pasojave faktike dhe atyre që mund të shkaktojë në vazhdim. Në nivel mbarëbotëror, kjo ka nxitur gjenerimin e shumë ideve dhe marrjen e masave për zbutjen e pasojave. Pavarësisht ndryshimeve në madhësinë e vendeve dhe në mënyrën e qeverisjes së tyre, pavarësisht natyrës së kompanive dhe stilit të menaxhimit të tyre, prej disa muajve po vihen në veprim modele, masa e instrumenta ekonomike mjaft të ngjashëm në vende të ndryshme. Qëllimi i përbashkët i të gjithave është të mbështetin bizneset dhe aktivitetin ekonomik në tërësi.

Ky punim sjell një pasqyrim të masave dhe mjeteve që janë përdorur gjerësisht nga ana e shteteve, kompanive dhe individëve në këndvështrimin makro dhe mikroekonomik. Përtej pjesës përshkruese, qëllimi kryesor i punimit është të parashtojë rrugë, mjete dhe instrumenta për fuqizimin e SME-ve në përballjen me sfidat e kësaj krize dhe të situatave të vështira me të cilat mund të ndeshen edhe në të ardhmen kompanitë shqiptare. Kjo realizohet duke kombinuar studimin empirik të përvojave ekzistuese me analizën e aplikueshmërisë së masave në biznesin shqiptar. Gjetjet mbështeten në shqyrtimin e evidencave, në vëzhgimin në terren dhe në arsyetimin mbi rrugët dhe mjetet që rrisin qëndrueshmërinë e biznesit.

Punimi ve në dukje disa blloqe masash në funksion të përmirësimit të situatës aktuale dhe të ardhshme të SME-ve. Ndërsa instrumentat financiarë dhe masat e përkohshme lehtësuese kontribuojnë kryesisht në mbështetjen e kompanive në periudhë afat-shkurtër, politikat strukturore dhe përgatitja për sfidat në periudhë afatgjatë rekomandohet të bëhen pjesë e rëndësishme e strategjisë së biznesit.

Fjale kyçe: qëndrueshmëria e ndërmarrjeve, forcat e punës, papunësia, instrumentat financiarë, politika strukturore, organizata ndërkombëtare.

Abstract

Exceptional situations can be overcome by means and policies that require the commitment of all actors. The current crisis of public and economic health is characterized by the diversity both of real and expected-to-come consequences. This has, on the global level, generated a multitude of ideas and measures to mitigate the consequences. Despite changes in the size of countries and the way they are governed, regardless of the type of companies and their management style, very similar economic means and instruments have been introduced in different countries. The common goal of them all remains the support of businesses and economic activity as a whole.

This paper provides an overview of the means and tools that have been widely used by governments, companies and individuals, from a macroeconomic and microeconomic perspective. Beyond the descriptive part, the main purpose of the study is to present ways, means and instruments to strengthen SMEs facing the challenges of this crisis, as well as

the difficult situations that Albanian companies may encounter in the future. We do this by combining the empirical study of current evidencies with the analysis of the measures' applicability in Albanian business. The findings are based on evidence review, field observation, and reasoning on ways and means to increase business sustainability. The paper points out some sets of means intended to improve the current and future situation of SMEs. While financial instruments and temporary mitigation measures contribute mainly to supporting companies in the short term, the structural policies and preparation for long-term challenges are recommended to become an important part of the business strategy.

Keywords: company's resilience, work forces, unemployment, financial instruments, structural policies, international organizations.

1. HYRJE

Qëllimi themelor i strategjisë së biznesit është të drejtojë kompanitë drejt burimeve të qëndrueshme të rritjes dhe fitimit. Analiza e ndikimit të një morie faktorësh, të brendshëm e të jashtëm, dhe zgjedhja e alternativave që i çojnë kompanitë drejt suksesit është një mësim që jepet në të gjitha kurset e menaxhimit strategjik. Njëkohësisht është e pritshme që kompanitë të ndeshen me ngjarje të papritura në rrugën e tyre dhe të jenë të afta të reagojnë, me qëllim që të ruajnë qëndrueshmërinë në një mjedis të karakterizuar nga paqëndrueshmëria, pasiguria, kompleksiteti dhe paqartësia (WEF, 2019).

Mjafton një vëzhgim jo shumë i thelluar për të kujtuar se në shekullin e kaluar bota ka përjetuar të paktën pesë sulme të rrezikshme të viruseve, nga pandemia e 1918, që infektoi rreth një të tretën e popullsisë globale, deri te pandemia aktuale, Covid-19. Ka patur të paktën dy shpërthime bërthamore shkatërruese, dy luftëra botërore (dhe disa të tjera gati në shpërthim), tërmete të shumta dhe cunami, konflikte të panumërta të armatosura rajonale që kanë kërcënuar furnizimin e vendeve me mallra thelbësorë. Mundësia e shfaqjes së këtyre kërcënimeve përsëri në të ardhmen është evidente dhe ndikohet nga ndryshimi i klimës, mbipopullimi dhe pabarazia në rritje në mbarë botën, pa përjashtuar edhe faktorë të tjerë (Huy, 2020). Për rrjedhojë për kompanitë do të duhet që parashikimi i ngjarjeve shkatërruese dhe veprimeve mbrojtëse, që dalin jashtë kornizës së analizës klasike konkurruese të Michael Porter, të jetë një pjesë e rëndësishme e strategjisë së biznesit në vitet që vijnë. Sikurse shprehen drejtuesit e lartë të Forumit Ekonomik Botëror, pandemitë si Covid-19 po bëhen pjesë e normalitetit tonë dhe ne duhet të mësojmë t'ju përgjigjemi shpërthimeve të ardhshme me efektivitet dhe me dëme sa më të vogla ekonomike (WEF, 2020).

Prej këtij merr rrugë përpjekja jonë modeste që paraqitet në vijim të punimit.

2. QËLLIMI I PUNIMIT DHE METODOLOGJIA

Pandemia Covid-19, përveç gjithë pasojave të tjera, duket se ka patur një ndikim të ndjeshëm në vëzhgimet e natyrës ekonomike. Ajo i përshpejtoi dhe i shumëfishoi monitorimet, vëzhgimet dhe analizat nga ana e kompanive, vendeve dhe organizmave ndërshtetërorë.

Institucione dhe organizata në nivel kombëtar e ndërkombëtar që nga fundi i 2019 dhe sidomos pas shpalljes së situatës së pandemisë (WHO, 2020)¹ në vazhdimësi kanë ofruar kontributet e

¹ <http://www.euro.who.int/en/health-topics/health-emergencies/coronavirus-covid-19/news/news/2020/3/who-announces-covid-19-outbreak-a-pandemic>

tyre me parashikime të pasojave dhe sugjerime e mbështetje konkrete për sektorë, industri, rajone e vende të botës.

Mundësia e përfitimit nga këto vëzhgime ka qenë dhe është e hapur edhe për Shqipërinë. Ndjekja në vazhdimësi e modeleve dhe paketave të ofruara nga vende të ndryshme nxit interesin tonë për një studim krahasues me fokus në ndërmarrjet e mesme dhe të vogla shqiptare.

Qëllimi kryesor i punimit është të parashtrijë rrugë, mjete dhe instrumenta për fuqizimin e SME-ve në përballjen me sfidat e kësaj krize dhe të situatave të vështira me të cilat mund të ndeshen edhe në të ardhmen. Kemi shtruar pyetjet e mëposhtme, përgjigjet e të cilave janë objektiva të këtij punimi.

- Cilat janë instrumentet më të përdorura në përgjigje të pandemisë në nivel të organizatave publike dhe private;

- Cilat janë masat që mund të lehtësojnë SME në përballimin e bllokimit gjatë pandemisë, sipas perceptimeve dhe përvojës së biznesit shqiptar

- Cfare sugjerohet për SME pas rihapjes dhe në vazhdimësinë e aktivitetit të tyre.

Metodologjia përfshin:

- studimin empirik të literaturës dhe të një numri vëzhgimesh nga ana e organizatave ndërkombëtare (OECD, EBRD, FMN, ILO, EU), prej nga buron analiza e ndikimeve të pritshme dhe të evidentuara të krizës dhe e masave për zbutjen e tyre;

- vëzhgimin e masave të ndërmarra nga qeveria dhe kompanitë shqiptare përgjatë një periudhe tre-mujore (9 mars – 8 qershor 2020), të shpallura zyrtarisht prej tyre;

- një vëzhgim në terren, lidhur me perceptimet dhe parashikimet e tyre mbi qëndrueshmërinë dhe përgatitjen e kompanive shqiptare për t'i rezistuar krizës.

- analizën e rezultateve të këtyre vëzhgimeve që cojnë në përfundime e rekomandime për bizneset e vogla e të mesme.

Kufizimet e punimit konsistojnë në numrin e ulët të kompanive të kontaktuar, kryesisht online dhe në kohën e pamjaftueshme për të analizuar efektivitetin e masave qeveritare dhe veprimeve konkrete nga ana e SME.

3. NGA PARASHIKIMET TE SITUATA REALE – KORNIZA E REFERIMIT

Nga pikëpamja shëndetësore, pandemia koronavirus për një periudhë të shkurtër kohe u shtri në shumë vende, ka shkaktuar shumë humbje jete dhe vuajtje të rënda njerëzore në nivel global, të cilat raportohen në vazhdimësi (ECDC, 2020) ². Është konsideruar si kriza më e madhe e shëndetit publik që ka sjellë pas vetes një krizë të madhe ekonomike, me ndalimin e prodhimit në vendet e prekura, me një kolaps të konsumit e besimit, dhe me reagim negativ ndaj pasigurive të shtuara (OECD, 2020).

Natyra gjithëpërfshirëse, shtrirja gjeografike dhe në kohë e pandemisë e kanë bërë parashikimin e pasojave ekonomike një punë shumë sfiduese. Ndërkohë recesioni global tashmë është pranuar gjerësisht dhe ajo që diskutohet është sa i thellë do të jetë dhe sa do të zgjasë ai (McKinsey, 2020; WB, 2020; FMN, 2020).

Parashikimet, nga më të hershmet në fillim të muajit shkurt deri në fund të majit flasin për ndikimet kryesore të drejtpërdrejta të mbylljeve (lockdown), që u shtrinë pothuajse në të gjitha vendet. Përgjithësisht parashikohet rënie në nivelin e prodhimit, ulje e shpenzimeve konsumatore, ndikim i konsiderueshëm në rritjen vjetore të GDP, në varësi nga shumë faktorë, përfshirë kohëzgjatjen dhe madhësinë e mbylljeve sipas vendeve, efektin e kërkesës së zvogëluar

² <https://www.ecdc.europa.eu/en/geographical-distribution-2019-ncov-cases>

për mallra dhe shërbime në pjesë të tjera të ekonomisë, dhe shpejtësinë me të cilën efektet e politikës fiskale dhe asaj monetare do të japin efekt.³ (OECD, 2020)

OECD, FMN, EBRD dhe të tjera organizata kanë publikuar një numër rishikimesh dhe reflektimesh mbi efektin e pritshëm dhe politikat që nevojiten, një pjesë e të cilave kanë përfshirë edhe Shqipërinë.

Në përgjithësi, këto vëzhgime theksojnë se krahasuar me krizën globale financiare të vitit 2008, kësaj radhe rënia e shërbimeve në nivel botëror shfaqet shumë më e madhe, si pasojë e mbylljeve dhe distancimit fizik e shoqëror, veçanërisht në mjediset urbane.

Një vend të vecantë zenë vëzhgimet që lidhen me tregun e punës. ILO ka vlerësuar ndikimin e pritshëm të COVID-19 mbi papunësinë dhe nënpunësimin (underemployment), si edhe riskun me të cilin përballen sipërmarrjet. Bazuar në skenarë të ndryshëm për ndikimin e COVID-19 në rritjen globale të GDP, vlerësimet paraprake të ILO parashikojnë një rritje të papunësisë globale ndërmjet 5.3 milion (skenari "i ulët") dhe 24.7 milion (skenari "i lartë"), nisur nga një nivel bazë prej 188 milion në 2019⁴. Megjithëse këto vlerësime duken shumë të pasigurta, edhe për shkak të kohës kur janë bërë (ILO, 18.03.2020), në vijim të gjitha shifrat kanë treguar një rritje të konsiderueshme të papunësisë globale⁵. Në monitorimet e mëpasme, ILO raporton ulje të orëve të punës në masën 4,8% në nivel botëror gjatë tremujorit të parë (ekuivalente me rreth 135 milion punë me kohë të plotë). Po në të njëjtën kohë, 27 maj 2020, bëhet parashikimi për orët e punës të humbura gjatë 3-mujorit të dytë, që mund të shkojnë në 10,7% në nivel botëror (ekuivalente me rreth 305 milion punë me kohë të plotë) (ILO Monitor, 4-th ed.) Për krahasim, kriza globale financiare e vitit 2008-9 e rriti papunësinë me 22 milion.

Situata e sipërmarrjeve dhe qëndrueshmëria e SME-ve ka qenë gjithashtu në vëmendje të vëzhgimeve, parashikimeve dhe sugjerimeve për mbështetje. Sipas ILO Monitor (3-rd ed., 29.04.2020), rreth 436 milion ndërmarrje, punëdhënës dhe të vetëpunësuar në sektorët më të goditur në të gjithë botën, aktualisht po përballen me rrezik të lartë të ndërprerjes së punës. Më shumë se gjysma e tyre, rreth 232 milion, janë në tregtinë me shumicë dhe pakicë, aktualisht një nga sektorët më të ndikuar globalisht. Të vetëpunësuarit përfaqësojnë 45% të punësimit në këtë segment. Të vetëpunësuarit dhe ndërmarrjet e vogla përbëjnë më shumë se 70% të punësimit global në tregtinë me pakicë dhe gati 60% në sektorin e akomodimit dhe shërbimeve të ushqimit, shifra këto që dëshmojnë sa rëndë mund të jenë prekur ose të preken këta sektorë në krizën aktuale ekonomike.

4. ANALIZA DHE GJETJE

Përtej parashikimeve, në javët e para të përhapjes globale të pandemisë, kishte pak prova empirike se si situata prek SME-të në të gjitha vendet. Disa nga provat e para filluan të dalin nga sondazhet dhe, të kombinuara me analizën ekonomike në vijim, mundësojnë një paraqitje më të plotë të ndikimit të krizës dhe politikave ekonomike për të minimizuar pasojat mbi individët, ndërmarrjet dhe shtetet.

4.1. Ndikimet në SME

Evidentohen dhe parashikohen disa mënyra se si pandemia po ndikon në ekonomi, veçanërisht te SME. Në radhë të parë ndikimi shfaqet në të dy anët e tregut, tek oferta dhe te kërkesa.

³ https://read.oecd-ilibrary.org/view/?ref=126_126496-evgsi2gmqj&title=Evaluating_the_initial_impact_of_COVID-19_containment_measures_on_economic_activity

⁴ https://www.ilo.org/global/about-the-ilo/WCMS_738753/lang--en/index.htm

⁵ <https://www.oecd.org/sdd/labour-stats/unemployment-rates-oecd-update-may-2020.htm>

Në anën e ofertës, kompanitë përballen me një ulje të burimeve të punës, sepse punëtorët nuk mund të shkojnë në punë. Ata duhet të kujdesen për fëmijët dhe personat e tjerë që kanë në ngarkim, ndërkohe që shkollat janë të mbyllura dhe lëvizjet e njerëzve janë të kufizuara. Masat për të frenuar përhapjen e sëmundjes nepermjet bllokimeve dhe karantines, çojnë në ulje më të mëdha në përdorimin e kapaciteteve. Për më tepër, zinxhirët e furnizimit janë ndërprerë duke çuar në mungesë të lendeve të para dhe materialeve ndihmëse.

Në tërësi ulet oferta e produkteve dhe shërbimeve në tregje.

Nga ana e kërkesës, ulja shumë e madhe dhe e papritur e kërkesës dhe e të ardhurave për SME ndikon ndjeshëm aftësinë e tyre për të funksionuar dhe në shumicën e rasteve shkakton mungesë të theksuar të likuiditetit. Për më tepër, konsumatorët kanë pësuar ulje të të ardhurave, kanë frikë nga infektimi dhe rritje të pasigurisë, të cilat nga ana e tyre zvogëlojnë shpenzimet dhe konsumin. Këto efekte janë të kombinuara, sepse punëtorët janë larguar nga puna dhe punëdhënësit nuk janë në gjendje të paguajnë pagat. Ndikimi i situatës në tregjet financiare pritet të sjellë ulje të mëtejshme të besimit dhe ulje të kreditimit.

Këto ndikime, në formë dhe nga drejtime të ndryshme, prekin të gjitha firmat, të mëdha dhe të vogla. Por efekti mbi SME është veçanërisht i rëndë, kryesisht për shkak të nivelit më të lartë të çënueshmërisë dhe rezistencës më të ulët që vjen nga madhësia e tyre.

Në shumë vende të botës SME përbëjnë shumicën dërrmuese të kompanive, nga numri i tyre, vlera e shtuar dhe punësimi (ILO Monitor, 29.04.2020). Kjo ndryshon sipas vendeve dhe sipas rajoneve, duke bërë që disa zona ku numri dhe roli i SME-ve është më i lartë, të ndjejnë me shumë ndikim prej situatës. (OECD, 2020)

Edhe Shqipëria përfshihet në këtë grupim, për shkak të strukturës ekonomike dhe numrit të SME, që në 2019 përbënin 98,8% të ndërmarrjeve gjithsej, sipas numrit të të punësuarve (INSTAT, 01.06.2020).

SME-të shpesh kanë një numër më të kufizuar furnitorësh. Në disa raste, kjo mund t'i mbrojë ata nga goditja. I tillë ishte rasti me SME-të gjermane që operojnë më shumë në zinxhirët e furnizimit rajonal dhe në fillimet e shpërthimit të pandemisë në Kinë ishin më pak të prekur nga zhvillimet në atë rajon.

Në raste të tjera, SME-të mund të mbështeten te furnitorët nga vendet dhe rajonet më të prekur nga COVID-19, duke rritur ndjeshmërinë e tyre. Në mënyrë të ngjashme, pengesat në transportin detar, tokësor ose ajror ndikojnë në këto kompani.

Disa SME janë veçanërisht të ndjeshme ndaj ndërprerjeve të rrjeteve të biznesit dhe zinxhirëve të furnizimit, për shkak të lidhjeve me operatorë më të mëdhenj ose klientë (rasti tipik i kompanive fason në Shqipëri dhe rajon), por edhe sepse marrin shërbime outsourcing për pjesë të rëndësishme të aktivitetit të tyre.

SME-të mund të kenë më pak aftësi dhe fleksibilitet në përballimin e kostove që sjellin këto goditje. Kostot për parandalim si dhe ndryshimet e kërkuara në proceset e punës, siç është kalimi në punën në distance, mund të jenë relativisht më të larta për SME duke pasur parasysh madhësinë e tyre, si edhe në shumë raste, nivelin e ulët të dixhitalizimit dhe vështirësitë në qasjen dhe adoptimin e teknologjive dixhitale. Kjo është shumë tipike për biznesin shqiptar, sikurse evidentohet nga anketa mbi përdorimin e ICT (INSTAT 2019).⁶

Nëse prodhimi ulet për shkak të ndërprerjeve, kostot e punës dhe kapitalit të pashfrytëzuar rendojnë më shumë mbi SME sesa mbi firmat më të mëdha. Për më tepër, SME mund ta kenë më të vështirë të marrin informacione jo vetëm për masat për të ndaluar përhapjen e virusit, por edhe për strategjitë e mundshme të biznesit për të lehtësuar tronditjen, dhe nismat qeveritare në dispozicion për të siguruar mbështetje (rasti i vonësive nga ana e kompanive shqiptare për të aplikuar për paketat e ndihmës për punonjësit e tyre).

⁶ <http://www.instat.gov.al/al/temat/kushtet-sociale/teknologjis%C3%AB-s%C3%AB-informacionit-dhe-komunikimit-tik-n%C3%AB-familje-dhe-nga-individ%C3%ABt/publikimet/2019/anketa-mbi-p%C3%ABrdorimin-e-teknologjis%C3%AB-s%C3%AB-informacionit-dhe-komunikimit-tik-n%C3%AB-familje-dhe-nga-individ%C3%ABt-2018-2019/>

Duke pasur parasysh burimet e kufizuara të SME dhe pengesat ekzistuese për të siguruar kapital, periudha gjatë së cilës SME mund të mbijetojnë nga tronditja është më e kufizuar sesa për firmat më të mëdha. Sikurse sinjalizojnë ekspertët e organizmave ndërkombëtare (OECD, EBRD, WB), ekziston rreziku që firmat të cilat, në kushte të tjera kanë aftësi paguese, veçanërisht SME, në kushtet kur janë në fuqi masat kufizuese, mund të falimentojnë.

4.2. Politikat ekonomike të vendeve në mbështetje të SME-ve

Duke pasur parasysh rrethanat specifike me të cilat SME përballen aktualisht, vendet kanë marrë masa për t'i mbështetur ato. Përtej shqetësimit të parë, që është shëndeti publik i punonjësve, punëdhënësve dhe i gjithë popullatës, janë ndërmarrë edhe një sërë masash për të zbutur ndikimin ekonomik të shpërthimit të koronavirusit mbi bizneset. Në mënyrë të veçantë, shumë vende kanë marrë urgjentisht masa për të mbështetur SME-të dhe të vetëpunësuarit gjatë kësaj kohe tejet sfiduese, me një përqendrim të fortë në nismat për të ruajtur likuiditetin afatshkurtër.

Disa vende janë përqendruar në politika më të përgjithshme që kanë potencialin për të zvogëluar goditjen për ekonominë dhe për të gjitha bizneset. Në shumë vende Bankat Qendrore janë përfshirë duke lehtësuar kushtet monetare dhe duke u mundësuar bankave tregtare të japin më shumë kredi për SME. Shembujt përfshijnë masat e pashembullta të marra nga Rezerva Federale e SHBA dhe Banka Qendrore Evropiane (OECD, 2020).

Ndërkohë, shumë vende kanë prezantuar masa specifike të politikave të SME, të cilat variojnë sipas kushteve kombëtare të "shëndetit ekonomik dhe publik".

Megjithë shumëllojshmërinë e politikave dhe masave konkrete, një analizë dhe krahasim i tyre është konsideruar i dobishëm dhe është realizuar nga disa organizma, kryesisht në këndvështrimin gjeografik/ rajonal (WB)⁷, ose prej angazhimit të vendeve në këto organizma (OECD, EBRD)⁸.

Duke pasur parasysh situatën në zhvillim, këto përmbledhje nuk janë gjithëpërfshirëse. Gjithashtu, nuk ka ende asnjë vlerësim apo gjykim të bërë në këtë fazë mbi efektivitetin e masave të tilla. Mbi të gjitha, në cdo rast nevojitet:

1 - gatishmëria e institucioneve që ofrojnë mbështetje dhe

2 - aftësia dhe kapacitetet e palëve përfituese (qofshin këto shtete apo sektorë e biznese të vecanta) për të përthithur fondet apo për të përshtatur e zbatuar politikat dhe masat konkrete. Gjithsesi, analiza eidenton cilat janë instrumentet më të përdorura në përgjigje të pandemisë. Ato janë të ndara në katër grupe politikash, secila e zbatueshme nëpërmjet instrumentave ose mjeteve të natyrës mikroekonomike, makroekonomike dhe menaxheriale.

1. Masa në lidhje me shkurtimin e kohës së punës, pushimet e përkohshme dhe pushimet për arsye shëndeti.

Me rënien e prodhimit dhe kërkesës, shumë SME përballen me vështirësi në pagimin e pagave dhe detyrimeve shëndetësore për punonjësit. Vendet, përfshirë Shqipërinë, kanë marrë masa për të kontribuar në pagesat e pagave për punonjësit përkohësisht pa punë ose me raport mjekësor. Qasjet e vendeve lidhur me ndikimin në tregun e punës dhe atë të sigurisë sociale ndryshojnë shumë, që do të thotë se masat e mundshme dhe të nevojshme mbështetëse ndryshojnë.

Mundësitë për shkurtimin e përkohshëm të orarit të punës ose për të larguar punonjësit e tepërt janë një opsion për SME që të përballojnë përkohësisht ndikimin e pandemisë. Vende të ndryshme kanë bërë rregullime ligjore në mënyrë që t'ju lejohet kompanive të zvogëlojnë orarin e punës së punonjësve ose ndërprerjen e përkohshme të punësimit. Në shumë raste, vendet kanë

⁷ <https://www.worldbank.org/en/data/interactive/2020/04/14/map-of-sme-support-measures-in-response-to-covid-19>

⁸ <https://www.ebrd.com/what-we-do/coronavirus/coronavirus-policy-response>

prezantuar masa të përqendruara posaçërisht për të vetëpunësuarit, si skema të mbështetjes me paga për papunësi të pjesshme ose fonde solidariteti dhe ndihmë direkte nga shteti.

II. Shtyrja e taksave, pagesa e sigurimeve shoqërore, pagesa e borxhit, pagesa e qerave dhe shërbimeve utilitare

Shumica e vendeve kanë ndërmarrë masa që lejojnë SME (por edhe kompanitë e mëdha) të shtyjnë pagesat, në mënyrë që të shmangin më tej problemet e likuiditetit të tyre. Ato kanë shpallur shtyrje të tilla në pagesën e taksave të korporatave, tatimit mbi të ardhurat dhe për TVSH, për të gjithë sektorët ose të përqendruar në sektorë të veçantë si turizmi dhe transporti. Një numër vendesh mundësojnë shtyrjen e pagesave të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Edhe këtu, në disa raste fokusi i shtyrjes është në sektorë specifikë, më të prekur nga ndërprerja e detyruar e aktivitetit (turizmi, industria e filmit, restorantet, aktivitetet e argëtimit, sportet, shërbimet kulturore, transporti i pasagjerëve).

Disa vende ofrojnë shtyrje dhe lehtësim përmes masave të prokurimit publik. Ato kanë lejuar shmangie nga procedurat standarde për të mbuluar nevoja të jashtëzakonshme. Disa vende ndaluan gjobat për vonesë furnizimi/ shërbimi (penalitetet) në prokurimet publike dhe kanë shpejtuar procedurat e miratimit në sektorë të caktuar (përfshirë shëndetësinë).

III. Instrumentat financiare/ Garancitë e huasë

Shumë qeveri kanë prezantuar dhe shtuar masa që stimulojnë bankat tregtare të ndihmojnë huadhënien e tyre për SME. Në disa vende, bankat qendrore kanë hequr kërkesat për rezerva për bankat, për të lejuar ato të rritin kreditimin. Në raste të tjera, përmes masave të pazakonta të politikës monetare, bankat qendrore kanë blerë paketa kredish për SME dhe kompani të tjera për të rritur kreditimin e ardhshëm. Disa vende kanë thjeshtuar procedurat administrative për të lehtësuar qasjen në garancitë e kredive ose kanë rritur kreditimin e drejtpërdrejtë për SME. Ka përvoja që janë krijuar edhe instrumente të reja kredie ose janë përqendruar instrumentet e reja të kredisë në sektorë të veçantë, ku gjithashtu spikat turizmi.

IV. Politikat strukturore

Disa vende kanë ndërmarrë veprime për të ndihmuar SME të adoptojnë procese të reja pune, të shpejtojnë dixhitalizimin dhe të gjejnë tregje të reja. Politika të tilla synojnë një sfidë urgjente afatshkurtër, por njwkohsisht kontribuojnë në forcimin e qëndrueshmërisë së SME në një mënyrë më strukturore dhe mbështesin rritjen e tyre të mëtejshme. Politika të tilla përfshijnë mbështetjen për gjetjen e tregjeve të reja alternative, për punën në distance dhe dixhitalizimin, për inovacionin dhe (ri) trajnimin e forcës së punës. Këto politika kanë një rëndësi të veçantë, pasi SME ndoshta janë më pak të afta të adoptojnë teknologji dhe metoda të tilla të reja. Në të njëjtën kohë, mbështetja e adoptimit të teknologjive dhe praktikave të reja mund t'i lejojë ata të rrisin kërkesën e tyre të pas krizës dhe aftësinë për të adresuar sfidat e paraqitura nga zhvillimet komplekse. Mundësimi i SME-ve për të ruajtur aftësitë gjatë krizës, si dhe për të zhvilluar aftësi të mëtejshme, përbën një aspekt të rëndësishëm të përgjigjes së kërkuar të politikës strukturore ndaj krizës.

Iniciativat e sektorit privat dhe sipërmarrja janë ana tjetër për t'u evidentuar. Kriza ka sjellë shembuj të sipërmarrjes dhe kreativitetit të biznesit të vogël në përballimin e krizave. Shumë firma të vogla kanë dalë me nisma si salla ekspozite virtuale të modës apo mjete mësimore digjitale që ndihmojnë për të zhvilluar mësim në distancë në vendet ku shkollat janë mbyllur. Janë krijuar mënyra të reja për të afruar ofertën me kërkesën në kushtet e kufizimit të lëvizjeve fizike. Në përgjithësi, platformat e mësimi elektronik kanë patur një rritje të madhe të aktivitetit, me firmat e vogla dhe sipërmarrësit që shpallin përmbajtjen e tyre në internet.

Në disa vende po shtohen dhe shpejtohen iniciativat Fintech për të lehtësuar problemet e likuiditetit të sipërmarrësve. Raportet nga Kina sugjerojnë se teknologjia blockchain dhe teknologji të tjera të industrisë 4.0, si Big Data, 5G dhe AI kanë ndihmuar në shpejtimin e rimëkëmbjes së biznesit dhe kanë luajtur një rol në përpjekjet për të kontrolluar përhapjen e virusit dhe për të zhvilluar një vaksinë COVID-19. Në disa vende, janë organizuar hakatonët

(nxitës të zhvillimit të software) për të shfrytëzuar kreativitetin e ndërmarrjeve start-up dhe sipërmarrësve për të kontribuar në zgjidhjet për çështjet e krizes. Të tilla kemi patur edhe në Shqipëri.

Pa asnjë dyshim, mjedisi për SME-të dhe sipërmarrësit në periudhën e ardhshme do të jetë sfidues, dhe do të ketë nevojë për mbështetjen shtetërore për të ndihmuar firmat të mbijetojnë. Në të njëjtën kohë, "pandemitë dhe recesionet janë përshpejtues të inovacionit".⁹ Për t'iu përgjigjur krizës, cdo vend duhet të marrë parasysh këtë kontribut sipërmarrës dhe potencialin e SME-ve.

4.3. Diskutim në kontekstin e biznesit shqiptar

Një krahasim i situatës së përgjithshme në Shqipëri me vendet e tjera që kanë raportuar masat e tyre (si anëtare të WB, OECD, EBRD, etj.) do të kërkonte një masë të dhënash që nuk janë të disponueshme. Megjithatë, ne kemi bërë një përpjekje për të evidentuar situatën në bizneset shqiptare, duke u mbështetur kryesisht në perceptimet e tyre:

së pari për pasojat e krizës (kufizimi i lëvizjeve, mbyllja e SME, ulja e kërkesës),

së dyti për mbështetjen e pritshme ose që do donin nga shteti për rimëkëmbjen e tyre.

Vëzhgimi është kryer gjatë muajit prill- fillim i majit, ndërkohë që masat kufizuese ishin ende në fuqi. Modeli u mor nga një vëzhgim i kryer paralelisht në disa vende të Europës me iniciativën e SME Europe, që kishte për qëllim të siguronte një pamje të përgjithshme të forcës së SME-ve për tu përballur me krizën dhe të nxiste diskutimin për masat e ndihmës që kërkon kjo shtresë e mesme e popullatës.

Kemi ruajtur të njëjtën strukturë të pyetësorit si në vëzhgimin e SME Europë me qëllim që të mundësohet krahasimi i rezultateve (SME, 18.05.2020). Pyetësori u shpërnda në formë elektronike në një numër biznesesh të vogla e të mesme në qytetin e Tiranës dhe të Gjirokastrës. Megjithë numrin e kufizuar të kompanive që kthyen përgjigje, gjykojmë se gjetjet janë interesante. Natyra e aktivitetit ekonomik dhe mbizotërimi i bizneseve të vogla pasqyrohet grafikisht në fig.1.




Figura 1. Përbërja e mostrës sipas aktivitetit ekonomik dhe numrit të punonjësve.

Burimi: përpunim nga autorët

Ishte i pritshëm konfirmimi nga të gjitha bizneset, pa përjashtim, për prekjen e tyre nga kufizimet prej pandemisë. Masa e prekjes nga mbyllja e detyruar e aktiviteteve, nga rënia e fuqisë blerëse dhe interesit të konsumatorëve për shpenzime, nga kufizimet në transportet brenda dhe jashtë vendit rezultoi e ndryshueshme: rreth 67% e kompanive parashkojnë ulje në masën mbi 10% dhe më pak se 50%. Ndërsa 10% e tyre nuk ishin në gjendje të bënin vlerësim në momentin e vëzhgimit, plotësisht logjike kjo për shkak të mosnjohjes së kohëzgjatjes së masave kufizuese (Fig.2). Pavarësisht rezultateve të evidentuara, pothuajse për të gjitha bizneset është e pritshme (edhe pa llogaritje të sakta) një ulje vjetore mesatare në intervalin 20%-35%.

⁹ <https://www-entrepreneur-com.cdn.ampproject.org/c/s/www.entrepreneur.com/amphtml/347669>





Figura 2. Ndikimi i krizës në uljen e aktivitetit dhe të të ardhurave të kompanive.
Burimi: përpunim nga autorët

Në varësi nga natyra e aktivitetit, rreth 45% e kompanive gjatë muajit prill kanë patur një ulje të të ardhurave (deri në 75% të xhiros krahasuar me të njëjtin muaj të 2019), ndërsa 10% e kompanive kanë realizuar të ardhura shumë të ulëta krahasuar me ato të vitit të kaluar (vetëm 10%). Rënia e aktivitetit dhe e të ardhurave i ka detyruar një pjesë të tyre (10% e kompanive) të largojnë punonjës nga puna, ndërkohë që 67% e SME të vëzhguara kanë ruajtur të paprekur fuqinë e tyre punëtore. Pjesa tjetër (22%) kanë zgjedhur të reduktojnë kohën e punës, duke përdorur variantin e punës me kohë të shkurtuar (Fig.3).





Figura 3. Ndikimi i krizës në punësimin dhe qëndrueshmërinë financiare të kompanive.
Burimi: përpunim nga autorët

Ruajtja e fuqisë punëtore edhe për periudhat në vazhdim, pavarësisht krizës deklarohet se do të bëhet nga 56% e kompanive, të cilat duket se e vlerësojnë këtë aset dhe njëkohësisht dëshmojnë edhe përgjegjshmërinë e tyre sociale. Gjithsesi një pjesë tjetër e kompanive (44%) do detyrohen të heqin punonjës nga puna në 2 muajt e mëpasme. Përveç këtij ndikimi të drejtpërdrejtë në papunësi, të gjitha kompanitë kishin planifikuar të shtonin punonjës të rinj. Për rrjedhojë efekti në papunësi për periudhat e mëpasme do jetë edhe më i ndjeshëm, të paktën deri sa të fillojë ringritja, e shoqëruar me hapje vendesh të reja pune. Gjithsesi, kërkesa për punonjës në sektorë të tjerë pritet të ketë rritje, që mund të ndikojë në kahun e kundërt.

Përpara kësaj situate 78% e bizneseve pjesë e vëzhgimit kishin planifikuar të bënin investime për zhvillim të aktivitetit të tyre, që tashmë ose i kanë anuluar ose do rishikojnë burimet e financimit. Cështja e burimeve financiare lidhet edhe me aftësinë e kompanive për të mbuluar shpenzimet e tyre në mungesë të të ardhurave gjatë veprimit të masave kufizuese. Më shume se gjysma e kompanive (56%) deklarojnë se kanë likuiditete financiare për të funksionuar deri në muaj, ndërsa rreth 10% e kompanive mund të rezistojnë vetëm 1-2 javë. Nëse do të krahasojmë qëndrueshmërinë financiare të kompanive shqiptare me atë të deklaruar nga kompani

europiane (SME EUROPE, 2020), vërejmë se nuk ka biznese që do mund të përballonin deri në 6 muaj apo më shumë.

Perceptimet e biznesit shqiptar për rrugët dhe mjetet që do ndikonin në lehtësimin e krizës lidhen kryesisht me lehtësimin nga detyrimet. Rreth 20% e tyre kërkojnë ndihmë direkte nga shteti, por pjesa më e madhe e shikojnë shtyrjen e detyrimeve fiskale (44%) ose heqjen e tyre (33%) si një masë që do ju mundësonte të mbanin në punë biznesin në kushtet aktuale ose me ndonjë shkurtim të vogël në personel (Fig.4).

Vëzhgimi jep pak informacion mbi sugjerime shtesë nga ana e kompanive për rimëkëmbjen pas krizës. Në tërësi, gjykojmë se ulja e cmimit në tregun e punës dhe e investimeve (publike dhe private) vërtet mund të cojnë në uljen e kostove funksionale të bizneseve, por dalja nga kriza nuk mund të realizohet vetëm nëpërmjet uljes së kostove. Për këtë nevojitet edhe ristrukturimi i ekonomisë, të cilin mund ta orientojnë politikat e investimeve që shteti në bashkëpunim me sistemin bankar duhet të vërë në shërbim të biznesit për ndryshimin e modeleve të sipërmarrjes dhe për krijimin e tregjeve të reja. Ky është një sugjerim që buron nga vëzhgimi, për masat që duhet të marrë qeveria për zhvillimin e ekonomisë.




Figura 4. Masa në ndihmë të kompanive për kapërcimin e krizës.
Burimi: përpunim nga autorët

5. Përfundime

Në mbyllje të këtij punimi mund të evidentohen disa çështje që lidhen me qëllimin e studimit tone, parashtrimin e rrugëve, mjeteve dhe instrumentave për fuqizimin e SME-ve në përballjen me sfida dhe situata të vështira. Punimi paraqet:

- instrumentet më të përdorura në përgjigje të pandemisë në nivel të organizatave publike dhe private;

- masat që mund të lehtësojnë SME në përballimin e bllokimit gjatë pandemisë, sipas perceptimeve dhe përvojës së biznesit shqiptar, mbështetur në një vëzhgim të kryer në terren. Analiza e ngjarjeve dhe veprimeve të deritanishme lejon të bëhen sugjerime për politikat ekonomike dhe ndryshimet strukturore për SME pas rihapjes dhe në vazhdimësinë e aktivitetit të tyre.

- Bizneset shqiptare duhet të përgatisin dhe përshtasin strukturat e tyre menaxheriale për të reaguar me shpejtësi në situata vështirësish. Kompanitë duhet të dedikojnë më shumë kohë e burime për të përcaktuar llojet e ndryshme të kërcënimeve. Në botën pas COVID-19, për të siguruar mbijetesën duhet të hartohen planet e emergjencave (contingency planning) për çdo hallkë të zinxhirit të vlerës. Pyetja kryesore duhet të jetë "cfarë -nëse?" (what -if).

- Në aspektin financiar kompanitë kanë nevojë për plane të detajuara financiare, që parandalojnë falimentimet dhe pa-aftësinë paguese, kur është e mundur, pa shkaktuar kriza për njerëzit, të cilët presin të paguhen.

- Institucionet arsimore të fushës ekonomike mund të luajnë rol në këtë drejtim duke përgatitur brezat e drejtuesve të ardhshëm të kompanive.
Jo të gjitha krizat janë të përgjithshme, si kjo aktualja, ndërsa kompanitë, qofshin SME apo korporata do duhet të përballojnë situata komplekse në vazhdimësi.

6. Bibliografi

- Baldwin R., di Mauro B.W., Economics in time of COVID-19, A VoxEU.org book, 2020.
- Cochrane J.H., Corona virus monetary policy, 2020.
- HBR, Coronavirus and Business: The insights you need from Harvard Business Review, March 2020.
- Huy, Q. N., Four Strategic Priorities for the Post-COVID-19 World, INSEAD, 12.05.2020 aksesuar nga <https://knowledge.insead.edu/blog/insead-blog/four-strategic-priorities-for-the-post-covid-19-world-14086>
- ILO Monitor: COVID-19 and the world of work. Updated estimates and analysis, Fourth edition, 27 May 2020
- SME Europe, Business Impact Assessment Covid-19 survey, <http://www.smeeurope.eu/>
- <https://www.weforum.org/sustainability-world-economic-forum>
- <https://www.mckinsey.com/business-functions/strategy-and-corporate-finance/our-insights/an-instant-economic-crisis-how-deep-and-how-long>
- <https://blogs.worldbank.org/climatechange/for-a-sustainable-recovery-from-covid-19>
- <http://www.oecd.org/coronavirus/#>
- https://read.oecd-ilibrary.org/view/?ref=126_126496-evgsi2gmqj&title=Evaluating_the_initial_impact_of_COVID-19_containment_measures_on_economic_activity
- https://unctad.org/en/pages/newsdetails.aspx?OriginalVersionID=2313&utm_source=CIO+-+General+public&utm_campaign=0fa89ab0a6-EMAIL_CAMPAIGN_2019_05_17_11_42_COPY_01&utm_medium=email&utm_term=0_3d334fa428-0fa89ab0a6-70609233
- https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---dgreports/---dcomm/documents/briefingnote/wcms_738753.pdf
- <https://www.oecd.org/coronavirus/>
- <https://www.ecdc.europa.eu/en/geographical-distribution-2019-ncov-cases>

KRIZA CORONAVIRUS, EFEKTET E TIJ NE EKONOMI

Dr Florenca Gjorduni
Universiteti "Aldo Moro", Bari Itali
florenca.gjorduni@uniba.it

Abstrakt

Duke vlerësuar ndikimin ekonomik të pandemisë Covid-19 është thelbësore për politikë-bërësit, por sfiduese sepse kriza është shpalosur me shpejtësi ekstreme dhe ne jemi akoma të pasigurt për kohëzgjatjen e saj. Dy nga pasojat më të rënda të Covid-19 janë humbjet e këqija në njerëz dhe aktiviteti ekonomik kontraktues. Fillimisht, kjo pandemi goditi furnizimin, duke pezulluar çdo aktivitet, dhe tani kërkesa po zvogëlohet. Pavarësisht se gjatë këtyre tre muajve në Shqipëri numri i rasteve është vetëm 1263 persona, nga të cilët 34 persona kanë vdekur, kështu që dimensionet nuk mund të jenë në krahasim me vendet e tjera, ekonomitë e globalizuara dhe zinxhirët e furnizimit të integruar bëjnë që pasojat ekonomike të shtrihen në të gjithë botën.

Fjalë kyçe: covid-19, zinxhirët e furnizimit, kërkesa, politika monetare, stimulimi fiskal.

Abstract

Assessing the economic impact of pandemic Covid-19 it is essential for policy makers, but challenging because the crisis has unfolded with extreme speed and we are still unsafe of its duration. Two of the most severe consequences of Covid-19 are large losses in people and contracting economic activity. Initially, this pandemic hit the supply, suspending any activity, and now the demand is shrinking. Despite the fact that during these three months in Albania the number of cases is only 1263 people, of which 34 people have died, so the dimensions cannot be compared to other places, globalized economies and integrated supply chains cause the economic consequences to extend all over the world.

Keywords: covid-19, supply chains, demand, monetary policy, fiscal stimulus.

Hyrje

Coronavirus është një tragjedi njerëzore me pasoja të rënda në të gjithë fushat e jetës. Ndikimi në ekonomi si pasojë e virusit është një sfidë e pashmangshme për të gjithë botën por thellësia e kësaj krize ende nuk mund të matet me shifra konkrete sepse çdo gjë varet nga rrethanat sesi do të vazhdoi situata. Për një gjë jemi të sigurt që variablat përshkrues të ekonomisë kanë filluar të bien. Vlerësimi i këtyre efekteve ekonomik është i rëndësishëm për të ndihmuar marrjen e masave se më efektive dhe në mënyrë të menjëhershme. Për të bërë vlerësim në këtë punim ne do të përdorim historinë e pandemisë dhe pasojave që ato kanë shkaktuar për vite me radhë. Në përgjigje të rrezikut të pandemisë, firmat pavarësisht nga lloji ishin të detyruara të mbylleshin. Ekonomia ndali papritur dhe çdo gjë pushoi së funksionuari. Por çdo ditë pune e munguar për sektorin privat do të thotë humbje. Nga ana tjetër kjo humbje do të vazhdojë edhe gjatë kohës kur po mendohet se gradualisht po i kthehem hapjes. Kjo ndodh pasi kërkesa është tkurrur.

Pra në rastin me të mirë bizneset do të hapen dhe do të fillojnë aktivitetin, duke supozuar që kanë arritur të mbulojnë shpenzimet gjatë kohës së pezullimit të aktivitetit. Por në kushte kur kërkesa është tkurrur kompanitë do të vazhdojnë të përballen me humbje të ardhurash gjë që mund ti cojë në faliment ose në reduktim të punonjësve. Për çdo vend njëmbjllje aktiviteti do të thotë reduktim i bazës fiskale, me pak të ardhura në buxhetin e shtetit. Ndërsa reduktim i fuqisë puntore do të thotë zgjerim i shtresës me nevoja për mbështetje financiare. Ndaj sfida e sotme për çdo shtet është të vendosë fonde në dispozicion me mënyra sa më transparente, të

reduktioi detyrimet fiskale bizneseve me qëllim mbrojtjen e punësimit dhe mbështetjen e aftësisë prodhuese të bizneseve për të nxitur rimëkëmbje.

Rishikim i pandemive ndër vite

Për të vlerësuar ndikimet e mundshme të virusit COVID-19 në aktivitetin ekonomik mund të shfrytëzohet të dhënat nga pandemitë e tjera të përjetuara në botë. Studimet mbi epidemitë e kaluara identifikojnë një numër kanalesh përmes të cilave mund të lindin kostot ekonomike dhe sesi ato transmetohen në gjithë zinxhirin e aktiviteteve ekonomike. Gripi i vitit 1918 përgjithësisht konsiderohet si epidemia më e kushtueshme e cila preku rreth 500 milion njerëz në 184 vende zgjati 24 muaj dhe mori 50 milion jetë njerëzish dhe vecanerisht të rinj. Në ekonomi kjo do të thotë humbje e fuqisë punëtore prodhuese. Në një studimin të bërë nga Fan et al (2016) u zbuloni se, në rastin e pandemisë së gripit të vitit 1918, kostoja më e rëndësishme ishte vdekshmëria dhe zvogëlimi i forcës së punës. Një ulje e njëfishtë e forcës së punës do të rrisë raportin e kapitalit të punuar dhe ul shkallën e kthimit në kapital, duke ngadalësuar ritmin e grumbullimit të kapitalit dhe rritjes së PBB-së për shumë vite.

Në një studim tjetër të bërë nga Jordà et al (2020) mbi studimin e efekteve të 12 epidemive kryesore në Evropë që shtrihen në shekullin XIV treguan edhe një tjetër component të rëndësishëm. Rezultati ishte nga rritja e pasigurisë së konsumatorit për të ardhmen e nxiste atë të rriste kursimet duke reduktuar sa mundej shpenzimet ndërsa investimet u bllokuan. Në dallim nga luftrat ku dëmtohet kapitali fizik gjatë pandemive kemi një akumulim të kapitalit të tepërt për të përballuar të ardhmen e pasigurt. Por ajo që e bënë edhe më të vështirë situatën e kësaj pandemie është përhapja e shpejtë duke pezulluar cdo gjë nga sot nesër. Hapja ekonomike, politike dhe bashkepunimi i ngushtë ndërkombëtar midis vendeve ka çuar në transmetim shumë më të shpejtë se pandemitë e kaluara. Përvojat nga recesionet e kaluara sugjerojnë që këto plagët në strukturën ekonomike do të jenë të thella (Eichengreen (2020)).

Në vitin 2003 në Kinë u shfaq SARS, i cili infektoi një numër më të vogël njerëzish, 8,096 të prekur, me rreth 774 vdekje, ishte shumë më pak e përhapur, por në mënyrë të konsiderueshme më vdekjeprurëse sesa Gripi Spanjoll, sepse shkalla e saj e vdekshmërisë ishte prej gati 10%. Në katër vendet më të prekura (Hong-Kong, Kinë, Singapor dhe Tajvan), prodhimi ra me 0.5-1.1% të PBB. Industria që u godit më shumë nga SARS ishte turizmi, duke u përballur me një humbje të të ardhurave prej rreth 80% krahasuar me vitin e kaluar, ndërsa agjencitë e udhëtimit, linjat ajrore, restorantet, shitjet me pakicë dhe transporti panë një rënie të të ardhurave 10-50%.

Në vitin 2013 u përhap Ebola, e cila preku 28.616 njerëz dhe çoi në 11.310 vdekje në Guineja, Liberi dhe Sierra Leone. Shkallat e vdekshmërisë së këtij virusi ishte 40% e të prekurve dhe zgjati dy vjet. Ebola shënoi humbje vjetore të PBB-së prej 5% në Guineja, 7% në Liberi dhe mbi 20% në Sierra Leone.

Koha mesatare, që prodhimi të rikthehej në nivelet e para-shpërthimit në shtatë vendet e goditura më shumë nga tre shpërthimet virale të mësipërme ishte tre vjet.

Efektet ekonomike të Covid -19

Pandemia e Covid-19 është pikësepari kriza më serioze shëndetësore globale e përjetuar që nga 1918. Humbja më e madhe dhe e pakthyeshme është ajo e jetës së njerëzve të cilët në mënyrë dramitike u shuan larg përkujdesjes së familjarëve të tyre. Por edhe nga pikëpamja ekonomike besoj se është një nga pandemitë më të kushtueshme në historitë e fundit. Ndikimi ekonomik i Covid-19 është një sfidën e pashmangshme për të gjithë botën madje thellësia e kësaj krize varet dhe mund të ndryshoi në varësi të rrethanave që ndryshojnë me shpejtësi. Kjo pandemi bllokoi jetën dhe ekonominë e botës në mënyrë të menjëhershme. Kostot makroekonomike mund të materializohen përmes efekteve në ofertë dhe kërkesë. Në përgjigje të rrezikut të pandemisë, firmat pavarësisht nga lloji ishin të detyruara të mbylleshin. Kështu punëtorët mbeten pa punë për ditë por edhe muaj të tërë që do të thotë me pak ditë pune dhe me pak ose 0 produktivitet për firmat. Mallrat stok, kostot fikse që pavarësisht nivelit të aktivitetit rëndojnë

mbi financat e bizneseve, punonjësit pa punë por jo për shkak të tyre do të thotë që çdo ditë mbyllje rregjistron vetëm shpenzime për firmat. Në fund të marsit, OECD vlerësoi se mbylljet në shkallë të gjerë do të rezultojnë në një humbje të PBB-së prej rreth 20-25% për çdo muaj që ata mbesin në vend, duke nënkuptuar se një tre-muaj mbyllje do të shkaktonte një rënie prej 5-7% të PBB-së vjetore. Në këto rrethana pasiguria e biznesit është rritur në mënyrë dramatike. A mund të rezistojnë financiarisht kur edhe kërkesa është tkurrur masivisht?! Pra mbyllja ekonomike e zgjatur dhe reduktimi ndjeshëm i kërkesës për shkak të pasigurisë së konsumatorit për të ardhmen në mënyrë të pashmangshme do të sjellë falimentim të shumë firmave. Kjo do të shoqërohet me efekte të tjera negative duke prishur zinxhirët e furnizimit të firmave që mbijetojnë dhe duke rritur papunesinë.

Ndërprerja e zinxhirit të furnizimit është jo vetëm një problem për vazhdimësinë e veprimtarisë së firmave të mbijetuara, por mund të përkthehet edhe në një problem jetik për ato vende ku mallrat e shportës bazë importohen. Në Shqipëri niveli i produkteve që importohen, produkte bazë, është shumë i lartë. Kështu që ndërprerja e marrëdhënieve me jashtë nga njëra anë dhe mungesa e fabrikave në vend për të nisur prodhimin brenda vendit do ta vendoste vendin në vështësi për furnizime jetike e do të paralizonte veprimtarinë e shumë aktiviteteve që marrin lëndë të parë a produkte të gatshme nga jashtë.

Një tjetër pasojë që po përjeton ekonomia botërore është rënie në çmimet e aksioneve, rritja e paqëndrueshmërisë së çmimeve të tyre dhe ulja e normës nominale të interesit.

Një nga sektoret me kontribut të konsiderueshëm në PBB është sektori i shërbimeve dhe në veçanti turizmi. Ky mendohet do të jetë një nga sektoret që do ta përjetojë më rëndë pasojat e pandemisë. Ashtu siç është treguar edhe nga pandemitë e mëparshme në situatë të tilla konsumatori priret të bëhet me racional në zgjedhjet e tij duke reduktuar në maksimum shpenzimet dhe nxitur kursimet. Aktivitetet argëtuese, udhëtimet shpenzimet e luksit nuk janë pjesë e planifikuar për tu përballuar nga buxheti i konsumatorëve.

Në kushte të gjendjes së fatkeqësisë natyrore një nga pasojat që do të rëndoi buxhetin e shtetit është rritja e shpenzimeve publike. Këto shpenzime janë të domosdoshme për shëndetësinë, për shtresat në nevojë dhe për të mbështetur biznesin për rimëkëmbjen ekonomike. Këto shpenzime duhet të përvetësohen nga bilancet e qeverisë për të mbrojtur qytetarët dhe ekonominë. Detyra e shtetit është gjithmonë ta bëjë këtë përballë urgjencave kombëtare. Shqetësimi i vërtetë në këndvështrimin e ekonomistëve nuk është sigurimi i të ardhurave njerëzve por mbrojtja e njerëzve nga humbja e punës. Pra në i njohim efektet që do të sjellë pandemia nga humbjen dramatike të të ardhurave të bizneseve por mbrojtja e punësimit dhe e aftësisë prodhuese janë thelbësore për të kapërcyer krizën. Në mungesë të masave mbështetëse humbjet e akumuluar rrezikojnë shkatërimin e kapacitetit prodhues të bizneseve dhe rrjedhimisht edhe të bazës fiskale për ekonominë e vendit. Çdo njësi e mbyllur do të thotë më pak të ardhura për buxhetin e shtetit dhe më shumë të papunë që do të përfshihen në skemat e ndihmave sociale. Të vënë përballë një krize globale të sinkronizuar të likuiditetit, qeveritë mund të kenë nevojë të drejtohen te Bankat e tyre Qendrore për likuiditetin e nevojshëm. Banka Qendrore duhet që përmes normave të interesit të ndryshojnë politikën monetare para se vendi të futet në një kurth deflacionist i cili do të bënte format tradicionale të politikës monetare joefikase.

Inflacioni do të jetë një problem që do të shoqëroi ekonominë në këtë periudhë pas mbylljes masive. Po ti referohemi të dhënave të Instat muaji maji ka shënuar një rritje të përgjithshme të çmimeve në vend, rritje kjo e ndikuar kryesisht nga grupi 'Ushqime dhe pije joalkoolike'.

Pandemia do të ndikojë edhe në nivelin e investimeve të huaja. Siç e dimë Kina është një nga thithësit kryesor të flukseve të investitoreve të huaja për shkak të fuqisë së lirë puntore. Shpërthimi i pandemisë pikërisht në Kinë dhe pasiguria për të ardhmen pa dyshim që ndikon në tërheqjen e investitoreve të huaja. Por kjo mund të shihet si një aspekt pozitiv për ne, duke patur një pozitë gjeografike të favorshme në Europë dhe mbi të gjitha një fuqi të lirë puntore mund të tërheqim vëmendjen e investitoreve të huaja.

Efektet sociale

Pandemia ka një tjetër efekt po kaq të rëndësishëm, ndikimin në psikologjinë e njeriut. Kjo pandemi solli një transformim të menjëhershëm në stili e jetës së gjithësecilit. Izolimi për një kohë të zgjatur, ndërprerja e çdo lloji aktiviteti në mënyrë të pashmangshme influencon në sjelljen njerëzore. Kjo sjellje rendohet edhe me shume nga perjetimi i rrezikut të humbjes së jetës nën presionin e lajmeve dhe informacioneve për kaosin e krijuar në gjithë botën.

Një tjetër efekt përjetoi arsimit. Të gjithë jemi të vetëdijshëm për vështësitë e përjetuara për t'iu adaptuar mënyrave të reja të zhvillimit të mësimin. Për më tepër situata e rënduar detyroi marrjen e masave ekstreme, atë të liritimit të të burgosurve. Kjo mund të jetë një domosdoshmëri për shkak të gjendjes së burgjeve tona por kjo rrit rrezikun e kriminalitetit, mundësinë e vetëgjyqësisë por edhe vënien bashkë të dhunuesit me viktimën në rastin e dhunës në familje.

PËRFUNDIME

1. Ndikimi ekonomik i Covid-19 është një sfidën e pashmangshme për të gjithë botën por thellesia e kësaj krize varet dhe mund të ndryshoi në varësi të rrethanave që ndryshojnë me shpejtësi.

2. Shkalla e ulët e vdekshmërisë së Covid-19 për popullatën e re duhet të ndihmoi në zbutjen e humbjes së fuqisë punëtore dhe efektet në prodhimin e mundshëm.

3. Do të duhet më shumë kohë që të kthehemi "normalitetit" dhe e ardhmja ekonomike padyshim që do të jetë sfiduese.

4. Politika optimale për t'u përballur me pandeminë do të ishte një kombinim i politikës fiskale me atë monetare për të mbështetur ndërprerjen e furnizimit dhe reduktimin e kërkesës.

5. Shqetësuese është mënyra sesi shteti do mund të garantojë likuiditet normal në një situatë jonormale të ngjashëm me luftën me një armik të padukshëm. Për të mbrojtur punësimin dhe aftësinë prodhuese në një kohë të humbjes së të ardhurave në mënyrë dramatike mbështetja e likuiditetit është thelbësore.

6. Pasiguria për vazhdimësinë e pandemisë, bllokimi i fluturimeve ka frenuar në mënyrë të konsiderueshme investimet e huaja. Për Shqipërinë, duke qenë se jemi një vend i prekur relativisht lehtë i matur nga numri i vdekjeve, situatë e shkaktuar nga Covid 19 mund të përdoret për tërheqjen e investitoreve të huaj. Jemi një vend me një pozicion të favorshëm gjeografik dhe me fuqi punëtore të lirë.

7. Pasojat e pandemisë janë shtrirë edhe në fushën e arsimit. U tentua përdorimi teknologjisë për dicka eficientë por të gjithë jemi të vetëdijshëm për vështësitë e këtij viti shkollor si për mësuesit dhe për nxënësit, veçanërisht për ata me pamundësi ekonomike për t'iu adaptuar një sistemi të tillë.

Bibliografia

- Barro, R, J Ursua and J Weng (2020): "The coronavirus and the Great Influenza Pandemic: lessons from the 'Spanish flu' for the coronavirus' potential effects on mortality and economic activity",
- Dimitris K. Chronopoulos, Marcel Lukas, John O.S. Wilson, Qershor 2020, "Consumer Spending Responses to the COVID-19 Pandemic: An Assessment of Great Britain"
- Wen Hai & Zhong Zhao & Jian Wang & Zhen-Gang Hou, 2004 "The Short-Term Impact of SARS on the Chinese Economy"
- Brahmabhatt, M., and A. Dutta, 2008 "On SARS Type Economic Effects During Infectious Disease Outbreaks"
- V. Guerrieri, G. Lorenzoni, L. Straub, I. Werning, 2020 : "Macroeconomic implications of covid-19: can negative supply shocks cause demand shortages?"
- Scott R. Baker, Nicholas Bloom, Steven J. Davis, Stephen J. Terry, 2020, "COVID-Induced Economic Uncertainty"

- Maddison, Angus, 2010, " Historical statistics on world population, GDP and Per Capita GDP, 1-2008"
- <http://www.instat.gov.al/al/covid-19-statistikat/>
- <https://it.tradingeconomics.com/albania/icu>

POLITIKAT MAKROEKONOMIKE TË APLIKUARA PËR DALJEN NGA KRIZA SANITARE COVID-19, RAST STUDIMI KANADA, JAPONI DHE KOREJA E JUGUT

Dr. Valter Hoxha
Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë
valter.hoxha@umsh.edu.al
Dr. Florjan Bombaj
Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë
florjan.bombaj@umsh.edu.al
Dr. Majlinda Shehu
Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë
majlinda.shehu@umsh.edu.al

Abstrakt

Pandemia sanitare e Covid-19 ka shkaktuar gati për të gjitha vendet e prekura në botë, një krizë ekonomike dhe financiare e cilësuar nga shumë ekonomistë, si kriza më e madhe që prej vitit 1929 apo e ashtuquajtur "Depresionit i Madh". Shumica e sektorëve ekonomikë u paralizuan. Ekonomia u përball me një "shok" si nga krahu i ofertës ashtu edhe nga ana e kërkesës. Problemi i pandemisë ende nuk ka përfunduar. Për të përballuar krizën dhe ristartuar ekonominë, vendet e prekura kanë aplikuar një sërë politikash makroekonomike të cilat bazohen mbi teoritë e mendimit ekonomik keynesian apo monetarist. Bazuar në specificitetin e kësaj krize, hipoteza jonë është se politikat e aplikuara makroekonomike kanë impakt të dobët në nxitjen e rritjes ekonomike. Për verifikimin e saj, ne kemi marr në studim paketat makroekonomike të zbatuara në tre shtete të zhvilluara : Kanada, Japoni dhe Koreja e Jugut. Rezultatet tregojnë për të treja shtetet, se këto politika kanë mundur të frenojnë rënien ekonomike por jo të japin një impkat real në rritjen e saj. Ne rekomandojmë një politikë ekspansioniste fiskale të kombinuar me një politikë neokejnesiane ku qeveria të financoj shpenzimet e saj nëpërmjet borxhit familjar.

Fjalë kyçe: Kriza ekonomike; Covid-19; Politika makroekonomike; Kanada; Japoni; Koreja e Jugut

Abstract

The Covid-19's sanitary pandemic has caused for almost all countries in the world, an economic and financial crisis described by many economists as the biggest crisis since 1929, when the world experienced what is called the "Great Depression". Most economic sectors were paralyzed. The economy faced a "shock" both in terms of supply and demand. The pandemic problem is not over yet. To cope with the crisis and restart the economy, the affected countries have applied a range of macroeconomic policies based on the theory of Keynesian or monetarist economic thought. Based on the specificity of this crisis, our hypothesis is that applied macroeconomic policies have a weak impact on fostering economic growth. To verify it, we have studied the macroeconomic packages implemented in three developed countries: Canada, Japan and South Korea. The results for these three countries show that these applied policies have been able to curb the economic decline but not give a real boost to its growth. We recommend a fiscal expansionary policy combined with a neo-Keynesian policy where the government finances its expenditures through the family debt.


Keywords: Economic crisis; Covid-19; Macroeconomic policy; Canada; Japan; South Korea

1. HYRJE

Edhe pse kriza sanitare e Covid-19, kishte filluar që prej fillimit të janarit 2020, rrezikun e tij serioz, shtetet më të prekura si Italia, filluan ta ndjenin nga fundi i muajt shkurt dhe fillimi i muajt mars. Ishte pikërisht data 11 mars ku Organizata Botërore e Shëndetësisë e cilësoi zyrtarisht përhapjen e virusit Covid-19 si pandemia botërore. Deri në fillim të qershorit, sipas bazës së të dhënave të Qendrës Universitare të Johns Hopkins për Shkencë dhe Inxhinieri të

Sistemeve¹⁰por edhe nga OBSH-ja (Organizata Botërore e Shëndetësisë) (figura 1), numri i të prekurve është mbi 7 milionë nga ku regjistrohen mbi 400.000 të vdekur.

Figura 1. Numri i rasteve të konfirmuara me Covid-19 sipas rajoneve në botë.



Burimi : Organizata Botërore e Shëndetësisë, Qershor 2020¹¹

Evolucioni i kurbës së të prekurve apo të diagnostikuar me Covid-19 në nivel global, është në rritje eksponenciale. Por sot, rajonet më problematike që rrezikohen më shumë, janë vendet Evropiane dhe ato të Amerikës së Veriut ku regjistrohet gati 80% e të prekurve dhe mbi 75% të të vdekurve.

Sipas ish Shefit të FMN-së Dominique Strauss-Kahn, kjo krizë sanitare nuk është një lloj si krizat që kanë kaluar, (Strauss-Kahn, 2020). Kjo krizë sanitare në nivel botëror, prodhoi një tjetër krizë ekonomike, ku dhe sipas shumë ekonomistëve, mund të klasifikohet si kriza më e madhe që prej Depresionit të Madh të vitit 1929. Në të vërtetë kjo pandemi siç e quan me të drejtë OBSH-ja, ka goditur gati të gjithë sektorët e ekonomisë botërore. Nga njëra anë, rritja eksponenciale e të prekurve detyroi qeveritë të marrin masa drastike duke mbyllur kufijtë e jashtëm (Jin Wu, et al., (2020). Ndërsa nga ana tjetër, masat për mbrojtjen nga përhapja e virusit nëpërmjet karantinimit, krijuan një bllokim të bizneseve (Peterson & Thankom, 2020).

Jemi nisur nga një goditje në krahun e ofertës, për shkak të rënies së prodhimit gjeneruar nga mungesa e fuqisë punëtore e cila u izolua nga karantina për të paktën 2 muaj. Ky "shok" padyshim, preku të gjithë sektorët ekonomikë. Në krahun tjetër, kjo krijon një goditje në krahun e kërkesës. Mungesa e të ardhurave për familjet nga njëra anë si dhe izolimi brenda në shtëpi, bëri që të kemi një rënie konsumi dhe për rrjedhojë një rënie të ardhurash apo arkëtimesh. Ky cikël shumë i njohur për ekonomistët çon ekonominë e vendit në recesion (Strauss-Kahn, 2020).

Sot, ekonomitë e gati të gjitha vendeve janë shumë të ndërvaruar midis tyre dhe mbyllja e menjëhershme shkaktoi "tërmet" në tregjet ekonomike dhe financiare (Sułkowski, 2020). Në tregun botëror, Kina përfaqson një prej furnizuesve kryesorë në lëndë të parë. Kështu për shembull, gati 70% e lëndës së parë, për industrinë farmaceutike, varet nga Kina. Vetëm për Hondën, Ëuhan përfaqson 50% të prodhimit total në Kinë. Ajo është gjithashtu një eksportuese kryesore edhe e lëndëve të para për prodhimin e materialeve elektronike dhe të

¹⁰<https://gisanddata.maps.arcgis.com/apps/opsdashboard/index.html#/bda7594740fd40299423467b48e9ecf6>

¹¹<https://covid19.who.int/>

telekomunikacionit, për industrinë e automobilitetit etj. Por Kina është edhe një prej importuesve kryesor të lëndëve të para dhe të produkteve finale ku vetëm për vitin 2018, ajo ka shpenzuar një shumë prej 500 miliardë dollarë¹². Sipas Jean Pisani-Ferry, këshilltar ekonomik i Presidentit francez Macron, nëse në 2008 kishim një krizë financiare që goditi ekonominë reale, sot kemi një krizë sanitare që godet ekonominë financiare¹³.

Në muajt mars gati të gjitha bursat botërore qoftë ato amerikane, europiane apo aziatike, u goditën tepër rëndë¹⁴. Kështu, kompanit më të mëdhaja që përbëjnë gati ¼ e GDP amerikane (mbi 4000 miliardë dollarë), Facebook, Amazon, Apple dhe Google, patën rënie me një mesatare prej -6 % ose e përkthyer në vlerë monetare 240 miliardë dollarë humbje për aksionerët. Në Europë, edhe pse Guvernatoria e BOE (Bankës Qëndrore Europiane) Christine Lagarde, doli me një deklaratë pozitive për një manovër në tregun e titujve, ajo nuk i ka bindur tregjet ku bursa e Milanos mbyllet me -16%, Madrid (-14,6%), Frankfurti dhe Parisi (-12,2%), Londra (-10,9%)¹⁵.

Një parashikim pesimist i rritjes ekonomike në nivel botëror

Edhe në muajt prill dhe maj, impakti i kësaj krize sanitare ka bërë që rritimi i rritjes ekonomike të ulet (De Vijlder, 2020). Sipas FMN-së, parashikimet për vitin 2020 të PBB-së, në nivel botëror është -3%. Sipas rajoneve zona Evropiane mbetet më e goditur me një rënie prej -7.5% e shoqëruar nga USA me -5.9%, Amerika Latine me -5.2%, Lindja e Mesme dhe Azia Qëndrore me -2.8%, Afrika Sub-Sahariane me -1.6% dhe në fund, Vendet në zhvillim të Azisë me një rritje tepër të vogël prej 1% (figura 2).

Në këtë kontekst, me qëllim frenimit të kësaj rënie dhe ristartimit të rritjes ekonomike, pyetja që ne shtruan është : çfarë politike makroekonomike duhet të aplikojnë qeveritë e këtyre shteteve të prekura?


Figura 2. Parashikimet e impaktit të Covid-19 në rritjen ekonomike botërore dhe rajonale për vitin 2020 dhe 2021

¹²<https://www.ispionline.it/it/pubblicazione/le-conseguenze-del-coronavirus-sulleconomia-globale>

¹³https://www.lemonde.fr/economie/article/2020/03/12/coronavirus-ce-n-est-pas-le-moment-d-economiser-pour-jean-pisani-ferry_6032746_3234.html

¹⁴<https://fr.investing.com/indices/major-indices>

¹⁵<https://fr.investing.com/indices/major-indices>



Burimi : FMN, Prill 2020¹⁶

Në vazhdim të këtij artikulli do të trajtojmë kuadrin teorik në lidhje me mendimin ekonomik në rastet e krizave. Në pjesën e tretë metodologjia shpjegon mënyrën e mbledhjes së rezultateve që analizohen në pjesën e katërt të këtij artikulli. Pjesa e pestë diskuton rezultatet dhe tenton t'i japë përgjigje hipotezës sonë fillestare.

2. KUADRI TEORIK

Për të zgjidhur këto kriza ekonomike, paradigma ekonomike ndahet midis dy rrymave dominante: mendimit ekonomik kejnesian i cili propozon një stimulim të kërkesës nëpërmjet ndërhyrjes së shtetit në ekonomi, dhe mendimit neoklasik dhe neoliberal i cili e shikon zgjidhjen në stimulimin e ofertës. Në krizat e mëparshme, historia ka treguar që qeveritë nëpërmjet mendimit ekonomik kejnesian mund të ristartojnë motorin ekonomik. Mjaftojmë të kujtojmë ndërhyrjen mbas Depresionit të Madh të 1929, të Qeverisë Amerikane të Presidentit Franklin D. Roosevelt, ose pas luftës së Dytë Botërore, ku qeveritë aplikuan teorinë kejnesiane përrindërtimin e vendeve të tyre. Pas viteve 1970, shikohet një mosfunksionim i kësaj politike makroekonomike dhe ekonomia botërore preket nga dy kriza botërore (vitet 1973 dhe 1979) të mundësjes së ofertës së arit të zi, nafta, të cilat duke filluar pas viteve 1980, i hapin rrugën aplikimit të rrymës tjetër ekonomike monetariste dhe neoliberale të përfaqësuara nga Shkolla e Çikagos (Strauss-Kahn, 2020). Aplikimi i kësaj teorie u shoqërua me ndryshime të mëdha politike dhe ekonomike. Në vitin 1991, kemi fundin e bllokut të Lindjes (URSS), dhe më pas në


¹⁶<https://www.imf.org/en/Publications/WEO/Issues/2020/04/14/weo-april-2020>

2008 kemi një krizë të madhe interbankare e shoqëruar me humbje të mëdhaja financiare (FMN, 2009).

Kjo krizë tregoi se politika monetariste konvencionale nëpërmjet përdorimit të levës monetare nga Bankat Qendrore duke ulur normën e interesit nuk ka arritur të nxis investimet apo kërkesën agregate. Përdorimi i politikës monetariste jo konvencionale nëpërmjet instrumentit "Quantitative Easing" (QE) nga Banka Qendrore Amerikane (FED) (Engen, *et al.*, 2015) dhe Banka Qendrore e Anglisë (Breedon *et al.*, 2012), prodhuan rezultate pozitive qoftë në ristartimin e ekonomisë qoftë edhe në stabilizimin e tregjeve bursiere ku rënie dhe rritja ishte e formës "V" (Balatti, *et al.*, 2016). Ky instrument konsiston në blerjen nga ana e bankave qendrore të titujve të pronësisë (bono thesari dhe obligacione shtetërore) bankave të nivelit të dytë me qëllim rritjen e mundësisë së kapacitetit kredidhënës të këtyre të fundit (Lim *et al.*, 2016). Problemi i dekadës së fundit qëndron se ekonomia e vendeve të zhvilluara është futur në atë që ekonomisti amerikan Lawrence Henry Summers, e quan periudhë ekonomike "stacionare shekullore" (Summers, 2014). Kjo shikohet edhe tek rritja ekonomike e vendeve kryesore si Gjermani Francë apo Itali, e cila rrotullohet midis 1% në këta dhjetë vitet e fundit. Këtij stanjacioni apo rritje mediokre siç e quan drejtuesjaaktuale e BQE Christine Lagarde, ju bashkua edhe kriza sanitare e Covid-19.

Për të dal nga kjo krizë, qeveritë e vendeve të prekura kanë marr situatën në dorë duke theksuar se në mënyrë direkte dhe indirekte, do të ndihmojnë tregjet ekonomike dhe financiare nëpërmjet aplikimit të paketave fiskale stimuluese. Në raport me PBB, Japonia zë vendin e parë me 21.1 %, e ndjekur nga SHBA-ja 11% të PBB-së, pastaj Australia dhe Kanadaja me 9.9% dhe 9.8 %, për të përfunduar me Italinë në fund me 4.6% (figura 3).

Figura 3. Pësia në raport me PBB-së të vitit 2019, e paketave stimuluese fiskale të vendeve G20, për të përballuar COVID-19.




Burimi : Dufin, Maj 2020¹⁷

E përkthyer në shifra më konkrete, sipas statistikave të Bruegel¹⁸ deri në 25 maj të 2020, Gjermania ka një plan financimi prej 1600 miliardë eurosh ose afërsisht 47% të PBB, Italia 780 miliardë euro ose afërsisht 44% të PBB që përbëhen më shumë nga shtyrjet e barrës fiskale dhe fondi i garancisë për kreditim ose 91% të totale. Plani francez zë 25.6% të PBB i cili përbëhet prej 88 miliardë euro financim direkt (shëndetësi, papunësi, fond solidaritetit etj.) dhe 338 miliardë euro për garanci kredish bankare. Ndryshe ndodh me planin amerikan i cili zë 14.3% të PBB por që 9% janë financim i menjëhershëm (figura 4).

Figura 4. Ndihmat ekonomike të ndërmarra nga shtetet nëpërgjigje të krizës së COVID-19, të shprehura në % ndaj PBB-së të vitit 2019.

¹⁷<https://www.statista.com/statistics/1107572/covid-19-value-g20-stimulus-packages-share-gdp/>

¹⁸<https://www.bruegel.org/about/>



Burimi : Bruegel¹⁹, Maj 2020

Padyshim këto paketa kanë rritur në mënyrë të konsiderueshme shpenzimet qeveritare dhe për rrjedhojë borxhin publik në raport me PBB.

Paralel me paketat ekonomike të qeverive kanë vepruar edhe Bankat Qëndrore duke aplikuar politikë monetare konvencionale dhe jo konvencionale ekspansioniste. Kështu FED në SHBA, BoJ në Japoni, BQ në Kanada, BQ në Angli apo BCE, kanë ulur normën REPO nën 1% : BQ e Kanadas 0.25, FED e SHBA 0.25, BQ e Korejsë së Jugut 0.75%, BoJ e Japonisë -0.1. Në krahun tjetër, për të rritur likuiditetin në treg, në 18 mars të 2020, BCE lajmëron një program të blerjes së titujve shtetërorë për një shumë prej 750 miliardë eurosh (Strauss-Kahn, 2020).

Gjithsesi, qoftë politikat monetare ekspansioniste qoftë edhe politika fiskale qeveritare, në rastin e kësaj krize sanitare, kanë limitet e tyre. Ne mendojmë se aplikimi i këtyre politikave makroekonomike, prej vendeve të prekura që operojnë me ekonomi tregut, për zgjidhjen e kësaj krize ekonomike në kushtet e krizës sanitare, mbetet gjithmonë një hipotezë për tu verifikuar..

3. METODOLOGJIA

Për verifikimin e hipotezës së kërkimit, ne kemi përdorur metodë krahasuese midis dy dy periudhave ekonomike, para dhe përgjatë pandemisë Covid-19. Në fakt, të dhënat e indikatorëve makroekonomikë përgjatë pandemisë Covid-19 i krahasuam me të dhënat e indikatorëve makroekonomikë të tremujorit të fundit të vitit 2019. Përsa i përket të dhënave historike për evolucionin e Covid-19, para 14 Marsit 2020, burimi ka qënë nga Qendra Universitare e Johns Hopkins për Shkencë dhe Inxhinieri të Sistemeve, e cila bazohet pjesërisht në raportet ditore nga Organizata Botërore e Shëndetit e Kombeve të Bashkuara (OBSH)²⁰. Hulumtimi ishte i literaturës mbi impaktin ekonomik të krizës së Covid-19 që përmbledh periudhën që prej janarit deri në maj të këtij viti.

Ndërsa identifikimi i politikave makroekonomike si një përgjigje ndaj impaktit të masave sanitare të implementuara nga qeveritë e vendeve të prekura, u bazua në të dhënat ekonomike dhe financiare qoftë në publikimet e faqeve zyrtare të internetit të ministrive të ekonomisë dhe

¹⁹<https://fr.statista.com/infographie/21476/comparaison-pays-aides-economiques-plans-de-sauvetage-crise-coronavirus/>

²⁰<https://covid19.who.int/region/amro/country/ca>

financave, por edhe nga bazat e të dhënave të faqeve të internetit të institucionet serioze ndërkombëtare²¹. Mbi këto statistika ne analizuam edhe impaktin e këtyre politikave. Hapi i fundit sihteseleksionimi i shteteve të cilët janë të prekur nga pandemia. Kështu, në mënyrë empirike, ne përzgjedhëm në studim politikat makroekonomike të tre shteteve të zhvilluara: Kanada, Japoni dhe Koreja e Jugut. Padyshim, kufizimi në tre shtete është edhe një prej limiteve të këtij studimi.

4. REZULTATET

4.1. Situata e Covid-19 në Kanada, Japoni dhe Koreja e Jugut : dy trende të ndryshme

Në figurën 5 është paraqitur për periudhën 15 shkurt deri në 31 maj, evolucioni ditor i numrit të të prekurëve dhe numri i të vdekurëve nga Covid-19, për të tre shtetet që kemi marrë në analizë: Kanada, Japoni dhe Koreja e Jugut. Ashtu si tregojnë edhe grafikët, Japonia dhe Koreja e Jugut kanë një evolucion pak më ndryshe se Kanadaja. Ato ishin ndër vendet e para që u kërcënua nga Covid-19 për arsye jo vetëm gjeografike, Japonia është në kufi me Kinën, por edhe sepse një pjesë e mirë e shkëmbimeve tregëtare i realizon me këtë vend.

Koreja e Jugut është vendi i dytë në botë që preket mbas Kinës për arsye ekonomike dhe gjeografike. Vendi e fillon krizën në shkurt por piku i saj arrin në fund të shkurtit dhe në fillim të muajit mars me një mesatare prej 700 të prekurish në ditë. Në total deri në fund të majit rezultoi në 11503 të prekur dhe 271 të vdekurish me Covid-19. Fal masave inteligjente në zbatimin e rregullave sanitare, autoritetet e vendit ka vendosur nën kontroll krizën²². Aktualisht edhe pse kanë një numër shumë të vogël të prekurish autoritetet e Koresë së Jugut ende refuzojnë të shpallin fitoren në betejën e tyre kundër epidemisë Covid-19. Por, që prej 6 maj vendosën të rifillojë, një jetë gati normale²³. Suksesi mbështetet gjithmonë në numrin e testeve duke shpenzuar miliona dollarë në teknologjinë e re ku nëpërmjet programeve të kontrollit dhe gjurmimit, arrin të identifikojnë në kohë reale personat e infektuar²⁴.


Figura 5. Evolucioni i numrit të të prekurëve dhe të viktimave prej pandemisë Covid-19 për shtetet Kanada, Japoni dhe Koreja e Jugut, periudha 15 shkurt deri 31 maj.

²¹<https://tradingeconomics.com/canada/stock-market>.

²²<https://www.ccifrance-international.org/le-kiosque/covid-19/n/nees/covid-19-coree-du-sud-combattre-le-virus-et-preserver-ses-entreprises-la-strategie-coreenne.html>

²³<https://www.lesechos.fr/monde/asie-pacifique/coronavirus-apres-avoir-mate-lepidemie-sans-confinement-la-coree-du-sud-passe-a-la-distanciation-de-routine-1200787>

²⁴<https://www.businessinsider.com/coronavirus-south-korea-tech-contact-tracing-testing-fight-covid-19-2020-5>



Burimi : *përpunuar nga autorët, bazuar në të dhënat e OBSH-së, 2020*²⁵.

Ndërsa Japonia u kërcënua nga Covid-19 nga mesi i janarit, por në datë 9 mars, Kryeministri Shinzo Abe thekson se situata e krijuar është serioze, numri i rasteve me koronavirus në Japoni tejkaloi 1100, atëherë që vendi përgatitet të organizojë Lojërat Olimpikë të verës në korrik dhe gusht²⁶. Gjithsesi, Japonia pikun e krizës e arrin në muajin prill me një shifër mesatare afërsisht 600 të prekur në ditë. Në kontekstin gjeografik rajonet e prekura janë Matsumoto-Shi dhe Yokohama me një shifër inferior se 400 persona të prekur.

Kanadaja, deri në fund të muajt shkurt, është ndër vendet për pak të prekura nga pandemia botërore që prej lindjes së saj në Kinë. Sipas të dhënave të OBSH (figura 5), problemi real fillon në muajin mars ku numri fillon rritet deri në 1816 të prekur. Piku i kësaj krize arrin në 4 maj me një numër të prekurish prej 3793 personash, ndërsa piku i numrit të të vdekurve brenda 1 dite ka qenë përsëri në fillim të majit me një numër prej 235 personash. Kjo kurbë fillon dhe ulet duke krijuar një trend rënës nga mesi i muajt maj e në vazhdim. Në kontekstin gjeografik rajonet më të prekura janë ato në jug të Kandas, ku dhe është përqëndruar pjesa më e madhe e popullësisë siç mund të shohim, zonat më problematike janë British Columbia, Alberta, Ontario dhe Quebec²⁷.

4.2. Impakti i politikave makroekonomike

4.2.1. Kanada

Qeveria Kanadaze filloi përgatitjen e plani federal të veprimit kundër Covid-19, që në fillim të marsit, disa orë para se Organizata Botërore e Shëndetit të deklaronte se virusi tani është një pandemi globale. Ajo mori në konsideratë jo vetëm sektorin shëndetësor por edhe në atë ekonomik dhe social. Deri në fund të muajt maj, qeveria ka planifikuar në paketën fiskale 9.8%

²⁵ <https://covid19.ëho.int/region/ëpro/country/jp/ca/kr>

²⁶ <http://www.businessworld.in/article/Japan-s-Economy-Shrinks-Faster-Than-Estimated-As-Virus-Compounds-Recession-Risk/09-03-2020-185745/>

²⁷ <https://gisanddata.maps.arcgis.com/apps/opsdashboard/index.html#/bda7594740fd40299423467b48e9ecf6>

të PBB (figura 3, më lartë). Si fillim, u përlogarit 1.1 miliardë dollarë, gati gjysma (500 milionë dollarë) të shkojnë për provincat dhe territoret në ndihmë të plotësimin të nevojave shëndetësore dhe, 275 milion dollarë të tjerë do të shpenzohen për kërkime, përfshirë kërkimin për një vaksinë. Gjithsej 200 milionë dollarë do të përdoren për të marrë përsipër përgjegjësi federale shëndetësore, përfshirë nevojat e komuniteteve autoktone. Gjithashtu, Otava bëri të ditur se 50 milionë dollarë do të shkonin për të ndihmuar vendet e huaja që përballeshin me këtë situatë.

Ministri i Financave Bill Morneau, Presidenti i Bordit të Thesarit Jean-Yves Duclos, si edhe Guvernatori i Bankës së Kanadasë Poloz, deklaruan që ndërhyrja si nga ana e shpenzimeve qeveritare si nga ana e Bankës Qëndrore nëpërmjet levës monetare do të jenë në çdo kohë gati për të ndërhyrë. Kështu, në Planin e Reagimit Ekonomik kundër Covid-19, Qeveria planifikoi deri në 27 miliard dollarë ndihmë të drejtpërdrejtë për punëtorët dhe bizneset kanadeze dhe përmes shtyrjes së taksave në shumën 55 miliardë dollarë si siguri për të përmbushur nevojat e likuiditetit të familjeve dhe bizneseve kanadeze. Në total, kjo mbështetje prej 82 miliardë dollarësh përfaqëson më shumë se 3% të PBB-së së Kanadasë.

Për punëtorët dhe familjet e tyre, ky plan merrte parasysh pagesën e qirasë së tyre dhe ushqimin. Për punëtorët që nuk kanë të drejtë sigurimi shoqëror dhe që janë në rrezik të humbasin punën e tyre, ky plan parashikonte një ndihmë emergjence prej 5 miliardë dollarë ku përfitimi do të paguhej përmes Agjencisë së të Ardhurave në Kanada.

Qeveria e Kanadasë ofroi gjithashtu njëndihmë shtesë për familjet me fëmijë duke rritur përkohësisht pagesat e përfitimeve të fëmijëve. Kjo siguronte gati 2 miliard dollarë ndihmë shtesë. Ndërsa 10 miliardë dollarë kandezë u alokuan për ndihmë Kujdesi për Urgjencës në shtëpi. Një ndihmë shtesë u ofrua edhe për individët dhe familjet me të ardhura të ulëta dhe modeste ku shuma e injektuar do të ishte 5,5 miliardë dollarëdollarë kanadezë.

Në vazhdimësi të kësaj pakete, në 27 mars, qeveria planifikoi një tjetër financim ku shuma ishte 107 miliardë dollarë kanadez. Në këtë paketë kishte më shumë financime konkrete dhe direkte qoftë tek firmat qoftë tek individët dhe familjet. Kështu për të gjithë punëtorët që do të prekeshin nga kjo situatë, dhe që smund të punonin, qeveria do të paguante 2000 dollarë kanadez në muaj për katër muajt në vazhdim. Në shumën prej 107 miliard dollarë kanadezë përfshihen edhe personat që kanë sigurim social edhe ata që nuk kanë por që janë të penalizuar nga pandemia.

Ky plan, për biznesetsynonte ndihmë për pagat e punonjësit dhe faturat e tyre gjatë kësaj kohe pasigurie. Ndërsa, në 27 mars, Kryeministri Trudeau deklaroi një subvencionim jo më 10% por 75% të pagave për të punësuarit e FMV (firmat e mesme dhe të vogëla). Gjithashtu u parashikua edhe një ndihmë për median deri në 30 milion dollarë kanadez të cilat po vuajnë pasojat e rënda të krizës financiare.

Në aspektin financiar, ky plan vinte në dispozicion më shumë se 500 miliardë dollarë kredi dhe likuiditet për individët dhe bizneset përmes bashkëpunimit midis korporatave financiare Crown, Banka e Kanadasë, Zyra e Mbikëqyrësit të institucioneve financiare (OSFI) dhe huazuesit tregtar në mënyrë që bizneset të mund të vazhdojnë të funksionojnë. Në sigurimin e fondeve të qëndrueshme dhe të likuiditetit për institucionet financiare që do të mbështesin kreditimin e vazhdueshëm për bizneset dhe konsumatorët kanadezë me kredi hipotekore, u bënë ndryshime në kriteret e pranueshmërisë hipotekore, të përcaktuara në Ligjin Kombëtar të Strehimit dhe Ligjin për Mbrojtjen e Strehimit. Gjithashtu, qeveria garantonte bankat nëpërmjet fondit të garancisë prej 25 miliardë dollarë kanadez, për të gjitha firmat që kanë një faturim prej 1 milion dollarësh dhe që kanë probleme me likuiditetin. Shuma e kredidhënies ishte deri në 40 mijë dollarë, dhe vitin e parë ishte pa interes. Për më tepër ¼ e vlerës së huasë mund të konsiderohet jo e rimbursueshme sipas disa kushteve. Një shumë tjetër shtesë prej 12.5 miliardë dollarë do të kalohen në Bankën e zhvillimit të Kanadas si dhe Eksportimit dhe zhvillimit Kanadez për tju përgjigjur nevojave për likuiditet të këtyre firmave. Edhe këtu, 80 % e huave garantoheshin BZHK dhe EZHK të cilat duhet të kthehen brenda 1 viti.

Gjithsesi, deri në prill, vlera e masave në dollarë kanadezë shkon në 200 miliardë por Ministri i Financave Erik Girard thekson "Nuk do të ketë limit nëse është e nevojshme". Kjo për arsye se Qeveria Kanadeze ka bashkpunuar me Bankën Qëndrore (BoC) e cila nëpërmjet politikës së saj monetare ka ndërhyrë në tregun financiar duke ulur normën e interesit REPO nga 1.75% që ishte në tremujorin e fundit të vitit 2019, në 0.25% në fund të marsit²⁸.

Koordinimi i të dyja politikave makroekonomike ka ndikuar gjithashtu në këmbimin valutor të dollarit kanadez i cili përball dollarit amerikan, në fillim të krizës sanitare humbet vlerë duke u këmbyer 1:1.39. Në fakt, sipas Krishen Rangasamy, ekonomist i lartë në Bankën Qëndrore, ai ka qenë nën një sulm të dyfishtë në të njëjtën kohë: nga njëra anë rënia e fortë e çmimeve të naftës dhe nga ana tjetër kriza e koronavirusit e cila po i çon investitorët drejt parajsave të sigurta. Fal ndërhyrjes së Bankës Qëndrore për të përmirësuar ndikimin ekonomik nga pandemia e koronavirusit në fund të majit dollari kanadez këmbëhet 1:1.33²⁹

Padyschim, situata e krijuar kanë krijuar panik të madh në tregjet bursiere të aksioneve. Ashtu si edhe në vendet e tjera kudo në botë, edhe idenkasi i bursës së Kanadasë S&P/TSX Toronto në 20 shkurt ra nga 17897 pikë në 11201 pikë në 23 mars ose me - 62.5%. Kompanitë si Magna International (-41%), Husky Energy (-77,69%), Canadian Natural Resources (-66,46%), Imperial Oil (-63,71%), Bank Of Montreal (-38%) etj. Sektori më i prekur është ai i energjitikës dhe veçanërisht ai i prodhimit të naftës. Rënia e çmimeve në pikën më të ulët prej 4\$, bëri që kompanitë Husky Energy, Cenovus Energy (32%) dhe Suncor (26% ose 1.5 miliard dollar) të ulin investimet dhe ky sektor të ndodhet në prag falimentimi³⁰. Kjo ka bërë që edhe prodhimi industrial të ulët në tremujorin e II (T2_20) me -5.6% (figura 6). Gjithsesi, fal ndërhyrjes së Qeverisë nëpërmjet subvencionimeve në këtë sektor dhe Bankës Qëndrore nëpërmjet uljes së normës REPO, bursa filloi prap të ket një rritje pozitive me 42.8%³¹.

Prodhimi i Brendshëm Bruto ose GDP, në tremujorin e I-rë të 2020 (T1_20) është në stanjacion, ndërsa në tremujorin e II (T2_20) deri në fund të majit është vlersuar në -2.1% (figura 6) dhe parashikohet sipas të dhënave të fundit të Drejtorit të buxhetit parlamentar Yves Giroux të kemi një rritje të deficitit publik 5.2% të GDP, dhe një rënie të ekonomisë vjetore prej -5.1%³². Norma e inflacionit në krahasim me tremujorin e IV-rë të 2019 (T4_19) për tremujorin e I-rë të 2020 (T1_20) është ulur në 0.1% dhe vazhdon të ulët edhe për tremujorin e II-rë (T2_20) duke kaluar në deflacion me normë negative në -0.2%. Edhe Indeksi i Çmimeve të Konsumit (ICK) nga në 137% që ka qenë në tremujorin e I-rë të 2020 shkon duke u ulur në tremujorin e II në 135.7%.

Figura 6. Evolucionin e indikatorëve makroekonomikë për dy tremujorët e fundit dhe parashikimi për tremujorin e dytë të vitit 2020, Kanada.


²⁸<https://fr.tradingeconomics.com/canada/interest-rate>

²⁹<https://fr.tradingeconomics.com/canada/currency>

³⁰https://www.abcbourse.com/forums/msg762802_oui-oui-au-bal-des-faillites-petrolieres.aspx

³¹<https://fr.tradingeconomics.com/canada/stock-market>

³²<https://ici.radio-canada.ca/nouvelle/1689036/deficit-dette-finances-ottaëa-contraction>



Burimi: përpunuar nga autorët, 2020, bazuar në të dhënat e Trading Economics³³

Gjithashtu edhe indikatorët e tjeërë ekonomikë janë në përkeqsim. Kështu, Bilanci i llogarisë korrente shkon në -0.6% dhe Bilanci tregëtar rritet në -1.47%. Kjo situatë ka gjeneruar edhe rritje të papunësisë në tremujorin e I-rë të në 5.6%, ndërsa në tremujorin e II-rë në 13.7% (figura 6).

4.2.2. Japonia

Ekonomia japoneze për shkak të situatës së krijuar nga kriza sanitare e importuar nga Kina fqinje, filloi seriozisht të kërcënohej nga recesioni. Kësaj krize i shtohet edhe ajo e turizmit shkaktuar nga konflikti me Koren e Jugut atëherë që Japonia përgatitet për organizimin e lojrave olimpikë³⁴. Sipas gazetës prestigjioze The New York Times³⁵, të 16 shkurtit, ekonomia japoneze ra me një normë vjetore prej 6.3% në tremujorin e I-rë të 2020, situata më e keqe që nga mesi i 2014. Shkak ishte një rënie mujore e kërkesës kineze për eksportet japoneze. Kina është partneri i saj më i madh qoftë tregtar qoftë edhe si numër vizitorësh që frekuentojnë vendin e tyre. Sipas të dhënave nga Shoqata Japoneze e Agjentëve të Udhëtimit, më shumë se 30 % e vizitorëve në total janë kinez, duke qenë për Japonin një burim i konsiderueshëm të ardhurash në bilancin tregëtar³⁶. Kështu për Japonin, sipas kompanisë ajrore ANA Holdings, sektori i transportit ajror është goditur në 80%. Humbjet vlerësohen në 2000 miliardë Yen ose 18 miliardë dollarë amerikanë për vitin 2020, atëherë që revista ekonomike NIKKEI vlerëson 9 miliardë dollarë amerikanë humbje për këtë vit. ANA kërkon të marr hua 12 miliardë dollarë ku 9 miliardë do tja akordojë BoJ dhe 3 të tjera bankat private.

Në 9 mars, bursat japoneze gjithashtu u goditen. Rënia e çmimeve të naftës dhe frikësimi i koronavirusit krijuan panik në tregjet financiare të Tokios duke ulur vlerën e aksioneve Nikkei, të hënë 19 mars, me -30% ose në 16541 pikë krahasuar me situatën para krizës ku pika më e lartë ishte 23805 pikë³⁷.

³³<https://fr.tradingeconomics.com/canada/indicators>

³⁴<https://asiatimes.com/2020/03/olympic-delay-may-turn-out-to-be-positive-for-abe/>

³⁵<https://www.nytimes.com/2020/02/16/business/coronavirus-japan-economy.html>

³⁶<https://www.nytimes.com/2020/02/16/business/coronavirus-japan-economy.html>

³⁷<https://fr.tradingeconomics.com/japan/stock-market>

Për të përballuar këtë situatë, në këta katër muajt e fundit, Qeveria Japoneze aplikoi tre paketa masash ekonomike dhe financiare. E para ishte në fund të shkurtit ku Kryeministri Abe deklaroi se masat përfshijnë sigurimin e subvencioneve për pagat e punonjësve që kompanitë e tyre nuk punojnë për shkak të karantimit, për të vetpunësuarit, si edhe për ata punëtorë pa kontrata të rregullta pune. Qeveria gjithashtu do të rrisë kufirin për kredi të vogla urgjente për individët nga 100,000 Yen (900 miliardë dollarë) në 200,000 Yen (1800 miliardë dollarë). Ndërsa për bizneset e vogla, Qeveria gjithashtu parashikoi një program të ri kredie prej 4,6 miliardë dollarë, pa interes dhe pa kolateral. Një masë e re përfshinte faljen e tatim fitimit nëse të ardhurat vjetore do të binin me 20%. Ndërsa në paketën e dytë, më 11 mars, Qeveria Japoneze e shtoi këtë shumë kredie në 15 miliardë dollarë³⁸.

Në 7 prill, Qeveria Japoneze, ndërmerr ndërhyrjen e tretë të masave ekonomike ku për sektorin ajror planifikon: për kompanitë të një kredie nga Banka e Zhvillimit të Japonisë; shtyrje afati për pagesat e taksave aeroportuale; shtyrje për pagesat e taksave për karburantet si dhe modifikim të tarifave të kontrollit ajror. Në fakt plani i 3-të i emergjencës ekonomike³⁹ ishte 108 trillions Yen (983 miliardë dollarë) ose gati 20% e PBB, ku vëmendje e veçantë i kushtohet bizneseve dhe familjeve më të prekura. Japonia është një vend ku masat ekonomike janë të ndryshme nga vendet e perëndimore. Japonia ka zgjedhur të financoj konsumin duke u dhënë të gjithë rezidentëve nga 857 euro pa asnjë kushtëzim. Ky plan artikullohet rreth 5 shtyllave : 74% e ndihmës është e drejtuar në mbajtjen e punësimit dhe vazhdimin e aktivitetit, 15% drejt rindërtimit të një strukture ekonomike më elastike (inovacion), 8% për rifillimin e veprimtarisë, 2% në favor të masave të destinuara për të parandaluar përhapjen e infeksionit, 1% për fond rezervë. Për të siguruar këto financime, Qeveria Japoneze do të emetonte bono sovranë për shumën 16 000 miliardë Yen (145 miliardë dollarë).

Përveç ndërhyrjes së qeverisë, një rol të rëndësishëm luajti edhe Banka Qëndrore e Japonisë (BoJ)⁴⁰. Pak para se ta hapte bursa e Tokios, BCE (Banka Qëndrore Europiane) lajmëroi se kishte ndërmend të blinte për 750 miliardë euro tituj të borxhit publik dhe privat deri në fund të 2020, me shpresën për të ndihmuar bankat që të nxisin kredidhënien ndaj firmave dhe familjeve. Në anën monetare të gjërave, më 16 mars, Banka e Japonisë njoftoi një rritje të konsiderueshme në QE (Quantitative easing). Ajo tha se do të dyfishonte blerjet në ETF (exchange-traded fund) nga 56 miliardë dollarë në vit në 112 miliardë dollarë, dhe gjithashtu ajo rriti blerjet e obligacioneve dhe letra tregtare të korporatave⁴¹. Nën një kontroll të quajtur kurbë të rendimentit politik, Banka Qëndrore udhëzon normat afatshkurtra të interesit në -0.1% dhe rendimentin e bonove 10-vjeçare të qeverisë në gati 0%⁴². Në 9 mars, kemi një vlerësim të monedhës Yen në krahasim me dollarin amerikan në raportin 1\$ me 103 Yen, por aktualisht, ajo është zhvlerësuar duke shkuar në raportin 1\$ me 107 Yen (JPY)⁴³.

Gjithsesi, edhe pse kemi kombinim të të dyja politikave makroekonomike, rezultatet për të gjithë këtë periudhë tregojnë që jemi midis recesionit dhe stanjacionit të ekonomisë. Figura 7 tregon se Prodhimi i Brendshëm Bruto (GDP), për tremujorin e I-rë (T1_20) ka rënie me -1.8% atëherë që në tremujorin e fundit (T4_19) ishte 0%. Po kështu vazhdon edhe për tremujorin e II (T2_20) por me një ringritje të vogël me 1.2%.

Norma e inflacionit në krahasim me tremujorin e IV-rë të 2019 (T4_19) për tremujorin e I-rë të 2020 (T1_20) është ulur me normë negative në -0.1% dhe vazhdon të ulet edhe për tremujorin e II të 2020 (T2_20) në -0.2%. Këto shifra tregojnë që jemi në deflacion.

³⁸<https://asiatimes.com/2020/03/japan-stimulus-highlight-15bn-small-biz-loans/>

³⁹<https://www.tresor.economie.gouv.fr/Articles/2020/04/10/covid-19-troisieme-plan-d-urgence-economique>

⁴⁰https://www.boj.or.jp/en/announcements/release_2020/k200316b.pdf


⁴¹<https://www.investopedia.com/government-stimulus-efforts-to-fight-the-covid-19-crisis-4799723#citation-19>

⁴²<https://fr.tradingeconomics.com/japan/government-bond-yield>

⁴³<https://fr.tradingeconomics.com/japan/currency>

Podhimi industrial,ashtu si Kandaja, është përmirësuar pak por mbetet akoma negativë me -4.3% nga -6.7% që ishte tremujorin e fundit të 2019. Ndërsa Bilanci i llogarisë korrente nuk ka ndryshuar në krahasim me tremujorin e fundit të 2019. Të njëjtën gjë mund të themi edhe për normën e papunësisë e cila mbetet gati në të njëjtat shifra me 2.4% (figura 7).

Figura 7. Evolucionin e indikatorëve makroekonomikë për dy tremujorët e fundit dhe parashikimi për tremujorin e dytë të vitit 2020, Japoni.



Burimi: përpunuar nga autorët, 2020, bazuar në të dhënat e Trading Economics⁴⁴

4.2.3. Koreja e Jugut

Koreja e Jugut është ndër të pakta vende që nuk përdori në strategjinë e menaxhimit të karantinimit total për krizën sanitare, duke bërë që ekonomia e vendit të mos mbyllej plotësisht. Sektorët që u prekën më shumë ishin turizmi dhe transporti ajror. Ndërsa bursa e titujve KOSPI, nga 2250 pikë në shkurt, para kontaminimit nga Covid-19, zbriti 1 muaj më vonë 19 mars, në pikën më të ulët të saj 1540 pikë ose me 46% më pak.

Për përballimin e kësaj situatë, Qeveria Koreane Jugore, ndërmori një sërë masash ekonomike dhe financiare. Si fillim, ajo vendosi në dispozicion 50 miliardë Won (39 miliardë dollarë amerikanë), në ndihmë të firmave të vogla dhe të mesme (PME) që ishin të prekura direkt nga kriza sanitare⁴⁵. Gjithashtu, qeveria ofroi garanci kreditimi për të gjitha ato firma që kishin të ardhurat vjetore deri në 100 milionë Won (78 mijë dollarë amerikanë)⁴⁶, për një shumë prej 12 miliardë Won (9.12 miliardë dollarë amerikanë), me një normë interesi 1.5 % nga çdo institucion financiar⁴⁷. Në 10 prill, starton paketa tjetër ekonomike në shumën 150 miliardë Won (124 miliardë dollarë amerikanë) ose 7.8% të PBB⁴⁸. Mbi këtë total, ndihmat financiare janë 32 miliardë Won, dhe masat për të qetësuar tregjet financiare shkojnë në 100 miliardë Won. Për më tepër, shtyrjet e pagesave të sigurimit shoqëror, taksave, kësteve të kredive, si ndihmë indirekte kapin vlerën 349 miliardë Won⁴⁹. Gjithashtu, për të rritur ofertën e likuiditetit, Qeveria e Koresë Jugore, ka emetuar bono thesari dhe obligacione (5 miliardë euro), rimbursim dhe financim obligacione të

⁴⁴<https://fr.tradingeconomics.com/japan/indicators>

⁴⁵http://tbs.seoul.kr/eFm/newsView.do?typ_800=J&idx_800=2388698&seq_800=

⁴⁶<https://www.usnees.com/nees/eorId/articles/2020-03-18/south-korea-reports-152-nees-coronavirus-cases-total-8-565-kcdc>

⁴⁷http://tbs.seoul.kr/eFm/newsView.do?typ_800=J&idx_800=2388698&seq_800=

⁴⁸<https://fr.yna.co.kr/view/AFR20200410002000884>

⁴⁹<https://fr.yna.co.kr/view/AFR20200410002000884>


korporatave (3.1 miliardë euro), 20 miliardë për operacionet në fondet e stabilizimit e të tregut të Obligacioneve dhe të bonove të thesarit.

Përsa i përket politikës monetare kemi ndërhyrje nga ana e Bankës Qëndrore në uljen e normës REPO nga 1.5% në 0.75% dhe në muajin maj ka zbritur në 0.5%⁵⁰. Financim në shumën 7.5 miliardë euro për stabilizimin e tregut të bursës apo të titujve të pronësisë. Këto manovra kanë bërë që këmbimi i monedhës me dollarin ka pasur një zhvlersim në datën 23 mars në 1270, por qënëfillim të muajit qershorështë riformuar duke u shkëmbyer mesatarisht 1 dollarë me 1200ëon (monedha koreane jugore)⁵¹.

Ndërhyrja e kombinuar e këtyre politikave makroekonomike qoftë nga ana e qeverisë qoftë nga ana e Bankës Qëndrore, kanë gjeneruar një stabilitet të tregut bursier KOSPI, i cili rritet në fillim të qershorit, me 49%⁵².

Ndërsa analizojmë indikatorët makroekonomikë, shohim që prodhimi i brendshëm brutonë krahasim me tremujori i parë i vitit 2019, u rrit në tremujorin e I-rë të 2020 (T1_20) nga 0.4% në 1.3%. Por për shkak të një rënie të fortë të kërkesës private botërore, në tremujorin e II të 2020 (T2_20), kemi një rënie në -1.3% (figura 8). Kjo shikohet edhe në rënien e prodhimit industrial në -3.8% në tremujorin e I-rë të 2020 (T1_20) dhe -6% në tremujorin e II.

Figura 8. Evolucionit i indikatorëve makroekonomikë për dy tremujorët e fundit dhe parashikimi për tremujorin e dytë të vitit 2020, Koreja e Jugut.



Burimi: përpunuar nga autorët, 2020, bazuar në të dhënat e Trading Economics⁵³

Norma e inflacionit në krahasim me tremujorin e IV-rë të 2019 (T4_19), për tremujorin e I-rë të 2020 (T1_20) është ulur me normë negative në 0% dhe vazhdon të ulet edhe për tremujorin e II të 2020 (T2_20) në -0.2%. Këto shifra tregojnë që jemi në deflacion. Ndërsa norma e papunësisë mbetet gati konstant në 4.5 % në tremujorin e II (figura8).

5. DISKUTIMI DHE KONKLuzioni

Pandemia e Covid-19 e ka futur ekonominë botërore në një recesion ku pasojat financiare dhe ekonomike por edhe sociale dhe shëndetsore, janë akoma të pallogaritshme. Një pjesë e mirë e

⁵⁰<https://fr.tradingeconomics.com/south-korea/interest-rate>

⁵¹<https://fr.tradingeconomics.com/south-korea/currency>

⁵²<https://fr.tradingeconomics.com/south-korea/stock-market>

⁵³<https://fr.tradingeconomics.com/canada/indicators>

vlerës financiare humbi për shkak të mbylljes së bizneseve nga masat sanitare ose karantinimi. Një pjesëtjetër e saj u shkatërruar apo u transformua në bursat botërore.

Metodat konvencionale dhe jo konvencionale të ndërhyrjes nëpërmjet politikës monetare nga bankat qendrore, duke ulur normën REPO në 0% apo edhe negative, nuk po japin impaktin e duhur. Aplikimi i politikave makroekonomike nëpërmjet paketave qeveritare, kanë ndihmuar në frenimi e këtij recesioni por nuk kanë mundur ta ndalin apo të krijojnë një rritje pozitive. Në shtetet që ne morëm në analizë, qoftë Kandaja, dhe Japonia, shohim që indikatorët makroekonomikë mbeten për këto dy tremujorë akoma negativë. Kemi një rënie të PBB, një rënie me normë negative të inflacionit, një rënie të bilancit tregtar dhe të prodhimit industrial, për shkak të rënies së kërkesës globale, dhe në fund një rritje të normës së papunësisë. Koreja e Jugut mbetet vendi që ruan më mirë indikatorët dhe stabilitetin makroekonomik, duke treguar një model për tu studiuar nga shkenca ekonomike. Gjithsesi, numri i vogël i shteteve të studiuar dhe periudha e shkurtër gati 6-mujore, e analizës së të dhënave, limitojnë rezultatet e këtij studimi.

Duhet theksuar se kjo lloj krize ekonomike buron nga një krizë sanitare e cila si karakteristikë kryesore ka pasigurinë tek agjentët ekonomikë. Kërkesa agregate do të jetë gjithmonë e frenuar sidomos nga ana e konsumit i cili përbën edhe pjesën më të madhe të saj. Në situatë deflacioni kemi një korrelacion të drejtë me rritjen e normës së papunësisë, cka mund të shkaktojë problem të tjera sociale. Sado të munden shtetet të rrisin shpenzimet qeveritare nëpërmjet rritjes së borxhit, ashtu siç veprroi Presidenti Franklin Roosevelt në 1933, për këtë situatë krize ekonomike mbetet gjithmonë parçiale. Kjo ndërhyrje e amortizon situatën por nuk rimëkëmbë ekonominë. Prandaj edhe shumë prej ekonomistëve në përfundim apo edhe në daljen e fundit të guvernatoit të Bankës Qendrore të Francës François Villeroy de Galhau, dhe njëkohësisht antar i Këshillit të BCE (Banka Qendrore Evropiane), i cili deklaroi se ka ardhur koha të ndjekim në tjetër politikë financiare jo nëpërmjet qeverive por një lloj "helicopter money" për firmat⁵⁴.

Bibliografia

- Breedon, F., J. S. Chadha, and A. Waters.(2012). "The Financial Market Impact of UK Quantitative Easing." *Oxford Review of Economic Policy* 28, no. 4 (December): 702–728.
- Balatti, M., Brooks, Ch., Clements, M. P. and Kappou, K., (2016). Did Quantitative Easing Only Inflate Stock Prices? Macroeconomic Evidence from the US and UK (September 13, 2016). Available at SSRN: <https://ssrn.com/abstract=2838128>
- De Vijlder W., (2020). Covid-19 : l'impact sur l'économie mondiale.
- <https://group.bnpparibas/actualite/covid-19-impact-economie-mondiale>
- Engen, Eric M., Thomas Laubach, and Dave Reifschneider.(2015). The Macroeconomic Effects of the Federal Reserve's Unconventional Monetary Policies. Technical report. Washington: Board of Governors of the Federal Reserve System.
- FMN, (2009). "World Economic Outlook: Crisis and Recovery, April 2009".
- Joyce, Michael, David Miles, Andreë Scott, and Dimitri Vayanos.(2012). "Quantitative Easing and Unconventional Monetary Policy—an Introduction." *Economic Journal* 122 (564): F271–F288.
- Jin Wu, Weiyi Cai, Derek Watkins and James Glanz, (2020). « How the Virus Got Out », The New York Times, 22 mars 2020.
- Lim, Jamus Jerome, and Sanket Mohapatra.(2016). "Quantitative Easing and the Post-Crisis Surge in Financial Flows to Developing Countries." *Journal of International Money and Finance* 68 (November 1): 331–357.
- Ozili, Peterson & Arun, Thankom. (2020). Spillover of COVID-19: impact on the Global Economy. *SSRN Electronic Journal*. 10.2139/ssrn.3562570.

⁵⁴<https://www.ft.com/content/c60a3bab-9229-48d7-8da5-574f8b0b9df6>

- Strauss-Kahn, D., (2020). L'être, l'avoir et le pouvoir dans la crise. *Politique Internationale - La Revue n° - AUTOMNE* –.
- https://archives.politiqueinternationale.com/revue/read2.php?id_revue=0&id=1945&search=&content=texte
- Summers L., (2014). "U.S. economic prospects: secular stagnation, hysteresis, and the zero lower bound", *Business Economics*, 49, p.65-73.
- Sułkowski, Ł. (2020). Covid-19 pandemic; recession, virtual revolution leading to de-globalization?. *Journal of Intercultural Management*, 12(1), 1-11.

PANDEMIA - TURIZËM APO VIZA-TOUR

MSc. Armelina Lila (Fushekati)
Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë
armelina.lila@umsh.edu.al
Dr. Ferjolt Ozuni
Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë
ferjolt.ozuni@umsh.edu.al

Abstrakt

Shqipëria prej më shumë se tre muajsh gjendet përballë sfidave të panjohura dhe shtigjeve përmes të cilave nuk kanë kaluar as superfuqitë e rruzullit më parë. Duke parë situatën aktuale dhe parashikimet për ekonominë pas pandemisë, industria e turizmit global, si më e goditura, pritet të ketë një ridimensionim të përgjithshëm, si në veprimtari të përditshme, ashtu edhe në mënyrën dhe kanalet e kryerjes së tij. Ka qenë pikërisht turizmi dhe industria ndërkombëtare e transporteve, sektori që ka nxjerrë nga kriza Europën dhe botën tetë vitet e fundit duke kontribuar konsiderueshëm në ekonominë globale. Gjithashtu, ndikimi i turizmit në ekonomi, si dhe efekti social e kanë kthyer në një nga sektorët prioritarë të Qeverisë për Planin Strategjik 2020-2022. Aftësia e sektorit ka shumëfishuar rikuperimin edhe në sektorë të tjerë si bujqësia, blegtoria, peshkimi etj duke mbajtur në këmbë rritjen ekonomike të Shqipërisë si burimi kryesor i injektimit të valutës në vend që prevalon mbi investimet e huaja. Qëllimi i këtij studimi është të analizohet sektori i turizmit dhe transportit në tërësi, barrierat më të mëdha me efekte ekonomiko-sociale, sipërmarrjet shqiptare, roli dhe politikat e Qeverisë në promovimin dhe ofrimin e modaliteteve lehtësuese për shfrytëzimin me sa më efektivitet të potencialit që zotëron Shqipëria në këtë sektor jetik. Si një nga komponentët më të rëndësishëm të zhvillimit të qëndrueshëm të vendit është vital ristrukturimi i turizmit, ndërveprimi rajonal si dhe orientimi i tregut drejt turizmit vendas, çka do të zhbllokojë ngërcin ekonomik dhe do të përmirësojë situatën në tregun e shërbimeve duke rregulluar pozicionet financiare të tyre.

Fjalë kyçe: turizmi, transportet, punësimi, lëvizja e lirë.

Abstract

For more than three months, Albania is facing unknown challenges and paths, through which even the superpowers of the globe have not passed before. Looking at the current situation and the prospects for the economy after the pandemic, the global tourism industry, as the most affected, is expected to have a general resizing, both in daily activities and in the manner and channels of its performance. It was precisely tourism and the international transport industry that have pulled Europe and the world out of the crisis in the last eight years by contributing significantly to the global economy. Also, the impacts of tourism on the economy and social effects have become one of the priority sectors for the Government Strategic Plan 2020-2022. The sector's ability has multiplied other sectors as well, such as agriculture, livestock, fishing etc. Keeping up Albania's economic growth as the main source of foreign exchange injection prevailing over foreign investment. The purpose of this study is to analyze the tourism and transport sector as a whole, the biggest barriers with economic and social effects, Albanian enterprises, the role of the Government policies in promoting and facilitating the modalities for the most effective use of the potential that Albania possesses. As one of the most important components of the country's sustainable development, it is vital tourism restructuring, regional interaction and market orientation towards domestic tourism, which will unblock economic stalemate and improve the situation in the services market by adjusting their financial positions.

Keywords: tourism, transportation, employment, free movement

1. Hyrje

... Bota nuk do të jetë më e njëjtë paskëta. COVID-19 tronditi rëndë ekonominë ndërkombëtare të turizmit. Nevoja për masa të menjëhershme në funksion të mbështetjes së sektorit të turizmit dhe shërbimeve është vitale për rimëkëmbjen e ekonomive lokale. Heqja e kufizimeve të udhëtimit, rivendosja e besimit të udhëtarëve dhe rimodelimi i sektorit të turizmit do të japë frymë sektorit. Aktorët e turizmit dhe Qeveria duhet të forcojnë mekanizmat e tyre të koordinimit në funksion të vitalizimit të biznesit si dhe ruajtjes së fuqisë punëtore e cila është një nga asetet më të vjera të sektorit. Qeveritë janë aktorët kryesorë që do të ndikojnë në mbajtjen e një tranzicioni të ulët në funksion të një ekonomie më të qëndrueshme dhe elastike të turizmit. Kriza që pason COVID-19 duhet të shihet në një këndvështrim 360 gradë duke avantazhuar si një mekanizëm oportun për të ardhmen.

Turizmi është një pjesë e konsiderueshme e shumë ekonomive kombëtare, dhe tronditja e menjëhershme dhe e jashtëzakonshme për sektorin e turizmit që vjen si rezultat i pandemisë po ndikon në ekonominë më gjërësisht. Ndërsa qeveritë në të gjithë botën kanë prezantuar masa të pashembullta për të mbajtur nën kontroll virusin, kufizimet në udhëtime, operacionet e biznesit dhe ndërveprimet e kanë vendosur ekonominë e turizmit në një ngërç. Shumë vende tani janë duke hyrë në një fazë të re për të luftuar virusin, ndërsa në të njëjtën kohë po menaxhojnë rihapjen e ekonomisë së turizmit. Kjo është një detyrë komplekse dhe sfiduese dhe sasia e ndikimit në ekonominë e turizmit është e vështirë për t'u matur.

Pesë muaj në krizë, situata vazhdon të evoluojë dhe pamja mbetet e pasigurt. Rimëkëmbja tani pritet të fillojë më vonë dhe të jetë më e ngadaltë nga sa ishte parashikuar më parë. Kufizimet e udhëtimit dhe masat e kontrollit ka të ngjarë të ekzistojnë për më gjatë, dhe pritet të ngrihen vetëm gradualisht, më mundësinë e kthimit nëse ndodhin valë të reja. Edhe kur zinxhirët e furnizimit të turizmit fillojnë të funksionojnë përsëri, protokollat e reja shëndetësore nënkuptojnë se bizneset do të operojnë me kapacitet të kufizuar. Shërimi i kërkesës do të marrë edhe ca kohë, duke marrë parasysh pasojat e ndërlydhura të krizave ekonomike dhe shëndetësore, dhe heqjen progresive të kufizimeve të udhëtimit, ndërsa vetëbesimi i konsumatorit dhe sjellja e udhëtimit do të ndikohen më thellë, sa më gjatë të zgjasë pandemia. Kjo do të ketë pasoja të mëdha për shumë ekonomi kombëtare.

2. Metodologjia e përdorur

Pandemia ka sjellë një ndryshim të madh në stilin e jetës së gjithësecilit. Rrethohemi dhe përballemi me lajme dhe kronika të pafundme, por njëkohësisht jemi të përndjekur nga e panjohura, çka mundëson që të përqëndrohemi më shumë në një analizë cilësore sesa sasiore. Rishikimi i literaturës së mëparshme në lidhje me kontributin e industrisë ndërkombëtare të turizmit si dhe analiza e të dhënave të këtij sektori në Shqipëri janë themeli i këtij punimi. Identifikimi i problematikave dhe "viktimitave" të sektorit të turizmit, dëmi ekonomiko-social si dhe plan-loja e rimëkëmbjes duke u fokusuar në përthithjen e ndryshimeve të mundshme teknologjike. Objekti i studimit është ndikimi i pandemisë në industrinë e turizmit, analiza e aplikimeve të teknologjisë në funksion të shpëtimit të sektorit si dhe rimëkëmbjes ekonomike.

3. "PACIENTËT" e Pandemisë

COVID-19 u shfaq në Wuhan, Kinë, në dhjetor 2019 dhe nëpërmjet transportit rrugor tokësor, ajror dhe detar arriti të prekë në kohë rekord pothuajse çdo cep të globit. Industria e aviacionit në Kinë, ku u shfaq virusi, ka qënë një nga më të prekurit nga kriza, pas frenimit të udhëtimit nga kombet që kanë frikë nga ngjitja dhe zvogëlimi i kërkesës. Qeveria Kineze kritikoi disa nga ato frenime, veçanërisht ato të vendosura nga Shtetet e Bashkuara. Sipas raportit të publikuar nga Administrata e Aviacionit Civil të Kinës, linjat ajrore kineze raportuan një humbje totale prej 20,996 miliardë juanë (2.99 miliardë dollarë) gjatë muajit shkurt 2020. Turizmi është bërë një pjesë gjithnjë e më e rëndësishme e ekonomisë kineze dhe vlerësohet se kontribuon rreth 11% të rritjes ekonomike të Kinës dhe punëson rreth 28 milion njerëz. Nëse i referohemi

Rankimit të Turizmit Botëror gjatë 2018, 62.9 milionë turistë vizituan Kinën, duke e renditur atë si destinacionin e katërt më të popullarizuar turistik pas Francës, Spanjës dhe SHBA.

Në Shqipëri, koronavirusi u shfaq për herë të parë në 9 Mars 2020. Pas përhapjes së koronavirusit të ri (COVID-19), Këshilli i Ministrave i Shqipërisë vendosi të shpallte gjendjen e fatkeqësisë natyrore në të gjithë Republikën e Shqipërisë. COVID-19 ka ndikuar shumë në bizneset e çdo sektori ekonomik në Shqipëri. Sipas sondazhit të kryer nga Sekretariati i Këshillit të Investimeve të Shqipërisë ku u anketuan rreth 833 kompani, të shpërndara në 12 qarqe të vendit, sektori i turizmit dhe i shërbimeve kanë ndikimin më të lartë negativ.

Figure 6. COVID19 impact as per economic activity





Figure 8. Closure of economic activity during COVID19 as per economic sector



Akomodimi, aktivitetet e shërbimit të ushqimit dhe agjencitë e udhëtimit / operatorët turistikë, të lidhur me sektorin e turizmit janë më të prekurit nga situata COVID-19, siç pritet për shkak të kufizimeve të qeverisë për aktivitetet e tyre. 94% e aktivitetit të turizmit ka ndaluar tërësisht ose pjesërisht punën. Nëse qëllimi i parë i çdo Qeverie ishte siguri i burimeve të nevojshme për urgjencat mjekësore, padyshim që objektivi i dytë ishte të merrte masa mbështetëse për të mbrojtur ekonominë nga një kolaps i mundshëm. Ndërsa nuk ka asnjë mënyrë për të thënë saktësisht se çfarë dëmi ekonomik do të shkaktojë pandemia globale COVID-19, në mesin e ekonomistëve pohohet njëzëri se ajo do të ketë ndikime të mëdha negative në ekonominë globale. Shoqata Botërore e Udhëtimeve & Turizmit evidenton se humbjet e kësaj industrie llogariten në 46 Miliard USD në muaj dhe afro 560 Miliardë \$ humbje në vit. Kontributi i Industrisë Ndërkombëtare të Turizmit sipas Këshillit Botëror të Udhëtimeve dhe Turizmit është 8.8 trilion dollarë në ekonominë globale gjatë 2018, pra me 10.4% të të gjithë aktivitetit ekonomik.

Për vitin 2018, sipas INSTAT, në Shqipëri aktivitetet që i përkasin kategorisë së turizmit gjeneruan rreth 45 miliardë lekë vlerë të shtuar – 2.8% e PBB. Turizmi në Shqipëri shihet si burimi kryesor i valutës në vend, dhe qëndron mbi investimet e huaja. Pritej që turizmi të ishte sektori i ekonomisë më i prekur por dhe ndër sektorët me të ardhura të konsiderueshme për shqiptarët dhe Shqipërinë, duke qenë se në 2019 vendin e vizituan 6.4 milionë turistë të huaj të cilët shpenzuan rreth 1.8 miliardë Euro. Duke marrë për bazë shifrat dhe veprimtaritë e 3 viteve të shkuara, tashmë në Shqipëri do të kishin kaluar pushimet dhe do ta kishin vizituar rreth 2 milionë turistë të huaj dhe do të numëronin ditët për të ardhur edhe 5 milion të tjerë, gjë që nënkupton se Shqipëria do të përgatitej të ofronte shërbime Turistike (dhe jo vetëm) më një vlerë prej mbi 2 miliardë Euro.

Gjatë muajve të verë-vjeshtë 2020 është pothuajse e pamundur që të mendohet për turizëm hyrës (Incoming) në Shqipëri – ashtu siç është pothuajse e pamundur të mendohet edhe për turizëm dalës (Outgoing). Në këto kushte, shumë aktorë të industrisë turistike në Shqipëri, si psh, Agjencitë Turistike, Tour-Operator-ë, Linjat Ajrore, Njësitë Akomoduese, Transportuesit Turistike dhe Ndërkombëtarë Rrugor, Restorantet dhe Bizneset e tjera mbështetëse janë detyruar të rimendojnë dhe rikonceptojnë shërbimet turistike të mundshme për këtë vit, e pikërisht turizmin brenda vendit. Duke marrë parasysh sa më sipër, një zgjidhje sado e vogël në ndihmë të sektorit të turizmit dhe shërbimeve do të ishte turizmi lokal dhe rajonal. Në këtë mënyrë, do të ndihmohet mbijetesa e kompanive që operojnë në industrinë turistike në Shqipëri duke lubrifikuar sadopak ekonominë dhe rivënien në punë të sektorit të shërbimeve.

4. E-tourism

Biznesi dixhital dhe tregëtia elektronike, si rezultat i popullaritetit mbrësëlënës dhe zgjerimit të shpejtë të Internetit dhe teknologjisë së rrjetit, është bërë një nga aktivitetet bashkëkohore më të përdorshëm prej më shumë se dy dekadash. Interneti po revolucionarizon shpërndarjen e informacionit dhe shitjeve njëkohësisht duke u transformuar nga një “mundësi” në një “domosdoshmëri”. Çdokush mund të aksesojë platforma të caktuara dhe të kryejë transaksione për të shitur dhe blerë mallra dhe/apo shërbime. Ky biznes është bërë gjithashtu pjesë e pandarë e aktiviteteve të industrisë turistike, parë nga këndvështrimi i ofruesvë të këtij shërbimi si dhe nga ana e konsumatorëve. Bashkëjetesa kaq aktive në ditët e sotme zhvillohet në dhe përmes internetit. Industria e biletarisë dhe turizmit të çdo lloj kategorizimi sot nuk mund të mendohet të funksionojë pa ndihmën e teknologjisë së informacionit, pasi një biletë avioni apo një akomodim hoteli nuk mund të rezervohet apo blihet pa ndihmën e një pajisjeje të lidhur në internet; menaxhimi i rezervimeve vështirë se mund të bëhet pa ndihmën e një sistemi informatik; menaxhimi i grupeve turistike apo i fluturimeve charter është e pamundur të bëhet pa ndihmën e teknologjisë së informacionit.

Në Shqipëri, tranzicioni nga operacionet manuale në ato dixhitale ka hedhur hapa tepër të ngadaltë dhe vijon të jetë ende i vështirë sidomos në sektorin e turizmit. Sipas treguesve të konkurrencës së inovacionit, Shqipëria renditet përkatësisht i 110-ti nga 141 vënde, por COVID-19 do të japë një shtytje përdorimit të tij nga ana e konsumatorëve si dhe një hov investimeve në teknologji të reja dhe shërbime online. Gjatë pesë-vjeçarit të fundit, sipërmarrësit e mëdhenj të agjencive dhe operatorëve turistike janë fokusuar dhe kanë përqëndruar vëmendjen e tyre drejt implementimit të teknologjisë së informacionit. Gjithsesi varfëria teknologjike vjen si rezultat i kapaciteteve teknike të limituara që ofrojnë kompanitë e këtyre shërbimeve në Shqipëri por edhe si rezultat i kostos së lartë, cilësisë së dobët të shërbimeve të internetit, si dhe mangësive ligjore apo burokracive ligjore e administrative përmes të cilave duhet të kalojë biznesi në rastin e përdorimit të faturave elektronike.

Në këtë periudhë izolimi, ku distancimi social është i detyrueshëm, komunikimi nëpërmjet teknologjisë është më i dobishëm dhe vital se kurrë më parë. Interneti dhe lundrimi online është i vetmi aktivitet i pagoditur nga pandemia dhe kriza ekonomike që po gjunjëzon botën.

Fluksi i përdorimit të internetit, programet apo platformat online të aksesuara së fundmi na tregojnë se qënia njerëzore adaptohet me risitë, nëse risitë i adaptohen nevojave dhe tregut. Ky pushim i detyruar në ofrimin e shërbimeve biletari/turizëm mund të përdoret nga aktorët e këtij sektori në Shqipëri për të reflektuar apo për të ristrukturuar veprimtarinë e tyre më qëllim maksimizimin e të ardhurave dhe uljen e kostove të aktivitetit post-pandemi. Aspekti të cilit i duhet kushtuar më shumë vëmendje është ai i implementimit të teknologjisë së informacionit në aktivitetet e përditshme të të gjithë sektorit të turizmit (dhe jo vetëm), pasi tregu ynë mund të orientojë shumë shpejt përdorimin e teknologjisë kur ka nevojë dhe kërkesë. Ndaj rifillimi i aktivitetit të agjencive turistike, hoteleve, restoranteve dhe transportit, duhet të ecë paralelisht me instalimin e strategjisë dhe teknologjisë së informacionit. Ky trend në turizëm do të përthithet lehtësisht nga sektori në tërësi. Angazhimi në aktivitete online të biznesit siguron benefite jo vetëm për ofruesin e shërbimeve por edhe për përfituesin e tyre, si rezultat i uljes së kostove të funksionimit. Jetësimi i e-business kërkon jo vetëm mbështetje institucionale nga Qeveria, një bazë ligjore të shëndoshë por edhe bashkëveprim të aktorëve të tjerë të biznesit si sektorët e transportit të udhëtarëve; ofruesit e shërbimeve të internetit të cilët duhet të ofrojnë çmime më konkurruese dhe cilësi më të mirë; ofruesit e sistemeve informatike në ofrimin e sistemeve dhe platformave me çmime më konkurruese.

5. "VISA – TOUR"

Dukë parë situatën aktualë dhe parashikimet për ekonominë pas pandemisë, industria e turizmit global pritet të ketë një ridimensionim të përgjithshëm, si në veprimtari të përditshme, ashtu edhe në mënyrën e kryerjes së tij. E-business ofron mundësi të panumërta në zgjerimin e bazës së klientit, hyrjen në tregje dhe për produkte të reja. Ky ridimensionim pritet të arrihet dhe të realizohet më ndihmën e teknologjisë së informacionit. Ndërkohë që vendet e zhvilluara kanë arritur majat e e-business si rrjedhojë e kërkesave të tregut global, le të shërbejë kjo periudhë në Shqipëri për të hedhur hapa galopant në modernizimin e teknologjive.

Nëse i referohemi Agjencisë së Sigurisë së Aviacionit të Bashkimit Evropian (EASA) dhe Qendrës Evropiane për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve (ECDC), përballemi me udhëzimet e nevojshme që kanë për qëllim ofrimin e një protokolli të sigurisë së shëndetit në aviacion që sigurojnë një burim të praktikës më të mirë se si operatorët e aeroportit, aeroplanëve që kryejnë operacione komerciale dhe jo-komerciale të transportit të pasagjerëve dhe autoritetet kombëtare të aviacionit mund të sigurojnë shëndetin dhe sigurinë e pasagjerëve, si dhe të stafit dhe ekuipazhit që i shërbejnë atyre, duke mbajtur operacione të sigurta për të minimizuar rrezikun e transmetimit të virusit. Kjo duhet të plotësojë këshillat e autoritetëve të shëndetit publik dhe të ndihmojë punëdhënësit në detyrat e tyre sipas legjislacionit përkatës për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë së punëtorëve.

Kështu, të gjitha format e transportit, përfshirë autobusë, trena, aeroplan dhe anije që i afrojnë njerëzit, veçanërisht në hapësira të mbyllura, paraqesin një rrezik të shtuar për transmetim. Masat e këshilluara përfshijnë ruajtjen e distancës fizik të përshtatshme dhe shmangien e kontaktit me sipërfaqet e kontaminuara, së bashku me higjienën e rreptë të duarve dhe etikëtimin e kollës / teshtitjes. Sipas ekspertëve të shëndetit, higjiena do të zvogëlojë rrezikun e transmetimit, por njëfarë rreziku do të mbetet.

Gjithashtu, linjat ajrore janë inkurajuar të jenë shumë fleksibël me udhëtarët në mënyrë që ata të mos tundoheën më që të përpiqen të fluturojnë më çdo kusht vetëm për të mos humbur vlerën e biletës. Inkurajohet rimbursimi i çmimit të paguar në tërësi, ose rishikimin falas në një fluturim tjetër, kur pasagjeri të jetë i shëndetshëm.

Disa teza të shtruara në tavolinë nga ekspertët dhe autoritetet është përdorimi i opsioneve "të shëndetshëm" si Check-in në internet, funksionimi i sporteleve të vetë-shërbimit për dorëzimin e bagazheve, skanimi individual i dokumenteve të identitetit, plotësimi i deklaratës se individ i gëzon shëndet apo pajisja me analizë vertetuese që nuk jeni mbartës i COVID – 19, mbajtja e maskës që nga momenti i hyrjes në aeroport, deri sa të dilni nga dera e aeroportit të

destinacionit final. Duke ju referuar sa më sipër, konstatohet se i gjithë procesi i udhëtimit do të zgjasë më shumë, do të jetë më i vështirë, por këto janë momentet ku jetojmë dhe udhëtimi me "pasaportë" mjekësore do të jetë kryefjala e lëvizjes me çdo mjet transporti.

6. "No-Borders" vs "Border-crossing"

Nëse kthehemi pas në kohë, kujtojmë se gjatë krizës së Ebolas të vitit 2014, autoritetet evropiane zbatuan masat e mëposhtme:

- Identifikimi i hershëm dhe izolimi i rasteve
- Trajtimi i pacientëve të konfirmuar dhe monitorimi i simptomave
- Anulimi i fluturimeve dhe kontrolli i temperaturës

Epidemia e Ebola preku kryesisht kombet e Afrikës Perëndimore, me vetëm disa raste në Evropë (Itali, Spanjë dhe Mbretërinë e Bashkuar). Bashkimi Evropian dha një kontribut të rëndësishëm financiar në përpjekjen e ndihmës (1.8 miliardë € deri në korrik 2015) si dhe sigurimin e pajisjeve mbrojtëse, automjeteve etj. Megjithëse Ebola tani është nën kontroll, situata vazhdon të monitorohet dhe niveli i rrezikut vlerësohet në vazhdimësi nga Qendra Evropiane për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve.

Në vitin 2016 u hodhën themelet dhe nisën procedurat ligjore për ETIAS – Sistemi i Informacionit dhe Autorizimit Evropian të Udhëtimit, një sistem plotësisht elektronik i cili lejon dhe gjurmon vizitorët nga vendet që nuk kanë nevojë për vizë për të hyrë në Zonën Shengen, system që pritet të fillojë brenda vitit 2022. ETIAS do të nënshtrojë një kontroll të detajuar të sigurisë për secilin aplikant për të përcaktuar nëse lejohet të hyjnë në vendet e Zonës Shengen. Ky sistem i autorizimit të udhëtimit do të mbledhë, mbikqyrë informacionin e nevojshëm në lidhje me vizitorët për të përcaktuar nëse është e sigurt për ta të hyjnë në vendet e Shengenit. ETIAS, përveç se përdoret për qëllime biznesi dhe turistike, gjithashtu do t'i lejojë njerëzit të vizitojnë vendet e Shengenit për arsye mjekësore dhe tranziti. Për më tepër, ky sistem do të jetë i detyrueshëm për të gjitha vendet që udhëtojnë pa viza. ETIAS jo vetëm nënkupton mbajtjen e ketyre kombeve të sigurta nga individët e rrezikshëm dhe veprimtarinë kriminale por edhe mbrojtjen e shëndetit publik. Neni 10 i rregullores thotë se ETIAS do të *'kontribuojë në mbrojtjen e shëndetit publik duke parashikuar një vlerësim nëse aplikanti paraqet një rrezik të lartë epidemik'*. Ai gjithashtu ofron shembuj të llojeve të sëmundjeve infektive të cilat ETIAS, pasi të zbatohen, do të ndihmojnë në parandalimin e përhapjes në Evropë.

Udhëtarëve do t'ju kërkohet të japin informacionin personal, detajet e pasaportës, përfshirë vendin e lëshimit të saj. Konfirmimi i kombësisë së njerëzve që vizitojnë Evropën është i rëndësishëm për disa arsye, njëra prej të cilave është aftësia për të identifikuar ata që vijnë nga zona që përjetojnë një shpërthim të një sëmundjeje të njohur / të panjohur. Gjatë epidemive dhe pandemive, mund të merren vendime për të bllokuar individë ose grupe të caktuara nga zonat e prekura të hyjnë në Zonën Shengen si një mjet për të parandaluar përhapjen e saj.

Për të plotësuar me sukses formularin e aplikimit ETIAS, shtetasve jo-anëtarë të BE-së u kërkohet gjithashtu t'u përgjigjen një sërë pyetjesh në lidhje me shëndetin publik. Kushtet ekzistuese mjekësore, sëmundjet parazitare infektive ose ngjitëse duhet të deklarohen me vërtetësi. Kur aplikimi dorëzohet, të dhënat e pasagjerëve drejtohen automatikisht përmes disa bazave të të dhënave. Agjencia Evropiane e Kufirit dhe Rojes Bregdetare (FRONTEX) ka fuqinë për të ndaluar hyrjen e udhëtarëve në zonë edhe nëse ata kanë në zotërim një autorizim ETIAS. Nëse Autoriteti ka arsye të mjaftueshme për të dyshuar se individit paraqet një rrezik të çfarëdo lloji për vendet evropiane, hyrja do të refuzohet duke shtuar në këtë mënyrë një nivel shtesë sigurie.

Ekzistojnë 2 arsye kryesore për bllokimin e përkohshëm të shtetasve jo-BE me sëmundje ngjitëse për të aksesuar Zonën Shengen. E para është ndalimi i transmetimit të sëmundjes tek banorët dhe vizitorët e tjerë, veçanërisht kur sëmundja është serioze dhe mund të çojë në efektë afatgjatë ose vdekshmëri. Sigurisht që kjo ndihmon për të mbrojtur mirëqenien globale, pasi mbajtja e çdo shpërthimi sa më e lokalizuar është e domosdoshme për çrënjosjen e një sëmundje ngjitëse.

Konsiderata e dytë, është parandalimi i mbingarkesës së sistemeve evropiane të kujdesit shëndetësor. Një rritje e papritur e pacientëve e shkaktuar nga mbërritja e një sëmundje infektive në një vend mund të shkaktojë stres të madh në spitale dhe personelin mjekësor.

Në rastet kur një sëmundje ose virus i veçantë prek një numër shumë të madh njerëzish në të gjithë botën njëkohësisht, Organizata Botërore e Shëndetësisë mund ta deklarojë atë një epidemi ose pandemi. Në rrethana të tilla, vendet reagojnë në mënyrë që të frenohet përhapja e sëmundjes së caktuar infektive. Një nga mënyrat më të mira për ta bërë këtë është vendosja e kufizimeve të udhëtimit, dhe nëse është e nevojshme mund të avancohet me vendimmarrjen e mbylljes së kufijve.

Përpjekjet për të kontrolluar virusin përfshinin zbatimin e kufizimeve të hyrjes në BE për shtetasit e vëndeve të treta. Sikur ETIAS të ishte aktiv dhe funksional, ai do të kishte luajtur një rol kryesor në identifikimin e kombësisë së vizitorëve të mundshëm para mbërritjes së tyre në kufirin e Zonës Shengen. Këto veprime janë në përputhje me një nga qëllimet kryesore të ETIAS: parashikimi i një vlerësimi nëse aplikanti paraqet një rrezik epidemie. Nëse një situatë e ngjashme paraqitet në të ardhmen, transmetimi në Evropë i sëmundjeve me origjinë jashtë BE mund të minimizohet me ndihmën e procesit të para-shqyrtimit ETIAS.

Konkluzione

Në situatën e paprecedente planetare me të cilën po përballlet njerëzimi, si rezultat i distancimit social dhe masave të ndërmarra nga qeveritë, turizmi dhe shërbimet mbështetëse janë ndër industritë më të goditura. Ky sektor për nga vetë objekti i veprimtarisë ka gjasa që ti kthehet normalitetit dhe të rinisë kur stuhia e pandemisë të jetë shuar plotësisht. Periudha post-pandemike do vijojë të diktojë vigjilencën e lartë në mbrojtje të shëndetit. Pa cënuar përditshmërinë, vëmendja jonë do të fokusohet tek shërbimet teknologjike për ato veprimtari të cilat mund ti kryejmë në distancë. Si rezultat do të duhet një rikonceptim në aktivitetet e kompanive duke ndryshuar trajektoren drejt biznesit elektronik dhe aktiviteteve të plota që e-business ofron. Shkenca e informatikës, sistemet kompjuterike kanë lehtësuar funksionet bazike të shërbimit të turizmit, të cilat disa vite më parë ofroheshin paper-based dhe kryheshin manualisht. Qëllimi kryesor i këtyre sistemeve është kryerja e procedurave të punës në një kohë shumë më të shkurtër, me cilësi më të lartë dhe pa barrierë në hapësirë dhe kohë. Dalja e industrisë nga kriza do të ndihmohej së pari nga orientimi i turizmit patriotik dhe nëpërmjet promovimit të burimeve që ofron Shqipëria gjatë gjithë muajve të vitit falë klimës së favorshme. E pikërisht kjo mund të arrihet falë teknologjisë e cila përveç funksionit bazë të saj, në afatgjatë shkurton kostot fikse të sektorit. COVID-19 rriti ndërgjegjësimin e kompanive për efikasitetin e shërbimeve online si dhe detyroi konsumatorin të gjente përgjigje të nevojave/kërkesave duke përdorur teknologjinë. Ridimensionimi i sektorit ofron mundësi të panumërta në zgjerimin e bazës së klientit, hyrjen në tregje dhe produkte të reja.

Bibliografia

- <https://www.fastnewsalbania.com/2020/05/turizmi-pre-dhe-post-covid-19-ku-do-kalojmë-pushimet-këtë-vit/>
- <https://a2news.com/video/sfidat-teknologjike-te-kompanive-shqiptare/>
- <https://www.fastnewsalbania.com/2020/05/zgjidhjet-urgjente-per-sektorin-e-transportit-nderkombetar-te-udhetarëve>
- <https://www.ecdc.europa.eu/en/publications-data/covid-19-aviation-health-safety-protocol>
- <https://www.voanews.com/economy-business/global-times-chinas-airlines-cut-international-flights-due-coronavirus>
- <https://www.bbc.com/news/business-51232374>

- <https://www.forbes.com/sites/willhorton1/2020/01/26/china-bans-outbound-group-travel-airline-impacts-vary-as-wuhans-novel-coronavirus-tackled/#4441ef512fb4>
- <https://www.newsbomb.al/do-mbështetet-sektori-i-transportit-të-udhëtarëve-për-ti-mbijetuar-pandemisë-201225>
- <http://www.gazetadita.al/ridimensionimi-i-turizmit-në-shqipëri-dhe-rol-i-e-business>
- <https://portavendore.al/2020/04/13/turizmi-drejt-falimentit-bizneset-me-sytë-nga-paketa-ii-e-qeverisë/>
- <https://www.etiasvisa.com/etias-news/etias-role-protecting-public-health>
- <https://voyagesafriq.com/2020/04/10/rethinking-and-reinventing-travel-and-tourism-post-covid-19/>
- https://www.investment.com.al/wp-content/uploads/2020/07/EN_Covid-19-on-the-Business.pdf

SI, SA DHE ÇFARË NDIKIMI PATI COVID 19 NË EKONOMINË BRITANIKE

MSc.Elona Shehu
Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë
elonashahini@umsh.edu.al

Abstrakt

Pandemia e cila filloi ne vitin 2019 në Kinë dhe që u quajt COVID 19, ndikoi të gjithë globin duke shkaktuar depresione ekonomike te ngjashme me krizat me te thella financiare, ekonomike dhe sociale të shkaktuara ndonjëherë më parë. Do ta kujtojmë vitin 2020 si vitin që u goditëm, së bashku me të gjitha kombet e tjera, nga një armik i panjohur më parë. Si pjesa tjetër e botës, edhe Anglia ka paguar një çmim të rëndë për nga numri i jetëve të humbura dhe goditja ekonomike. Është menduar të analizohen pasojat në këtë vend pasi ishte një ndër të paktat vende që mendonte të mos kufizonte përditshmërinë. Por, duheshin ndërmarrë vendimet e duhura në kohën e duhur, bazuar në gjetjet shkencore. Përparësia kryesore e masave të ndërmarrat ishte mbajtja e vendit në kushte të sigurta.

Duke marrë parasysh kërcënimin që virusi shkaktonte për sistemin shëndetësor dhe kapacitetet që ai kishte. Një problem global ka nevojë për zgjidhje globale. Por ndërsa shpresojmë për një përparim, shpresa nuk është një plan. Kjo është arsyeja pse Mbretëria e Bashkuar ka qenë në pararojë të përgjigjes ndërkombëtare ndaj virusit. Sa më gjatë virusi të ndikojë në ekonomi, aq më të mëdha janë rreziqet e dhëmbëzimit afatgjatë dhe aktivitetit të ulët ekonomik përgjithmonë, me dështime biznesi, papunësi vazhdimisht më të lartë dhe fitime më të ulëta. Kjo do të dëmtonte qëndrueshmërinë e financave publike dhe aftësinë për të financuar shërbime publike përfshirë NHS. Kjo gjithashtu ka të ngjarë të çojë në rezultate më të këqija të shëndetit fizik dhe mendor, me një rritje të konsiderueshme të prevalencës së sëmundjes kronike. Materiali konsiston në analizimin e situatës nëpërmjet të dhënave sekondare të botuara nga institucionet e MB.

Fjalë kyçe: Britania e Madhe, COVID 19, efekte ekonomike, efekte sociale, masa parandaluese, masa mbeshtetëse, masa post pandemie, etj.

Abstract

The pandemic which began in 2019 in China and was called COVID 19, affected the entire globe, causing economic depressions similar to the deepest financial, economic and social crises ever caused. We will remember 2020 as the year we were hit, along with all the other nations, by an unknown enemy. Like the rest of the world, England has paid a high price by the number of lives lost and the economic crisis. In this paper is intended to analyze the consequences in this country as it was one of the few countries that thought not to limit normal life. But the right decisions had to be made in a timely manner, based on scientific findings. The main advantage of the measures taken was to keep the country safe.

Considering the threat that the virus posed to the health system and the capacities it had. A global problem needs global solutions. But while we hope for progress, hope is not a plan. That is why the United Kingdom has been at the forefront of the international response to the virus. As long the virus affects the economy, present is the risks of long-term of low economic activity, with business failures, consistently higher unemployment, and lower profits. This would damage the sustainability of public finances and the ability to finance public services including NHS. This is also likely to lead to worse physical and mental health outcomes, with a significant increase in the prevalence of chronic disease. The material consists of analyzing the situation through secondary data published by UK institutions.

Keywords: UK, COVID 19, economic effects, social effects, preventive measures, support measures, post-pandemic measures, etc.

Hyrje

Pandemia e cila filloi ne vitin 2019 ne Kinë dhe që u quajt COVID 19, ndikoi të gjithë globin duke shkaktuar depresione ekonomike te ngjashme me krizat me te thella financiare, ekonomike dhe sociale të shkaktuara ndonjëherë më parë. Do ta kujtojmë vitin 2020 si vitin që u goditëm, së bashku me të gjitha kombet e tjera, nga një armik i panjohur më parë dhe i pafytyrë. Si pjesa tjetër e botës, edhe Mbretëria e Bashkuar (MB) ka paguar një çmim të rëndë për nga numri i jetëve të humbura dhe goditjet në ekonomi dhe jetën sociale. Duhet ndërmarrë vendimet e duhura në kohën e duhur, bazuar në gjetjet shkencore lidhur me pandeminë dhe pasojat që pritet të shkaktojë. Përparësia kryesore e masave të ndërmarra në MB ishte mbajtja e vendit në kushte të sigurta. Duke marrë parasysh kërcënimin që virusi shkaktonte për sistemin shëndetësor dhe kapacitetet që ai kishte.

Deri në 15 qershor 41.698 njerëz kanë humbur jetën në Mbretërinë e Madhe. Zyra për Përgjegjësi Buxhetore (OBR) dhe Banka e Anglisë kanë shprehur qartë që nëse Qeveria nuk do të kishte ndërmarrë veprimet që ata kishin propozuar, situata do të ishte shumë më e keqe. Por pavarësisht kësaj, ndikimi në ruajtjen e vendeve të punës dhe jetesës së njerëzve ka qenë i rëndë. Aktiviteti ekonomik është ndërprerë për një numër të madh biznesesh në ekonominë e Mbretërisë së Bashkuar, dhe jo vetëm. Qeveria po mbështet miliona familje dhe biznese, por nuk mund të mbrojë çdo vend punë dhe çdo biznes, edhe në këto raste zbatohen prioritetet.

Rreth 79% e shërbimeve, të tilla si kafenetë dhe parukeritë, raportuan një rënie të aktivitetit të biznesit gjatë mbylljes në përgjigje të koronavirusit. IHS Markit tha se PBB në Mbretërinë e Bashkuar mund të bjerë me një normë tremujore prej 7%. Ai paralajmëroi gjithashtu se rënia mund të ishte edhe më e madhe. Tim Moore, drejtori i ekonomisë në IHS Markit, tha se të dhënat "theksojnë se rënia në ekonominë e Mbretërisë së Bashkuar gjatë tremujorit të dytë të vitit 2020 do të jetë shumë më e thellë dhe më e përhapur se gjithçka që mund të perceptohet dhe shihet".


Një problem global ka nevojë për zgjidhje globale. Por ndërsa shpresojmë për një përparim, shpresa nuk është një plan. Kjo është arsyeja pse Mbretëria e Bashkuar ka qenë në pararojë të përgjigjes ndërkombëtare ndaj virusit. Sa më gjatë virusi të ndikojë në ekonomi, aq më të mëdha janë rreziqet për një ndikim afatgjatë në aktivitet të ulët ekonomik, shoqëruar me falimentim biznesi, papunësi vazhdimisht më të lartë dhe fitime më të ulëta. Kjo do të dëmtojë qëndrueshmërinë e financave publike dhe aftësinë për të financuar shërbime publike. Kjo gjithashtu ka të ngjarë të çojë në rezultate më të këqija të shëndetit fizik dhe mendor, me një rritje të konsiderueshme të prevalencës së sëmundjes kronike.

Çdo javë që kalon, mësohet më shumë rreth virusit dhe kuptohet më shumë se si të mposhtet. Por, është një e keqe e përbashkët që të gjithë duhet të punojmë së bashku për ta mposhtur. Masat që merren në vazhdimësi nuk mbështeten në "receta" të gatshme se si të luftohet virusi. Por, vende të ndryshme hartojnë plane dhe strategji për të dhënë zgjidhje të mundshme çdo situatë shëndetësore, ekonomike dhe sociale. Planet që hartohen duhet t'u japin shpresë njerëzve të Mbretërisë së Bashkuar dhe të gjithë Globit. Kjo, do të kërkojë shumë nga të gjithë që të mbetemi vigjilent dhe të kujdesemi për ata që rrezikojnë më shumë. Është e qartë se e vetmja zgjidhje e mundshme afatgjatë qëndron në një vaksinë ose trajtim të bazuar në ilaçe. Janë mbështetur deri tani dy programeve më premtuese të zhvillimit të vaksinave në Universitetin e Oksfordit dhe Kolegjit Imperial, të mbështetur nga një sektor farmaceutik i njohur globalisht. Bashkëpunimi i fundit midis Universitetit të Oksfordit dhe AstraZeneca është një hap thelbësor që mund të ndihmojë në përparimin e shpejtë të prodhimit të një vaccine COVID-19. Në rastin më të keq, kurrë nuk mund të gjendet një vaksinë. Pra, plani duhet të paraqesë një situatë ku globi do të jetë në këtë situatë për një kohë të gjatë, edhe pse po bëhet gjithçka për të shmangur atë përfundim.

Në një epidemi, një nga treguesit më të rëndësishëm është "R"-numri i riprodhimit. Nëse kjo është nën një, atëherë mesatarisht çdo i infektuar do të infektojë më pak se një person tjetër.

Kështu numri i infeksioneve të reja do të bjerë me kalimin e kohës. Sa më i ulët numri, aq më shpejtë do të bjerë numri i infeksioneve të reja. Kur R është mbi një, numri i infeksioneve të reja do të përshpejtohet. Sa më e lartë të jetë R më shpejtë përhapet virusi në popullatë.

Figura 2: Transmetimi i virusit - Diagrama skematike e transmetimit të virusit me një vlerë $R=3$, dhe ndikimi i distancimit shoqëror.



Në Mbretërinë e Bashkuar, Grupi Këshillues Shkencor për Emergjencat (SAGE) vlerësoi se R në fillim të epidemisë ishte midis 2.7 dhe 3.0; secili person me sëmundje u dha mesatarisht tre personave të tjerë virusin. Vlerësimi i fundit i SAGE është se, në të gjithë Mbretërinë e Bashkuar, R është zvogëluar në mes 0.5 dhe 0.9, që do të thotë se numri i të infektuarve po bie. Ndikimi i masave distancuese sociale në R është demonstruar edhe në figurën 2 më sipër. Numri i të shtruarve po ulet dhe vdekjet gjithashtu. Sidoqoftë, sfidat e vërteta mbesin në mbështetjen operative të nevojshme për menaxhimin e virusit. Qeveria nisur nga kjo situatë me shumë të panjohura është në gjendje vetëm të heqë me kujdes elementët e masave kufizuese dhe ti rritë ato nëse e sheh të nevojshme. Shoqëruar kjo me një plan tashmë të mirëpërcaktuar veprimi.

Impakti që pati COVID 19 në ekonominë dhe jetën sociale në Angli

Në periudha afatshkurtra ne nuk mund të bëhen ndryshime drastike. Për ta mbajtur me sukses R nën 1, ka shumë pak hapësirë për manovrim. Modelimi SAGE sugjeron që ose hapja e plotë e shkollave ose zbutja e të gjitha masave të distancimit sociale, do të çojnë në ringjalljen e virusit në një valë të dytë që mund të jetë më e madhe se e para. Në një popullatë ku shumica e njerëzve nuk kanë imunitet, epidemia do të dyfishohet në madhësi çdo disa ditë nëse nuk ekzistonin masa kontrolli.

Në periudhë afatmesme, lejimi i virusit të përhapet në mënyrë të pakontrolluar derisa të arrihet imunitet natyror në nivelin e popullsisë, do ta vinte sistemin shëndetësor nën presion të madh. Në asnjë moment nuk ka qenë kjo pjesë e strategjisë së qeverisë. Nuk është e mundur të dihet me saktësi efikasiteti relativ i masave specifike të mbrojtjes dhe shtypjes, as sa njerëz në popullatë janë ose janë infektuar në mënyrë asimptomatike. Edhe ata që nuk janë në rrezik të një dëmi të rëndësishëm vetë mund të përbëjnë një rrezik të vërtetë të infektimit pa dashje të tjerëve.

Krahas masave distancuese sociale janë ndërmarrë gjithashtu edhe për të mbështetur njerëzit dhe bizneset përmes kësaj krize dhe për të minimizuar ndikimet e thella dhe të gjata për ekonominë. Vlerësohet nga burime zyrtare se 800,000 punëdhënës kanë aplikuar në Skemën e ndihmër për të ndihmuar në pagesën e pagave të 6.3 milion vendeve të punës duke filluar nga data 3 maj.

Papunësia po rritet nga një nivel i ulët 40-vjeçar në fillim të vitit; rreth 1.8 milion familje kanë bërë kërkesa për Kredi Universale midis 16 Marsit dhe 28 Prillit 12. OBR ka publikuar një skenar 'referencë' i cili sugjeron që, nëse masat aktuale qëndrojnë në vend deri në Qershor dhe lehtësohen më pas gjatë tre muajve të ardhshëm, papunësia do të rritet me më shumë se 2 milion

në tremujorin e dytë të vitit 2020.¹³ Skenari i OBR sugjeron që PBB mund të bjerë me 35% në tremujorin e dytë të këtij viti - dhe tkurrja vjetore mund të ishte më e madhja në mbi 300 vjet.¹⁴ Qeveria duhet të përgatitet për sfidat që do të sjellë sezoni i gripit dimëror. Kjo do të ketë efekte të gjera, nga pengimi i çdo përpjekjeje për të gjurmuar virusin (sepse kaq shumë njerëz pa COVID-19 ka të ngjarë të kenë simptoma që ngjajnë me COVID-19, e cila mund të çojë në rritje të shtrimeve).

Masat që duhet të ndërmerren në vazhdim

Ekziston rreziku që nëse qeveria vendos të kthejë të njëjtat masa, kjo do të shkaktojë një shpërthim të dytë që mund të mposhtë çdo skenar. Mbretëria e Bashkuar duhet të përshtatet me një realitet të ri një ku shoqëria mund të kthehet në normale sa më shumë që të jetë e mundur, ku fëmijët mund të shkojnë në shkollë, familjet mund të shohin njëri-tjetrin dhe jetesa mund të mbrohet, ndërsa gjithashtu vazhdon të mbrohet kundër përhapjes së sëmundjes. Një ekonomi e fortë është mënyra më e mirë për të mbrojtur vendet e punë dhe për të siguruar që Qeveria mund të financojë shërbimet publike thelbësore të vendit, përfshirë përgjigjen e kujdesit shëndetësor.

Kjo do të thotë që Qeveria do të marrë parasysh:

- ndikimi ekonomik afatshkurtër
- e ardhmja ekonomike afatgjatë e vendit
- stabiliteti financiar në mënyrë që bankat dhe të tjerët të mund të vazhdojnë të ofrojnë financa për ekonominë;
- mbrojtja e konkurrencën ekonomike ndërkombëtare të Mbretërisë së Bashkuar

Pranohet nga autoritetet që masat për distancim social mund të përkeqësojnë sfidat shoqërore, nga ndikimet negative në shëndetin mendor të njerëzve dhe ndjenjat e izolimit, deri te rreziqet e abuzimit në familje dhe mashtrimet në internet. Qeveria duhet të veprojë për të minimizuar kostot e pafavorshme sociale, si ashpërsinë dhe kohëzgjatjen e tyre. Gjatë javëve dhe muajve të ardhshëm, Qeveria do të monitorojë nga afër efektin e secilit rregullim, duke përdorur efektin në epidemi për të vlerësuar hapin e duhur të ardhshëm.

Kjo do të thotë që Qeveria do të marrë parasysh:

- numrin e ditëve të shkollës që humbasin fëmijët;
- transparenca e çdo veprimi që merr Qeveria, veçanërisht ato me ndikim në distancimin social
- rëndësinë e ruajtjes së forcës së shërbimeve publike dhe organizatave qytetare

Konkluzione dhe Rekomandime

Kur anëtarët e tjerë të shoqërisë të kthehen në aspekte të jetës së tyre të përditshme normale, sfida për ata që u kërkohet të mbrohen mund të thellohet. Do të vazhdohet me rishikimin e nevojave mbështetëse dhe mbrojtëse për aq kohë sa shoqëria dhe individit nevojë për ndihmën e drejtpërdrejtë të autoriteteve publike.

Shumë biznese në të gjithë Mbretërinë e Bashkuar tashmë kanë qenë shumë inovative në zhvillimin e mënyrave të reja, të qëndrueshme të të bërit biznes. Shumë nga këto ndryshime, si rritja e volumit të punës nga shtëpia kanë përfitime të konsiderueshme. Të gjitha kompanitë duhet të jenë më inovative në zhvillimin e qasjeve të reja gjatë kësaj situatë. Kërkimi dhe Inovacioni në Mbretërinë e Bashkuar (UKRI) do të mirëpresë aplikacionet për grante për propozime për të zhvilluar teknologji dhe qasje të reja që ndihmojnë Mbretërinë e Bashkuar të lehtësojë ndikimin e këtij virusi.

Më 4 maj, Mbretëria e Bashkuar bashkë-drejtoi veprimtarinë e zotimit ndërkombëtar të përgjigjes Coronavirus, duke bashkuar 42 kombe për të mobilizuar 6.5 bn £. Mbretëria e

Bashkuar gjithashtu bashkë-drejtoi, me Indinë, zhvillimin e Planit të Veprimit të G20 që, përveç të tjerash, kërkon zbatimin e shpejtë të paketës prej 200 miliardë dollarësh (USD) të mbështetjes globale nga Grupi i Bankës Botërore dhe Bankat e Zhvillimit Rajonal. Kjo gjithashtu ka parë një pezullim historik të shlyerjeve të shërbimit të borxhit për kreditorët zyrtarë, me vlerë 12 miliardë dollarë (USD), për vendet më pak të zhvilluara në botë deri në vitin 2021.

Kontributet në Mbretërinë e Bashkuar gjithashtu kanë luajtur një rol të rëndësishëm për të siguruar që përgjigja globale është e financuar dhe e përshtatshme për qëllimet për të cilat është krijuar. MB përfaqëson kontributin më të madh të çdo vendi në apelin e Koalicionit Epidemik të Gatishmërisë së Inovacioneve, i cili po bën përpjekjet për të zhvilluar një vaksinë COVID-19. Mbretëria e Bashkuar gjithashtu do të sigurojë 330 milion në vit për pesë vitet e ardhshme për Global Vaccine Alliance (Gavi), duke e bërë Mbretërinë e Bashkuar donatorin më të madh në botë dhe Gavi gati që të shpërndajë një vaksinë COVID-19 në vendet në zhvillim.

Bibliografia

- <https://www.aljazeera.com/ajimpact/uk-post-coronavirus-economy-report-200602045758726.html>
- <https://voxeu.org/article/three-scenarios-impact-coronavirus-uk-economy>
- <https://www.theguardian.com/business/2020/may/27/how-the-coronavirus-crisis-has-hit-the-uk-economic-outlook>
- <https://www.bbc.com/news/business-52542943>
- <https://www.resolutionfoundation.org/publications/the-economic-effects-of-coronavirus-in-the-uk/>
- <https://edition.cnn.com/2020/05/07/economy/uk-economy-bank-of-england/index.html>
- <https://www.statista.com/study/71627/coronavirus-impact-on-the-uk-economy/>

Msc. Ina Shehu
Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë
inashehu@umsh.edu.al

Abstrakt

Debati mbi borxhin publik është ndezur përsëri kohët e fundit si pasojë e krizës së Covid -19 e cila e gjeti Shqipërinë me hapsirë të kufizuar për të vepruar nëpërmjet politikës fiskale dhe monetare. Koronavirusi dhe dy paketat ekonomike për mbështetjen e biznesit dhe individëve përmes politikave të mbështetjes financiare nxorën në pah problematika të ndryshme dhe sprovuan një ekonomi të vogël si ajo e vendit tonë. Si pasojë e dy goditjeve të njëpasnjëshme: tërmetit të 26 nëntorit 2019 dhe pandemisë globale, borxhi publik në vend si në vlerë nominale ashtu edhe në raport me PBB-në duket se është rritur. Recesioni ekonomik dhe masat mbështetëse ekonomike parashikohet të thellojnë deficitin fiskal dhe borxhin e qeverisë. Në bazën e çdo studimi mbi borxhin publik qëndron pyetja se sa mund të rritet ky i fundit pa kompromentuar aftësinë paguese fiskale. Tashmë është e njohur se ndjekja e politikave fiskale të paqëndrueshme përkeqëson kushtet makroekonomike dhe e bën ekonominë më të prekshme ndaj goditjeve të jashtme, gjeneron një alokim joefiçent të burimeve, dëmton mirëqënien e vendit përmes defiçiteve fiskale dhe stokut të borxhit publik të tepruar. Këto pasoja të dëmshme nuk janë vetëm hipotetike. Ato janë konfirmuar nga fakti se shumë ekonomi të zhvilluara apo në zhvillim po përballen me situata kritike dhe kosto të mëdha fiskale për shkak të Covid -19. Për disa ekonomi, nivelet e reja të borxhit rezultojnë të jenë të përballueshme ndërsa për ekonomi të tjera rritja e mprehtë e borxhit publik mund të sjellë kufizime fiskale të detyrueshme.

Qëllimi i këtij studimi është një përpjekje për të kontribuar me argumenta në sqarimin e disa prej çështjeve më të mprehta mbi borxhin publik dhe Covid -19, që po debatohen gjerësisht sot në rradhët e studiuesve të shkencave ekonomike si dhe të politikanëve.

Fjalë kyçe: borxhi publik, qëndrueshmëria e borxhit, Covid 19, politika fiskale, PBB, rritja ekonomike

Abstract

The public debt debate has flared up again recently as a result of the Covid-19 crisis, which found Albania with limited space to operate through fiscal and monetary policy. The two economic packages granted from the Albanian Government in order to assist small and medium businesses and individuals through financial support policies highlighted various issues and tested the fragile Albanian economy. As a result of two consecutive natural disasters: the earthquake of November 26, 2019 and global pandemic Covid-19, public debt in the country both in nominal value and in relation to GDP seems to have increased consistently. Economic recession and supportive economic measures from the government side are likely to deepen the fiscal deficit and government debt. At the core of any public debt study remains the question of how much the latter can grow without compromising fiscal solvency. It is already acknowledged that pursuing unsustainable fiscal policies worsens macroeconomic conditions and makes the economy more vulnerable to external shocks, generates inefficient allocation of resources, damages the country's welfare through fiscal deficits and excessive public debt stock. These harmful consequences are not just hypothetical. They have been confirmed by the fact that many developed or developing economies are facing critical situations and high fiscal costs due to Covid-19. For some economies, new debt levels turn out to be affordable, while for other economies the sharp rise in public debt can lead to mandatory fiscal constraints.

The purpose of this study is to try to contribute with arguments in clarifying some of the most intensely felt issues on public debt and Covid-19, which are being widely discussed today in the levels of economics researchers and politicians.

Keywords: public debt, debt sustainability, Covid-19, fiscal policy, GDP, economic growth.

1. Hyrje

Historia ka treguar se ekonomitë përballen me barrën e borxhit në mënyra të ndryshme. Ndonjëherë, krizat shfaqen edhe në ekonomi, të cilat paraqesin nivele të ulta të borxhit ndaj (PBB), ndërsa ekonomi të tjera funksionojnë shumë mirë edhe kur borxhi i tyre publik tejkalon në mënyrë të konsiderueshme vlerën e përgjithshme të prodhimit në vend, gjatë një viti. Si rrjedhim, është e vështirë të flasësh për ekzistencën e kufijve absolut dhe universal të borxhit publik megjithëse, mund të thuhet se këto kufij preken atëherë kur objektivat e politikës fiskale janë në rrezik. Në përgjithësi, thuhet se niveli optimal i borxhit publik nuk arrihet deri atëherë kur shtesa e shpenzimeve publike të financuara nga borxhi të rrisin apo përmirësojnë kapacitet prodhues të ekonomisë apo të mundësojnë afrimin drejt shpërndarjes së dëshiruar.

Nisur nga fakti se nuk ekziston asnjë përkufizim unik apo i pranuar gjerësisht lidhur me qëndrueshmërinë e borxhit publik, kjo bën që në të njëjtën kohë të ekzistojë një shkallë e lartë mosmarrëveshjeje. Debati mbi borxhin publik është ndezur përsëri kohët e fundit si pasojë e krizës së Covid -19 e cila e gjeti Shqipërinë me hapsirë të kufizuar për të vepruar nëpërmjet politikës fiskale dhe monetare. Koronavirusi dhe dy paketat ekonomike për mbështetjen e biznesit dhe individëve përmes politikave të mbështetjes financiare nxorrën në pah problematika të ndryshme dhe sprovuan një ekonomi të vogël si ajo e vendit tonë. Si pasojë e dy goditjeve të njëpasnjëshme: tërmetit të nëntorit 2019 dhe pandemisë globale, borxhi publik në vend si në vlerë nominale ashtu edhe në raport me PBB-në duket se është rritur. Recesioni ekonomik dhe masat mbështetëse ekonomike parashikohet të thellojnë deficitin fiskal dhe borxhin e qeverisë. Në bazën e çdo studimi mbi borxhin publik qëndron pyetja se sa mund të rritet ky i fundit pa kompromentuar aftësinë paguese fiskale.

Në këtë punim janë trajtuar pikëpamje teorike klasike dhe moderne për borxhin publik si dhe disa teori të tjera relevante. Gjithashtu, është analizuar qëndrueshmëria e borxhit publik dhe është dhënë një kontribut modest në përcaktimin e nivelit të përshtatshëm të borxhit publik të Shqipërisë, në evidentimin e faktorëve të rritjes së tij, duke analizuar argumente kundër rritjes pas krizës së Covid -19.

2. Pikëpamje të teorisë klasike, moderne dhe teori të tjera relevante mbi borxhin publik

2.1 Teoria klasike dhe moderne për borxhin publik

Vështirë të gjendet ndonjë argument tjetër në fushën ekonomike që të jetë diskutuar në mënyra kaq kundërshtuese me njëra-tjetrën sesa roli i borxhit publik. Që në mes të shekullit XVIII, David Hume ka konstatuar se *“shteti duhet të zhdukë kredinë publike ose përndryshe kredia publike do ta zhdukë shtetin”*.⁵⁵ Totalisht në të kundërt, Carl Dietzel deklaroi fuqishëm 100 vjet më vonë se *“huamarrja publike është leva për progres të fuqishëm ekonomik, e cila lëviz botën nga boshti i saj”*.⁵⁶ Ndërsa 100 vjet më pas, në shek. XX, analizohen si fillim ndërlikimet që sjell për shtetin borxhi publik dhe duke menduar për rregulla që mund ta kufizojnë atë.

Teoria klasike, shfaqet kundër borxhit publik duke argumentuar se drejtuesit e pandërgjegjshëm e ngarkojnë shtetin me borxhe duke shpenzuar jo-racionalisht dhe për qëllime joproduktive. Përfaqësuesit e teorisë klasike si Smith, Rikardo, Mill, etj, hedhin disa argumenta kundër huasë publike duke përmendur se mendjelehtësia e hyrjes tepër në borxh jo vetëm që

⁵⁵ Hume, D. (1777): “Essays and Treatises on Several Subjects”

⁵⁶ Dietzel, C. (1855): “Das System der Staatsanleihen im Zusammenhang der Volkswirtschaft betrachtet”

pengon zhvillimin ekonomik dhe ndikon dëmshëm në ekonominë e vendit, por shpesh mund të përfundojë në falimentim të shtetit.

Teoria moderne e shikon huanë në mënyrë realiste duke theksuar se huaja jo vetëm është e dobishme, por edhe e domosdoshme. Kjo teori fokusohet më tepër në qëllimin e huasë, mënyrën se si do të realizohet dhe shpenzohet ajo.

Përfaqësuesit bashkëkohorë japin argumente, të cilat avantazhojnë marrjen e huasë dhe ngarkimin e shtetit me borxhe. Sipas tyre, në kohët e sotme shteti nuk do të mundte kurrsesi të kryente funksionet e tij pa iu drejtuar borxhit, i cili është pjesë e sistemit të zhvillimit të një shteti bashkëkohor. Vendet e zhvilluara karakterizohen nga tregje financiare të mirë-organizuara ndërkohë që, vendet e pazhvilluara shfaqin mjaft dobësi në sistemin bankar, në mënyrën e organizimit e tregut financiar dhe zhvillimin e tij. Kjo e vështirëson huamarrjen publike. Teorikët modern shtojnë se në një shtet modern huatë përdoren për qëllime produktive si: investim apo prodhim të cilat ndikojnë në fuqinë prodhuese të vendit dhe ndihmojnë në krijimin e kushteve dhe mjeteve për shërbimin e borxhit në të ardhmen. Nëse është arritur një ngarkesë e lartë tatimore në vend, huaja mund të jetë mënyra më e shpejtë dhe më e lehtë për mbledhjen e shumave të mëdha krahasuar me aplikimin e tatimeve të reja apo rritjen e ngarkesës së tatimeve ekzistuese.

Përveç avantazheve të sipërpërmenduara, huaja publike shfaq dhe të metat apo disavantazhet e saj.

Së pari, huaja e marrë duhet të shlyhet së bashku me detyrimet për interesin, shpenzimet administrative në lidhje me regjistrimin si dhe kosto të tjera që e shoqërojnë atë. *Së dyti*, krijohet një grup në shoqëri i cili jeton vetëm prej normave të interesit të huasë publike. *Së treti*, huaja e jashtme mund të krijojë varësi ekonomike dhe politike me shtetin huadhënës, kryesisht në rastet kur shteti huamarrës është një vend në zhvillim. *Së fundi*, duke qënë se huatë e brendshme merren nga subjekte private në vend, kjo do të zvogëlonte sasinë e mjeteve monetare të nevojshme për kryerjen e aktiviteteve të ndryshme nga këto subjekte ekonomike si dhe do të rriste normën e interesit.

2.2 Teori të tjera relevante

Borxhi publik mund të kontraktohet gjatë kohës kur shfaqen shpenzime të papritura apo të paparashikuara siç është rasti i luftës, rasti i pandemisë Covid -19 apo ndodhive natyrore. Një borxh i tillë quhet jo produktiv sepse nuk krijon ndonjë aset të caktuar apo nuk shton kapacitete produktive të ekonomisë. Shumat e interesave dhe të principalit mund të paguhen nga burime të tjera të ardhurash, përgjithësisht nga taksat dhe prandaj borxhe të tillë janë barrë për komunitetin.

*Teorema e Ekuivalences Rikardiane*⁵⁷ është një teori ekonomike e cila argumenton se nuk ka rëndësi mënyra se si qeveria i financon shpenzimet e saj, nëpërmjet borxhit publik apo rritjes së nivelit të taksave, sepse niveli i kërkesës totale në ekonomi do të mbetet gjithmonë i njëjtë. Nëse qeveria financon shpenzimet e saj duke marrë borxh nga taksapaguesit, në të ardhmen kjo do të nënkuptonte rritjen e taksave për financimin e borxhit. Pra, taksat do të ndryshohen herët a vonë. Konsumatorët racionale nuk do t'i shpenzojnë të ardhurat e tyre shtesë, por do t'i kursejnë ato me qëllimin që vetë ata apo fëmijët e tyre të paguajnë taksat e rritura në të ardhmen. Megjithatë, kjo teori ka dy momente të cilat mund të cilësohen si kritike. *Së pari*, jo të gjithë konsumatorët janë racionale dhe disa prej tyre nuk do ta presin apo logjikojnë një rritje të taksave në të ardhmen. *Së dyti*, si pasojë e recensionit prirja mesatare për konsum do të bjerë dhe disa nga të ardhurat shtesë do të shpenzohen, megjithëse prirja marxhinale për kursim rritet. (Robert Barro 1974). Nëse borxhi qeveritar drejtohet drejt konsumit dhe jo drejt investimeve, do të ketë një ulje të njëkohëshme në formimin e kapitalit dhe rritjes ekonomike.⁵⁸ Modelet e rritjes (Saint-Paul 1992) theksojnë se barra e tepërt e borxhit imponon kosto për

⁵⁷ Barro, Robert J., Reflections on Ricardian Equivalence (March 1996). NBER Working Paper No. w5502

⁵⁸ Barro, R (1974), "Are Government Bonds Net Wealth?", *Journal of Political Economy* 82(6): 1095–17

rritjen ekonomike.⁵⁹ Kejnianët e rinj (Eggertsson dhe Krugman 2012) konfirmojnë mundësinë e rritjes së ngadaltë për shkak të kufizimeve të borxhit.⁶⁰

3. Qëndrueshmëria e borxhit publik

Ekonomi të ndryshme përballen me barrën e borxhit në mënyra të ndryshme. Ndonjëherë, krizat shfaqen edhe në ekonomi të cilat paraqesin nivele të ulëta të borxhit ndaj Produktit të Brendshëm Bruto (PBB), ndërsa ekonomi të tjera funksionojnë shumë mirë edhe kur borxhi i tyre publik tejkalon në mënyrë të konsiderueshme vlerën e përgjithshme të prodhimit në vend gjatë një viti.

Si rrjedhim, bëhet e vështirë të flasim për ekzistencën e kufijve absolute dhe universal të borxhit publik megjithëse, mund të thuhet se këto kufij preken atëherë kur objektivat e politikës fiskale janë në rrezik. Në përgjithësi, thuhet se niveli optimal i borxhit publik nuk arrihet deri atëherë kur shtesa e shpenzimeve publike të financuara nga borxhi të rrisin apo përmirësojnë kapacitetet prodhuese të ekonomisë apo të mundësojnë afrimin drejt shpërndarjes së dëshiruar.⁶¹

Në mënyrë të ngjashme, shpesh konsiderohet se një huamarrje e re është një lëvizje e "zgjuar" nëse është në përputhje me qëllimet makroekonomike (rritja e investimeve private, kontrolli i inflacionit, ruajtja e besueshmërisë). Duke qënë se kriteret të cilat lidhen me nivelin e kënaqshëm të huamarrjes janë të vështira për t'u matur, aplikohen disa raporte të thjeshta që shërbejnë si tregues të huamarrjes si dhe paraqesin mundësinë për huamarrje të mëtejshme. Nëse borxhi rritet me 5% në vit ndërkohë që kemi një rritje ekonomike po prej 5% në vit, atëherë mund të themi se jemi duke stabilizuar borxhin në raport me PBB-në. Nëse borxhi rritet me 5% në vit, por kemi një rritje negative ekonomike prej -2%, atëherë borxhi në raport me PBB-në është rritur me 7% në vit. Siç mund të vërehet edhe nga shembujt e marrë, rritja ekonomike është një faktor kyç në përcaktimin e borxhit ndaj PBB-së.

Një politikë fiskale e qëndrueshme do të thotë që borxhi publik në termat e PBB-së nuk ka prirje pozitive. Çdo politikë huamarrjeje që nuk është e paqëndrueshme, shpesh konsiderohet si e qëndrueshme. Thënë ndryshe, me qëndrueshmëri të borxhit i referohemi shërbimit të borxhit i cili do të mbahet në ato nivele për një kohë të gjatë në mënyrë të tillë që shteti mos të ketë vështirësi në përballimin e këtyre shpenzimeve.

Kjo do të thotë se:

volumi i shërbimeve të borxheve nuk duhet të ndikojë shpenzimet e zakonshme, pjesa e borxhit publik ndaj PBB-së është e ulët dhe nuk rritet me kalimin e kohës.

Në terma teknik, kjo do të kërkonte që shpenzimet e shërbimit të borxhit dhe përfitimet nga burimet e marra hua të paktën ë balancojnë njëra-tjetrën apo që norma e parashikuar e rritjes së borxhit publik të jetë më e vogël se norma e interesit gjatë një periudhe afatgjatë. Gjithsesi, kur borxhi është duke financuar konsumin ose duke u përdorur në mënyrë joproductive, ka të ngjarë të bëhet më i paqëndrueshëm në kohë. Kjo ndodh sepse financimi i borxhit nuk është duke shtuar kapacitetet produktive dhe të ardhurat për gjenerimin e kapaciteteve për ekonominë dhe shteti do ta kishte të vështirë për të shlyer principalin dhe detyrimet e interesit. Nga një tjetër këndvështrim, politika e huamarrjes së një qeverie është e paqëndrueshme nëse subjektet private (vendase dhe të huaja) e konsiderojnë atë si të tillë. Kjo do të thotë se kreditorët duke dyshuar për aftësitë e vendit lidhur me shlyerjen e kredisë, do të pezullojnë dhënie e kredive. Kreditorët vendas mund të presin një rritje të taksave dhe emetim parash në të ardhmen, e lidhur kjo e fundit me inflacionin, madje dhe zhvlerësim, të cilat të gjitha sëbashku mund të çojnë në kursime të monedhës vendase, duke marrë kapital jashtë vendit dhe

⁵⁹ Saint-Paul, G (1992), "Fiscal Policy in an Endogenous Growth Model", *Quarterly Journal of Economics* 107(4): 1243–59.

⁶⁰ Eggertsson, G and P Krugman (2012), "Debt, Deleveraging, and the Liquidity Trap: A Fisher-Minsky-Koo Approach", *Quarterly Journal of Economics* 127(3): 1469–1513.

⁶¹ Brummerhoff, Dieter, (1996), *Finanzwissenschaft*, Munchen: Oldenbourg

duke cuar në fund në një krizë financiare apo në krizë të bilancit të pagesave. Ky është një skenar i zakonshëm për vendet me tregje financiare të pazhvilluara.⁶² Në vendet me tregje të zhvilluara financiare, një politikë e huamarrjes së qëndrueshme mund të shkaktojë rritje në ofertën e obligacioneve qeveritare, gjë e cila çon në rritjen e çmimit të tyre dhe uljen e normës së interesit. Sipas një tjetër skenari⁶³, në të njëjtat kushte, një politikë e një borxhi të paqëndrueshëm do të çojë në rënien e kërkesës për obligacionet qeveritare dhe një rritje në normat e interesit të tyre, gjë e cila nga ana tjetër do e pengonte shtetin të kontrollonte normën e rritjes së ofertës monetare dhe inflacionin.

4. Kriza e Covid -19 dhe borxhi publik në Shqipëri

4.1 Goditja e kërkesë – ofertës si pasojë e Covid -19

Pandemia Covid-19 krijoi një krizë të thellë shëndetësore dhe ekonomike duke goditur veçanërisht bizneset e vogla dhe të mesme (SME) në anën e kërkesës dhe ofertës duke bërë që ato të tkurren njëkohësisht. Ekonomia u përballë papritur me një rënie të kërkesës dhe ulje të të ardhurave të SME e cila solli mungesë të theksuar të likuiditetit. Konsumatorët pësuan humbje të të ardhurave duke bërë që shpenzimet e konsumit të ulen si mungesë e të ardhurave dhe si mungesë e gadishmërisë për të paguar si pasojë e pasigurisë për të ardhmen. Ata shmangen aktivitetet jo jetike, investimet, konsumi jo jetik, etj duke i shtyrë ato në një moment të dytë.

Në anën e ofertës, ndërmarrjet u detyruan të qëndrojnë të mbyllura ose të zvogëlojnë veprimtarinë e tyre. Ato u përballen me ulje të burimeve njerëzore dhe ulje të kapaciteteve prodhuese. Duke mos patur aftësi për t'u përgjigjur krizës në shkallën dhe thellësinë e nevojshme ato u detyruan të largonin punëtorë nga puna duke mos qenë në gjendje të paguajnë pagat. Gjithashtu, burimet njerëzore u ulen dhe si pamundësi e disa punëtorëve për të punuar për shkak të kufizimit të lëvizjes apo si nevojë për t'u kujdesur për persona të tjerë (fëmije, persona të varur, etj).

Këto efekte të kombinuara me njëra-tjetrën preken të gjithë sektorët e ekonomisë duke e bërë të domosdoshme ndërhyrjen e shtetit për të mbajtur në këmbë funksionimin e tregjeve dhe të ekonomisë në tërësi.

Ndërhyrjet e shtetit janë të domosdoshme fillimisht për të kapërcyer krizën duke marrë masat e duhura në periudhën afatshkurtër për të mbështetur ekonominë dhe më pas për të stimuluar rimëkëmbjen e saj duke siguruar një ekonomi më të qëndrueshme dhe me elastike ndaj goditjeve që do të pasojnë. Për të ruajtur vazhdimësinë e veprimtarisë ekonomike shumica e vendeve suportuan kategoritë me vulnerabël përmes granteve, subvencioneve, garancise bankare, etj për të kapërcyer vështirësitë ekonomike të krizës aktuale të Covid -19. Paketat ekonomike nuk janë të mjaftueshme për të dhënë fund krizës por ato luajnë një rol thelbësor. Shumat monetare që secili vend injektoi, mënyrat, drejtimit dhe koha ndryshojnë në ekonomi të ndryshme por të gjithë "*Paketat e Shpëtimit*" bashkohen në: injektimin monetar në ekonomi, financimin e sektorit shëndetësor, subvencionimin e pagës për punonjës të cilët mbyllen perkoheisht aktivitetin e tyre, sigurimi i likuiditetit për bizneset, mbështetjen e SME me kredi nga sistemi bankar me garanci sovraane nga qeveria dhe interes 0%, shtyrje afatesh në pagim taksash, sigurimesh shoqërore dhe detyrimesh për shërbime utilitare, etj. Në vendin tonë, mbështetja u ofrua përmes dy paketave të mbështetjes financiare.

Duke përjashtuar garancitë e huasë, të cilat mund ti kthehen ose nuk mund ti kthehen shtetit, shpenzimet e tjera fiskale do të thellojnë deficitin dhe do të rrisin ndjeshëm borxhin publik në të ardhmen e afërt. Rritjet në stokun e borxhit të qeverisë përbëjnë vetëm një nga kolonat e

⁶² IMF Institute, (1993): "Fiscal Policy for Stabilization and Adjustment: Macroeconomics and Financial Policies", Selected Readings, Vol. II.


⁶³ Sargent, Thomas J. and Neil Wallace (1981): "Some Unpleasant Monetarist Arithmetic", Federal Reserve Bank of Minneapolis Quarterly Review, fq. 1-17.

prekura nga barra e borxhit me të cilat duhet të përballë ekonomia. Agjentë të tjerë ekonomikë, si familjet të cilat u përballën me një rënie theksuar të të ardhurave dhe me papunësi të pavullnetshme, kanë të ngjarë ti drejtohen borxheve. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (SME) të cilat u ndeshën me një kolaps të papritur dhe të pashembullt të kërkesës kanë të ngjarë të kërkojnë kredi bankare. Kjo rritje e pritshme e borxhit privat do të ketë ndikimin e saj edhe në atë publik.

4.2 Borxhi publik në Shqipëri dhe Covid -19

Lufta kundër pasojave ekonomike të Covid -19 solli një rritje të konsiderueshme të borxhit publik edhe për Shqipërinë duke e konsideruar si një mekanizëm për rikuperimin e ekonomisë. Pas një rritje të shpejtë të borxhit publik në Shqipëri ndërmjet viteve 2010–2013, trajektorja e borxhit publik filloi të kishte një tendencë rënësive pas vitit 2015. Mbështetur nga një rregullim i konsiderueshëm fiskal në tre vitet e fundit, borxhi i përgjithshëm publik ra nga kulmi i tij në nivelin 72,7 % të PBB-së në vitin 2015, në 68,0 % në vitin 2018.


Grafik 1. Përqindja e borxhit ndaj PBB-së 2008-2018



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Megjithëse në raportin e tyre ndërkombëtarët shprehen se në përgjithësi ekziston hapësira për thellimin e defiçiteve gjatë krizës së COVID-19, e cila duhet të përdoret krahas aktivizimit të masave mbështetëse të politikës ekonomike, pritët që politika fiskale të frenohet nga shqetësimet për mbajtjen e borxhit nën kontroll. Sipas skenarëve bazë të qeverisë dhe FMN-së efektet negative të tërmetit të 26 nëntorit 2019 dhe kriza ekonomike që krijoi pandemia Covid -19 do të rrisin borxhin publik në 75.6% të PBB-së duke shkuar në një trajektore rënësive pas 2021. Sipas referimit të FMN-së, shkak për rritjen e borxhit do të jetë edhe rënia e rritjes ekonomike, e cila parashikohet në -5%, nga 3% që ishte pritshmëria në fillim të vitit. Ndërkohë, recesioni dhe masat mbështetëse ekonomike parashikohet të zgjerojnë defiçitin fiskal në 5.4 % të PBB-së.

Grafik 2. Rritja reale e ekonomisë shqiptare, në vitet 2016-2021



Burimi: FMN, INSTAT

Sipas skenarit bazë të FMN, raporti i borxhit publik ndaj PBB-së parashikohet të arrijë në 56,8 % deri në vitin 2024.

Shteti shqiptar ka marrë 170 milionë euro borxh nga FMN me një normë interesi 4.05 % për të mbuluar nevojat financiare për shkak të pandemisë dhe 650 milionë euro nga Eurobondi. Borxhi i jashtëm është forma më e rëndësishme e mbledhjes së mjeteve monetare për shtetet në zhvillim, megjithatë ekspertët theksojnë se duhet të ishte parë edhe mundësia për borxhet e brendshme.

Cilat janë avantazhet dhe disavantazhet e një borxhi publik të jashtëm?

Avantazhet e borxhit publik të jashtëm:

Nëpërmjet borxhit të jashtëm shteti mund t'i realizojë më shpejt qëllimet e caktuara.

Kur mjetet monetare në vend nuk janë të mjaftueshme dhe kushtet në botën e jashtme paraqiten më të volitshme, borxhi i jashtëm avantazhohet.

Financimi i deficitit buxhetor i krijuar për arsye të ndryshme të cilat ndikojnë stabilitetin ekonomik të vendit.

Disavantazhet e borxhit publik të jashtëm:

Kthimi i borxhit si dhe pagimi i normës së interesit duhet të kryhen në valutë të huaj. Kjo situatë do të ndikonte në keqsimin e bilancit të pagesave në vend.

Pagesat e mëdha në dobi të botës së jashtme dobësojnë monedhën vendase duke ndikuar kështu në pozitën tregtare ndërkombëtare të vendit, e cila është e lidhur me konkurrueshmërinë dhe avantazhet në këto tregje.

Dalja në tregjet ndërkombëtare e shtetit shqiptar duke kërkuar here pas here borxh mund të rrezikojë stabilitetin ekonomik të vendit. Megjithatë, esenca qëndron në mënyrën se si ky borxh do të menaxhohet. Prioriteti i shtetit nuk duhet të jetë vetëm siguri i të ardhurave për ata persona që humbën punët e tyre në mënyrë të pavullnetshme, por fillimisht duhet të fokusohet në mbrojtjen e tyre për të ruajtur vendin e punës ose për të kanalizuar ata në drejtime të tjera. Ashtu sic e theksuam edhe më sipër, subvencionet për punonjësit dhe të papunët në kushtet e humbjes së të ardhurave, pagesat e kontributeve janë hapa të rëndësishëm por ato nuk paraqesin një kthim të ardhurash për të financuar borxhin e jashtëm. Thelbësore është

mbështetja me likuiditet e bizneseve që u preken nga kjo goditje, qoftë SME apo të vetëpunësuar duke e bërë mbështetjen e ofruar me gjithëpërfshirëse.

4.3 Argumente kundër rritjes së nivelit të borxhit publik në Shqipëri

Mënyra sesi klasifikohet ekonomia e një vendi bazohet shumë në nivelin e borxhit. Dalja në tregun ndërkombëtarë me tregues të përkeqësuar të ekonomisë së vendit do ta vështirësonte shërbimin e borxhit dhe do të rriste koston e tij në të ardhmen. Një borxh i lartë e pengon rritjen ekonomike si dhe kufizon politikat sociale që mund të ndërmerren.

E para, nëse ekonomia do të ketë vërtet një rritje ekonomike -5% është momenti për të qënë më të kujdesshëm. I gjithë debati lidhet me faktin se sa dhe si duhet të shkurtohen deficietet dhe borxhet publike, duke mos dëmtuar rritjen ekonomike, pa të cilën nuk arrihet stabiliteti financiar. Pa rritje ekonomike stabiliteti i financave jo vetëm që nuk arrihet, por përkeqësohet. Një borxh publik i lartë sot imponon rritjen e taksave nesër. Sot, borxhin po e krijojmë lehtë, por brezat e ardhshëm nuk do e falin lehtë këtë veprim nëse nuk është i mirë-argumentuar. Rritja e borxhit publik nuk do jetë pa efekt edhe në jetën e shtetasit të thjeshtë dhe të biznesit, pasi ndikon tek normat e interesit të kredive. Rritja ekonomike e ngadalësuar nga borxhi i lartë përkthehet në më pak vende të reja pune. Nga rezultatet e një studimi të realizuar pranë INSTAT vërejmë se, një rritje me 1,0 % e normës së PBB-së do të shkaktonte një rënie të borxhit publik me 0,09 %.⁶⁴

E dyta, nëse rritja e borxhit publik argumentohet se duhet të mbështesë rritjen ekonomike dhe të ndalojë recesionin dhe krizën ekonomike që solli Covid -19, kjo kërkon politika buxhetore që nuk çenojnë rritjen afatgjatë. Politikat e rritjes së mirëqenies nëpërmjet rritjes së borxheve janë të dështuara. Pyetja që lind vetvetiu është: *A ka rritje ekonomike pa rritje në punësim?! Ajo që mbetet të thuhet është se një situatë e tillë kërkon reflektim se pse kjo rritje e deritanishme nuk po gjeneron prodhim, rritje të ardhurash, mirëqenie dhe barazi sociale, punësim, etj. Pikërisht, është prodhimi ai që e rrit ekonominë dhe jo shpenzimet! Ekonomia vendase nuk e ka vënë theksin në degët e prodhimit por në degë që përfaqësohen prej shpenzimeve.*

E treta, nëse rritja e përkohëshme e defiçiteve dhe borxheve financohet me norma interesi afër zeros, edhe në këtë rast, një pjesë të konsiderueshme të koston e paguajnë taksapaguesit. Ekonomia nuk ka para me kosto zero, kjo kosto indirekt transferohet tek taksapaguesi.

E katërta, edhe në debatet akademike nuk justifikohet në asnjë rast rritja e defiçitit dhe borxhit pa pasur një strategji të qartë të reduktimit të tyre. Niveli optimal i borxhit në raport me PBB-në, ndryshe nga çfarë dëshirojnë të argumentojnë disa ekspertë apo opinionistë nuk është një shifër krejt konvencionale, por një kufi që ka një logjikë ekonomike prapa tij. Për çdo grup vendesh ka një nivel të caktuar borxhi. Për ekonomitë e mëdha e të zhvilluara, niveli më i mirë i borxhit publik është 90%. Për ekonomi më të vogla të zhvilluara është 60 %, ndërsa për ekonomi të ngjashme si Shqipëria, rekomandohet një nivel borxhi 40 - 50 % të PBB-së. Të gjitha studimet serioze nga ekspertë ndërkombëtarë e vendas argumentojnë se kufiri i pranueshëm i borxhit, për mundësitë e përballimit normal nga ekonomia jonë është jo më shumë se 45 % dhe jo 64 % e PBB-së. Rritja e mëtejshme e borxhit do të kufizonte edhe më shumë hapësirat e politikës monetare. Sipas FMN-së (2003), në vendet me ekonomi në tranzicion dhe në zhvillim, mundësia për të gjeneruar suficit të tepërt zvogëlohet, ndërsa niveli i barrës së borxhit lëviz drejt 50 % të PBB-së. Kjo tregon se, kur borxhi publik e tejkalon kufirin prej 50 %, sjellja e politikës fiskale është e diskutueshme dhe nuk mund të garantojë aftësi pagueuese financiare pa shkaktuar rritje të mëtejshme të borxhit.

Deri tani nuk është pranuar ndonjë teori mbi nivelin optimal të borxhit publik. Për qëllime praktike, qëndrueshmëria e borxhit publik, krahasuar me nivelin e tij optimal, është më i

⁶⁴ <http://instat.gov.al/media/7041/revista-kerkimi-4.pdf>

rëndësishëm.⁶⁵ Një normë e dhënë e borxhit në përqindje të PBB-së, mund të tregojë për një qëndrueshmëri të këtij borxhi në një vend të dhënë, dhe në të njëjtën kohë po ky nivel borxhi mund të tregojë për një paqëndrueshmëri të borxhit publik, në një vend tjetër, që karakterizohet nga goditje të mëdha negative të rritjes, të normës së interesit ose të kursit të këmbimit.

Cfarë mund të ndodhë, nëse synohet të arrihet një nivel shumë i ulët i borxhit publik në një afat të shkurtër, në kushtet kur niveli aktual i tij është i lartë? Arritja e një synimi të tillë do të kërkonte ndjekjen e një politike të shtrënguar fiskale për një periudhë të gjatë kohë. Kjo mund të çonte në rënie të investimeve publike, në rënie të prodhimit potencial për periudhat e ardhshme, ngadalësim të treguesve të zhvillimit, etj.

Nga ana tjetër, çfarë do të ndodhte nëse pranohet mbajtja e një niveli më të lartë të borxhit publik? Një gjë e tillë mbart rrezikun që goditjet e kundërta (të tilla si rënia e prodhimit dhe e të ardhurave tatimore) të rrisin kostot e huamarrjes publike, normën e borxhit publik ndaj PBB-së dhe të shkaktonin paqëndrueshmëri të borxhit e për rrjedhojë edhe paqëndrueshmëri në politikën fiskale të një vendi. Kritikët argumentojnë se rritja e borxhit publik do ta përfshinte ekonominë e vendit në të tjera situata më të vështira, nga sa ka kaluar deri më tani. Ata pranojnë se ajo që është e rëndësishme në financat publike nuk është aq niveli numerik i borxhit publik, sesa qëndrueshmëria e tij, mundësia për ta financuar atë dhe sigurisht, aftësia për të kthyer borxhin së bashku me interesat.

Konkluzione

Problemi që shfaqet lidhet me pyetjen se me çfarë të ardhurash do të shlyhet një borxh i cili po rritet pa asnjë tavan, pa asnjë limit në sasi dhe në kohë? Duke pasur parasysh se heqja e tavanit të borxhit është një veprim i cilësuar si i rrezikshëm kjo sepse politikën buxhetore janë të prirura drejt shpenzimeve dhe nevojave të momentit, pyetja e mësipërme kërkon një përgjigje, e cila të jetë e përgjegjshme dhe transparente në të njëjtën kohë. Në të kundërt, rreziku që shfaq një rritje e pakontrolluar është i pashmangshëm dhe do të përngjajë gjithmonë e më shumë me një "ortek borxhi".

Ekonomistët në të gjithë botën vlerësojnë se ka një lidhje të ngushtë mes nivelit të borxhit publik dhe rritjes ekonomike, gjë që do të thotë se sa më shumë të rritet borxhi i qeverisë, aq më keq ecën ekonomia. Rritja e mëtejshme e borxhit do të kufizonte edhe më shumë hapësirat e politikës monetare. Ajo që mbetet të thuhet është se një situatë e tillë kërkon reflektim se pse kjo rritje e deritanishme nuk po gjeneron prodhim, rritje të ardhurash, mirëqenie dhe barazi sociale, punësim, etj. Pikërisht, është prodhimi ai që e rrit ekonominë dhe jo shpenzimet! Ekonomia vendase nuk e ka vënë theksin në degët e prodhimit por në degë që përfaqësohen prej shpenzimeve. Esenca qëndron në mënyrën se si ky borxh do të menaxhohet. Prioritet i shtetit nuk duhet të jetë vetëm sigurimi i të ardhurave për ata persona që humbën punët e tyre në mënyrë të pavullnetshme, por fillimisht duhet të fokusohet në mbrojtjen e tyre për të ruajtur vendin e punës ose për ti kanalizuar ata në drejtime të tjera. Thelbësore është mbështetja me likuiditet e bizneseve që u preken nga kjo goditje, duke e bërë mbështetjen e ofruar me gjithëpërfshirëse.

Bibliografi

- Barro, R (1974), "Are Government Bonds Net Wealth?", *Journal of Political Economy* 82(6): 1095–17
- Barro, Robert J., Reflections on Ricardian Equivalence (March 1996). NBER Working Paper No. w5502
- Brummerhoff, Dieter, (1996), Finanzwissenschaft, Munchen: Oldenbourg

⁶⁵ Wyplosz, Ch. (2005): "Fiscal Policy: Institutions versus Rules", National Institute Economic Review No. 191, fq.70-84

- Dietzel, C. (1855): "Das System der Staatsanleihen im Zusammenhang der Volkswirtschaft betrachtet"
- Eggertsson, G and P Krugman (2012), "Debt, Deleveraging, and the Liquidity Trap: A Fisher-Minsky-Koo Approach", *Quarterly Journal of Economics* 127(3): 1469–1513.
- <http://instat.gov.al/media/7041/revista-kerkimi-4.pdf>
- Hume, D. (1777): "Essays and Treatises on Several Subjects"
- IMF Institute, (1993): "Fiscal Policy for Stabilization and Adjustment: Macroeconomics and Financial Policies", *Selected Readings*, Vol. II.
- Saint-Paul, G (1992), "Fiscal Policy in an Endogenous Growth Model", *Quarterly Journal of Economics* 107(4): 1243–59.
- Sargent, Thomas J. and Neil Wallace (1981): "Some Unpleasant Monetarist Arithmetic", *Federal Reserve Bank of Minneapolis Quarterly Review*, fq. 1-17.
- Wyplosz, Ch. (2005): "Fiscal Policy: Institutions versus Rules", *National Institute Economic Review* No. 191, fq.70-84

IMPAKTI EKONOMIK I COVID-19 DHE E ARDHMJA E SIPËRMARJES

Ardita Hykaj
Universiteti Mesdhetar I Shqipërisë
arditahyka@umsh.edu.al

Abstrakt

COVID-19, një ngjarje e paparashikueshme dhe e papritur, u bë kryefjala e ditës tonë të përditshme, tashmë për disa muaj. Teksa të gjithë përpiqemi ti kthehemi normalitetit, në të njëjtën kohë na mundon ajo pyetje e famshme "A ka ikur vërtet ky virus vdekjeprurës apo do të përshtatemi të jetojmë me të deri sa të krijojmë imunitet ndaj tij"?

Nëse në momentin e parë të shfaqjes së këtij virusi, shqetësimi më i madh i cdo shteti të prekur ishte sigurimi i burimeve të nevojshme për urgjencat mjekësore, në një moment të dytë shqetësimi më i madh ishte mbi efektin dhe pasojat që do të sillte prania e tij në ekonominë e shtetit respektiv dhe në ekonominë globale gjithashtu. Mendohet që kriza ekonomike që do të pasohet pas COVID-19, do të jetë shumë e ndjeshme aq sa shpesh thuhet që do të përjetojmë dhe një kolaps negativ ekonomik, por e gjitha kjo ngelet në kuadrin e parashikimeve pasi është shumë e vështirë të parashikojmë me objektivitet të plotë mbi të ardhmen ekonomike.

Ajo çfarë është e dukshme deri tani, është efekti negativ që shkaktoi kjo pandemi në ekonominë e cdo vendi të prekur ku brenda një kohe shumë të shkurtër arriti të shkaktojë mijëra të vdekur, të cenojë rëndë sektorin privat, të rrisë papunësinë, dhe mbi të gjitha të rrisë pasigurinë për jetën.

Ky punim synon të analizojë ndikimin e COVID-19 në ekonominë e Shqipërisë, bazuar kryesisht në këndvështrimin e sektorit privat. Do të evidentojë masat e marra deri tani nga qeveria dhe prithmëritë e tyre tek bizneset dhe një fokus tek risitë teknologjike që solli kjo periudhë në mënyrën sesi do të bëjmë biznes. Në fund, do të nxjerrë konkluzione mbi masat dhe reformat vijuese që mund të ndërmerren qeveria për rimëkëmbjen ekonomike e parë kjo në afat mesem dhe afatgjatë.

Fjalëtkyçe: Covid 19, biznesi, e ardhmja

Abstract:

COVID-19, an unpredictable and unexpected event, became the headline of our daily routine, for several months now. As we all try to get back to normal, at the same time we are tormented by the famous question "Has this deadly virus really gone away or will we adapt to living with it until we build immunity to it"?

If in the first instance of the appearance of this virus, the biggest concern of any affected state was to provide the necessary resources for medical emergencies, in a second moment the biggest concern was over the effect and consequences of its presence in the economy of the respective state and in the global economy as well. It is thought that the economic crisis that will follow from the COVID-19 will be so significant that it is often said that we will experience a negative economic outbound, but all this remains within the framework of a forecasts as it is very difficult to predict with full objectivity over the economic future.

What is evident so far is the negative effect that this pandemic has had on the economy of every affected country, where within a very short time it has managed to cause thousands of deaths, severely damage the private sector, increase unemployment and most of all increase the insecurity of life.

This paper aims to analyze the impact of COVID-19 on the Albanian economy, based mainly on the perspective of the private sector. The measures taken so far by the government and their expectations in businesses will be highlighted and a focus on the technological innovations that this period brought and their impact in the way we will do business. Finally, it will draft conclusions on the upcoming measures and reforms that the government can undertake for the economic recovery in the medium and long term.

Keywords: Covid 19, business, the future

Hyrje

COVID-19 u shfaq për herë të parë në Ëuhan, Kinë në dhjetor të vitit 2019 dhe u desh shumë pak kohë që prania e tij të ishte prezente në cdo cep të globit. Deri në momentin e përhapjes së ndikimit të tij në Shqipëri, cdo lajm që ne dëgjonim kryesisht nga Kina dhe nga Italia (në atë kohë vendi më i prekur), dukej për ne si dicka e largët dhe e pabesueshme që edhe ne mund të ishim pjesë e tij në një moment të caktuar. Për një kohë shumë të shkurtër, virusi vendosi që të stacionohej edhe në Shqipëri, ku konkretisht u shfaq për herë të parë më 9 Mars 2020. Të gjendurit në një situatë të vështirë, ku nga njëra anë kishim pasojat që virusi kishte shkaktuar në vendet e tjera të prekura dhe nga ana tjetër, informacioni i pakët në lidhje me sjelljet e këtij virusi, Këshilli i Ministrave të Shqipërisë⁶⁶ deklaroi gjendjen e fatkeqësisë natyrore në të gjithë Republikën e Shqipërisë. Një gjendje e tillë solli një izolim total të qytetarëve, institucioneve publike, bizneseve dhe cdo njësie tjetër ekzistuese.

Qëllimi kryesor i qeverisë ishte padiskutim ruajtja e jetës së njerëzve duke u përpjekur që të shmangë përhapjen e virusit në një shkallë të gjërë që mund të ishte e papërbalueshme jo vetëm për qendrat shëndetësore por edhe për vetë shtetin si humbje qytetarësh. Objektivi i parë i qeverisë në këtë nismë, ishte sigurimi i burimeve të nevojshme për urgjencat mjekësore në mënyrë që në cdo kohë të ofrohej ndihma e parë e nevojshme për të prekurit me COVID-19. Ndërsa objektivi i parë mendohej të ishte jetik për jetën e njerëzve dhe mirëqënien e shoqërisë, nga ana tjetër, objektivi i saj i dytë ishte marrja e masave mbështetëse për të mbrojtur ekonominë nga një "kolaps" të pritur ekonomik.

Ekonomia u prek ndjeshëm. Pjesa më e madhe e sipërmarrjeve pezulluan aktivitetin, duke rrezikuar kështu jetëgjatësinë e tyre në treg. Për këtë arsye, gjatë këtij punimi do të kushtojmë një rëndësi të madhe trajtimit të sektorit privat, për të cilën do të bazohemi kryesisht në gjetjet kryesore të anketës nga Këshilli i Investimeve. Do të analizojmë ndikimin e COVID-19 në aktivitetin e bizneseve, ecurinë e aktivitetit të tyre, problematikat që kanë hasur gjatë kesaj periudhe, ndihmat e ofruara nga qeveria, risitë që COVID-19 solli në mënyrën e të bërit biznes, parashikimin kohor se kur mendojnë të rimëkëmben, sektorët më të prekur të ekonomisë si dhe disa parashikime drejt reformave vijuese që mund të marrë qeveria për rimëkëmbjen e sektorit privat dhe të ekonomisë në tërësi. Gjithashtu, një vëmendje e rëndësishme do të kushtohet edhe ndërhyrjeve konkrete sektoriale, me focus kryesor zgjerimin e zinxhirit të operacioneve në Shqipëri, për të përmbushur kërkesat ndërsektoriale, sidomos ato më të prekurat, sic mund të jetë turizmi.

Ndërhyrja qeveritare në ekonomi

Nisur nga ndikimi i situatës pandemike, për pothuajse 3 muaj, shumë sektorë jetikë të ekonomisë u paralizuan dhe pushuan së funksionuari. Shumë pak sektorë kanë punuar me kapacitet të plotë ose të pjesshëm dhe pjesa tjetër dërrmuese ka qënë e asfiskuar dhe pezulluar kundrejt cdo aktiviteti, duke ndikuar negativisht në shumë aspekte ekonomike. Sipas sondazhit të realizuar nga Këshilli i Investimeve⁶⁷, rreth 47% e bizneseve ndaluan plotësisht aktivitetin e tyre gjatë COVID-19, ndërsa pjesa tjetër për afro 53% e bizneseve kanë vazhduar aktivitetin me kapacitet të plotë ose të pjesshëm. Dëmi ekonomik i bizneseve konsiston në një natyrë të dyfishtë. Nga njëra anë kemi mosprodhimin e produkteve dhe shërbimeve për shkak të pezullimit të aktivitetit ose uljes së kërkesës dhe nga ana tjetër, janë kostot e rifillimit të aktivitetit të tyre nga hapja e ekonomisë përgjatë këtyre ditëve. Sektori më i prekur gjatë kesaj periudhe është sektori i shërbimeve duke përmendur :turizmin, transportin, dhe shërbime të tjera por në të njëjtën kohë është dhe sektori i prodhimit si psh industria fashione. Janë këto sektorë të cilat kanë dhënë ndikimet e tyre kryesisht në nivelin e punësimit dhe mbledhjen e të

⁶⁶<https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2020/03/VKM-nr.-243-date-24.3.2020.docx..pdf>

⁶⁷https://www.investment.com.al/wp-content/uploads/2020/06/AL_COVID-19-Survey-Findings_news-publication.pdf

ardhurave publike. Kriza ekonomike keto muaj u shoqerua me renien e kerkeses por edhe te ofertes per produkte te ndryshme.

Qeveritë e shteteve të prekura në të gjithë botën, pasi siguruan kushtet shëndetësore, u përqëndruan në ndihmën e të punësuarve, bizneseve dhe nevojave të menjëhershme për të mos lejuar që ekonomia të shembet. Me të njëjtën strategji, edhe qeveria shqiptare ndërmori nismat e para për tju gjendur afër të gjithë të punësuarve aktualë dhe atyre të larguar nga puna si pasojë e COVID-19 si dhe lehtësi të shumta përsa l përket njësivë të bizneseve. Në këtë mënyrë, plani i parë financiar i qeverisë shqiptare u komunikua me 19 Mars 2020 ku fokusi kryesor ishin bizneset e vogla dhe të mesme, ndërsa e dyta u komunikua me 13 Prill 2020, me një focus më të gjërë.

Dy planet e qeverisë konsistojnë në:

Ndihma financiare për të vetëpunësuarit dhe të punësuarit në subjektet e biznesit me të ardhura vjetore deri në 14 milionë lekë për periudhën pas ndërprerjes së aktivitetit ekonomik/marrëdhënieve të punës

Shtyrja e afatit të pagimit të kësteve të kredive deri më 31.05.2020

Masat mbështetëse për biznesin e vogël dhe të mesëm

Riskedulimi në 6 mujorin e dytë të vitit 2020 dhe në vazhdim, i pagesës së tatimit për të gjithë bizneset me të ardhura vjetore deri në 14 milionë lekë.

Shtyrja e dorëzimit të bilanceve për vitin 2019, deri më 31 korrik 2020 për bizneset që dorëzojnë bilancet në QKB online ose drejtëpërdrejtë.

Garanci sovraane për kompanitë që kanë vështirësi objektive për të paguar pagat e punonjësve Fshirja përgjithmonë e kamatvonesave për debitorët aktivë për faturat e energjisë

Të dy planet ekonomike të publikuara nga qeveria, l ka ardhur në ndihmë pjesës më të madhe të popullsisë (ata që plotësojnë kriteret për përfitim) duke menduar që ishte një ndihmë mbijetese për pjesën më vulnerabël të shoqërisë që do të kishin mungesë burimesh të të ardhurave. Nga ana tjetër, një pjesë e shoqërisë është penalizuar drejt marrjes së një ndihme të tillë kryesisht për shkak të punës së zezë të kryer prej tyre (informalitetit).

Ndikimi I COVID-19 në sipërmarrje

Izolimi gati për 3 muaj l bizneseve të sektorit privat nga COVID-19, patjeter që do të conte në një rënie ekonomike dhe vështirësi të shumta për të rimarrë veten. Se si do të jetë ecuria e ekonomisë në të ardhmen, këtë askush nuk e di të sigurtë. Por që pasojat e këtij virusi ndaj sektorit privat dhe ekonomisë në tërësi do të jenë negative, kjo mund të vihet re edhe në këto tre muaj që sapo kaluan. Rënia e kërkesës dhe ofertës për produkte dhe shërbime, rënia e prodhimit, disponibiliteti l fuqisë punëtore, mungesa e likuiditetit të biznesit etj ishin disa nga arsyet më kryesore që ndikuan në bllokimin e ekonomisë.

Mbështetur në studimin e realizuar në formën e një anketimi drejtuar bizneseve, nga Këshilli l Investimeve në Shqipëri, mund të nxjerrim disa nga përfundimet më kryesore analitike të ndikimit të COVID-19 në sektorin privat. Studimi synonte kryesisht të evidentonte disa nga efektet e mundshme që ka patur pandemia në aktivitetet e biznesit. Anketimit ju nënshtruan 833⁶⁸ biznese në të gjithë Shqipërinë, ku 55% prej tyre ishin biznese me xhiro vjetore mbi 14 milion leke, 15 % me xhiro nga 8-14 milion leke, 8% me xhiro nga 5- 8 milion leke, dhe 21% ishin me xhiro deri në 5 milion leke.

Bazuar në këtë studim, të gjithë sektorët e ekonomisë konsiderohen të prekur nga pandemia si: shërbimet, turizmi, industria, tregtia, bujqësia. Rreth 97% e bizneseve kanë deklaruar që aktiviteti l tyre është prekur negativisht, ndërkohënjë pjesë e bizneseve në sektorin e bujqësisë kanë deklaruar që ndikimi ka qënë më l vogël krahasuar me bizneset e tjera. Konkretisht, rreth 4.8% e bizneseve në sektorin bujqësor nuk është prekur dhe ka pritshmëri të mos preket në periudhën post-COVID-19. Mbrojtja e sektorit të bujqësisë nga pandemia ka ardhur si rezultat

⁶⁸https://www.investment.com.al/wp-content/uploads/2020/06/AL_COVID-19-Survey-Findings_news-publication.pdf

se 81% prej bizneseve në këtë sektor vazhduan aktivitetin e tyre ndonëse jo të gjithë me fuqinë e plotë punëtore, për të plotësuar kërkesat për produkte vendase.

Eksporti dhe importi, janë disa elementë të tjerë që ndikojnë në PBB dhe zhvillimin ekonomik të një vendi. Gjatë pandemisë, rreth 62% e eksportuesve deklarojnë që ndikuan dhe do të ndikohen ndjeshëm negativisht nga COVID-19. Rënia e kërkesës së konsumatorëve të huaj për produktet shqiptare, zvogëlimi i kapacitetit të fuqisë punëtore në vënd dhe kufizime të tjera si pasojë e pandemisë, ndikuan në rënien e nivelit të eksporteve të produkteve vendase. Nga ana tjetër, rreth 52% të bizneseve deklarojnë që kanë pasur problematika në lidhje me importet e produkteve kryesisht nga vendet e BE-së. Nisur nga ky problem, një pjesë e madhe e tyre po konsiderojnë faktin e vlerësimit të produktit vendas duke e zëvendësuar atë me produktin e importuar.

Nga të gjithë sektorët e ekonomisë, turizmi deklarohet të jetë më i prekuri duke pezulluar aktivitetin rreth 75% nga bizneset e anketuara. Sipas Strategjisë Kombëtare të Turizmit⁶⁹, sektori i turizmit jep një kontribut prej 8.9% në Prodhimin e Përgjithshëm Kombëtar, dhe vlerësohet si një nga shtyllat më kryesore që mban në këmbë ekonominë. Me cenimin e këtij sektori nga pandemia, vlerësohet dhe arsyeja se pse parashikohet një recession ekonomik pas COVID-19, ku sipas FMN-së mendohet të jetë nga -5%⁷⁰ deri në -9%.

Përsa i përket qarkullimit vjetor, pothuajse të gjitha bizneset (rreth 80% e tyre) pavarësisht sektorit që i përkasin apo madhësisë që ata kanë, presin të kenë një rënie të xhiros së tyre vjetore prej afro -20%. Pritshmëritë e tyre lidhen kryesisht me sfidat që po hasin aktualisht dhe që presin të vijojnë dhe në vazhdimësi.

Disa nga sfidat më kryesore që po përballen aktualisht bizneset dhe parashikojnë të përballen edhe në vazhdimësi janë: rënia ose mungesa e klientëve (kryesisht sektori i turizmit), mungesa e likuiditetit, vështirësitë në pagesat e pagave të fuqisë punëtore, vështirësitë në përmbushjen e detyrimeve tatimore, rritja e kostove, vështirësi në organizimin e punës, mungesa e lëndës së parë, rënia e prodhimit, pasiguria ligjore, konkurrenca e pandershme, etj. Mungesa e klientëve dhe ajo e likuiditetit, ishin dy nga sfidat më problematike që u përballën pothuajse të gjitha bizneset. Ngelet për tu theksuar që bizneset në sektorin e turizmit deklaruan se sfida më e madhe e tyre kundrejt sfidave të tjera ishte mungesa e klientëve që vinte si pasojë e mbylljes së linjave ajrore dhe kufijve tokësore dhe ujqor. Vështirësitë në përmbushjen e detyrimeve tatimore ishin më të pranishme në bizneset e vogla, ndërsa bizneset e mëdha kishin vështirësi në pagesën e pagave dhe për këtë arsye shumë prej tyre i janë drejtuar dhe kredive bankare.

Për përballimin e këtyre sfidave, vendimmarrja tek bizneset ka qënë e ndryshme në varësi me sfidën specifike që po kalonin, madhësisë së tyre, sektorit që i përkasin, sigurisë që ata kishin në treg etj. Bazuar në sondazh, rreth 34% të bizneseve janë detyruar të përdorin të ardhurat e mëparshme të akumuluar si mënyrë zgjidhjeje për vazhdimësinë e aktivitetit. Ndërkohë rreth 32% të tjerë më mungesë likuiditeti dhe dëshirë për vazhdimësinë e aktivitetit, janë detyruar të ulin kostot në cdo lloj mënyrë, si psh. shkurtimi i vendeve të punës, ulja e prodhimit, marrja e huase bankare etj.

Kohëzgjatja e rimëkëmbjes së sipërmarrjes

Ndikimi i COVID-19 në 3 muajt e izolimit ka qënë shumë i ndjeshëm për të gjitha bizneset në sektorin ekonomik. Por për sa kohë mendohet që është e nevojshme që këto biznese të rimarrin veten dhe në të njëjtën kohë me të ardhurat e tyre të rimëkëmbin dhe ekonominë?


Në varësi të madhësisë që bizneset kanë dhe sektorit ku i përkasin, patjetër që edhe periudha kohore vlerësohet të jetë e ndryshme. Pjesa më e madhe e tyre rreth 40% e mendojnë që koha e rikuperimit mund të jetë për rreth 1 vit, ku në këtë pjesë futen bizneset në fushën e ndërtimit, tregtisë, turizmit, shërbimeve dhe të industrisë. Nga ana tjetër sic vihet re edhe në grafik, bizneset

⁶⁹<http://www.mjedisi.gov.al/wp-content/uploads/2019/06/Strategjia-Komb%C3%ABtare-e-Turizmit-2019-2023.pdf>

⁷⁰<https://www.imf.org/en/Countries/ALB>

që pretendojnë që periudha e tyre e rikuperimit mund të jetë deri në 6 muaj janë në fushën e bujqësisë, rreth 28% prej tyre.


Kohëzgjatja e ndikimit të COVID19



Burimi: Gjetjet kryesore të Anketës "COVID-19 mbi bizneset", Këshilli i Investimeve, Qershor 2020

Kjo mund të shikohet edhe më qartë në grafikun e mëposhtëm, të specifikuar sipas sektorëve ekonomikë:

Kohëzgjatja e ndikimit të COVID19 sipas sektorëve të ekonomisë



Burimi: Gjetjet kryesore të Anketës "COVID-19 mbi bizneset", Këshilli i Investimeve, Qershor 2020

Parashikimi i një kohëzgjatjeje të tillë për rimëkëmbjen e sektorëve të ekonomisë, bëhet duke menduar që ky virus do të zhduket ose popullata do të krijojë imunitet ndaj tij. Në momentin që në shoqëri do të rritet siguria për jetën dhe niveli i punësimit, patjetër që këto do të sjellin një rritje të kërkesës për produkte dhe shërbime, dhe rrjedhimisht do përshpejtojë cilin e biznesit dhe ekonominë në terësi.

Rritja e ndërgjegjësimit të sipërmarrjeve për rëndësinë teknologjike

Kushtet e izolimit nga COVID-19, i sollën shoqërisë tendenca të reja ndërveprimi me të tretët, në mënyrë që të përballojnë vetëm përhapjen e virusit por edhe për të qënë të dobishëm në aktivitetet e rëndësishme si: në mësim, në vendet e punës, argëtim, blerje dhe shitje produktesh etj. Pjesa më e madhe e bizneseve të cilat vazhduan aktivitetin e tyre gjatë pandemisë, përdorën shërbimet online. Patjetër që akoma ngelet për tu diskutuar mbi mënyrën e ofrimit të produktit online përsa kohë për pjesën më të madhe të produkteve, pagesa realizohet cash në dore në

momentin e marrjes së produktit. Por gjithsesi, është shumë e rëndësishme për tu theksuar ndërgjegjësimi i biznesve për investimin e këtij lloji shërbimi për shkak të efektivitetit të tyre. Kryesisht shërbimet e reja online të zbatuara nga biznese të ndryshme në ofrim të konsumatorëve, dhe efikasiteti i tyre në plotësimin e kërkesave të konsumatorëve, bëri që bizneset të inkurajohen në rritjen e investimeve në fushën e teknologjisë. Tashmë konsumatorët por edhe investitorët do të prirën të investojnë më shumë drejt teknologjive dhe shërbimeve online, për ta kthyer si një asset të vyer dhe të kohës për rimëkëmbjen e tyre. Një pjesë e konsiderueshme e bizneseve rreth 38%, pohuan që do të investonin akoma më shumë në drejtimin e shërbimeve online.

Pritshmëritë janë që të gjitha ato biznese të cilat janë të afta që ta përdorin teknologjinë gjatë aktivitetit të tyre, për shndërrimin e biznesit në kushtet e reja "online", patjetër që do të jenë më konkurrueset në treg. Sesa të mundur do ta kenë bizneset adaptimin e dixhitalizimit të aktiviteteve të tyre, kjo varet kryesisht nga nadhësia e biznesit, vjetërsia e tij, vendndodhja e tij, një strategji për modifikimin e modelit të biznesit por edhe kapitali në dispozicion për të investuar në këtë fushë.

Gjatë pandemisë, dixhitalizimi nuk ishte një zgjedhje por ishte një mundësi për mbijetesë dhe për të përfituar një avantazh konkurrues kundrejt të tjerëve në treg. Rritja e konkurrencës në lidhje me shërbimet online si dhe përfaqimi i shpejtë i konsumatorëve me këtë lloj shërbimi, bëri që gjatë kohës së pandemisë dhe tani, bizneset të vetedijeshen mbi rëndësinë e përdorimit të teknologjisë si një asset për aktivitetin e tyre. Tashmë, ata janë të orientuar drejt teknologjive të reja, forcimit të kanaleve të shitjes, menaxhimit të riskut dhe mirëmbajtjes së klientëve.

Konkluzionet:

COVID-19 ka ndikuar negativisht në të gjithë ekonominë në terësi, por kryesisht turizmin. Gjatë pandemisë, pjesa më e madhe e bizneseve pezulluan aktivitetin e tyre ose punuan me kapacitet të pjesshëm, si rasti i sektorit bujqësor por dhe të tjerë. Pavarësisht madhësisë apo sektorit ku bëjnë pjesë, pothuajse të gjitha bizneset deklarojnë pritshmëritë e tyre të uleta deri në -20% për xhirot vjetore.

Paketat e ofruara të qeverisë, për mbështetjen e bizneseve në këtë gjendje pandemike, duket që vërtet kanë qënë të duhurat dhe të pazëvendësueshmet për situatën pandemike, ndonëse jo të mjaftueshme. Të gjitha bizneset me xhiro vjetore mbi 14 milion leke kanë deklaruar që shtyrja e pagesave të huasë të ofruar nga paketat e qeverisë ka qënë vërtet mbështetje për ta. Gjithashtu bizneset me xhiro vjetore deri në 14 milion leke, theksuan ndikimin pozitiv që kishte mbështetja financiare për punonjësit, pasi ata në kushtet e mungesës së likuiditetit, nuk do ja dilnin dot të mbështesnin fuqinë e tyre punëtore. Problematike është situata e atyre bizneseve që nuk u kategorizuan përfituese në asnjërën nga paketat e ofruara nga qeveria.

COVID-19 vërtetoi që bizneset në Shqipëri janë të papërgatitura për tu përballur me situata të paparashikuara. Pjesa më e madhe e tyre nuk kanë një plan të parapërgatitur emergjence për të bërë ballë cdo lloj situatë të vështirë që mund tju kanoset, kryesisht duke planifikuar edhe ndonjë capital rezerve për përballimin e vështirësive që mund tju hasen.

Rënia e importeve kryesisht për lëndën e parë, mund të jetë një nga sfidat më kryesore të hasur nga bizneset kryesisht në sektorin e industrisë. Por, ana positive mund të jetë orientimi i tyre drejt vlerësimit të produkteve vendase duke e zëvendësuar atë me produktin e importuar., duke ndikuar kështu jo vetëm në promovimin e tij por edhe në rritjen e Produktit Kombëtar.

Pezullimi i turizmit këto 3 muaj, ka ndikuar relativisht shumë në mirëqënien e sektorit të shërbimeve, dhe në të njëjtën kohë rihapja e tij në Qershor, lë shumë pyetje dhe diskutime për rimëkëmbjen e tij. Gjithashtu, recesioni do të vijë si rezultat i rënies së kërkesës së brendshme dhe të jashtme gjatë krizës COVID-19, dhe varësia e ekonomisë nga turizmi bën që ky recession të jetë në vlera shumë të larta rreth -5% deri në 9%, të vlerësuar nga FMN-ja

COVID-19 rriti ndërgjegjësimin për efikasitetin e shërbimeve online. Tanimë dixhitalizimi do të jetë një nga asetet më kryesore që do të diferencojë bizneset nga njëri tjetri, si posedues të avantazhit konkurrues.

Ngelet për tu parë se cilat do të jenë reformat vijuese të ndërmarra nga qeveria për zbutjen e efektit të pasuar nga COVID-19 tek bizneset. Patjeter që synimi i qeverisë është që nëpërmjet paketave të saj të asistojë sadopak në rimëkëmbjen e bizneseve dhe jetëgjatësinë e tyre në treg, dhe në mënyrë direkte të ndihmojë rimëkëmbjen e ekonomisë në terësi. Aktualisht po flitet për ndërtimin e Planit Kombëtar Shqipëria 2030⁷¹, në të cilin vëmëndja kryesore do të jenë qytetarët dhe bizneset. Deri tani deklarohet që të gjitha bizneset e vogla (deri në 14 milion leke xhiro vjetore) do të taten me 0% tatim fitimi deri në vitin 2029. Gjithashtu diskutohet që kjo mund të shoqërohet edhe me heqjen e tatimit të vlerës së shtuar. Heqja e taksave mund të ndikojë në rritjen e likuiditetit të bizneseve dhe kapacitetit të tyre. Ka shumë pikë të tjera që diskutohen nga bizneset që mund të përfshihen në këtë plan kombëtar që do t'ju lehtësonte aktivitetin e tyre, sic mund të jenë: Shtyrja e pagesave të kësteve të kredisë për ato biznese që kanë vështirësi likuiditeti aktuale por mund ti shlyejnë në periudhën e ardhshme; rritja e granteve qeveritare për subvencionimin e bujqësisë dhe turizmit, Ulja e taksës së dividendëve, Rishikimi i tarifave doganore, Heqja e akcizës për produktet vendase, sigurimi i testimeve mjekësore për punonjësit, kredi pa interes etj.

COVID-19 ishte një armik i fuqishëm i ekonomisë në cdo sektor dhe rimëkëmbja e saj mund të jetë pak e vështirë dhe e ngadalshme. Por të ndodhur në këtë situatë, qeveria, bizneset dhe qytetarët, të gjithë bashkë, duhet të bëjnë të mundur që të promovojnë vendin e tyre dhe të shtojnë vlerë cdo gjëje që ajo zotëron. Në këtë mënyrë, ndërveprimi i të gjithë aktorëve të mësipërm do bëjë të mundur lehtësimin dhe shpejtësinë e arritjes së rimëkëmbjes ekonomike.

Referencat:

- VENDIM Nr.243, datë 24.3.2020 PËR SHPALLJEN E GJENDJES SË FATKEQËSISË NATYRORE
- (<https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2020/03/VKM-nr.-243-date-24.3.2020.docx..pdf>)
- Gjetjet kryesore të Anketës "COVID-19 mbi bizneset" Përgatitur nga Sekretariati i Këshillit të Investimeve, Qershor 2020
- (https://www.investment.com.al/wp-content/uploads/2020/06/AL_COVID-19-Survey-Findings_news-publication.pdf)
- VENDIM Nr.254, datë 27.3.2020 PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE, TË DOKUMENTACIONIT DHE TË MASËS SË PËRFITIMIT TË NDIHMËS FINANCIARE PËR TË PUNËSUARIT NË SUBJEKTET E BIZNESIT ME TË ARDHURA VJETORE DERI 14 MILIONË LEKË, NDIHMËS EKONOMIKE E TË PAGESËS TË SË ARDHURËS NGA PAPUNËSIA GJATË PERIUdhËS SË FATKEQËSISË NATYRORE VENDIM Nr.305, datë 16.4.2020 PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE, TË DOKUMENTACIONIT DHE TË MASËS SË PËRFITIMIT TË NDIHMËS FINANCIARE PËR TË PUNËSUARIT AKTUALË DHE PUNONJËSIT E LARGUAR NGA PUNA SI PASOJË E COVID-19
- (<http://www.ikm.org.al/wp-content/uploads/2020/04/vendim-2020-04-16-305.pdf>)
- STRATEGJIA KOMBËTARE PËR ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM TË TURIZMIT 2019 – 2023
- (<http://www.mjedisi.gov.al/wp-content/uploads/2019/06/Strategjia-Komb%C3%ABtare-e-Turizmit-2019-2023.pdf>)
- International Monetary Fund, Albania

⁷¹<https://www.kryeministria.al/newsroom/zero-tatim-fitimi-per-biznesin-e-vogel-deri-ne-2029/>

- (<https://www.imf.org/en/Countries/ALB>)
- Perspektiva e Ballkanit Perëndimor: Kohët e Vështira Kërkojnë Ekonomizim të Mirë
- (<http://pubdocs.worldbank.org/en/876501588143423927/RER-17-Outlook-ALB.pdf>)
- Fighting COVID-19. Europe and Central Asia Economic Update. Spring 2020
- (<https://openknowledge.worldbank.org/bitstream/handle/10986/33476/9781464815645.pdf?sequence=5>)
- Suksesi i rimëkëmbjes varet nga të gjithë Ne- Bujar Leskaj
- (http://www.klsh.org.al/web/gazeta_panorama_10_prill_2020_bujar_leskaj_5529.pdf)
- Henri Kissinger, "Koronavirusi do të ndryshojë përgjithmonë rendin botëror", editorial, The Wall Street Journal, 6 prill 2020.
- (www.wsj.com/articles/the-coronavirus-pandemic-will-foreveralter-the-world-order-11585953005)
- <https://www.kryeministria.al/newsroom/zero-tatim-fitimi-per-biznesin-e-vogel-deri-ne-2029/>

KRIZA E KORONAVIRUSIT POLITIKAT MONETARE DHE SEKTORI BANKAR NË SHQIPËRI

Msc Elia Botka,
Universitetit Mesdhetar i Shqipërisë
Email: elia.botka@umsh.edu.al

Abstrakt

Ky punim kërkon të shqyrtojë impaktin e krizës globale të paprecedentë të koronavirusit në ekonominë shqiptare dhe politikat monetare të ndërmarra der më tani me synim zbutjen e impaktit të krizës. Për këtë qëllim, analiza shtrihet përgjithësisht në një interval kohor njëvjeçar, një interval i mjaftueshmë për të evidentur ndryshimet në treguesit ekonomik ku reflektohen domosdoshmërisht edhe efektet e tërmetit të 26 Nëntorit dhe në përgjithësi brishtësia e rritjes ekonomike. Duke u nisur nga GDP-ja, bëhet një analizë e rritjes ekonomike në vënd në fund të 2019 e kërkesës agregate dhe e vlerësimit të stabilitetit financiar deri në fund të vitit 2019. Nëpërmjet një situatë krahasuese midis vëndeve të Ballkanit Perëndimor evidentohet shëndeti i ekonomisë shqiptare lidhur me tregun e punës, treguesit fiskalë, sektorin financiar dhe sektorin me jashtë. Tregu i punës me informalitetin por dhe me numrin e lartë të vetpunsuarve evidentohet si pika më kritike ndërsa sektori financiar me kapitalin dhe likuiditetin e lartë si pjesa më solide e sistemit. Në mënyrë më të hollësishme shqyrtohen politikat monetare të ndërmarra nga ana e Bankës së Shqipërisë, agregatët monetarë, paraja jashtë bankave dhe roli i bankës së Shqipërisë në financimin e qeverisë, oferta dhe kërkesa e kredisë në këtë periudhë duke konkluduar se deri më tani politikat monetare kanë qënë minimale - duke pasur parasysh normën bazë të interesit që ishte mjaft e ulët edhe përpara krizës - dhe me një efekt relativisht të dobët në ekonomi pa arritur të kontrastojnë tendencën drej recensionit në të cilin ka hyrë tashmë ekonomia shqiptare.

Fjalë kyçe: kriza e koronavirusit, politikat monetare, oferta e kredisë, kërkesa e kredisë, sistemi bankar.

Abstract

This paper examine the impact of the global Covid-19 crisis on the Albanian economy and the monetary policies undertaken so far with the aim of mitigating the impact of the crisis. To this end, the analysis extends to a temporary one-year interval, an interval sufficient to identify changes in economic indicators. On the basis of GDP, an analysis of economic growth and aggregate demand up to 2019 is carried out. Through a comparative situation between the countries of the Western Balkans, the health of the economy investigated through the labor market, fiscal indicators, the financial sector and the foreign sector is highlighted.

The informality of the labor market and the high percentage of self-employed workers is highlighted as the most critical point while the well-capitalized and sufficiently liquid financial sector is highlighted as the most solid part of the system. Monetary policies adopted by the Bank of Albania were then considered, policies centered mainly on the interest rate maneuver and the credit conditions of banks concluding that monetary policies have so far been minimal - given the basic interest rate which was quite low even before the crisis - and with a relatively weak effect on the economy without being able to contrast the trend towards the recession in which the Albanian economy has already entered.

Keywords: coronavirus crisis, monetary policy, credit supply, credit demand, banking system.

1.Hyrje

Pasojat e pandemisë së koronavirusit u ndjenë menjëherë në ekonominë botërore dhe atë shqiptare duke qënë se izolimi i detyruar i individeve coi në mbylljen e shumë aktiviteteve

ekonomike prodhuese , të shërbimeve e të tregëtisë. Duke ju referuar Bankes Botërore dhe FMN-së, GDP-ja reale që në fund të vitit 2019 u vlerësua me një rritje prej 2,2% parashikohet në zbritje në -5% në fund të 2020-ës. E gjitha kjo në hipotezën e një zgjatjeje “normale” të krizës shëndetsore. Sipas parashikimeve të Bankës së Shqipërisë rritje ekonomike parashikohet të zbritet me 6,7% si pasojë e një parashikimi rënieje të kërkesës agregate me 10% Normë e rritjes negative të GDP-së gjithësesi vlerësohet më pak negative sesa ajo e krizës e '97 ku rritja e GDP-së reale arriti vlerën -10,9% apo ajo akoma më e rënda e fillimviteve '90 . Në këtë krizë, ekonomia pësoi fillimisht një goditje nga ana e ofertës, dmth një ulje e ofertës si rrjedhojë e mbylljes së disa sektorëve të rëndësishëm të ekonomisë në radhë të parë transporti, turizmi, kategori të shërbimeve etj.

Goditja nga ana e ofertës domosdoshmërisht reflektohet në të ardhurat e realizuara dhe për pasojë e kërkesës agregate, ku të ardhurat e individëve dhe kompanive përbëjnë një faktor të rëndësishëm. Shpejt pasoi dhe një goditje e dytë dhe ndoshta më e madhe nga ana e kërkesës. Goditja nga ana e ofertës domosdoshmërisht reflektohet në të ardhurat e realizuara dhe për pasojë e kërkesës agregate, ku të ardhurat e individëve dhe kompanive përbëjnë një faktor të rëndësishëm. Ulja e kërkesës nga ana e vet vjen dhe nga tendenca e të kursyerit më shumë dhënë kjo situatë krize dhe pasigurie e paprecedentë. Pasojë e kesaj goditje të ekonomisë është natyrisht papunësia. Siç parashikon Banka Botërore kjo mund të sjelli një ndikim zinxhir edhe tek produktiviteti i ipunës duke qënë se papunësia do të prekë edhe punonjësit e kualifikuar. Se sa do të zgjasë kriza, kjo do të jetë përcaktuese e rëndësishme e pasojave ekonomike e sociale në vend.

Qeveria shqiptare ka reaguar me dy paketa të njëpasnjëshme ekonomike të cilat nuk kapin as vlerën 2% të GDP-së. E pra është cilësuar si një paketë sociale që ka pasur në fokus shtresa më të prekura nga kriza dhe e dyta është cilësuar si social ekonomike pasi përveç një ndihme të dytë për të papunët dhe shtresave sociale më të prekura ka ofruar edhe një ndihme marzhinale ndaj bizneseve. Ndihmë që përkoj më së shumti në ofrimin e një garancie shtetërore në mbështetje të kreditimit të bizneseve apo me shtyrjen e afateve të shlyerjes së kësteve të kredisë dhe të pagesave të tatim-fitimit. Deri tani, të shumta janë lajmet që i referohen fenomenit të mos aplikimit në mjaft raste nga ana e bizneseve për të përfituar nga kushtet më të favorshme të kredidhënies dhe në këtë kontekst ne do të shikojmë arsyet.

Gjithashtu me rëndësi ka qënë ndihma e menjëhershme financiare e FMN – së në prill të këtij viti e cila u aprovua nga parlamenti mbas në muajin Maj. Financimi kap vlerën prej 174 milion Euro.

2. Ekonomia në shifra

Ekonomia reale para krizës së koronavirusit shfaqet e përkeqësuar. Në tabelën e mëposhtme pasqyrohen sektorët e ekonomisë sonë dhe rritja ekonomike e tyre në dy vitet e fundit. Vëmë re se vlera e shtuar bruto në vitin 2019 është më pak se gjysma e saj të një viti më parë ku përveç efekteve të tërmetit të 26 Nëntorit vihet re edhe rënia e ndjeshme e industrisë nxjerrëse, dhe e aktiviteteve shkencore profesionale dhe teknike dhe akoma më tepër e kategorisë argëtim. Ndërsa kategoria e shërbimeve të mbrojtjes, arsimit, sigurimit social, dhe shëndetësisë nuk na jep mundësi që të bëjmë interpretim në funksion të kontekstit të krizës së mëvonshme të koronavirusit. Gjithësesi shpenzimet për këtë kategori janë mjaft të ulëta pasi nuk bëjnë pjesë në prioritetet e zhvillimit në shqipëri. Shpenzimet qeveritare në shëndetësi për frymë psh., janë më të ultat në vendet e Ballaknit Perëndimor.

Tabela1 PRODUKTI I BRENDSHEM BRUTO SIPAS METODËS SË PRODHIMIT NORMA E RITJES REALE OSE VLERA E SHTUAR PER SEKTOR

Sektoret	2018	2019
<i>Bujqësia, pyjet dhe peshkimi</i>	1,18	1,35

<i>Industria nxjerrëse</i>	15,73	2,72
<i>Ndertim</i>	2,49	-3,72
<i>Tregetia, riparimet, transporti dhe magazinimi, Akomodimi dhe sherbimi ushqimor</i>	4,41	4,06
<i>Informacioni dhe komunikacioni</i>	-4,51	3,41
<i>Aktivitetet financiare dhe te sigurimit</i>	2,93	11,12
<i>Aktivite te pasurive te paluajtshme</i>	-0,06	6,73
<i>Aktivite shekncore , profesionale dhe teknike dhe te sherbimeve administrative</i>	6,62	2,89
<i>Aktivite te sherbimeve administrative</i>		
<i>Administrata publike, mbrojtja, sigurimi social, arsim, shëndetsia</i>	1,56	3,22
<i>Argetim</i>	4,88	-15,96
<i>Vlera e shtuar bruto</i>	4,11	2,01
<i>Taksat neto mbi produktet</i>	3,81	3,62
<i>Prodhimi i brendshem bruto</i>	4,07	2,21

Burimi: Instat

Tabela 2 PRODHIMI I BRËNDSHËM BRUTO SIPAS METODËS SË SHPENZIMEVE

	Metoda e Shpenzimeve	2018	2019** Rritja
1	Konsumi Final (a+b+c)	1.475.119	3,30
a	Konsumi Final i Popullatës	1.277.421	3,30
b	Konsumi Final i Administratës Publike	184.731	3,11
i	Konsumi Individual	84.181	2,88
ii	Konsumi Kolektiv	100.550	3,38
c	Konsumi i Institucioneve Jo-fitimprurëse	12.967	
2	Formimi Bruto i Kapitalit Fiks	390.720	-4,06
3	Kërkesa e brendshme (1+2)	1.865.839	1,76
4	Eksporti neto^ (a-b)	(223.647)	
a	Eksportet e mallrave e shërbimeve (fob)	516.748	6,05
i	Eksportet e mallrave	125.677	-8,28
ii	Eksportet e shërbimeve	391.071	10,67
b	Importet e mallrave e shërbimeve (fob)	740.395	2,72
i	Importet e mallrave	490.911	1,65
ii	Importet e shërbimeve	249.483	4,82
5	Ndryshimet e gjendjeve	3.505	
6	Mospërputhje statistikore	(9.982)	
	PRODHIMI I BRËNDSHËM BRUTO (3+4+5)	1.635.715	2,40

Burimi: Instat

Në tabelën 2 jepet prodhimi i brendshëm bruto sipas Metodës së Shpenzimeve. Nga kjo tabelë mund të vërehet peshën e secilit komponent të kërkesës agregate zë në PBB. Sic vihet re, kërkesa agregate është e dominuar nga kërkesa për konsum, ndërsa kërkesa për investime është e papërfillshme. Eksportet neto janë me vlerë negative por tregojnë edhe peshën që ka në ekonominë tonë sektori i turizmit. Eksportet e shërbimeve tejkalojnë nivelin e investimeve në vitin 2018 dhe në vitin 2019 ky sektor ka normën më të madhe të rritjes ekonomike 10,67% e ekonomisë sonë. Me metodën e shpenzimeve rritje ekonomike në 2019 ka vlerën 2,40% sipas përlllogaritjeve tona.

Stabiliteti financiar gjatë viti 2019

Stabiliteti financiar këqyret duke marrë në konsideratë stabilitetin e tregjeve financiare, procesin e kreditimit, performancën e sistemit bankar dhe ekspozimin e tij ndaj rreziqeve.

Tregjeve financiare në vend. Siç evidenton Banka e Shqipërisë, gjatë periudhës u evidentua rritje e normave të interesit në tregun parësor të titujve të qeverisë, si për emetimet afatshkurtra ashtu edhe për ato afatgjata. Vëllimi i transaksioneve në tregun sekondar shënoi rënie dhe u përqendrua kryesisht në emetimet afatshkurtra, duke reflektuar preferencën e investitorëve për zotërimin e titujve të borxhit deri në maturim. Rënie e vëllimit të transaksioneve ditore dhe javore u vu re edhe në tregun ndërbankar, por normat e interesit mbetën pranë nivelit të normës bazë të interesit të përcaktuar nga Banka e Shqipërisë. Kursi i këmbimit të lekut tregoi luhatshmëri të ulët gjatë periudhës. Në tregun e pasurive të paluajtshme, treguesit e marrë nga vrojtimit tregojnë për rritje të çmimit, në kushtet e rritjes së kërkesës dhe të ofertës. Gjatë periudhës, funksionimi i sistemeve të pagesave ka qenë optimal, duke njohur rritje të vëllimit dhe numrit të pagesave të procesuara.

Financimi i bizneseve dhe individëve. Si individët ashtu edhe bizneset rritën financimin e tyre nga sektori bankar gjatë periudhës, por kjo rritje ishte më e shpejtë tek bizneset. Edhe depozitat e të dy sektorëve në banka njohën rritje, por zgjerimi i depozitave të individëve ishte rreth 6 herë më i lartë se ai i bizneseve. Rritja e depozitave të individëve, e cila ishte kryesisht në valutë, reflektoi edhe rënien e investimeve të tyre në tituj. Sipas vrojtimit që kryen rregullisht Banka e Shqipërisë, pesha e familjeve që kanë një borxh për të paguar është relativisht e ulët (24%), dhe ngarkesa e borxhit vlerësohet e përbalueshme. Për periudhën e ardhshme, familjet shpehen më të gatshme për të rritur nivelin e huamarrjes. Edhe për ndërmarrjet, ngarkesa me borxh vlerësohet e përshtatshme, në kushtet kur vlera e borxhit zë gjysmën e vlerës së kapitalit për 78% të ndërmarrjeve, dhe gati 67% e tyre deklarojnë se pagesa e borxhit nuk kalon 20% të të ardhurave të veprimtarisë. Megjithatë, barra e pagesës së borxhit shfaqet më e lartë tek ndërmarrjet e vogla. Edhe tek ndërmarrjet është vënë re një gatishmëri më e madhe për të rritur nivelet e huamarrjes në periudhën e ardhshme.

Performancën në përmirësim të sistemit financiar. Gjatë periudhës, aktiviteti i sistemit financiar u zgjerua me gati 2.6 pikë përqindje. Në këtë rritje, kontributin kryesor e dha zgjerimi i veprimtarisë së sektorit bankar, me gati 4% gjatë periudhës. Kontribut pozitiv në këtë ecuri dha aktiviteti i kreditimit, por më kryesori ishte aktiviteti i investimeve në tituj. Kredia shënoi rritje gjatë periudhës dhe për vitin 2019 ajo u zgjerua me 4.8%. Kontributin kryesor në këtë rritje e dhanë kredia për bizneset, në monedhën vëndase dhe me maturim afatgjatë. Edhe depozitat u rritën me 5.4% gjatë vitit, por kontributin kryesor kontributin kryesor e dhanë individët, gjatë kësaj periudhe patën rritje depozitat pa afat dhe ato në valutë. Kjo tregon edhe rritjen me të ndjeshme të agregatëve M1 dhe M3. Sektori bankar e mbylli vitin me fitim më të lartë se një vit më parë, me një normë kthimi mbi aktivet dhe mbi kapitalin, përkatësisht në nivelet 1.4% dhe 13.5% sic rrezulton nga dokumentat kontabël. Vitine ardhshme edhe mbikëqyrja bankare do t'i referohet parimeve kontabël IFRS, ku rezultatet e perfitueshmërisë që rezultojnë janë ndjeshëm më të ulta, të paktën për sa i përket ROE-s. Rezultati financiar u ndikua nga rritja e fitimit nga instrumenteve financiare, ndërsa të ardhurat neto nga interes ato që përbëjnë të ardhurat

karakteristike për bankat, pësuan rënie me 4.8%. Si rezultat, marzhi neto nga interesat ka zbritur në 3.4% në fund të periudhës, nga 3.7% një vit më parë. raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit megjithëse në rënie nga viti kap vlerën 18.3% vlerësohet i mirë.

Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rreziqeve. Gjatë periudhës, cilësia e portofolit të kredisë është përmirësuar megjithëse ende raporti i kredive jo performuese ka një nivel të lartë. Ai kap vlerën 8.4% të totalit të kredisë. Rezultati i arritur erdhi si pasojë e masave efektive të ristrukturimit të kredive dhe fshirjeve të kredive të humbura dhe shlyerjeve të tyre. Përmirësimi në cilësinë e kredisë vjen kryesisht nga kredia për biznese, kredisë në valutë dhe kredisë me afate më të gjata maturimi. Gjendja e likuiditetit të sektorit bankar është e pëlqyeshme dhe ka paraqitur pak ndryshime gjatë vitit 2019. Tek rreziqet e tregut, sektori bankar është i ndjeshëm ndaj rrezikut të kursit të këmbimit përmes segmentit të kredisë së pambrojtur në valutë. Ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit mbetet i pranishëm, por është relativisht i kufizuar.

Një krahasim midis vendeve të Ballkanit perëndimor.

Banka Botërore bën një krahasim midis vendeve të Ballkanit perëndimor dhe për pordor disa tregues të rëndësishëm si tregu i punës, politikën fiskale, sektori financiar dhe rreziqet e jashtëm. Në tabelën e mëposhtme secilit prej treguesve u shprehet vlera për të gjithë vendet në fjalë me qëllim krahasimin e tyre. Është për t'u theksur se vlerat e treguesve vlerësohen për impaktin që mund të kenë në krizën e koronavirusit. Kështu për shëmbull meqënëse sektori i turizmit ka një ndikim të madh në GDP –në e vendit, impakti i mbylljes së këtij sektori do të ketë simetrikisht një impakt negativ në ekonomi⁷². Dy treguesit që ndikojnë më së shumti në këtë krizë vijnë nga tregu i punës dhe janë përqindja e lartë të të punësuarve informal dhe numri i të vetpunësuarve.

Vëmë re që në rajon treguesit marrin vlerësimin më negativ ku niveli i punësimit informal në Shqipëri kap vlerën 61. Vende si Kosova dhe Maqedonia e Veriut nuk e disponojnë këtë të dhënë. Për sa i përket treguesve fiskalë, është borxhi publik treguesi më negativ për Shqipërinë që kap vlerën 68% të GDP-së krahasimish më i mirë se ai i Malit të Zi që kap vlerën 80%. Megjithëse Shqipëria është imëgnur të uli gradualisht borxhimin publik deri në kufirin prej 45% të GDP-së në rast të një krize të jashtëzakonshme, sic është kriza aktuale është e mundshme madje e këshillueshme që kjo krizë të përballohet duke rritur borxhin publik. Performancën më të mirë në Shqipëri e ka Sektori Financiar me treguesit e mjaftueshmërisë së kapitalit dhe të likuiditetit. Ndërsa kreditë me probleme me gjithë rënie që kanë pasur në vite falë politikave efektive që janë ndjekur mbeten akoma me vlerën më të lartë krahasimisht me vendet e tjera. Në sektori e jashtëm treguesit më problematik janë ato të lidhur me turizmin të cilët regojnë varësinë e madhe që kanë eksportet e shërbimeve nga turizmi, dërsa të ardhurat nga remitancat vlerësohen si jo influente.

	Treguesit	Albania	BIH	Kosova	Mali i Zi	Maqedonia e Veriut	Serbia
Tregu i punës	Të vetpunësuar (% e totalit të të punësuarve)	34,7	17,6	21,3	19,4	14,3	22,4
	Të punësuar të përkohshëm (% e të punësuarve)	9,7	17,5	79,5	34,6	16,1	22,6
	Të punësuar informalë (% e të punësuarve)	61	29,5		19,9		19,8

⁷²Me ngjyrën blu në tabelë jepen treguesit që kanë impaktin më negativ në ekonomi ndërsa me vishnje jepen treguesit që kanë impaktin më të mirë në ekonomi. Gradacionet e tjera shprehin situatë të ndërmjetme positive dhe negative. Me ngjyrë të verdhe janë shprehur vlerat neutrale.

	Norma punësimit (mosha +15)	52	34,3	25,4	48,1	44,9	48,6
--	-----------------------------	----	------	------	------	------	------

Politika fiskale	Ekulibri fiskal (%GDP)	-2,5	-0,5	-2,5	-3	-2,1	-0,2
	Të ardhurat fiscale (%GDP)	27,8	42,6	26,7	43,6	31,2	42,1
	Borxhi publik (%GDP)	68	34,6	17,6	80,7	48,9	52,9

Sektori Financiar	Mjaftueshmërisë së kapitalit	18,3	18,1	15,9	17,7	16,3	23,4
	Likuiditetit (aktive likuide ndaj aktiveve totale)	35,7	29,6	28,9	20,8	24	36
	Kredia jo performuese (% ndaj kredisë totale)	8,4	7,4	2	5,1	4,6	4,1

Rezerve të jashtëm	Llogaria korrente (% GDP)	-7,6	-3,7	-5,5	-15,2	-2,8	-6,9
	Eksporti i të mirave (%GDP)	6,8	29	5,6	9,5	47	35,8
	Eksporti i shërbimeve	23,9	10,8	23,2	34,6	14,7	14
	Turizmi ndërkombëtar (% e eksportit)	48,2	12,7		50,8	5,1	7,7
	Eksporti i turizmit (% e eksportit të shërbimeve)	60,7	44,8	82,5	85,5	20,9	33,5
	Të ardhurat nga Remitancat	5,2	8,4	12	4	1,7	5,8
	Rezervat (në muaj importi)	6,4	7,8	2,3	6,3	3,8	5,7

Burimi: Banka Botërore, tabelë e përshtatur

Oferta Monetare. Agregatët Monetare

Agregatet monetare apo Oferta monetare matet si shumë e depozitave bankare (D) dhe e parasë jashtë bankave (C). Banka e Shqipërisë mat tre agregatë monetarë. Agregati M1 ose paraja e ngushtë përfshin Parane jashtë korporatave depozituse (bankave) dhe llogaritë rrjedhëse dhe depozitat paafat në monedhë vëndase të rezidentëve me përjashtim të vetë bankave dhe me përjashtim depozitat e qeverisë qëndrore.

Agregati M2 - treguesi i parasë në monedhë vëndase - që llogaritet si shumë e agregatit M1 plus depozitat me afat të të njëjtave kategori. Agregati M3 që quhet paraja e gjërë që llogaritet si shumë e Agregatit M2 plus depozitat në valutë me afat dhe paafat për të njëjtat kategori. Grafiku i mëposhtëm Paraqet të tre agregatët monetarë gjatë një viti. (31Maj 2019 – 30 Prill 2020)

Vlerat e agregatëve janë vlera absolute. Siç vihet re nga grafiku në të cilin janë evidentuar edhe tendencat për çdo agregat, Agregati M3 ka tendencën rritëse më të madhe po pavaresisht nga tendenca në dy muaj e fundit ka pësuar rënie. Agregatet M1 dhe M2 kanë edhe ato tendencë rritëse po në dy muaj e fundit rritja e tyre është më e theksuar. Gjithësesë është shepejt për të folur për një tendencë të re të agregatëve monetarë. Depozitat me afat maturimi mbi dy vjet nuk përfshihen në agregatët monetarë M1,M2,M3. Në përqindje. Agregati M3 shënoi një rritje vjetore me 4.4% gjatë tremujorit të parë Agregati M2 shënoi një rritje mesatare vjetor prej 3,9% ndërsa Agregati M1 shënoi një përshejtim të normës së rritjes me 9,4% në tremujorin e parë sipas llogaritjeve të Bankës së Shqipërisë.

Rritja e kërkesa për mjete likuide, agregati M1, vjen si pasojë e rritjes së depozitave të përfshira në këtë agregat por dhe të parasë jashtë bankave. Kjo e fundit çon në rritje të gjithë agregatët monetarë. Krijimi i parasë në ekonomi është nxitur nga financimi kryesisht në monedhë vendase, i sektorit privat *por edhe i atij publik*, sipas raportimit të BSH-së, por huatë ndaj qeverisë nuk janë të raportuara tek statistikat e BSH-së. Kjo e fundit ka mbështetur zgjerimin e treguesit të parasë në lekë, agregatit M2, i cili shënoi rritje mesatare vjetore prej 3.9%. Gjithashtu struktura monetare pasqyron zhvendosjen e pjesëshme drejt depozitave me afat maturimi mbi dy vjet sipas BSH (por të cilat nuk përfshihen në llogaritjen e agregatëve monetarë), dhe rritjen e peshës së depozitave pa afat dhe llogarive rrjedhëse. Kështu, agregati M1, shënoi përshejtim të normave të rritjes në mesatarisht 9.4% në tremujorin e parë. Ecuria e këtij treguesi është ndikuar më së shumti nga shtimi i parasë jashtë bankave të cilat paraqiten grafikisht më poshtë, sidomos kjo në muajin mars. Rritja e kërkesës për mjete monetare likuide është në linjë me rritjen e konsumit afatshkurtër në sitatën aktuale.

Depozitave në sistemin bankar u zgjerua me mesatarisht 3.9% gjatë tremujorit të parë të vitit. Rritja e depozitave në lekë, është mesatarisht 5.4% në tremujorin e parë dhe bëhet fjalë kryesisht për depozita të individëve. Depozitat në valutë kanë shënuar një rritje më të ulët ndaj atyre në lek me 3.1%. ndërsa individët kanë rritur depozitat e tyre, bizneset i kanë tkurrur ato. Kjo ecuri vjen nga ulja e depozitave të bizneseve, të cilat, i kanë përdorur këto për financimin e aktivitetit si pasojë e situatës së krijuar nga Covid-19. Gjithashtu janë ulur depozitat e individëve në valutë, në të dy muajt shkurt dhe mars. Strukturakohore e depozitave ka vijuar të zhvendoset drejt përbërësit likuid, ku raportidepozita pa afat ndaj depozitave totale i afrohet vlerës 50%. Ndërsa kjo tendencë është e justifikueshme në situatën e krizës, nga ana tjetër ajo mund të coje në nevojë për aktive likuide nga ana e bankave. Depozitat me afatmaturimi mbi dy vjet ato që janë jashtë agregatëve kanë shënuar rritje, në fund të tremujorit, ato përbëjnë rreth 13.4% të stokut total sipas BSH-së,

Në grafikun e mëposhtëm tregojmë tendencën gjatë një viti të parasë jashtë bankave dhe bazës monetare diferenca e të cilave tregon edhe tendencë e rezervave të sistemit bankar. Paraja jashtë bankave ka pasur një rritje më të theksuar në muajin prill dhe kjo ka sjellë një ngushtim të rezervave.

Politikat monetare, stabiliteti financiar dhe stabiliteti i çmimeve

Në raportimin e fundit të politikës monetare Banka e Shqipërisë deklaroi që ka marrë masa të caktuara për arritjen e objektivave të rritjes së vëllimit të kredisë, garantimit të likuiditetit të nevojshëm të sistemit bankar dhe për të mbështetur stabilitetin financiar në të gjithë treguesit e tij. Stabiliteti financiar nga ana e tij në vetvete kërkon stabilitet të treguesve makroekonomi brënda dhe jashtë vëndit, stabilitetin e tregjeve financiare, kushte më të përshtshme të financimit për bizneset dhe individët, performancë të pëlqyer të sektorit bankar, ekspozim të ulët të sektorit bankar ndaj rreziqeve etj. Duhet pasur parasysh se objekti primar i Bankës së Shqipërisë është ruajtja e stabilitet të çmimeve, dhe kufiri maksimal i normës së inflacionit të cilës i referohet banka e Shqipërisë është tek 3%. Nje kufi ky që i lë hapësirë institucionit të kryej

politika në favor të stabilitetit financiar. Në Fakt, FMN dhe Banka Botërore bëjnë një parashikim të rritjes së normës së infalcionit nga 1,4 në 2019 në 2,4 në fund të 2020.

Masat e marra nga BSH konkretizohen në kuadër të politikës monetare:

- a. Këshilli Mbikëqyrës, vendosi uljen e normës bazë të interesit me 0.50 pikë përqindjeje, në nivelin 0.5%. Në këtë mënyrë, bankat mund të marrin hua nga Banka e Shqipërisë me një kosto më të ulët dhe mund ta reflektojnë këtë kosto më të ulët në likuiditetin që përcjellin në ekonomi. Ky është niveli më i ulët historik i normës bazë të interesit të politikës monetare;
- b. ngushtimin e diferencës mes normës së interesit të kredisë njëditore dhe të depozitës njëditore, duke ulur normën e interesit të kredisë njëditore në nivelin 0.9%. Përsëri, në këtë mënyrë, bankat që mund të kenë nevoja likuiditeti afatshkurtra, mund t'i përmbushin këto nevoja me instrumentin e posaçëm të Bankës së Shqipërisë.
- c. ndryshimin e formës së ankandit javor të injektimit të likuiditetit, për të mundësuar dhënien e likuiditetit të bankave në mënyrë të pakufizuar dhe me normën bazë të interesit.

2. Stabiliteti financiar dhe mbikëqyrja bankare

Në kuadër të veprimeve në sferën e mbikëqyrjes dhe të stabilitetit financiar, Banka e Shqipërisë është fokusuar në nevojën për të ndihmuar huamarrësit në lehtësimin e përkohshëm të detyrimeve të tyre ndaj bankave dhe subjekteve të tjera kredidhënëse, në rastet kur huamarrësit ndeshen me vështirësi në kryerjen e veprimtarisë për shkak të masave për kufizimin e përhapjes së pandemisë. Në vijim, Banka e Shqipërisë pret që bankat dhe institucionet e tjera të kreditit të ndjekin një qasje proaktive, përmes së cilës, në konsultim me huamarrësit, të përdorin forma të tjera të njohura veçanërisht nga përvoja e viteve të fundit, për të ulur probabilitetin e dështimit të huamarrësit. Gjithashtu është e nevojshme të vlerësohet dhe të mbështetet nevoja e agjentëve realë të ekonomisë për financim të ri, gjatë dhe në vijim të pandemisë.

Ndonëse pandemia do të jetë e përkohshme, mbetet e panjohur se kur dhe me ç'ritëm do të dalë ekonomia nga efektet e saj. Sipas BSH, të gjitha veprimet që janë ndërmarra dhe do të ndërmerren, do të orientohen gjithmonë nga objektivi kryesor, ai i *ruajtjes së qëndrueshmërisë së sektorit bankar*. Në këtë proces, kapacitetet e sektorit bankar do të vlerësohen në mënyrë të vazhdueshme.

Këto të dhëna vijnë nga raportimi i fundit i Bankës së Shqipërisë lidhur me politikën monetare që i referohet periudhës deri më 24 Prill. Këto janë masat specifike të ndërmarra të cilat ndahen në dy kategori kryesore. Ulja e normës së interesit që si faktor i vetëm duhet të cojë në rritjen e kreditimit dhe injektimin e likuiditetit në sektorin bankar nëpërmjet ankandëve. Në periudhën në fjalë injektimi i likuiditetit nuk vjen si nevojë e ndërhyrjes së Bankës së Shqipërisë për të ulur impaktin e krizës së koronavirusit. Por pas kësaj periudhe ka patur ankande të vazhdueshme të ndërmarra për këtë qëllim. Informacioni i plotë mbi to do të vijë në raportimin pasardhës të politikës monetare.

Vrojtimi i bankës së shqipërisë: Kreditimi

Si pas vrojtimit të kryer nga Banka e Shqipërisë mbi tendencat e kreditimit në vënd në tremujorin e parë të viti rezulton që standartet e kreditimit janë shtrënguar. Më i ndjeshëm ky shtrëngim është për bizneset e vogla e të mesme dhe për ato me qëllime investimi. Parashikimi për tremujorin e dytë të vitit jep një situatë shtrëngime të mëtejshme që përkon me vazhdimin e situatës së jashtëzakonshme të koronavirusit. Kjo situatë perceptohet nga bizneset me rrezik të shtuar i cili lidhet më konkretisht me:

- Aftësinë paguese të klientit;
- Prespektivën e situatës ekonomike
- Kolateralin

Por ka patur edhe faktorë të lehtësues të standarteve të kreditimit të lidhura me ndryshimet positive të sektorit bankar ku numri i bankave që operojnë tashmë është më i ulët. Situata e shëndoshë bankare e lidhur me treguesit e mjaftueshmërisë së kapitalit dhe likuiditetit të bankave, u raportuan si faktorë me ndikim lehtësues në standardet e kreditimit. Ndersa politika monetare ka reaguar duke ulur normën e interesit nga 1%, vlerë në vetevete mjaft e ulët në 0,5%, kushtet e tjera të kreditimit raportohen më të shtrënguara dhe kanë të bëjnë me reduktimin e vlerës së kredisë, uljen e maturitetit dhe kushtëzime të tjera.

Edhe kërkesa për kredi rezulton në rënie jo vetem për biznesin e mesëm dhe të vogël. Kërkesa më e ulët ishte për dy kategoritë: për investime por edhe për të mbuluar nevojën për likuiditet. Për tremujorin e dytë është parashikuar përkeqsim i mëtejshëm. Faktorët që kanë ndikuar në rënien e kërkesës për kredi janë:

Prespektiva e ekonomike jo e favorshme
Besimi tek biznesi

Faktorët që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen e kredisë së biznesit janë ulja e kostos së kredisë por edhe mungesa e burimeve alternative të financimit nga institucionet financiare jobankare. Shtrëngimi i tyre u arrit nëpërmjet marzheve më të larta të aplikuara mbi kreditë normale, reduktimit të madhësisë së kredisë dhe shtimit të komisioneve.

Një situatë analoge kemi dhe për kredinë ndaj individëve. Kushtet e kreditimit u shtrenguan qoftë për kredinë konsumatore qoftë për kredinë për pasuri të patundshme. Edhe nga ana e kërkesës për kredi situata paraqitet e njëjte me një rënie kërkesë si në pasuri të patundshme dhe për konsum. Në opinionin e bankave të gjithë faktorët ndikuan në këtë kah edhe rënia e besimit konsumator.

Konkluzione

Kriza ekonomike e koronavirusit ka patur dhe pritet të ketë efekte mjaft negative në ekonominë Shqiptare. Kjo edhe pasi kjo krizë vjen edhe pas goditjes nga tërmeti i 26 Nëntorit. Informaliteti i lartë i ekonomisë është një nga faktorët pse kjo krizë do të ndihet më shumë në Shqipëri në krahasim me vendet tjera të Ballkanit perëndimor. Financat publike kanë pësuar goditje qoftë nga ana e të ardhurave në buxhet qoftë nga ana shpenzimeve që qeveria shqiptare ka kryer në mbështje të krizës ekonomike. Në sektorin me jashtë, varësia që kanë eksportet nga turizmi është mjaft e lartë. Sektori financiar paraqitet me tregues të mirë kapitalizimi dhe likuiditeti por norma e ulët e interesit që ekzistonte përpara krizës e bën pak të ndjeshme manovren e uljes së mëtejshme të normës së interesit. Në këtë mënyrë efektet e politikës monetare nuk mund të kenë ndonjë impakt të madh në ekonomi. Sic vumë re, efekti i manovrës është më shumë se i kompensuar nga shtrëngimi i kredisë nga faktorë e tjerë. Një tjetër tregues negativ është involi i lartë i euroizimit të ekonomisë i cili reflektohet te kursi i këmbimit. Banka e Shqipërisë e konsideron të lartë rrezikun nga kursi i këmbimit në ekonominë bankare. Oferta dhe kërkesa e kredisë kanë pësuar rënie ku rënia prek më shumë instrumentat financiarë afatgjatë, kredinë për investime biznesin e mesëm dhe të vogël, prek kredinë konsumatore dhe atë në pasuri të patundshme.

Biznesit janë duke e përballuar krizën aktuale duke përdorur kursimet e tyre dhe pa përfituar mjaftueshëm nga paketat qeveritare për lehtësimin e kredisë.

E gjitha kjo do të reflektohet në kërkesën agregate duke prekur komponentët e saj sidomos konsumin duke qenë se pesha që ka konsumi në kërkesën agregate është mbi 70%. Do të reflektohet padyshim edhe në prodhimin kombëtar.

Si konkluzion, mund të themi që ndërhyrja në ekonomi me një plan rimëkëmbje duhet akoma të vi dhe se politikat fiskale dhe ato monetare dhe paketat qeveritare kanë një impakt deri diku të ndjeshëm në lehtësimin e krizës por papërfillshëm në kapërcimin e saj.

1. Banka e Shqipërisë.

Raporti i politikës monetare

Raporti i stabilitetit financiar

Vrojtım i aktivitetit kreditues

2. instat.gov.al Instat

3. Banka Botërore. Worldbank.org The economic e social impact of Covid 19

4. FMN. Imf.org